RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI
"AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË"

BASHKIA SELENICË

Tiranë 2023

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 4

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit 6

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve 7

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit 18

II. HYRJA 21

1. Objektivat e auditimit 21

2. Qëllimi i auditimit 21

3. Identifikimi i çështjes 22

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 22

5. Përgjegjësitë e audituesve 22

6. Kriteret e vlerësimit 22

7. Standardet e auditimit 23

8. Metodologjia e auditimit 23

9. Dokumentimi i auditimit 25

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT 25

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin - Bashkia Selenicë 25

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit 26

2.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm. 26

2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor për vitin 2021. 40

2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2021. 64

2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve. 86

2.4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike. 127

2.5 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme 139

2.6 Çështje të lëna për trajtim referuar Vendimit nr. 177, datë 20.10.2021 të Kryetarit të KLSH-së, mbi administrimin e aseteve të Bashkisë Selenicë. 164

2.6.1 Mbi administrimin e aseteve të Bashkisë Selenicë 164

2.6.2 Prerjet rigjeneruese dhe shfrytëzimi i lëndës drusore në fondin pyjor 175

2.6.3 Shfrytëzimi për veprimtari ekonomike i fondit pyjor 181

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME 202

V. ANEKSET 236

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve kreu auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me objektiv vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Selenicë, për aktivitetin ekonomik dhe financiar, prokurimet publike, investimet publike dhe administrimin e aseteve për periudhën nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar të KLSH-së, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive kryesore nga Bashkia Selenicë si planifikimi, hartimi dhe realizimi i zërave të shpenzimeve buxhetore, realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, auditim me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore, mbajtjen e evidencës kontabël, zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e procedurave të prokurimit publik, zbatimi i kontratave të punimeve në investimet publike, administrimi i aseteve, shfrytëzimi për veprimtari ekonomike i fondit pyjor etj.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi rezultoi se:

- Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka zhvilluar auditimin e prokurimeve me vlera të larta dhe të vogla, proces i cili është parashikuar në Planin Vjetor të vitit 2021, si pjesë e një prej fushave të auditimit të Drejtorisë së Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore.
- Nuk janë ndjekur të gjitha hapat e duhura në hartimin e PBA-së 2021-2023 si, nuk janë ngritur Ekipet e Menaxhimit të Programeve, nuk është miratuar Udhëzim i Brendshëm për përgatitjen e PBA-së, Projekt dokumenti i PBA-së 2021-2023 është miratuar jashtë afateve, nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore etj.
- Niveli i realizmit të treguesve të buxhetit për vitin 2021 është në masën 86%. Mos realizimi ka ardhur si rezultat i vonesave në zhvillimin e procedurave të prokurime, në lidhje kontratash apo në mosplotësim të organikës.
- Gjendje e detyrimeve të prapambetura në Bashkinë Selenicë në fund të vitit 2021 është në vlerën **77,195,390 lekë** nga të cilat **54,527,216 lekë detyrime nga buxheti i bashkisë** dhe 22,668,174 lekë detyrime nga buxheti i shtetit.
- Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" paraqitet më datë 31.12.2020, në vlerën 136,714,244 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2021, paraqitet në vlerën 142,398,480 lekë me një rritje në vlerë 5,684,236 lekë. Nga krahasimi i të dhënave të vlerës së debitorëve për taksa dhe tarifat vendore të paraqitur në bilanc, në listën e debitorëve të administruar nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në datën 31.12.2021, konstatohet se vlera e pasqyruar në bilanc nuk është e saktë. Në bilanc detyrimet për taksat dhe tarifat vendore janë në vlerën 212,403,902 lekë ndërkohë që vlera reale e këtyre detyrimeve është në vlerën 362,011,099 lekë me një diferencë paraqitje më pak në bilanc prej 191,868,902 lekë.
- Nga auditimi i llogarisë 202 "Studime dhe kërkime" konstatohet se, vlera prej 8,641,700 lekë e kësaj llogarie përbëhet nga 12 projekte, të cilat nuk duhet të regjistroheshin në këtë llogari pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar.
- Bashkia Selenicë nuk ka marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 "Toka, troje, terrene". Në këtë llogari pasqyrohen aktivet e ish-Bashkisë Selenicë të cilat janë zbërthyer në mënyrë analitike por jo ato të ish-komunave. Nuk disponohet një bilanc i saktë se cilat nga këto prona janë të regjistruara në ASHK dhe cilat janë të pa regjistruara.

- Llogaria 211 “Pyje, plantacione” paraqitet me vlerën 0 lekë, ndërkohë në pasqyrat financiare të vitit 2021, nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe e kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Selenicë me VKM nr. 433, datë 08.06.2016.
- Në procedurat e prokurimit me objekt: “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara”, “Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë”, “Rikonstruksion rruge të brendshme me beton”, “Rikonstruksion i ujësjellësit Vodicë”, “Sistemim Asfaltim rruga tubo (rruga varreza, spital)”, “Sistemim Asfaltim rruga Kropisht”, “Rehabilitim ura Brataj”, “Riparimi i shkarkuesit të rezervuarit të Harvalasë, Zgjerimi i rrugës Resulaj – Romës dhe punime gërmimi dhe riparimi në rrugën Bashaj - Vërmik”, “Rehabilitim i kanalit ujitës Hasomat Velçë dhe punime për rrjetin e kanalizimeve qendër Kotë”, zhvilluar në vitin 2021, janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik.
- Në 4 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik.
- Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave ka lidhur kontrata për përdorimin e sipërfaqeve kullosore pa patur të hartuar dhe miratuar planet e mbarështimit.
- Lidhur me aktivitetin e kryer nga Bashkia Selenicë në fondin pyjor me objekt “Prerjet rigjeneruese dhe shfrytëzimin e lëndës drusore në fondin pyjor” konstatohen parregullsi në të gjitha hapat e zhvillimit të këtij procesi.
- Vlera e detyrimeve nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton në **6,251,627 lekë për 244 objekte të legalizuara**.
- Gjatë vitit 2021 borxhi i krijuar është në shumën **32,070,957 lekë** dhe përbëhet nga detyrimet nga taksat dhe tarifat për personat fizikë/juridikë, detyrimet nga taksat dhe tarifat vendore për familjet dhe detyrimet nga taksa e tokës bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifa e vaditjes.
- Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore në mënyrë progresive më datë 31.12.2021 në Bashkisë Selenicë janë në vlerën **362,065,059 lekë** të përbëra nga:

- Detyrime për taksën e ndërtesës për 6343 familje në vlerën **4,110,003 lekë;**
- Detyrime për taksën e tokës bujqësore për 7516 familje në vlerën **255,577,812 lekë;**
- Detyrime nga biznesi i vogël për 470 subjekte në vlerën **38,882,100 lekë;**
- Detyrime nga biznesi i madh për 15 subjekte në vlerën **37,930,263 lekë;**
- Detyrime për taksat familjare (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim) për 7640 familje në vlerën **25,510,831 lekë;**
- Detyrime nga tarifa e vaditjes në vlerën **54,050 lekë.**

- Në Bashkinë Selenicë për vitin 2021 janë 3 subjekte që kanë ushtruar aktivitet të pa pajisur me autorizimin e nevojshëm për tregtimin e lëndëve djegëse me pakicë.
- Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Selenicë gjatë vitit 2021 ka konstatuar 10 raste të shkeljes së legjislacionin në fushën e mbrojtjes së territorit dhe për asnjë nga 10 shkeljet e konstatuara nuk është marrë vendim prishje apo masa e dënimit me gjobë.
- Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratave rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **2,828,092 lekë pa TVSH.**

- Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike në fondin pyjor në territorin e Bashkisë Selenicë u konstatuan parregullsi si vijon:

1. Bashkia Selenicë nuk ka informacion lidhur me llojin e pasurisë ku ushtrojnë veprimtari minerare subjektet e pajisura me leje nga AKBN.
2. Bashkia Selenicë nuk ka dokumentacion lidhur me statusin e pronës ku ushtrojnë aktivitet subjektet e pajisura me leje minerare.
3. Bashkia Selenicë nuk ka informacion për të gjitha subjektet e pajisura me leje lidhur me sipërfaqen e karrierës që kanë në shfrytëzim.
4. Bashkia Selenicë nuk ka lidhur kontratë qiraje me subjektet që ushtrojnë veprimtari minerare sipas tarifave *minimale* ligjore për zbatimin e kontratave të shfrytëzimit/kërkim-zbulimit.
5. Bashkia Selenicë nuk ka përpiluar raporte studimi tekniko-ekonomike për të gjitha subjektet me qëllim për të dokumentuar çdo ndryshim që mund të ketë pësuar sipërfaqja e fondit pyjor/kullosor apo in produktiv, asete në pronësi publike e marrë në përdorim me qira nga subjektet sipas lejeve minerare.
6. Në Bashkinë Selenicë asnjë nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e minierave nuk ka të miratuar me VKM apo ligj të veçantë heqjen nga fondi pyjor/ndryshimi i zërit kadastral i sipërfaqeve të miratuara referuar lejeve të AKBN-së.
7. Nga auditimi rezultoi se në Bashkinë Selenicë janë 4 subjekte që kanë aktive 6 leje minerare referuar të dhënave të marra nga AKBN të cilët edhe pse ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë nuk janë të pajisur me NIPT sekondar, si rezultat nuk ngarkohen për pagesën e detyrimeve vendore sikurse janë taksa e pastrimit / gjelbërimit / truallit / ndërtesës/ ndikimit në mjedis / mbrojtje, përmirësim mjedisi.
8. Nga auditimi i raporteve tekniko-ekonomike për vlerësimin e sipërfaqeve që do të hiqen nga fondi pyjor është konstatuar që në tre raste nuk është vlerësuar saktë bimësia/lënda drusore e ndodhur në sipërfaqen që është vlerësuar.
9. Subjektet me objekt veprimtarinë minerare në Bashkinë Selenicë, nuk kanë zbatuar parimet e veprimtarisë minerare që rregullon marrëdhëniet midis subjektit dhe titullarit të pronësisë (Bashkisë Selenicë).
Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Selenicë, KLSH ka dhënë "*Opinion të modifikuar*" për pasqyrat financiare dhe "*Opinion të kundërt*" për përputhshmërinë.
Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse të klasifikuara në rekomandime organizative, rekomandime për arkëtimin e të ardhurave të munguara, uljen e borxhit tatimor, rekomandime për shpërblim dëmi dhe rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi mbuloi çështjet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë Selenicë si: menaxhimi financiar dhe kontrolli, auditi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, të ardhurat, vlerësimi i pasqyrave financiare, planifikimi dhe zhvillimi i procedurave të prokurimit publik, zbatimi i kontratave të punimeve në investimet publike, administrimi i aseteve, shfrytëzimi për veprimtari ekonomike i fondit pyjor si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm. Për analizimin dhe vlerësimin e aktivitetit të subjektit sipas pikave të planifikuara në programin e auditimit, grupi i auditimit vlerësoi sistemet e kontrollit të brendshëm dhe analizoi të gjitha evidencat e grumbulluara gjatë kryerjes së auditimit në terren sipas çështjeve përkatëse.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit ka mbajtur dhe protokolluar në Bashkinë Selenicë 24 akt konstatime dhe 1 akt verifikim. Mbi akt konstatimet dhe akt verifikimet e mbajtura nga grupi i auditimit si dhe mbi Projekt Raportin e Auditimit janë paraqitur

observacione nga Bashkia Selenicë të cilat janë trajtuar në përputhjeve me përcaktimet e Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH-së. Gjithashtu, në ambientet e KLSH-së më datë 13.01.2023 me përfaqësuesit e Bashkisë Selenicë u zhvillua edhe takimi ballaqafues për disa nga çështjet e trajtuara në raportin përfundimtar të auditimit.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjeve	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2021 rezulton si vijon: **1.** Niveli i realizmit të treguesve të buxhetit për vitin 2021 është në masën 86%. Mos realizimi ka ardhur si rezultat i vonesave në zhvillimin e procedurave të prokurime, në lidhje kontratash apo në mosplotësim të organikës. Peshën specifike me të madhe të shpenzimeve në buxhet ndaj totalit, e zënë shpenzimet për investime 40.4% ndjekur nga shpenzimet për paga 35.4%, dhe shpenzimet operative 16.6%. **2.** Bashkia Selenicë ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në vlera relativisht të konsiderueshme, përkatësisht në fund të vitit 2020 detyrimet janë në vlerën **98,988,441** lekë, dhe në fund të vitit 2021 janë në vlerën **77,195,390 lekë** nga të cilat **54,527,216 lekë detyrime nga buxheti i bashkisë** dhe 22,668,174 lekë detyrime nga buxheti i shtetit. Nga analiza e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021 janë të pa likuiduara gjithsej 106 raste me vlerë **77,195,390** lekë. Këto detyrime janë të krijuara që nga vitet 2010 e në vijim si dhe disa prej tyre të trashëguara nga ish-komunat. Vlera e kontratave të lidhura për vitin 2021 është 72,823,574 lekë. Nga këto kontrata është likuiduar vlera 57,422,044 lekë dhe ka mbetur pa u likuiduar vlera prej 19,401,530 lekë. Vlera e kontratave të pa likuiduara deri në fund të vitit 2021 duke përshirë dhe kontratat e lidhura para vitit 2021 është 64,839,887 lekë. Vlera e detyrimeve të prapambetura në Bashkinë Selenicë më 31.12.2021 është **13.61%** të shpenzimeve vjetore të miratuara. **3.** Bashkia Selenicë për vitin 2021 ka hartuar dhe dërguar në MFE vetëm një raport monitorimi. Ky raport paraqet vetëm realizimin e shpenzimeve për 8 mujorin e parë të vitit 2021. Raportet e monitorimit nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", pasi nuk është plotësuar asnjë nga anekset përkatëse. Nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezulton që raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit të jenë paraqitur në Këshill sipas përcaktimeve të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48. Kryetari i Bashkisë Selenicë nuk ka miratuar rregullat	E lartë	Drejtoria e Shërbimeve Financiare në bashkëpunim me Ekipet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara. Planifikimi të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim efiçient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Shërbimeve Financiare të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave. Të monitorohet me kujdes zbatimi i buxhetit si dhe të hartohen raportet periodike të monitorimit duke plotësuar të gjitha anekset përkatëse, të cilat më pas të paraqiten në Këshillin Bashkiak si dhe të dërgohen në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

	specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. *(faqe 40-65 të RPA)*		
2	Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" paraqitet më datë 31.12.2020, në vlerën 136,714,244 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2021, paraqitet në vlerën 142,398,480 lekë me një rritje në vlerë 5,684,236 lekë. Nga krahasimi i të dhënave të vlerës së debitorëve për taksa dhe tarifat vendore të paraqitur në bilanc, në listën e debitorëve të administruar nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në datën 31.12.2021, konstatohet se vlera e pasqyruar në bilanc nuk është e saktë. Në bilanc detyrimet për taksat dhe tarifat vendore janë në vlerën 212,403,902 lekë ndërkohë që vlera reale e këtyre detyrimeve është në vlerën 362,011,099 lekë me një diferencë paraqitje më pak në bilanc prej 191,868,902 lekë. *(faqe 65-87 të RPA)*	E lartë	Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të sistemojë llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm", duke pasqyruar në të vlerën reale të debitorëve për taksat dhe tarifat vendore të kategorisë privat dhe familjar.
3	Nga auditimi i llogarisë 202 "Studime dhe kërkime" konstatohet se vlera prej 8,641,700 lekë e kësaj llogarie përbëhet nga 12 projekte, të cilat nuk duhet të regjistroheshin në këtë llogari pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e secilit investim për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë. *(faqe 65-87 të RPA)*	E lartë	Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 "Studime e kërkime", duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 8,641,700 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.
4	**1.** Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 "Toka, troje, terrene", për koston historike në vlerën 140,307,952 lekë, Bashkia Selenicë nuk posedon titull pronësie, për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur. **2.** Gjithashtu, Bashkia Selenicë nuk ka marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 "Toka, troje, terrene". Në këtë llogari pasqyrohen aktivet e ish-Bashkisë Selenicë të cilat janë zbërthyer në mënyrë analitike, por jo ato të ish-komunave. Nuk disponohet një bilanc i saktë se cilat nga këto prona janë të regjistruara në ASHK dhe cilat janë të pa regjistruara. **3.** Llogaria 211 "Pyje, plantacione" paraqitet me vlerën 0 lekë, ndërkohë në pasqyrat financiare të vitit 2021, nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe e kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Selenicë me VKM nr. 433, datë 08.06.2016. **4.** Nga auditimi i llogarisë 210 "Troje, toka, terrene" konstatohet se gjendja më datë 31.12.2020, ka qenë 140,307,952 lekë për të cilën është përllogaritur amortizim në vlerën 58,000 lekë dhe çelja më datë 01.01.2021, ka qenë në vlerën 140,249,952 lekë. *(faqe 65-87 të RPA)*	E lartë	**1.** Bashkia Selenicë të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 "Toka, troje, Terrene" dhe llogarisë 211 "Pyje, Kullota Plantacione", duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK. **2.** Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore në pasqyrat e vitit 2022 të bëjë sistemimin e vlerës 58,000 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të normës së amortizimit për llogarinë 210 "Toka, troje, terrene" si dhe për këto llogari mos të aplikohet normë amortizimi referuar parashikimeve në dispozitat ligjore përkatëse.
5	Nga auditimi i llogarisë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore", konstatohet se në vitin 2016 janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 526,501,279 lekë në Ujësjellës Selenicë Sh.A, por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Selenicë kjo situatë e konstatuar edhe në auditimet e mëparshme të zhvilluara nga KLSH por e pa sistemuar, pra nuk janë marrë masa për hartimin e dokumentacionit të dorëzimit dhe	E lartë	Nga Bashkia Selenicë të hartohen procesverbalet e transferimit dhe të marrjes në dorëzim të aktiveve nga Bashkia në Shoqërinë Ujësjellës Selenicë për vlerën kontabël 526,501,279 lekë. Të bëhet pasqyrimi në kontabilitet i efekteve të transferimit.

	marrjes së aktiveve midis Bashkisë Selenicë dhe Ujësjellësit Sh.A. Nuk janë hartuar procesverbale dorëzimi për aktivet transferuara nga dy institucionet. *(faqe 65-87 të RPA)*		
6	Bashkia Selenicë nuk disponon një regjistër aktivesh i cili hartohet në vartësi të llojit të aktiveve afatgjata apo afatshkurtra si dhe grupit përkatës brenda llojit. Gjithashtu ky regjistër duhet të përmbajë kërkesat minimale konkretisht, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datë e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. *(faqe 65-87 të RPA)*	E lartë	Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrin masa për hartimin e regjistrit të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre.
7	Llogaria 466 "Kreditorë për mjetet në ruajtje" në pasqyrat financiare është në vlerën 21,403,554 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se janë ngurtësuar fonde në vlerën 18,071,576 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e para, të cilave u ka kaluar afati i garancisë. Bashkia Selenicë nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për kalimin e këtyre fondeve. *(faqe 65-87 të RPA)*	E lartë	Kryetari i Bashkisë Selenicë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontrator për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.
8	Nga auditimi u konstatua se në procedurat e prokurimit me objekt: "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara", "Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë", "Rikonstruksion rruge të brendshme me beton", "Rikonstruksion i ujësjellësit Vodicë", "Sistemim Asfaltim rruga tubo (rruga varreza, spital)", "Sistemim Asfaltim rruga Kropisht", "Rehabilitim ura Brataj", "Riparimi i shkarkuesit të rezervuarit të Harvalasë, Zgjerimi i rrugës Resulaj – Romës dhe punime gërmimi dhe riparimi në rrugën Bashaj - Vërmik", "Rehabilitim i kanalit ujitës Hasomat Velçë dhe punime për rrjetin e kanalizimeve qendër Kotë", zhvilluar në vitin 2021, janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik. *(faqe 87-129 të RPA)*	E lartë	Kryetari i Bashkisë Selenicë të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kritere të veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e kontratës.
9	Nga auditimi rezultoi se në 4 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht si vijon: **1-**Në procedurën e prokurimit me objekt "Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë", me vlerë të fondit limit 6,651,036 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është shpallur fitues OE "I." SHPK, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DST, por është kualifikuar dhe shpallur fitues. **2-** Në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksion rruge të brendshme me beton", Bashkia Selenicë, me vlerë të fondit limit 12,000,347 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021", është shpallur fitues operatori ekonomik "A." ShPK,	E lartë	Titullari i AK të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

	me vlerë të ofertës ekonomike 14,388,000 lekë me TVSh , i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT. **3-** Në procedurën e prokurimit me objekt "Sistemim Asfaltim rruga Kropisht", Bashkia Selenicë, me vlerë të fondit limit 12.500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2021, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "A." ShPK, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT. **4-** Në procedurën e prokurimit me objekt "Rehabilitim i kanalit ujitës Hasomat Velçë dhe punime për rrjetin e kanalizimeve qendër Kotë", Bashkia Selenicë, me vlerë të fondit limit 7.500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2021, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "K." ShPK, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT. *(faqe 87-129 të RPA)*		
10	Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me menaxhimin e aseteve që disponon Bashkia Selenicë rezultoi se: - Për NJA Selenicë, bashkia administron listën me 109 prona që i janë transferuar me VKM nr. 195, datë 06.03.2013 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Selenicë, të Qarkut Vlorë". - Për NjA Vllahinë, bashkia administron listën me 826 prona e përgatitur nga komisioni i ngritur për të kryer këtë proces. - Për Njësitë e tjera Administrative, Armen, Kotë, Sevaster, Brataj nuk ka një listë të pronave të paluajtshme si dhe nuk është marrë asnjë masë për të hartuar këtë listë në secilën njësi administrative. - Gjithashtu, lidhur me listat e pronave të paluajtshme të NjA Selenicë dhe Vllahinë nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentet e pronësisë. *(faqe 167-178 të RPA)*	E lartë	Titullari i Bashkisë Selenicë të marrë të gjitha masat për të filluar procesin e inventarizimit dhe përditësimit të pronave/pyjeve/kullotave si vijon: - Të ngrejë një grup pune për verifikimin dhe përditësimin e të gjitha pronave që ka bashkia dhe NJA të transferuara në favor të tyre. - Të vendosë komunikim me ASHK-në me qëllim arritjen e një bashkëpunimi për të marrë asistencën e tyre për verifikimin e gjendjes faktike të pronave. - Të angazhojë Drejtorinë Juridike për verifikimin e gjendjes juridike të pronave. - Të dokumentohen me kujdes të gjitha hapat e këtij procesi të gjatë dhe të rëndësishëm për secilën Njësi Administrative dhe në nivel bashkie.
11	Nga auditimi i menaxhimit të sipërfaqeve kullosore në Bashkinë Selenicë konstatohet se: - Nuk janë hartuar planet e mbarështimit të kullotave. Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave ka lidhur kontrata për përdorimin e sipërfaqeve kullosore pa patur të hartuar dhe miratuar planet e mbarështimit; - Në nivel bashkie janë identifikuar në total 66,182 krerë bagëti. Është parashikuar që të lidhen kontrata dhe të jepen me qira sipërfaqe për 36,753 krerë bagëti, ndërsa për diferencën prej 29,429 krerë që janë të njohura nga bashkia nuk është parashikuar lidhje e kontratave për kullotje. - Bashkia Selenicë ka lejuar 118 blegtorë të përdorin kullotat pa lidhur kontratat përkatëse. Këto blegtorë faturohen nëpërmjet prerjes së faturave për secilin prej tyre. Sipërfaqja kullosore e përdorur nga këto blegtorë është 2,615.5 ha. *(faqe 167-178 të RPA)*	E lartë	Bashkia Selenicë të marrë masa që: - Të hartojë planet e mbarështimit të kullotave që ka në administrim; - Të nxisë blegtorët që ju jep në përdorin kullota pa lidhur kontratat përkatëse që të pajisen me Nipt si dhe të fillojnë regjitrimin e bagëtive në Sistemin e Informacionit Blegtoral dhe Veterinar; - Të sigurohet që të gjithë blegtorët të lidhin kontrata për shfrytëzimin e sipërfaqeve kullosore; - Të planifikojë dhe të kryejë investime në përmirësimin e kullotave, riparimin apo ndërtimin e lerave.

12	Nga auditimi mbi administrimin dhe përdorimin e fondeve nga buxheti i shtetit dhe të ardhurave nga aktivitetet në fondin pyjor dhe kullosor rezulton se për vitin 2021: - Bashkia Selenicë ka kryer financim për pyjet dhe kullotat në vlerën totale **8,421,610 lekë.** Shpenzimet për zërin paga dhe sigurime shoqërore janë në vlerën 7**,726,930 lekë**, ose **92%** e buxhetit. - Bashkia Selenicë nuk ka planifikuar dhe përdorur fonde për mbrojtjen e pyjeve, florës dhe faunës, punime për përmirësimin e gjendjes së pyjeve, investime për shtimin e sipërfaqes dhe volumit, hartimin e planeve të mbarështimit etj. - Nga ana tjetër të ardhurat e siguruara nga aktivitetet në sipërfaqet pyjore-kullosore për vitin 2021 janë në vlerën totale **3,715,637 lekë**. Kjo vlerë gjatë planifikimit të buxhetit është ndarë nëpër zëra të ndryshëm të buxhetit të bashkisë së bashku me të ardhurat e tjera të vitit 2021. *(faqe 167-178 të RPA)*	E lartë	Bashkia Selenicë të marrë masa që të ardhurat e siguruara nga përdorimi i fondit pyjor dhe kullosor të përdoren në funksion të mbrojtjes dhe rimëkëmbjes së pyjeve, ndërtimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës pyjore, zhvillimin dhe shtimin e sipërfaqes së pyjeve dhe volumit të tyre, hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit, kryerjen e punimeve të pastrimit, të mirëmbajtjes e të përmirësimit, etj.
13	Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me aktivitetin e kryer nga Bashkia Selenicë në fondin pyjor me objekt "Prerjet rigjeneruese dhe shfrytëzimin e lëndës drusore në fondin pyjor" konstatohen parregullsi në të gjitha hapat e zhvillimit të këtij procesi si më poshtë: **1.** Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave (DZHBAPK) nuk ka dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit Projektin teknik të shëndetësimit të pyjeve për ngastrën nr. 37, të hartuar më datë 08.06.2018 dhe ka vijuar me procesin e prerjeve të lëndës drusore pa marrë miratimin nga MTM. **2.** Studimi teknik i shëndetësimit të sipërfaqes në ngastrën nr. 37 është kryer jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 2 datë 03.03.2017, Kreu II, pika 1. **3.** Në dosjen e audituar për shfrytëzimin në ngastrën nr. 37 nuk administrohet një urdhër i Titullarit të Bashkisë për organizimin e procesit të damkimit; **4.** Proces verbalet me nr. 108 datë 13.06.2018, "Për dorëzimin e ngastrës/nënngastrës pyjore për shfrytëzim" dhe nr. 108/1 datë 13.06.2018 bien në kundërshtim me njëri tjetrin në përshkrimin e problemit të konstatuar; **5.** Nuk ka dokumentacion që të jetë miratuar nga MTM shfrytëzimi në ngastrën nr. 23/a. **6.** Është ngritur grupi i punës për të bërë verifikimin dhe damkosjen e pishave të rrëzuara në Ekonominë Pyjore Kotë-Sevaster, ngastra nr. 16, por në dosje nuk disponohet dokumentacion lidhur me përfundimin e këtij procesi, p.sh të jenë hartuar listëdamkat sipas llojeve drusore; **7.** Në dosje nuk gjendet i dokumentuar zhvillimi i procesit të damkimit për ngastrën nr. 11/c; **8.** Nga akt konstatimet e mbajtura nga inspektorët e bashkisë konstatohet se subjekti "L." SHPK në ngastrën nr. 16 dhe nr. 11 nuk ka respektuar kushtet e kontratës: janë vërejtur dëmtime të damkave dhe prerje të disa pishave të njoma pa damkë. Gjithashtu, është konstatuar se nga grupi i punës janë damkosur pisha të njoma të drejta që nuk janë objekt i projektit të përmirësimit të pyllit.	E lartë	Kryetari i Bashkisë Selenicë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave të marrin masa që: - Të hartojnë Planet e mbarështimit të pyjeve që kanë në territorin e bashkisë; - Të kryejnë periodikisht procesin e vlerësimit të fondit pyjor me prerje rigjeneruese duke hartuar projektet teknike të shëndetësimit të pyjeve rast pas rasti; - Të fillojnë procedurat e ankandit për ato ngastra që është miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit projekti për shëndetësimin e sipërfaqeve pyjore; - Të dokumentohet i gjithë procesi në çdo hap të tij.

	9. Bashkia Selenicë nuk kryen periodikisht procesin e vlerësimit të fondit pyjor me prerje rigjeneruese, por edhe në rastet kur janë kryer disa vlerësime në ngastra të caktuara ato nuk janë miratuar të gjitha në MTM. Për ato ngastra që është miratuar nga MTM që të kryehet procesi i shëndetësimit të sipërfaqeve pyjore nuk janë marrë masa për të zhvilluar më tej procedurat. **10.** Bashkia Selenicë nuk ka plane mbarështimi të pyjeve të cilat të shërbejnë si bazë për proceset që do të zhvillohen lidhur me trajtimin dhe shrytëzimin e fondit pyjor me qëllim sigurimin e nevojave për ngrohje, rigjenerimin dhe shëndetësimin e pyjeve. *(faqe 178-185 të RPA)*		
14	Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike në fondin pyjor në territorin e Bashkisë Selenicë u konstatua se kryejnë aktivitetin tregtar në fushën e minerare dhe kanë marrë në përdorim sipërfaqe nga fondi pyjor/kullosor gjithsej 19 OE me sipërfaqe totale në përdorim për S=12.311 Km^2 e konvertuar në sipërfaqe prej S=1,231.1 ha. Nga auditimi i dokumentacionit në dosjet e këtyre subjekteve si dhe të gjithë dokumentacionit që Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave vuri në dispozicion të grupit të auditimit u konstatuan parregullsi si vijon: **1.** Bashkia Selenicë nuk ka informacion lidhur me llojin e pasurisë ku ushtrojnë veprimtari minerare subjektet e pajisura me leje nga AKBN; **2.** Bashkia Selenicë nuk ka dokumentacion lidhur me statusin e pronës ku ushtrojnë aktivitet subjektet e pajisura me leje minerare; **3.** Bashkia Selenicë nuk ka informacion për të gjitha subjektet e pajisura me leje lidhur me sipërfaqen e karrierës që kanë në shfrytëzim. Nga 19 subjekte aktive sipas të dhënave të AKBN-së, Bashkia Selenicë nga verifikimi i bërë në terren ka informacion lidhur me sipërfaqen e karrierës vetëm për 12 subjekte me aktivitet nxjerrje qymyri/gurore ndërsa për subjektet *"R." SHKP, "S." SHPK, "A." SHPK, "T. I." SHPK, "B. M." SHPK, "B. M." SHPK, "B. G." SHPK* nuk ka informacion sa është sipërfaqja e karrierës që këto subjekte shfrytëzojnë; **4.** Bashkia Selenicë nuk ka lidhur kontratë qiraje me subjektet që ushtrojnë veprimtari minerare sipas tarifave *minimale* ligjore për zbatimin e kontratave të shfrytëzimit/kërkim-zbulimit. Nga auditimi u konstatua se në territorin e Bashkisë Selenicë kanë ushtruar aktivitet 19 subjekte private për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore për nxjerrje guri pllakë, gurë gëlqerorë, gëlqeror mermer dhe gëlqerorë masiv, referuar lejeve minerare të miratuara nga MEI. Nga bashkia nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private për sipërfaqen totale prej 1411.10 ha, detyrimi dysheme/minimal është përllogaritur përafërsisht **80,078,812 për vitin 2021**, për 17 subjekte (Aneksi nr. 2.6/4 bashkëlidhur), **vlerë e cila përbën të ardhura të pa planifikuara në buxhetin e Bashkisë Selenicë**. Përdorimi dhe shfrytëzimi i pasurive të paluajtshme që përdoren nga subjektet që ushtrojnë aktivitet mineral në	E lartë	Bashkia Selenicë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave duhet të marrë masa të menjëhershme lidhur me: **1.** T'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura. **2.** Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme. **3.** Të vendosen marrëdhënie kontraktuale me Operatorët Ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej 1,231.1 ha, duke aplikuar tarifat dysheme/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit (**80,078,812**, për 17 subjekte, Aneksi nr. 2.6/4 bashkëlidhur). **4.** Gjatë hartimit të raporteve tekniko-ekonomike rast pas rasti të vlerësohet saktë lloji i bimësisë dhe lëndës drusore që ndodhet në sipërfaqen për të cilën po hartohet raporti, si dhe llogaritja e vlerës të jetë gjithashtu referuar llojit të bimësisë apo lëndës drusore. **5.** Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që të ngarkojë subjektet "S." SHPK, "A." SHPK, "T. I." SHPK ,"B. M. I." SHPK që kanë aktive 6 leje minerare në territorin e Bashkisë Selenicë me detyrimeve vendore referuar përcaktimeve të Vendimit të Këshillit Bashkiak për miratimin e Pakës Fiskale.

	sipërfaqet ku funksionojnë lejet minerare aktive *(jo infrastruktura lidhëse apo depozituese)*, nuk ka asnjë impakt në situatën financiare të Bashkisë Selenicë. Niveli i të ardhurave të Bashkisë nga qiratë e kësaj pasurive të paluajtshme *(që nga viti 1998, kur janë aktive lejet minerare, referuar AKBN-së)* deri më sot, është në vlerë 0 lekë. **Për një sipërfaqe 1,231.14 ha që shfrytëzohet nga subjektet për aktivitet minerar, Bashkia Selenicë nuk merr asnjë të ardhur.** Në përllogaritjen e vlerës së sipërcituar, grupi i auditimit i është referuar pikës 2, të VKM –së nr. 1064, datë 22.12.2010 *"Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", ku sanksionohet: "Për përdorim sipërfaqesh të fondit pyjor e kullosor publik, zbatohen tarifat dysheme, që llogariten duke mbajtur parasysh përdorimin aktual të territorit dhe kohëzgjatjen e veprimtarisë së parashikuar, sipas lidhjes 2 të shtojcës,...".* Lidhjen nr. 2, pika 6 "Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë)" *kohëzgjatje 6-10 vjet, për përdorim territori është: 440,000 lekë/ha/vit.* Lidhjen nr. 2, pika 9 "Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe" *kohëzgjatje 6-10 vjet, për përdorim territori është: a) Pyll trungishte – 96,000 lekë/ha/vit; **b) Pyll cungishte/shkurre e kullota – 78,000 lekë/ha/vit;** c) Tokë me bimësi pyjore, djerr e Inproduktive 62,000 lekë/ha/vit.* Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", neni 25 "Përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar", pikat 3 dhe 4. **5.** Bashkia Selenicë nuk ka përpiluar raporte studimi tekniko-ekonomike për të gjitha subjektet me qëllim për të dokumentuar çdo ndryshim që mund të ketë pësuar sipërfaqja e fondit pyjor/kullosor apo in produktiv, asete në pronësi publike e marrë në përdorim me qira nga subjektet sipas lejeve minerare. Raportet tekniko-ekonomike janë hartuar vetëm për 7 subjekte (*"R." SHKP, "B. P." SHPK, "B. G." SHPK, "Y. S." SHPK, "A." SHPK, "M." SHPK, "T." SHPK*). Raportet tekniko-ekonomike nuk japin informacion në lidhje me llojin dhe vlerën e bimësisë që përmban sipërfaqja që do të përdoret nga subjektet minerare. **6.** Në Bashkinë Selenicë asnjë nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e minierave nuk ka të miratuar me VKM apo ligj të veçantë heqjen nga fondi pyjor/ndryshimi i zërit kadastral i sipërfaqeve të miratuara referuar lejeve të AKBN-së. Ndryshimi i zërit kadastral të sipërfaqeve përkatëse nuk është bërë edhe për ato subjekte për të cilët janë hartuar raportet tekniko-ekonomike. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor/rregullativ si vijon: - Ligji nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", për shfrytëzimin e grupit të		

	rërave dhe zhavorre Bituminoze neni 15, pika 5, Neni 24, pika 10; -Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005 *"Për pyjet dhe shërbimin pyjor",* i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 "Për Fondin Kullosor", pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008 *"Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor",* i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10. 2008 *"Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor",* i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016 dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4. **7.** Nga auditimi rezultoi se në Bashkinë Selenicë janë 4 subjekte ("S." SHPK, "A." SHPK, "T. I." SHPK ,"B. M. I." SHPK) që kanë aktive 6 leje minerare referuar të dhënave të marra nga AKBN të cilët edhe pse ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë nuk janë të pajisur me NIPT sekondar, si rezultat nuk ngarkohen për pagesën e detyrimeve vendore sikurse janë taksa e pastrimit / gjelbërimit / truallit / ndërtesës/ ndikimit në mjedis / mbrojtje, përmirësim mjedisi, në kundërshtim me përcaktimet e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 71 datë 30.11.2020 e nr. 3623 Prot., datë 01.12.20220 *"Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Selenicë-Administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për viti 2021".* **8.** Nga auditimi i raporteve tekniko-ekonomike për vlerësimin e sipërfaqeve që do të hiqen nga fondi pyjor është konstatuar që në tre raste nuk është vlerësuar saktë bimësia/lënda drusore e ndodhur në sipërfaqen që është vlerësuar. **- Subjekti "Y. S." SHPK,** në raportin tekniko- ekonomik me nr. 88 Prot, datë 15.05.2018, është cituar se sipërfaqja e kërkuar është 19.80 ha, dhe shtrihet në: - ngastrën nr. 26, që bën pjesë në ekonominë pyjore mali Bratit-Gumenicë me sipërfaqe 10.536 ha; - ngastrën nr. 13 bën pjesë në ekonomisë kullosore Gjorëm Vranisht me sipërfaqe 9.256 ha. <u>Në raport, nuk është përmendur statusi i veçantë i llojit të bimësisë, pasi është konsideruar si dru zjarri "trungishte".</u> **- Subjekti "A." SHPK, n**ë raportin tekniko- ekonomik me nr. 38 prot, datë 13.02.2019, është cituar se sipërfaqja e kërkuar është 14.064 ha, dhe shtrihet në: - ngastrat nr. 19; 25; 26 bën pjesë në ekonomisë pyjore mali Bratit-Gumenicë dhe ngastrat /nëngastart 1; 14, të ekonomisë kullosore Gjorëm Vranisht. <u>Në raport nuk është përmendur statusi i veçantë i llojit të bimësisë, pasi është konsideruar si dru zjarri "trungishte".</u> **- Subjekti "M. P." SHPK, n**ë raportin tekniko- ekonomik me nr. 37 Prot, datë 13.02.2019, është cituar se sipërfaqja e kërkuar është 55.48 ha, dhe shtrihet në; ngastrat/nënngastrat nr. 19; 25; 26; 28; 29;30, dhe bën pjesë në ekonominë		

	pyjore/kullosore mali Bratit-Gumenicë, dhe janë në pronësi/administrim të Bashkisë Selenicë. Në raport (përveç tabelës bashkangjitur raportit ku përmbajtja e ngastrës 26-përbërja e grumbullit është cilësuar "e thjeshtë"), nuk është përmendur statusi i veçantë i llojit të bimësisë, pasi është konsideruar si dru zjarri "trungishte". Referuar regjistrit kadastral të shqyrtuar nga grupi i auditimit prona V, parcela nr. 26, në ekonominë pyjore/kullosore mali Bratit-Gumenicë përmban **ilqe**. **9.** Subjektet me objekt veprimtarinë minerare në Bashkinë Selenicë, nuk kanë zbatuar parimet e veprimtarisë minerare që rregullon marrëdhëniet midis subjektit dhe titullarit të pronësisë (Bashkisë Selenicë), në përputhje me pikën 4 të nenit 4 "*E drejta minerare është një e drejtë e dallueshme dhe e pavarur nga e drejta e pronësisë mbi sipërfaqen e tokës, ku ato gjenden. Marrëdhëniet e subjektit përfitues të së drejtës minerare dhe titullarit të së drejtës së pronësisë mbi pronën, ku gjenden minerale, rregullohen me marrëveshje, sipas legjislacionit në fuqi*", të ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 "*Për Sektorin Minerar në Republikën ë Shqipërisë*" me ndryshimet e ligjit nr. 9/2013 dhe Ligjit nr. 134/2014 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar. *(faqe 186-207 të RPA)*		
15	Nga auditimi i ecurisë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton se, qytetarët/individët që kanë përfituar legalizimin e sipërfaqeve të caktuara nuk kanë paguar rregullisht detyrimin ndaj Bashkisë Selenicë për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Përkatësisht për vitin 2021 nuk kanë paguar detyrimin 19 qytetarë me vlerë totale **485,846** lekë, ndërsa nuk kanë paguar ende detyrimin 225 individë/qytetarë për sipërfaqet e legalizuara përpara vitit 2021 me vlerë totale **5,765,781** lekë. **Në total vlera e detyrimeve nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton në 6,251,627 lekë për 244 objekte të legalizuara, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Selenicë.** *(faqe 40-65 të RPA)*	E lartë	Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 244 debitorë në vlerën 6,251,627 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Drejtoria e të Ardhurave të dërgojë informacion periodik në Drejtorinë e Financës lidhur me listën e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Selenicë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen.
16	Nga auditimi i të dhënave lidhur me detyrimet që tatimpaguesit kanë ndaj Bashkisë Selenicë rezultoi se gjatë vitit 2021 borxhi i krijuar është në shumën **32,070,957 lekë** dhe përbëhet nga detyrimet nga taksat dhe tarifat për personat fizikë/juridikë, detyrimet nga taksat dhe tarifat vendore për familjet dhe detyrimet nga taksa e tokës bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifa e vaditjes. Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore në mënyrë progresive më datë 31.12.2021 në Bashkisë Selenicë janë në vlerën **362,065,059 lekë** të përbëra nga: - Detyrime për taksën e ndërtesës për 6343 familje në vlerën **4,110,003 lekë;**	E lartë	Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën totale **362,065,059 lekë**, e përbërë nga: - **4,110,003 lekë** detyrime për taksën e ndërtesës për 6343 familje; - **255,577,812 lekë** detyrime për taksën e tokës bujqësore për 7516 familje; - **38,882,100 lekë** detyrime nga biznesi i vogël për 470 subjekte; - **37,930,263 lekë** detyrime nga biznesi i madh për 15 subjekte;

	- Detyrime për taksën e tokës bujqësore për 7516 familje në vlerën **255,577,812 lekë**; - Detyrime nga biznesi i vogël për 470 subjekte në vlerën **38,882,100 lekë**; - Detyrime nga biznesi i madh për 15 subjekte në vlerën **37,930,263 lekë**; - Detyrime për taksat familjare (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim) për 7640 familje në vlerën **25,510,831 lekë;** - Detyrime nga tarifa e vaditjes në vlerën **54,050 lekë**. Lidhur me hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Selenicë rezulton se, të gjitha bizneset debitorë janë njoftuar për kalimin e afatit për pagesat vendore. Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore nuk janë marrë masa të tjera ligjore, veprime në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. *(faqe 40-65 të RPA)*		- **25,510,831 lekë** detyrime për taksat familjare (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim) për 7640 familje; - **54,050 lekë** detyrime nga tarifa e vaditjes. *a-T'u dërgohen bankave* të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare. *b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit*, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme). *c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar*, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar. *d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet*, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e DAPPLL të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal. e- DAPPLL të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Selenicë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq. f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.
17	Nga auditimi i subjekteve që tregtojnë lëndë djegëse me pakicë lidhur me pagesën e pajisjes me autorizim për ushtrimin e aktivitetit rezultoi se, në Bashkinë Selenicë për vitin 2021 janë 3 subjekte (T. O., Xh. G., M. O.) që kanë ushtruar aktivitet të pa pajisur me autorizimin e nevojshëm edhe pse nga ekstrakti i QKB-së rezulton se kanë filluar aktivitetin në këtë bashki që në vitin 2015. **Të ardhurat e munguara vetëm për vitin 2021 nga mos pagesa për autorizimin llogariten në vlerën 600,000 lekë (3*200,000).** Subjektet "P." SHPK dhe "D. Gj." SHPK janë pajisur me autorizim/licencë dhe me ato është lidhur akt marrëveshje për pagesën e detyrimit për autorizimin me këste. Marrëveshja konsiston në krijimin e mundësisë për subjektet që detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite ta paguajnë me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë. Vlera e mbetur ende për t'u paguar nga këto subjekte është **750,000 lekë**. *(faqe 40-65 të RPA)*	E lartë	Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që subjektet "T. O.", "Xh. G.", "M. O.", që ushtrojnë aktivitet në kundërshtim me dispozitat ligjore të pajiset menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke kryer pagesa të plota apo të pjesshme. Gjithashtu, DAPPLL të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për subjektet "P." SHPK dhe "D. Gj." SHPK me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.
18	Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Selenicë gjatë vitit 2021 ka konstatuar 10 raste të shkeljes së legjislacionin në fushën e mbrojtjes së territorit. Inspektorët e IMTV-së për këto raste kanë mbajtur proces verbalet përkatëse të konstatimit të kundërvajtjes dhe në 4 raste kanë marrë vendim për pezullim punimesh. Për asnjë nga 10 shkeljet e konstatuara nuk është marrë vendim prishje apo masa e dënimit me gjobë. *(faqe 40-65 të RPA)*	E lartë	Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Selenicë të rivlerësojë shkeljet e konstatuara referuar kundërvajtjes dhe të marrë masat për dënim me gjobë bazuar në llojin e shkeljes së kryer. Gjithashtu, në vijimësi për çdo proces verbal të konstatimit të kundërvajtjes të vendosen masat administrative përkatëse.

19	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratave rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **2,828,092 lekë pa TVSH,** përkatësisht për: - Kontrata me objekt "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pafavorizuara", Bashkia Selenicë, me vlerë të kontratës (me TVSH) 14,961,413 lekë, fituar nga BOE "J." SHPK & "C." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 508,648 lekë pa TVSH. - Kontrata me objekt "Rehabilitim Ura Brataj", Bashkia Selenicë, me vlerë të kontratës (me TVSH) 1,968,720 lekë, fituar nga OE "A." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 138,400 lekë pa TVSH. - Kontrata me objekt "Sistemim-Asfaltim lagjja Tubo – Rromës (rruga e varrezave, spitalit", Bashkia Selenicë, me vlerë të kontratës (me TVSH) 9,609,120 lekë, fituar nga OE "J." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 254,080 lekë pa TVSH. - Kontrata me objekt "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme me beton", Bashkia Selenicë, me vlerë të kontratës (me tvsh) 14,388,000 lekë, fituar nga BOE "A." SHPK & "Sh." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 471,240 lekë pa TVSH. - Kontrata me objekt "Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë", Bashkia Selenicë, me vlerë të kontratës (me TVSH) 14,388,000 lekë, fituar nga OE "I." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 486,900 lekë pa TVSH. *(faqe 129-142 të RPA)*	E lartë	Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës **2,828,092 lekë pa TVSH,** përkatësisht: - **508,648 lekë pa TVSH** nga BOE "J." SHPK & "C." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1423 Prot. datë 10.05.2021, me objekt "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara", Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera. - **138,400 lekë pa TVSH** nga OE "A." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 818/1 Prot. datë 16.03.2021, me objekt "Rehabilitim Ura Brataj", Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera. - **254,080 lekë pa TVSH** nga OE "J." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 830 Prot. datë 17.03.2021, me objekt "Sistemim-Asfaltim lagjja Tubo – Rromës (rruga e varrezave, spitalit", Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera. - **471,240 lekë pa TVSH** nga BOE "A." SHPK & "Sh." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1031 Prot. datë 06.04.2021, me objekt "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme me beton", Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera. - **486,900 lekë pa TVSH** nga OE "I." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1456 Prot. datë 12.05.2021, me objekt "Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë", Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
20	Nga auditimi në dosjen e prokurimit dhe në SPE të dosjes së prokurimit me objekt "Sistemim Asfaltim rruga Kropisht", Bashkia Selenicë, rezulton që OE "B." ShPK është skualifikuar padrejtësisht. KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me këtë OE, me ofertë ekonomike 9,532,318.8 lekë me TVSH, ose **4,997,602.2** lekë më pak se vlera e kontratës së lidhur me OE "A." ShPK, vlerë që përbën përdorim pa ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Selenicë. Nga auditimi në dosjen e prokurimit dhe në SPE të dosjes së prokurimit me objekt "Rehabilitim i kanalit ujitës Hasomat Velçë dhe punime për rrjetin e kanalizimeve qendër Kotë", Bashkia Selenicë, rezulton që OE "B. K." ShPK është skualifikuar padrejtësisht. KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me këtë OE, me ofertë	E lartë	Titullari i Bashkisë Selenicë dhe KVO, të marrin masa për eleminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DST, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirëpërdorur fondet e Bashkisë.

	ekonomike 6,386,960 lekë me TVSH, ose **2,307,781** lekë më pak se vlera e kontratës së lidhur me OE "K." ShPK, vlerë që përbën përdorim pa ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Selenicë. *(faqe 129-142 të RPA)*		

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit
Opinioni i auditimit:

Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2021:
Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara të Bashkisë Selenicë për vitin ushtrimor 2021, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj,.
Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 1700, ISSAI 1705 dhe ISSAI 1200, shprehim një **opinion të modifikuar/kualifikuar** [1] për llogaritë vjetore të vitit ushtrimor 2021 të Bashkisë Selenicë, duke arritur në përfundimin se anomalitë e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura në llogaritë vjetore të konsoliduara të vitin 2021, të cilat justifikojnë dhënien e opinionit të modifikuar. Këto anomali janë të shprehura te baza për opinionin e auditimit.
Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:
Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare", pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.
Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 7,542,000 lekë, si dhe anomalitë e mëposhtme:
-Në pasqyrat financiare nuk është hartuar formatin nr. 5, "Pyetësorë dhe shënime shpjeguese".
-Në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" nuk është pasqyruar vlera 191,868,902 lekë, e cila ka të bëjë me detyrimet për taksat dhe tarifat vendore.
-Llogaria 202 "Studime dhe kërkime" paraqitet në vlerën 8,641,700 lekë, ku përfshihen 12 projekte të cilat nuk duhet të regjistroheshin në këtë llogari, pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e secilit investim.

[1] *Sipas **Manualit të Auditimit Financiar** të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, kapitulli 4.2.2, fq. 141, "**Opinion i kualifikuar"** jepet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë, ose kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.*

-Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” paraqitet në vlerën 140,307,952 lekë, për të cilën Bashkia nuk posedon titull pronësie, si dhe në këtë llogari nuk janë pasqyruar asetet e ish-komunave.
-Llogaria 211 “Pyje, plantacione” paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që në këtë llogari nuk janë pasqyruar 26,899.51 ha sipërfaqe nga të cilat: 16,633.1 ha sipërfaqe “Kullotë”, 10,062.1 ha sipërfaqe “Pyll” dhe 204.31 ha sipërfaqe “Shkëmborë”.
-Në llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” është pasqyruar vlera 526,501,279 lekë, e cila i përket aseteve të transferuara në Shoqërinë Ujësjellës Selenicë.
-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet në vlerën 71,283,867 lekë dhe përfaqëson detyrime për investime në vlerën 40,935,736 lekë, detyrime për vendime gjyqësore në vlerën 14,112,369 lekë, si dhe shërbime në vlerën 16,235,762 lekë.
-Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” paraqitet në vlerën 21,403,554 lekë, nga të cilat 18,071,576 lekë i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e para, të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Selenicë nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për zhbllokimin e këtyre fondeve.

II. Opinioni mbi përputhshmërinë

Ne kemi audituar planifikimin e nevojave për investime, përputhshmërinë ligjore për zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, mbi zbatimin e buxhetit dhe menaxhimin e të ardhurave, mbi menaxhimin e aseteve si dhe zbatimin në teren të kontratave të punimeve të lidhura midis autoritetit kontraktor dhe operatorëve të shpallur fitues si dhe. Në opinionin tonë, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Selenicë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kundërt të përputhshmërisë.

Baza për dhënien e opinionit të kundërt[2]

Opinionin e dhënë e mbështesim në anomalitë e konstatuara, si më poshtë:
- Në **9** raste të procedurave të prokurimit të zhvilluara në vitin 2021 janë vendosur kritere të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.
- Në **6** raste, kriteret e vendosura nga NJP nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumet e punës.
- Në **4** raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën totale 37,651 mln lekë.
- Në dy raste dhe konkretisht në procedurat e prokurimit “Sistemim Asfaltim Rruga Kropisht” dhe “Rehabilitim i kanalit ujitës Hasomat Velçë dhe punime për rrjetin e kanalizimeve qendër Kotë” janë skualifikuar padrejtësisht Operatorë Ekonomikë me oferta ekonomike më të ulëta se ofertat ekonomike të shpallura fituese në vlerën totale 7,305,383 lekë, e cila është përdorim pa ekonomicitet i fondeve të Bashkisë Selenicë.
- Janë konstatuar detyrime të pa arkëtuara nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet me vlerë **6,251,627 lekë.**
- Në auditimin e dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve konstatohet se detyrimet që subjekteve fizikë/juridikë dhe familjet kanë deri më 31.12.2021 (debitorët progresiv), janë në vlerën totale **362,065,059 lekë,** (taksat familjare truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim 25,510,831 lekë, detyrime për taksën e tokës bujqësore 255,577,812 lekë).

[2] *Sipas **Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë** të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.06.2020, **Opinion i kundërt** jepet nëse rastet kur mospërputhjet janë materiale dhe të përhapura, fq. 105.*

- Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike në fondin pyjor në territorin e Bashkisë Selenicë u konstatuan parregullsi si vijon:

1. Bashkia Selenicë nuk ka informacion lidhur me llojin e pasurisë ku ushtrojnë veprimtari minerare subjektet e pajisura me leje nga AKBN.

2. Bashkia Selenicë nuk ka dokumentacion lidhur me statusin e pronës ku ushtrojnë aktivitet subjektet e pajisura me leje minerare.

3. Bashkia Selenicë nuk ka informacion për të gjitha subjektet e pajisura me leje lidhur me sipërfaqen e karrierës që kanë në shfrytëzim.

4. Bashkia Selenicë nuk ka lidhur kontratë qiraje me subjektet që ushtrojnë veprimtari minerare sipas tarifave *minimale* ligjore për zbatimin e kontratave të shfrytëzimit/kërkim-zbulimit.

5. Bashkia Selenicë nuk ka përpiluar raporte studimi tekniko-ekonomike për të gjitha subjektet me qëllim për të dokumentuar çdo ndryshim që mund të ketë pësuar sipërfaqja e fondit pyjor/kullosor apo in produktiv, asete në pronësi publike e marrë në përdorim me qira nga subjektet sipas lejeve minerare.

6. Në Bashkinë Selenicë asnjë nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e minierave nuk ka të miratuar me VKM apo ligj të veçantë heqjen nga fondi pyjor/ndryshimi i zërit kadastral i sipërfaqeve të miratuara referuar lejeve të AKBN-së.

7. Nga auditimi rezultoi se në Bashkinë Selenicë janë 4 subjekte që kanë aktive 6 leje minerare referuar të dhënave të marra nga AKBN të cilët edhe pse ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë nuk janë të pajisur me NIPT sekondar, si rezultat nuk ngarkohen për pagesën e detyrimeve vendore sikurse janë taksa e pastrimit / gjelbërimit / truallit / ndërtesës/ ndikimit në mjedis / mbrojtje, përmirësim mjedisi.

8. Nga auditimi i raporteve tekniko-ekonomike për vlerësimin e sipërfaqeve që do të hiqen nga fondi pyjor është konstatuar që në tre raste nuk është vlerësuar saktë bimësia/lënda drusore e ndodhur në sipërfaqen që është vlerësuar.

9. Subjektet me objekt veprimtarinë minerare në Bashkinë Selenicë, nuk kanë zbatuar parimet e veprimtarisë minerare që rregullon marrëdhëniet midis subjektit dhe titullarit të pronësisë (Bashkisë Selenicë).

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Selenicë:

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Selenicë.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kritereve të DT, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri më kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por

nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.
Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të japë opinion për këtë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 799/1 Prot, datë 03.10.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, i ndryshuar me shkresat nr. 799/2 Prot, datë 03.10.2022 dhe nr. 799/3 Prot, datë 19.10.2022, nga data 06.09.2022 deri në datë 28.10.2022, në subjektin Bashkia Selenicë u krye auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021.

Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. E. V. – *Përgjegjëse Grupi*
2. A. Z.– *Anëtar*
3. G. K. – *Anëtar*
4. M. H. – *Anëtar*

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Selenicë kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)[3];
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Selenicë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të

[3] *Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.*

rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Selenicë dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.

2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit,burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.

3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2021.

4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2021-31.12.2021.

5. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

6. Mbi administrimin e aseteve të Bashkisë Selenicë.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Selenicë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Selenicë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kritereve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Selenicë. Burimet e kritereve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e

Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar;
- Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2020", i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 "Për buxhetin e vitit 2021", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme", i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit";
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative";
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik";
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore";
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël";
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017;
- VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik";
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura";
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve";
- Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023".
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore";
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;
- Etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Selenicë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik";
- ISSAI 400 "Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë", që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë"; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim *(Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).*

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna *"jashtë normales",* që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Selenicë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale[4].

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe

[4] ISSAI 1315

ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.
Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.
Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-ja aplikon[5].
Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur*; dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. **Informacion i përgjithshëm mbi subjektin - Bashkia Selenicë**

   Bashkia e Selenicës kufizohet në veri me Bashkinë Fier, në lindje me Bashkinë Mallakastër, Tepelenë dhe Memaliaj, në jug me Bashkinë Himarë dhe perëndim me Bashkinë Vlorë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Selenicës.

   Sipas Censusit të vitit 2011, Bashkia Selenicë ka një popullsi prej 18.476 banorësh ndërsa në Regjistrin Civil rezulton me 35.793 banorë. Bashkia ka një sipërfaqe prej 561.24 km^2. me densitet prej 32.9 banorë/km^2 ndërsa sipas regjistrit civil, densiteti është 63.77 banorë/km^2.

[5] *Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit*

Bashkia e Selenicës shtrihet në një zonë kodrinore në bregun e majtë të lumit Vjosa si dhe përgjatë lumit Shushicë. Bashkia ka në territorin e saj minierën historike të bitumit në Selenicë, ku punësohen edhe banorët e fshatrave përreth, si dhe zonën naftëmbajtëse të Vllahinës.
Bashkia Selenicë përbëhet nga gjashtë Njësi Administrative: Selenicë, Armen, Vllahinë, Kotë, Sevaster dhe Brataj.
Aktiviteti kryesor ekonomik i bashkisë është bujqësia dhe blegtoria dhe si treg i rëndësishëm për produktet e saj është kryesisht qyteti i Vlorës.
Bashkia Selenicë për zhvillimin e aktivitetit të saj financohet nga të ardhurat që sigurohen nga taksat dhe tarifat vendore si dhe nga fondet e transferuara nga pushteti qendror apo të ardhurat nga taksat e ndara.

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së:
Titulli i gjetjes 1: Mangësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm sipas komponentëve u konstatuan parregullsitë si më poshtë:
a. Në lidhje me komponentin "Mjedisi i kontrollit":
-Për sa i përket programeve të trajnimit dhe përmirësimit të anës profesionale, punonjësit kanë mangësi të mëdha në trajnime pasi nuk janë përfshirë në programe trajnimi si dhe njohuritë e tyre në lidhje me kuadrin rregullator ligjor mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin rezultojnë të jenë të dobëta.
-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Ndërsa nga UK Sh.A Selenicë, Bashkia merr raportime ne lidhje me vendimmarrjen këshillit drejtues, pasi bashkia është aksionari kryesor, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat, përveç raportimeve financiare për efekt argumentimi subvencioni.
-Në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se kanë marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve), për të cilat nuk disponohen procesverbale të takimeve të tyre, me palët e treta si me grupet e interesit, si dhe për dëgjesa me publikun.
-Për vitit 2021 është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetin e Bashkisë sipas Urdhrit nr. 8, datë 18.01.2021, të Kryetarit të Bashkisë por nuk është marrë miratimi nga Këshilli Bashkiak për numrin e punonjësve.
-Në Rregulloren e Brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre.
-Mbi politikat dhe praktikat e ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregulloren e brendshme të institucionit janë përcaktuar detyrat vetëm sipas drejtorive dhe linjat e raportimit, por nuk ka të miratuar ndarje detyrash dhe përgjegjësish në nivel përgjegjës sektorësh dhe specialisti. Nuk ka përshkrime detyrash individuale e cila do të evidentonte ngarkesën konkrete me punë si dhe kërkesat lidhur me kualifikimet e nevojshme për secilin nëpunës. Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit.

-Me shkresën nr. 3995 Prot., datë 31.12.2020, dhe Urdhrin nr. 241, datë 31.12.2021, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik. Ky grup nuk është mbledhur për hartimin e planit strategjik dhe PBA.
-Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre. Nga ana e Bashkisë Selenicë nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.
b. Në lidhje me komponentin "Menaxhimi i riskut":
-Nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave. Nuk janë përcaktuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin dhe implementimin e kësaj strategjie.
c. Në lidhje me komponentin "Aktivitetet e kontrollit":
-Nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.
-Nuk ka procedura të përcaktuara anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsive.
-Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.
d. Në lidhje me komponentin "Monitorimi":
-Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollin.
-Nuk ka një plan të veprimit për ecurinë e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollin.
Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 8, germa "b", neni 15, pika 1-4, neni 16, pikat 2-3, neni 17, pika 1, neni 21, pika 2, neni 27, pikat 1-2, Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2, pika 2.2.4, nënpikat 1-5, dhe Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli II, pika 2.5.2, pika 2.2.6, Kapitulli III, pika 2.2, pika 3.2, pika 3.2.
Ndikimi: Mos njohja e plotë si dhe sa duhet e koncepteve të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.
Shkaku: Mungesa e trajnimeve të dedikuara për të gjithë stafin menaxhues në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit financiar.
Rëndësia: E lartë.
Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Selenicë të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe komponentëve të tij, për hartimin e gjurmës së auditimit dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të përcaktohen procedurat antikorrupsion, rregulla të shkruara për sinjalizimin e parregullsive, si dhe të hartohen programe trajnimi për punonjësit.
Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të hartohen rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me anë të Kodit të Punës.

Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të merren masa që në Rregulloren e Brendshme hartimi i detyrave dhe përgjegjësive të shtrihet për të gjithë punonjësit dhe jo vetëm në nivel drejtorie, në mënyrë që secili punonjës të ketë të qartë detyrën funksionale dhe përgjegjësit sipas pozicionit të punës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. P. B. me detyrë Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. L. H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Titulli i gjetjes 2: Mangësi mbi proceset/veprimtarinë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm.
Situata: Nga auditimi i veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm u konstatuan parregullsitë si më poshtë:
-Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka zhvilluar auditimin e prokurimeve me vlera të larta dhe të vogla, proces i cili është parashikuar në planin vjetor të vitit 2021.
-Subjektet e audituara pavarësisht se kanë pranuar rekomandimet e lëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve.
-Nga auditimi i dosjeve të evaduara për auditimet e zhvilluara përgjatë vitit 2021 nga Njësia e Auditimit të Brendshëm konstatohet se, në 1 rast nuk është zhvilluar "Takimi i hapur prezantues" si dhe në 5 raste nuk janë mbajtur "Letrat e punës".
-Nga Përgjegjësi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin VII, pika 7.1.1 "Vlerësimi i brendshëm i cilësisë" që kryhet nga vetë nga kjo Njësi. Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm, duhen bërë vlerësimet e brendshme të cilësisë me përcaktimin nëse politikat dhe procedurat e aplikueshme, janë krijuar dhe zbatuar për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet dhe kodin e etikës.
Kriteri: Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorit publik" dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, pika 4.1.12. Hapi 1, Kapitulli VII, pika 7.1.
Ndikimi: Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga institucioni. Mos auditimi i procedurave të prokurimeve paraqet risk të lartë mbi menaxhimin e fondeve të institucionit.
Shkaku: Mos vlerësimi nga drejtuesi i NJAB dhe mos përmbushja e angazhimeve për auditimin sipas planifikimeve. Mos plotësimi i dosjeve të auditimit me të gjithë dokumentacionin e parashikuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm.
Rëndësia: E mesme.
Rekomandim: Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Selenicë të merren masa që, pjesë e planit vjetor të vitit 2023 të përfshihet edhe auditimi i procedurave të prokurimeve me vlera të larta dhe ato me vlera të vogla . T'u kërkohet subjekteve të audituara plani i veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve nga kjo Njësi me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore mbi zbatueshmërinë e rekomandimeve.
Rekomandim: Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Selenicë të merren masa që të hartohen dhe plotësohen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dosja e auditimit, duke zbatuar njëkohësisht edhe detyrimet e ligjore të parashikuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm. Të kryhet vlerësimi i brendshëm i cilësisë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. S. me detyrë Përgjegjës i Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:
Ky auditim u krye në zbatim të Ligjit nr. 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar si dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve;

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Selenicë si dhe bazuar përgjigjeve/dokumentacionit të pyetësorit më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.
Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të MFK-së nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera tregon se aspektet e MFK-së kuptohen dhe funksionojnë jo mjaftueshëm përgjatë gjithë strukturave të njësisë pavarësisht përpjekjeve të këtij institucioni për të shkuar drejt konsolidimit.
Konkluzioni në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në mënyrë të detajuar argumentohet si më poshtë vijim:

1. Mjedisi i kontrollit
Mjedisi i kontrollit është bazë e menaxhimit të fondeve dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm i cili përmban:
a. Njësia publike demonstron angazhim për integritet dhe vlera etike.
-Nëpunësit e Bashkisë Selenicë duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e përcaktuara në Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" dhe Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale".
Në zbatim të nenit 3, të Rregullores së Brendshme të miratuar me Vendimin nr. 5, datë 15.05.2020, si dhe shkresën nr. 2184 prot., datë 02.09.2019, të Kryetarit të Bashkisë është miratuar Kodi i Etikës i cili zbatohet nga administrata qendrore dhe njësitë administrative.
-Për sa i përket programeve të trajnimit dhe përmirësimit të anës profesionale, punonjësit kanë mangësi të mëdha në trajnime pasi nuk janë përfshirë në programe trajnimi si dhe njohuritë e tyre në lidhje me kuadrin rregullator ligjor mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin rezultojnë të jenë të dobëta, veprime këto në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli III, pika 3.1.
-Në lidhje me ankesat dhe kërkesat e ndryshme të paraqitura pranë Bashkisë, ato regjistrohen pranë Zyrës së Koordinatorit të së drejtës së informimit dhe të drejtës me publikun me një ndalesë nga ku më pas bëhen raportimet e nevojshme në drejtoritë përkatëse dhe dhënia e përgjigjeve sipas afateve të përcaktuara, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, "Për të drejtën e informimit" dhe Urdhrin e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e te dhënave personale "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore".
-Referuar Ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, "Për vlerësimin e rezultateve në punë", Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i

Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, të gjitha drejtoritë kanë kryer vlerësimin e punonjësve të tyre çdo 6 mujor, vlerësim i cili nënshkruhet nga zyrtari përgjegjës, nëpunësi përkatës si dhe zyrtari i autorizuar.

b. Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e nëpunësit autorizues dhe të stafit menaxherial janë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme dhe veprohet në bazë të saj.

-Nga drejtoritë dhe sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve.

Në kreun II të Rregullores së Brendshme është përcaktuar mënyra e hartimit, miratimi, ndjekja e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e Njësitë Administrative si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë drejtuar Nënkryetarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë. Ky rregull jo gjithmonë është ndjekur për periudhë mujore por raportimi është realizuar për periudha 3-mujore e 6 mujore.

-Mungon dokumentimi i takimeve të menaxherëve me stafin e lartë menaxherial. Ndërsa për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale e protokoll.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe nëpunësi autorizues si dhe në Ministrinë e Financave.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Ndërsa nga Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Selenicë Bashkia merr raportime ne lidhje me vendim-marrjen Këshillit të Administrimit, pasi Bashkia është aksionari kryesor, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat, përveç raportimeve financiare për efekt argumentimi subvencioni.

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, Njësia e Harmonizimit në Ministrinë e Financave.

-Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë.

c. Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

-Është hartuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të institucionit miratuar me Vendimin nr. 5, datë 15.05.2020, të Kryetarit të Bashkisë.

-Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA por këto nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe plan veprimeve të menaxhimit të financave të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

-Në hartimin e planit strategjik konfirmohet se kanë marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve) për të cilat nuk disponohen procesverbale të takimeve të tyre me palët e treta si me grupet e interesit si dhe për dëgjesat me publikun.

-Mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike.
-Për vitit 2021 është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetin e Bashkisë sipas Urdhrit nr. 8, datë 18.01.2021, të Kryetarit të Bashkisë me një numër total 245 punonjës, nga të cilët nga të cilët 17 drejtues, 85 specialist, 2 teknikë, 62 nëpunës të thjesht dhe 77 punëtorë por nuk është marrë miratimi nga Këshilli Bashkiak për numrin e punonjësve. Referuar realizimit të strukturës organizative nuk janë konstatuar tejkalime të saj.
-Organigrama e Bashkisë Selenicë është e ndërtuar në mënyrë të tillë që, 2 nënkryetarët dhe 6 drejtuesit e Drejtorive kryesore bashkë me Administratorët e Njësive Administrative e Titullarët institucioneve të varësisë varen direkt nga Kryetari ku dhe llogaridhënia është direkt tek Kryetari i Bashkisë në vijë horizontale dhe jo vertikale.

d. Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave.

Nëpunësit e Bashkisë Selenicë i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel drejtorie, përgjegjës sektori apo specialist me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar dhe aktet nënligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrativ dhe terrenit (inspektor terreni, punonjës bujqësie, topograf, inxhinier pyjesh, inspektor pyje, kullota, punonjës sporti etj.,) i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.
Referuar Kreut II, të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, përcaktuar që:

- Një procedurë transparente për rekrutim;
- Kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit;
- Një sistem trajnimi dhe kualifikimi;
- Një sistem për vlerësimin e performancës;

Në Rregulloren e Brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre.
Mbi politikat dhe praktikat e ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregulloren e brendshme të institucionit janë përcaktuar detyrat vetëm sipas drejtorive dhe linjat e raportimit, por nuk ka të miratuar ndarje detyrash dhe përgjegjësish në nivel përgjegjës sektorësh dhe specialisti. Nuk ka përshkrime detyrash individuale e cila do të evidentonte ngarkesën konkrete me punë si dhe kërkesat lidhur me kualifikimet e nevojshme për secilin nëpunës. Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit.

e. Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Çdo titullar i njësisë publike duhet të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik (në vijim GMS) me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. GMS është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike si dhe luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike.
Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike. GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë dhe të garantojë se komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësisë.
-Me Urdhrin nr. 241, datë 31.12.2021, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 8, pika b, neni 27, pika 2.

-Ky grup nuk është mbledhur për hartimin e planit strategjik dhe PBA, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 8, pika 8/b, neni 27, pika 1 dhe 2, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli II, pika 2.2.6, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.4, nën pikat 1-5.
-Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre. Nga ana e Bashkisë Selenicë nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, nenin 15, pikat 1-4, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli II "Delegimi i detyrave".

2. Menaxhimi i Riskut

Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit qoftë kjo mundësi pozitive apo negative i veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.
Titullari i njësisë publike është përgjegjës për zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësisë së tij. Analizimin dhe rifreskimin e kontrolleve që synojnë minimizimin e riskut sipas strategjisë së riskut. Koordinator i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinator i Riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike.
Në përmbushje të përgjegjësive të tij nëpunësi autorizues mund t'i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinimin e riskut, punonjësve që janë pjesë e strukturës së financës, funksion i cili nuk është deleguar.
Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura.
Strategjia e riskut është përcaktuar si qasje organizative në drejtim të menaxhimit të riskut nga ana e titullarit të institucionit dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë dhe më tej. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si duhet të sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.
Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe për kontrollimin e risqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij kriteret për përcaktimin e risqeve madhore mekanizmat e regjistrit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut.
Bashkia Selenicë nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave. Nuk janë përcaktuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin dhe implementimin e kësaj

strategjie, veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 21, pika 2, si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli II, pika 2.5.2, "Menaxhimi i riskut".

3. Aktivitet e kontrollit

Sistemi me dy firma është një procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare si nënshkrimi i kontratave, urdhër-shërbimet, dhe kryerja e pagesës, sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare për pagesa. Qëllimi i kësaj procedure është të garantojë se personi përgjegjës për regjistrimet në kontabilitet është i informuar për detyrimin financiar që do të merret përsipër apo që do të paguhet dhe do të kryejë saktë veprimet e kontabilitetit.

Sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare. Të gjithat angazhimet likuidimet financiare nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues.

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme.

Përveç kësaj, gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione.

Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurmëve të auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Sipas Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016, "Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike", parashikohet se, "Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, struktura, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës".

Nëpunësi Autorizues duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duhet të përfshijë hapat kryesorë të vlerësuara të rëndësishme për një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit: "Përgatitja e Gjurmës së auditit për proceset kryesore të punës".

-Bashkia Selenicë nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar Gjurmët e Auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimit, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. Që ka si qëllim të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe

kontrollin" i ndryshuar, neni 16, pika 2-3 dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli III "Procesi i implementimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit" dhe pika 3.2 "Cikli i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin".
Titullarët e njësive kanë përgjegjësi për vendosjen e rregullave dhe procedurave për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi.
Procedurat antikorrupsion, përfshijnë:

- Kontrollet parandaluese;
- Një sistem për investigim të brendshëm të paralajmërimeve të hershme për korrupsion, mashtrime dhe parregullsi;
- Një sistem për zbulimin e mashtrimeve dhe parregullsive;
- Një sistem për raportimin e parregullsive të gjetura, që duhet të përshkruajë qartësisht linjën e brendshme dhe të jashtme të raportimit, pa rënë ndesh me të drejtën kushtetuese të individit;
- Procedurat e sinjalizimit;

-Bashkia Selenicë nuk ka procedura të përcaktuara anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsive, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 17, pika 1.
-Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 4, pika 20.

4. Monitorimi

Kontrolli i brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura.
Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit.
Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten efiçente me kalimin e kohës.
Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet: monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, Auditit të Brendshëm.
Procedura nëpërmjet vetëvlerësimit një përdorues i buxhetit ka nevojë për të përcaktuar nëse ka apo jo një sistem të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit me rregullat dhe procedurat që sigurojnë se operacionet janë duke u kryer rregullisht, në mënyrë etike, ekonomike, efikase dhe efektive.
Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit bëhet duke plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit. Çdo nëpunës autorizues për çdo vit duhet të përgatisë një deklaratë "Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm", në të cilën ai do të deklarojë se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimeve dhe objektivave ndërsa

ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike. Kjo deklaratë duhet të mbulojë vitin financiar paraardhës.
Në deklaratë Nëpunësi Autorizues i njësisë publike duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Me nënshkrimin e deklaratës, drejtuesi i njësisë merr përgjegjësinë për vërtetësinë e informacionit të deklaruar. Qëllimi i kësaj deklarate është për të rritur llogaridhënien e menaxhimit dhe për të inkurajuar përpjekjet për përmirësime në sistemin e kontrollit të brendshëm. Raporti vjetor i cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm çdo vit, nëpunësi autorizues i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi te nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave.
Me shkresën nr. 595 prot., datë 28.02.2022, nga Bashkia Selenicë është hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit" i ndryshuar, neni 18, pika 1, dhe Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011, "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike", pika 15.
Me shkresë nr. 595/1 prot., datë 28.02.2022, Bashkia Selenicë ka plotësuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave pyetësorin e vetëvlerësimit në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon menaxhimi financiar dhe kontrolli në përputhje me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 Kapitulli V, Shtojca 2 "Pyetësori i vetë vlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit".
Gjithashtu konstatohet se, nuk ka raportime të menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakt dhe produkti.
-Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
-Nuk ka një plan të veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli III.

5. Informimi dhe komunikimi

Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi që sigurojnë:

- Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
- Një komunikim efektiv, si vertikal, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.
- Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.

- Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet.
Menaxhimit duhet t'i jepen raporte të nevojshme mbi performancën (përmbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efiçiencë dhe efektivitet.
Zhvillimi ose rishikimi i sistemeve të informacionit duhet të bazohet në një plan strategjik për sistemet e informacionit të lidhur me strategjinë e njësisë dhe që ti përgjigjet përmbushjes së objektivave si në nivel aktiviteti ashtu edhe objektivave të përgjithshme të mbarë njësisë publike.
Mbështetja e menaxhimit për zhvillimin e sistemeve të nevojshme të informacionit duhet të shfaqet me angazhimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare. Informacioni është i dobishëm vetëm nëse arrin në kohën e duhur, përmban hollësi të mjaftueshme dhe është i përshtatshëm për përdoruesin.
Në rregulloren e brendshme nuk është e përfshirë mënyra e komunikimit, brenda institucionit dhe procedurat për qarkullimin e informacionit.
Në Bashkinë Selenicë shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike.
Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave.

Vlerësim mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm
Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm publik, kapacitetet audituese që mbulojnë këtë aktivitet, planifikimi, realizimi i programit vjetor të auditimit si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimi, ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga drejtimi.

Organizimi i Njësisë së Auditit të Brendshëm
Në bazë të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik", është krijuar Njësia e Auditimit të Brendshëm (në vijim NJAB), e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm.
Kapaciteti audites i strukturës së NJAB të Bashkisë Selenicë është bazuar në VKM nr. 212, datë 30.03.2012, "Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar.
Sektori e Auditit të Brendshëm funksionon sipas strukturës organizative të miratuar me Urdhrit nr. 8, datë 18.01.2021, të Kryetarit të Bashkisë Selenicë përbëhet nga tre pozicione konkretisht, Përgjegjësi i Njësisë z. A. S., dhe specialistët e auditit znj. Xh. M., znj. S. Gj.

1. Karta e Auditimit të Brendshëm për Njësinë e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Selenicë me nr. 2285 prot., datë 29.09.2017, është dërguar me shkresën nr. 2286 prot., datë 25.10.2017, pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, pika 2.5, Kapitulli II.

2. Plani Strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2021-2023, me shkresën nr. 3131 prot., datë 19.10.2020, përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.1.6.
Bashkëlidhur kësaj shkrese është dërguar edhe planifikimi vjetor për vitin 2021, në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.2. Sipas planit strategjik synohen 5 auditime në vit duke përfshirë edhe zbatimin e rekomandimeve.

3. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm për vitin 2021, është dërguar në DHAB me shkresën nr. 424 prot., datë 11.02.2022, bashkëngjitur dhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit i përgatitur sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.6.

4. Struktura e projekt raporteve dhe e raporteve përfundimtare të auditimit për vitin 2021 është hartuar e plotësuar sipas standardit të vendosur në manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, Pika 4.1.12, Hapi 11.

5. Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të Bashkisë Selenicë janë mbajtur të plotësuara e të administruara në përputhjet me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullit VI, në to është përfshirë i gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme, por në shumicën e tyre mungon Plani i Veprimit të subjekteve të audituara.

Nga auditimi i dokumentacionit të rekrutimit të punonjësve të Njësisë së Auditit të Brendshëm Bashkia Selenicë konstatohet se:

Nr.	Viti 2021	Funksioni	Arsimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
1	A. S.	Përgjegjës i Njësisë	Ekonomist	31	8	2016	Po
2	Xh. M.	Audituese	Ekonomist	6	4	2021	Po
3	S. Gj.	Audituese	Ekonomist	2	1	E pa certifikuar	Po

Vlerësimi mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Selenicë
Sipas planit Strategjik të viti 2021 i nënshtrohen auditimit të plotë, Administrata e Bashkisë, saktësia e veprimeve financiare, Ujësjellës Kanalizime Sh.a Selenicë, pyjet/kullota, licencat, lejet, prokurimet, të cilat janë miratuar nga Përgjegjësi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm mbi bazën e planit vjetor.
Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, (seksioni VI, kreu III, pika 1), programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës. Referencat ligjore të vëna në programet e auditimit kanë reflektuar dispozitat dhe kuadrin ligjor në fuqi.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit për vitin 2021 sipas planifikimit vjetor, janë planifikuar për tu kryer 5 auditime nga të cilat janë realizuar 5 auditime në masën 100% konkretisht është audituar Ujësjellës Kanalizime Sh.a Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare Juridike e Burimeve Njerëzore (Detyrimet e prapambetura), Drejtorinë e Zhvillimit, Bujqësisë dhe Pyje/Kullota

(Procesi i ujitjes), Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve e Licencave dhe Auditim për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme. Në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Nr.	Viti	Objektet e audituara	Përshkrimi i punës së Njësisë së Auditit të Brendshëm
		Ujësjellës Kanalizime Sh.a Selenicë	**Përbërja e dosjes**
		Referuar auditimit të zhvilluar nga Njësia e Auditit të Brendshëm është konstatuar se, Ujësjellës Kanalizime Sh.a Selenicë ka detyrime ndaj punonjësve të për mos likuidimin e pagave në vlerën 3,125,386 lekë për vitin 2019.	Njoftim auditimi dokument nr. 3286 prot., datë 02.11.2020.
			Takimi fillestar datë 09.11.2020.
			Program auditimi nr. 3322, datë 05.11.2020.
			Takim përmbyllës datë 15.02.2021.
			Projekt Raport datë 15.02.2021
			Raport Final nr. 895, datë 23.03.2021.
			Memorandum drejtuar Kryetarit të Bashkisë nr. 929, datë 26.03.2021.
			Urdhër i Kryetarit të Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve nr. 1419, datë 10.05.2021.
1	**2021**		Vlerësim i riskut sipas problematikave i lartë pikë 60.
		Drejtoria e Shërbimeve Financiare Juridike e Burimeve Njerëzore (Detyrimet e prapambetura)	**Përbërja e dosjes**
			Njoftim auditimi dokumenti nr. 2778 prot., datë 15.09.2021.
			Takimi fillestar datë 28.09.2021.
			Program auditimi nr. 2777 prot., datë 15.09.2021.
			Projekt Raport nr. 3714 prot., datë 22.12.2021.
			Raport Final nr. 66 prot., datë 10.01.2022.
			Memorandum drejtuar Kryetarit nr. 134 prot., datë 17.01.2022
2	**2021**		Vlerësimi i riskut sipas problematikave i lartë pikë 45.
		Drejtorinë e Zhvillimit, Bujqësisë dhe Pyje/Kullota (Procesi i ujitjes)	**Përbërja e dosjes**
			Urdhër për fillimin e Administrimit të procesit të ujitjes nr. 1894 prot., datë 17.06.2021.
			Program auditimi nr. 2039 prot., datë 28.06.2021.
			Raport përshkrues konsulence nr. 2862 prot., datë 22.09.2021.
			Akt konstatim nr. 164 prot., datë 03.07.2021.
			Urdhër i Kryetarit për zbatimin e rekomandimeve nr. 3177 prot., datë 26.10.2021.
3	**2021**		Vlerësimi i riskut sipas problematikave i lartë pikë 55.
		Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve e Licencave.	**Përbërja e dosjes**
			Njoftimi auditimi dokument nr. 1245 prot., datë 27.04.2021.
			Takim fillestar datë 04.05.2021.
			Program auditimi nr. 1244 pro., datë 27.04.2021.
			Takim përmbyllës datë 13.08.2021.
			Projekt Raport nr. 2558 prot., datë 20.08.2021.
			Raport Final nr. 2719 prot., datë 07.09.2021.
			Memorandum drejtuar Kryetarit nr. 2760 prot., datë 13.09.2021.
4	**2021**		Vlerësimi i riskut sipas problemeve i lartë pikë 60.
		Auditim për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme	**Përbërja e dosjes**
			Njoftim auditimi dokument 722/2 prot., datë 05.03.2021.
			Akt verifikim me zyrat e marrëdhënieve me publikun nr. 986 prot., datë 01.04.2021.
			Akt verifikim me Drejtorinë e të Ardhurave Pronave Publike Lejeve e Licencave nr. 1045 prot., datë 07.04.2021.
			Akt verifikim me Njësinë Administrative Kotë nr. 30 prot., datë 11.03.2021.
			Program auditimi nr. 722 prot., datë 05.03.2021.
			Raport Final nr. 895 prot., datë 23.03.2021.
			Memorandum drejtuar Kryetarit nr. 1337 prot., datë 04.05.2021.
5	**2021**		Urdhër i Kryetarit për zbatimin e rekomandimeve nr. 1381 prot., datë 06.05.2021.

Në lidhje me planet strategjike dhe planifikimet vjetore për vitin 2021, edhe pse auditimet janë realizuar 100% e atyre të planifikuara konstatohet se, për auditimin e Drejtorisë së Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore, fushat e parashikuara për tu audituar janë:

- Detyrimet e prapambetura;
- Prokurimet publike;

- Zbatimi i buxhetit sistemi i pagesave;

Për sa i përket auditimit të këtyre fushave nuk është kryer auditimi i prokurimeve publike.

Zbatimi i planeve të Auditimit të Brendshëm. Hartimi dhe mbajtja e dokumentacionit të auditimit.

Për veprimtarinë e Sektorit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2021, është raportuar në mënyrë sistematike Kryetarit të Bashkisë Selenicë. Për veprimtarinë e vitit 2021 janë dërguar evidencat e realizimit të auditimeve, me shkresë përcjellëse nr. 424, datë 11.02.2022, të cilat janë dërguar në Ministrinë e Financave (Drejtorinë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm), bashkë me dokumentacionin shoqërues, sipas Manualit të Auditit të Brendshëm.

Pasqyra e realizimit të auditimeve të brendshme për vitin 2021

VITI 2021						
Nr.	**Subjekti i Audituar**	**Numri i rekomandimeve**	**Pranuar**	**Zbatuar**	**Në proces**	**Pa zbatuar**
1	Ujësjellës Kanalizime Sh.a Selenicë	5	5	5	2	-
2	Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave	5	5	5	2	-
3	Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave (Sektori ujitës)	6	6	6	2	-
4	Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore (Struktura organizative pagat)	7	7	7	3	-
Totali		**23**	**23**	**14**	**9**	**0**

Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm por në disa raste konstatohet se:

Në dosjet e audituara, konstatohet se, në 1 rast nuk është zhvilluar takimi i hapur prezantues si dhe në 5 raste nuk janë mbajtur letrat e punës, veprime këto në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, pika 4.1.4 Hapi 3, pika 4.1.8 Hapi 7.

Hartimi i projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit. Për çdo rast si projekt-raportet edhe raportet finale të auditimit janë dërguar pranë subjekteve të audituara me shkresa të protokolluara dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara në manual. Në dosje janë të administruara komentet në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet.

Subjektet e audituara nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, pika 4.1.12, Hapi 11.

Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI, "Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese", në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve, dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimet që do të ndiqen, dhe grupin e auditimit. Në përgjithësi referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjor në fuqi.

Nga Përgjegjësi i NJAB nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin VII, pika 7.1.1 "Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë NJAB.

Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm, duhen bërë vlerësimet e brendshme të cilësisë me përcaktimin nëse politikat dhe procedurat e aplikueshme, janë krijuar dhe zbatuar për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet dhe kodin e etikës.

2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor për vitin 2021.

1. Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023

Nga auditimi i procedurave për hartimin e PBA-së 2021-2023 rezultoi se për realizimin e fazave të përgatitjes ka dalë Urdhri i Titullarit nr. 420, datë 10.12.2019 "Për krijimin e grupit të Menaxhimit Strategjik për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2021-2023" (GMS).

PBA për periudhën 2021-2023 është miratuar në Këshillin Bashkiak me Vendim nr. 80 datë 28.12.2020 "Për miratimin e Buxhetit Afatmesëm 2021-2023", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë më shkresën nr. 1236/1, datë 12.01.2021.

Në fazën përfundimtare duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor trevjeçar sipas programeve si për shpenzimet korrente, ashtu edhe për investimet dhe të ardhurat.

Faza e parë e PBA-së është miratuar në Këshillin Bashkiak në muajin Qershor, me VKB nr. 39. datë 30.06.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë më shkresën nr. 724/1, datë 14.07.2020.

Titulli i gjetjes 3: *Parregullsi në hartimin e programit buxhetor afatmesëm sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor dhe rregullativ në fuqi.*

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me hapat e ndjekura për hartimin e PBA-së dhe dokumentimit të procesit rezulton se:

- Nuk është miratuar nga KB raporti i vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave;
- Nuk janë përgatitur dhe dërguar për miratim në KB Tavanet Përgatitore të PBA-së 2021-2023, si rezultat nuk ka miratim të tavaneve për çdo program në Këshillin Bashkiak brenda datës 15 mars 2020;
- Nuk janë ngritur ekipet e menaxhimit të programeve (EMP);
- Nuk është miratuar Udhëzim i Brendshëm për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm;
- Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programeve nuk kanë paraqitur kërkesat buxhetore sipas programit te Kordinatori i GMS;
- Projekt dokumenti i PBA 2021-2023, është miratuar jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 10 datë 28.02.2020 të MFE;
- Nuk është dokumentuar ndjekja e hapave të tjera në vijim për të publikuar dokumentin e parë të PBA-së brenda datës 5 korrik 2020;
- Në dokumentin e PBA-së nuk janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si dhe nuk është bërë analiza e zërave të buxhetit në tre vite dhe tendencat nga viti në vit për tre vitet që përfshin kjo PBA.
- Për hartimin e programit buxhetor afatmesëm dhe projektbuxhetit vjetor nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të "Buxhetimit me pjesëmarrje", pasi mungojnë dokumentet e evidentimit të kryerjes së këtyre konsultimeve.
- Buxhetet nuk janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, ndërmarrja e shërbimeve dhe ujësjellësi, etj, gjë që vërteton se prej tyre nuk janë marrë kërkesat për nevojat reale, ku mbi bazën e tyre të hartohej buxheti.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore" si dhe përcaktimet e Udhëzimit nr. 10, datë 28.02.2020 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023".

Kriteri: Ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", nenet 33,34,35,36,37.
Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, neni 12.
Udhëzimit nr. 10, datë 28.02.2020 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023".
Ndikimi: PBA nuk është hartuar në përputhje me përcaktimet dhe udhëzimet e MFE.
Shkaku: Mos zbatim i përcaktimeve ligjore dhe mos ndjekja e hapave sipas udhëzuesve të MFE.
Rëndësia: E Mesme
Rekomandim: Titullari i Bashkisë Selenicë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare të marrë të gjitha masat për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm:
-Të hartojnë dhe të miratojnë Udhëzimi i Brendshëm për hartimin e PBA-së;
- Të përgatisë dhe të dërgojë për miratim në KB Tavanet Përgatitore të PBA-së brenda datës 15 mars të vitit përkatës;
- Të ngrihen Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) dhe të dokumentohet puna e tyre në hartimin e PBA-së;
- Të zbatohen afatet në miratimin e projekt dokumentit të PBA-së;
- PBA të hartohet mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, njësitë e varësisë, etj;
- Procesi i ndjekur për hartimin e PBA-së të dokumentohet në çdo fazë të tij, si dhe të bëhet publikimi brenda afateve;
- Në dokumentacionin që shoqëron procesin e hartimit të PBA-së të trajtohen risqet financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat cenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë.

2. Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2021
Buxheti i vitit 2021 është miratuar në Këshillin Bashkiak si dhe është konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarku Vlorë , konkretisht, *për vitin 2021*, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 80 datë 28.12.2020 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 1236/1 Prot. datë 2.01.2021 konkretisht pasqyra në vijim:

Tabela nr. 1: Planifikimi i buxhetit për vitin 2021, Bashkia Selenicë

Planifikimi i të ardhurave 2021		**Planifikimi i shpenzimeve 2021**	
Burimi i të ardhurave	000/ lekë	Emërtimi i zërave	000/ lekë
Të ardhura të planifikuara për vitin 2021	100,020	Art. 600 Paga	126,825
Te ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm e të planifikuara për shpenzim për vitin 2021	15,000	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shend.	23,200
Total të ardhurat e veta	**115,020**	Art.602 Shpenzime operative	105,917
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar.	24,765	Art.604 Transferime korrente te brendshme	1,200
Të ardhura të trashëguara nga granti i kushtëzuar (transferua specifike 600, 601, 602 etj.).	5,235	606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	
Grant i ri i çelur për llogari të vitit 2021	170,738	Art.230-231 Investime	116,391
Transfertë specifike e çelur për llogari të vitit 2021	73,368	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	15,593
Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit	**274,106**		
Totali të Ardhurave	**389,126**	**Totali Shpenzimeve**	**389,126**

Burimi:Bashkia Selenicë

Rezulton se buxheti i vitit 2021 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **389,126 mijë lekë**.

Tabela nr.2: Pasqyra e planit të buxhetit krahasuar me PBA për vitin 2021

Nr.	Emërtimi	Plani i Buxhetit 2021	Plani i vitit 2021 në PBA	Diferenca
1	Shpenzime personeli (600, 601)	150,025	152,025	
2	Shpenzime korrente (602,604,606,609)	122,710	124,811	+ 2101
3	Shpenzime investimi (230/231)	116,391	115,000	- 1,391
Totali		**389,126**	**389,836**	**+ 710**

Burimi:Bashkia Selenicë

Në planin faktik të buxhetit 2021 në krahasim me PBA 2021-2023, ka diferencë në shumën +710 mijë lekë, të cilat janë fonde të pa planifikuara në PBA. Kjo shtesë është bërë referuar ndryshimit në zërin të ardhura të tjera miratuar me VKB nr. 80 datë 28.12.2020.

3. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizmit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Titulli i gjetjes 4: *Parregullsi në ndryshimet e bëra në buxhetet vjetore të Bashkisë Selenicë.*

Situata: Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Vlorë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.
- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Nga auditimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Selenicë, konstatohet se buxheti vjetor ka pësuar ndryshime gjatë vitit, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Selenicë.

Ndryshimet buxhetore gjatë vitit ushtrimor 2021 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 3: Pasqyra e ndryshimeve të buxhetit gjatë vitit 2021 (000/ lekë)

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2021				**Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2021**				
Burimi i të ardhurave	**Buxheti fillestar, miratuar me VKB**	**Buxheti shtesë, miratuar me VKB**	**Vlera në 000/lekë**	**Emërtimi i zërave**	**Buxheti fillestar, miratuar me VKB**	**Buxheti shtesë miratuar me VKB**	**Buxheti pakesimet miratuar me VKB**	**Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)**
	1	**2**	**1+2**		**3**	**4**	**5**	**3+4-5**
Të ardhura të planifikuara për vitin 2021	100,020	0	100,020	Art. 600 Paga	132,157	11,226		**143,383**
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe te	15,000	1.122	16122	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	23,800	2,306		**26,106**

planifikuara për shpenzim për vitin 2021								
Total të ardhurat e veta	**115,020**	**1,122**	**116,142**	Art.602 Shpenzime operative	106,130	624	14,560	**92,194**
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	24,765	2,888	27,653	Art.604 Transferime korrente të brendshme	1,200	5,258		**6,458**
Të ardhura të trashëguara nga transferta specifike	5,235		5,235	Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	158,241			**158,241**
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2021	170,738	5,258	175,996	Art. 230-231 Investime	171,390	47,440	33,110	**185,720**
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2021	73,368	2,272	75,640	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	15,593		7,644	**7,949**
Buxheti i shtetit	**219,385**		**219,385**					
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit te shtetit	**274106**	**10,418**	**284,524**					
Totali të Ardhurave	**608,511**	**11,540**	**620,051**	**Totali Shpenzimeve**	**608,511**	**66,854**	**55,314**	**620,051**

Burimi:Bashkia Selenicë

Të ardhurat dhe shpenzimet përfundimtare të miratuara janë në shumën **620,051 mijë lekë**.

Nga auditimi i ndryshimeve të bëra në buxhet rezulton se:
- Gjatë vitit buxhetor 2021 ka patur lëvizje të konsiderueshme, gjë që tregon se planifikimi i buxhetit nuk është plotësisht efektiv;
- Ndryshimet nuk janë shoqëruar me relacion shpjegues lidhur me arsyet e ndryshimit;
- Nuk ka një analizë se si ndikon ky ndryshim në realizimin e objektivave të synuar të bashkisë;
- Kryetari i Bashkisë Selenicë nuk ka paraqitur brenda datës 31 mars të vitit pasardhës raport me shkrim pranë Këshillit Bashkiak për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 47[6], ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 44[7].

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 47.
Ligji 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 44.

Ndikimi: Ndryshimet e shpeshta dhe të pa argumentuara të buxhetit ndikojnë drejtpërsëdrejti në realizimin e objektivave dhe angazhimeve të planifikuara të bashkisë.

Shkaku: Mos planifikim dhe mos hartim i saktë i buxhetit vjetor duke u mbështetur në nevojat e strukturave si dhe mos koordinim me objektivat dhe angazhimet e synuara.

Rëndësia: E Mesme

[6] Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, edhe propozimet përkatëse për ndryshimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, që ka miratuar buxhetin e vitit. Procedura e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore është e njëjtë me atë të vendimit për miratimin e buxhetit vjetor.

[7] Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

Rekomandim: Titullari i Bashkisë Selenicë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare të marrin masa që:
- Për ndryshimet e bëra në buxhetin vjetor të hartohet relacioni shpjegues lidhur me arsyet e ndryshimit si dhe të bëhet analiza e duhur se si ndikojnë ndryshimet në realizimin e objektivave të synuara të bashkisë;
- Të përgatitet dhe të paraqitet brenda afateve raporti përkatës pranë Këshillit Bashkiak për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë.

4. Saktësia e realizmit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Vlorë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.
Gjatë vitit 2021 janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Vlorë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar të realizuar me Vendim të KB, ose të diktuara nga Transferta e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin është respektuar disiplina buxhetore.
Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.4: Pasqyra e buxhetit përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Selenicë, për vitin 2021

000/ lekë

Nr.	Emërtimi	2021		
		Plan	Fakt	Real.%
1	Artikulli - 600 Paga	143,383	133,919	93 %
2	Artikulli – 601 Sig. shoqërore & shëndetësore	26,106	23,259	89%
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	97,452	62,618	64,2%
4	Artikulli - 604 Transferta korrente të brendshme	1,200	300	36%
5	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare (Ndihma ek. dhe PAK)	158,241	155,510	98.2%
6	Artikulli - 230 Projekte	5,000	4,514	90.3%
7	Artikulli - 231 Investime	180,720	152,512	84.4%
8	Artikulli – 609 Emergjenca	7,949	753	**9%**
	Totali	**620,051**	**533,385**	**86%**

Burimi:Bashkia Selenicë

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme, niveli i realizmit të treguesve të buxhetit për vitin 2021 paraqitet i realizuar 533,385 mijë lekë nga 620,051 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 86%.
Në këtë masë realizimi ka ndikuar niveli i realizimit në zërat e buxhetit si vijon:

- Shpenzimet për paga dhe sigurime Art. 600-601 janë realizuar 157,178 mijë lekë nga 169,489 mijë lekë ose në masën 93%. Realizimi në këtë nivel për këto zëra shpenzimesh ka ardhur nga mos plotësimi i plotë i organikës.
- Shpenzimet operative Art. 602 është realizuar 62,618 mijë lekë nga 92,194 mijë lekë ose në masën 68%;
- Shpenzimet për investime Art. 231 janë realizuar 152,512 mijë lekë nga 180,720 mijë lekë të planifikuara ose në masën prej 84.4%.

Buxheti i vitit 2021 është realizuar në masën 86%. Këto mos realizime kanë ardhur si rezultat i vonesave në prokurime dhe në lidhje kontratash, apo realizime të vogla të të ardhurave të planifikuara. Mosrealizimet në programet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë tregon se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale.
Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit e zënë shpenzimet për investime 40.4% ndjekur nga shpenzimet për paga 35.4%, dhe shpenzimet operative 16.6%, tregues të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 5: Pasqyra mbi peshën e shpenzimeve sipas zërave ndaj totalit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Fakt	Pesha ndaj totalit përfshirë 606	Pesha ndaj totalit pa 606
1	Artikulli - 600 Paga	133,919	25.1	35.4
2	Artikulli – 601 Sig. shoqërore & shëndetësore	23,259	4.4	6.2
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	62,618	11.7	16.6
4	Artikulli - 604 Transferta korrente të brendshme	300	0.1	0.1
5	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare (PAK)	155,510	29.2	0.0
6	Artikulli - 230 Projekte	4,514	0.8	1.2
7	Artikulli - 231 Investime	152,512*	28.6	40.4
8	Artikulli – 609 Emergjenca	753	0.1	0.2
	Totali	**533,385**		

*Burimi:Bashkia Selenicë, përpunoi grupi i auditimit *Në artikullin investime është përfshirë edhe vlera 7,644 mijë e investimit për riparimin e shkarkuesit Harvala.*

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës
Në fillim të vitit 2021 fondi rezervë dhe i kontigjencës është planifikuar në masën 15,593,046 lekë. Ky fond është realizuar në vlerën 8,397,915 lekë ose në masën 54% (vlera). Fondi rezervë dhe i kontigjencës është përdorur për investim në riparimin e shkarkuesit Harvala në vlerën 7,644,437 lekë, për shpërblimin e 5 qytetarëve në vlerën 692,278 lekë, qira banesa sociale në vlerën 61,200 lekë në zbatim të VKM nr. 329, datë 16.05.2020 *"Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare".*

5. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve
Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikoje procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.
Me fondet e vitit buxhetor 2021, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të pa likuiduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministritë e linjës apo FZHSH sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Detyrimet e pa likuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës "*Detyrimet e prapambetura*", sipas llojeve të detyrimeve të grupuara në raportin vjetor të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Tabela nr. 6: Raportimi në MFE i detyrimeve të prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2021

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur nga viti 2020 (në lekë)	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021 (në lekë)	Total detyrime (në lekë)	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2021 (në lekë)	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2021 (në lekë)
a	**1**	**2**	**3=1+2**	**4**	**5=3-4**
Investime	58,338,107	42,202,840	100,540,947	59,506,811	41,034,136
Vendime gjyqësore	20,215,412	2,216,957	22,432,369	8,320,000	14,112,369
Mallra dhe shërbime	20,434,922	6,376,598	26,811,520	4,762,635	22,048,885
Totali	**98,988,441**	**50,796,395**	**149,784,836**	**72,589,446**	**77,195,390**

Burimi:Bashkia Selenicë

Bashkia Selenicë ka dërguar në MFE raportimin e detyrimeve të prapambetura për vitin 2021, paraqitur në tabelën e mësipërme. Rezulton se detyrimet në mbyllje **të vitit 2021** janë në shumën **77,195,390 lekë.** Detyrimet e prapambetura të raportuara në MFE janë të rakorduara me Degën e Thesarit Vlorë si dhe rakordojnë me detyrimet e paraqitura në bilanc në llogaritë e klasës 4 (**77,195,390**). Detyrimet e prapambetura të detajuara paraqiten në Anekset nr. 1-3 bashkëlidhur.
Pjesë e detyrimeve të prapambetura të paraqitura më sipër janë edhe detyrimet e prapambetura nga buxheti i shtetit, që janë pjesë e zërit "*Investime*". Përkatësisht detyrimet e prapambetura për investime kanë vlerën totale **41,034,136 lekë** nga të cilat 1**8,365,962 lekë janë detyrime të bashkisë** dhe **22,668,174 lekë janë detyrime nga buxheti i shtetit**.
Detyrimet nga buxheti i shtetit përbëhen si vijon:
1. Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit Selenicë-Kotë-Armen, vlera e detyrimit 4,375,254 lekë, subjekti "B.";
2. Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit Selenicë-Kotë-Armen, vlera e detyrimit 17,012,628 lekë, subjekti "S.";
3. Kolaudim i rrjetit të ujësjellësit Selenicë-Kotë-Armen, vlera e detyrimit 285,331 lekë, subjekti "D." SHPK;
4. Supervizim i rikonstruksion të rrjetit të ujësjellësit Selenicë-Kotë-Armen, vlera e detyrimit 994,961 lekë, subjekti "P.".
Konkluzion: Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se, në fund të periudhave ushtrimore 2020-2021, Bashkia Selenicë ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në vlera relativisht të konsiderueshme, përkatësisht në fund të vitit 2020 detyrimet janë në vlerën **98,988,441** lekë, dhe në fund të vitit 2021 janë në vlerën **77,195,390 lekë** nga të cilat **54,527,216 lekë detyrime nga buxheti i bashkisë dhe 22,668,174 lekë detyrime nga buxheti i shtetit**.
Nga analiza e detyrimeve të prapambetura për vitin 2021, të paraqitura në Anekset nr. 2.2/1-2.2/2-2.2/3 bashkëlidhur rezulton që, në fund të vitit 2021 janë të pa likuiduara gjithsej 106 raste me vlerë **77,195,390** lekë. Këto detyrime janë të krijuara që nga vitet 2010 e në vijim si dhe disa prej tyre të trashëguara nga ish-komunat. Sipas zërave detyrimet janë të ndara si vijon:

a. 30 fatura për shpenzime për investime në vlerën 41,034,136 lekë (kryesisht sistemin asfaltim i infrastrukturës rrugore, rehabilitim rrjeti ujitës, ndërtim ujësjellësi apo kanalesh ujitëse,

mbikëqyrje dhe kolaudim), për të cilat ka patur likuidime pjesore në rastet që kanë patur dokumentacion ligjor.

b. 49 fatura për mallra e shërbime në vlerën 22,048,885 lekë. Janë kryer likuidime të plota dhe të pjesshme vetëm për faturat e viteve 2019-2021 dhe jo për faturat para kësaj periudhe pasi për to nuk ekziston dokumentacion ligjor.
c. 27 vendime gjyqësore në vlerë 14,112,369 lekë, për të cilat ka patur likuidime të plota dhe pjesore gjatë vitit 2021.

Analiza dhe shlyerja e detyrimeve për vendimet gjyqësore.

Detyrimet e prapambetura për vendimet gjyqësore sipas vitit të krijimit, objektit të padisë, likuidimeve të kryera, gjendjet në fund për vitin 2021 paraqiten në Aneksin nr. 2.2/2.

Nga auditimi i dokumentacionit për detyrime për vendime gjyqësore, rezulton se Bashkia Selenicë ka trashëguar detyrime të prapambetura që nga viti 2010. Këto detyrime janë:

- Vendime gjyqësore për detyrime kontraktuale (6 vendime me vlerë 6,932,696 lekë);
- Vendime për largime nga puna (28 vendime me vlerë 7,127,593 lekë);
- Vendime për detyrime përmbarimi (2 vendime me vlerë 52,080 lekë).

Vlera e vendimeve gjyqësore në fund të vitit 2020 llogaritet 20,215,412 lekë. Gjatë vitit 2021 janë shtuar 4 vendime për largime nga puna në vlerën 2,216,957 lekë ndërsa janë likuiduar plotësisht apo pjesërisht 30 vendime në vlerën 8,320,000 lekë, mbetet për t'u likuiduar vlera 14,112,369 lekë.

Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Me miratimin e buxhetit vjetor janë miratuar dhe projektet për investime. Investimet kryesisht janë me burim financimi nga transferta e pakushtëzuar, të ardhurat e veta të Bashkisë Selenicë, si dhe nga buxheti i shtetit.

Në vitin 2021 për realizimin e investimeve janë përdorur fondet e Bashkisë nga të ardhurat e veta dhe transferta e pakushtëzuar e buxhetit të shtetit në rehabilitim kanalesh ujitëse, rehabilitim ujësjellsa, sistemim, asfaltim dhe rikonstruksion rrugësh dhe lagjesh, rehabilitim ure dhe blerje materialesh të ndryshme.

Për vitin 2021 janë planifikuar fonde për investime në shumën 185,720 mijë lekë për 11 projekte me burim financimi nga të ardhurat dhe transferta e pakushtëzuar. Vlera e kontratave të lidhura për vitin 2021 është 72,823,574 lekë. Nga këto kontrata është likuiduar vlera 57,422,044 lekë dhe ka mbetur pa u likuiduar vlera prej 19,401,530 lekë. Nga buxheti i shtetit për vitin 2021 është financuar vetëm 1 projekt për financim të përmirësimit të kushteve për komunitetin e pa favorizuar me vlerë kontrate 14,961,413 lekë dhe është likuiduar vlera 14,953,018 lekë, mbetet për t'u likuiduar vlera 8,395 lekë.

Vlera e kontratave të pa likuiduara deri në fund të vitit 2021 duke përshirë dhe kontratat e lidhura para vitit 2021 është 64,839,887 lekë. Projektet e investimeve me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likuidimet e tyre paraqiten në Aneksin nr. 2.2/4 bashkëlidhur.

Burimet e financimit të buxhetit vjetor

Tabela nr. 7: Realizimi i buxhetit për vitin 2021 sipas burimit të financimit

000/lekë

Nr.	Emërtimi	2021		
		Plan	Fakt	Real.%
1	**Paga 600**	**143,383**	**133,919**	**93%**
a	Grant i kushtëzuar	5,332	5,288	99.2

b	Grant i pakushtëzuar + transferta specifike	121,948	113,225	92.8
c	Të ardhura	16,103	15,406	95.7
2	**Sigurime shoqërore 601**	**26,106**	**23,259**	**89%**
a	Grant i kushtëzuar	600	596	99.3
b	Grant i pakushtëzuar + transferta specifike	23,200	20,615	88.9
c	Të ardhura	2,306	2,048	88.8
3	**Shpenzime Operative 602**	**97452**	**62,618**	**64.2%**
a	Grant i kushtëzuar	213	24	11.27
b	Grant i pakushtëzuar + transferta specifike	66,625	39,118	58.71
c	Të ardhura	30,614	23,476	76.68
4	**Transferta korrente të brendshme 604**	**1,200**	**300**	**36%**
a	Grant i kushtëzuar			
b	Grant i pakushtëzuar + transferta specifike			
c	Të ardhura	1,200	300	25
5	**Nd. Ekonomike 606**	**158,241**	**155,510**	**98.3**
a	Grant i kushtëzuar	158,241	155,510	98.3
b	Grant i pakushtëzuar + transferta specifike			
c	Të ardhura			
6	**Investime 230-231**	**185,720**	**157,026**	**0.8**
I	Buxheti i bashkisë (Grant + të ardhura)	130,721	102,506	78.4
a	Grant i pakushtëzuar + transferta specifike	69,410	61,275	88.3
b	Të ardhura	61,311	41,231	67.2
II	Ministritë e linjës + FZHR	54,999	54,520	99.1
7	**Emergjenca 609**	**7,949**	**753**	**9,5%**
a	Grant i kushtëzuar			
b	Grant i pakushtëzuar + transferta specifike	3,342	753	0.2
c	Të ardhura	4,607		
	Bashkia	**620,051**	**533,385**	**86.0**

Burimi: Bashkia Selenicë

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se **me të ardhurat e veta** kjo bashki përballon në fakt:
- Shpenzimet në artikullin 600 "paga e shpërblime" në masën 11.5% .
- Shpenzimet në artikullin 601 "kontributin për sigurime shoqërore e shëndetësore" në masën 8.8%.
- Shpenzimet në artikullin 602 "shpenzime operative për mallra e shërbime" në masën 37.4 %.
- Shpenzimet në artikullin 230-231 "investime" në masën 26.2%.

Referuar burimit të financimit, shpenzimet buxhetore në total janë përballuar:
Për vitin 2021, nga të ardhurat e veta në shumën 82,461 mijë lekë ose në masën 15.4%, nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta specifike në shumën 234,986 lekë ose në masën 44 %, nga transferta e kushtëzuar në shumën 161,418 mijë lekë ose në masën 30.2 %, nga Ministritë e Linjës në shumën 54,540 mijë lekë ose në masën 10.2%.
Pra duke u nisur nga burimi i financimit rezulton se rolin kryesor në financimin e buxhetit vjetor për funksionet e kësaj njësie vendore, kryesisht përballohen nga fondet e alokuara nga buxheti i shtetit dhe në masë të vogël nga të ardhurat e veta rreth 15%.

<u>Vështirësia financiare</u>

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	**Borxhe (a+b)**	**0**		
a	**Hua sfatgjatë**	**0**		
b	**Hua afatshkurtër**	**0**		

II	**Detyrime (a+b+c)**	**54,527,216**		**13.61%**
a	**Shpenzime korrente**	**22,048,885**		
a.1	Mallra dhe shërbime	21,749,63		
a.2	Paga dhe sigurime	299,262		
b	**Shenzime kapitale**	**18,365,962**		
b.2	Subjekte private	18,365,962		
c	**Vendime gjyqësore**	**14,112,369**		
c.1	Marrëdhënie pune	7,179,833		
c.2	Mallra dhe Shërbime	6,932,536		
III	**Totali (I+II)**	**54,527,216**	**400,697,100**	**13.61%**

Vështirësia financiare e Bashkisë Selenicë është llogaritur referuar përcaktimeve të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", kreu XI "Vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre", neni 55. Referuar pikës 1 të nenit "Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet me probleme financiare kur në një muaj të caktuar të vitit buxhetor konstatohen vonesa prej më shumë se 30 ditësh në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta dhe kur detyrimet e konstatuara dhe të papaguara përbëjnë 15% të shpenzimeve vjetore të miratuara". Nga të dhënat e audituara në Bashkinë Selenicë dhe të paraqitura në tabelën më sipër vlera e detyrimeve të prapambetura në Bashkinë Selenicë më 31.12.2021 është 13.61%.

6. Raportet e Monitorimit

Për vitin 2021 nga bashkia Selenicë është përgatitur 1 raport 8-mujor për monitorimin e procesit të zbatimit të buxhetit.

Raporti i monitorimit 8 mujor është dërguar pranë MFE, me shkresën nr. 2931 Prot. datë 30.09.2021.

Konkluzion: Bashkia Selenicë për vitin 2021 ka hartuar dhe dërguar në MFE vetëm një raport monitorimi. Ky raport paraqet vetëm realizimin e shpenzimeve për 8 mujorin e parë të vitit 2021. Raportet e monitorimit nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", pasi nuk është plotësuar asnjë nga anekset përkatëse. Nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezulton që raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit të jenë paraqitur në këshill sipas përcaktimeve të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 48. Kryetari i Bashkisë Selenicë nuk ka miratuar rregullat specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore".

Titulli gjetjes 5: *Mbi realizimin dhe zbatimin e buxhetit për periudhën objekt auditimi.*

Situata:

1. Nga auditimi mbi nivelin e realizmit të treguesve të buxhetit për vitin 2021 rezulton se, buxheti është realizuar në masën 86%.

Në nivelin e realizimit ka ndikuar realizimi në zërat e buxhetit si vijon:

- Shpenzimet për paga dhe sigurime Art. 600-601, është realizuar në masën 93%. Realizimi në këtë nivel për këto zëra shpenzimesh ka ardhur nga mos plotësimi i plotë i organikës.
- Shpenzimet operative Art. 602, është realizuar në masën 68%;
- Shpenzimet për investime Art. 231, është në masën prej 84.4%.

Gjithashtu, mos realizimi ka ardhur edhe si rezultat i vonesave në zhvillimin e procedurave të prokurime dhe në lidhje kontratash. Mosrealizimet në programet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë tregon se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumetuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale.

Peshën specifike me të madhe të shpenzimeve në buxhet ndaj totalit e zënë shpenzimet për investime 40.4% ndjekur nga shpenzimet për paga 35.4%, dhe shpenzimet operative 16.6%,

2. Nga auditimi konstatohet se Bashkia Selenicë ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në vlera relativisht të konsiderueshme, përkatësisht në fund të vitit 2020 detyrimet janë në vlerën **98,988,441** lekë, dhe në fund të vitit 2021 janë në vlerën **77,195,390 lekë** nga të cilat **54,527,216 lekë detyrime nga buxheti i bashkisë dhe 22,668,174 lekë detyrime nga buxheti i shtetit**.

Nga analiza e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021 janë të pa likuiduara gjithsej 106 raste me vlerë **77,195,390** lekë. Këto detyrime janë të krijuara që nga vitet 2010 e në vijim si dhe disa prej tyre të trashëguara nga ish-komunat. Sipas zërave detyrimet janë të ndara si vijon:

d. 30 fatura për shpenzime për investime në vlerën 41,034,136 lekë (kryesisht sistemin asfaltim i infrastrukturës rrugore, rehabilitim rrjeti ujitës, ndërtim ujësjellësi apo kanalesh ujitëse, mbikëqyrje dhe kolaudim), për të cilat ka patur likuidime pjesore në rastet që kanë patur dokumentacion ligjor.
e. 49 fatura për mallra e shërbime në vlerën 22,048,885 lekë. Janë kryer likuidime të plota dhe të pjesshme vetëm për faturat e viteve 2019-2021 dhe jo për faturat para kësaj periudhe pasi për to nuk ekziston dokumentacion ligjor.
f. 27 vendime gjyqësore në vlerë 14,112,369 lekë, për të cilat ka patur likuidime të plota dhe pjesore gjatë vitit 2021.

Nga auditimi i dokumentacionit për detyrime për vendime gjyqësore, rezulton se Bashkia Selenicë ka trashëguar detyrime të prapambetura që nga viti 2010. Këto detyrime janë:

- Vendime gjyqësore për detyrime kontraktuale (6 vendime me vlerë 6,932,696 lekë);
- Vendime për largime nga puna (28 vendime me vlerë 7,127,593 lekë);
- Vendime për detyrime përmbarimi (2 vendime me vlerë 52,080 lekë).

Vlera e vendimeve gjyqësore në fund të vitit 2020 llogaritet 20,215,412 lekë. Gjatë vitit 2021 janë shtuar 4 vendime për largime nga puna në vlerën 2,216,957 lekë ndërsa janë likuiduar plotësisht apo pjesërisht 30 vendime në vlerën 8,320,000 lekë, mbetet për t'u likuiduar vlera **14,112,369 lekë**.

Për vitin 2021 janë planifikuar fonde për investime në shumën 185,720 mijë lekë për 11 projekte me burim financimi nga të ardhurat dhe transferta e pakushtëzuar. Vlera e kontratave të lidhura për vitin 2021 është 72,823,574 lekë. Nga këto kontrata është likuiduar vlera 57,422,044 lekë dhe ka mbetur pa u likuiduar vlera prej 19,401,530 lekë. Nga buxheti i shtetit për vitin 2021 është financuar vetëm 1 projekt për financim të përmirësimit të kushteve për komunitetin e pa favorizuar me vlerë kontrate 14,961,413 lekë dhe është likuiduar vlera 14,953,018 lekë, mbetet për t'u likuiduar vlera 8,395 lekë.

Vlera e kontratave të pa likuiduara deri në fund të vitit 2021 duke përshirë dhe kontratat e lidhura para vitit 2021 është 64,839,887 lekë.

Vlera e detyrimeve të prapambetura në Bashkinë Selenicë më 31.12.2021 është **13.61%** të shpenzimeve vjetore të miratuara.

3. Nga auditimi rezulton se **me të ardhurat e veta** Bashkia Selenicë përballon:

- Shpenzimet në artikullin 600 "Paga e shpërblime" në masën 11.5% .

- Shpenzimet në artikullin 601 “Kontributin për sigurime shoqërore e shëndetësore” në masën 8.8%.
- Shpenzimet në artikullin 602 “Shpenzime operative për mallra e shërbime” në masën 37.4 %.
- Shpenzimet në artikullin 230-231 “Investime” në masën 26.2%.

4. Bashkia Selenicë për vitin 2021 ka hartuar dhe dërguar në MFE vetëm një raport monitorimi. Ky raport paraqet vetëm realizimin e shpenzimeve për 8 mujorin e parë të vitit 2021.

Raportet e monitorimit nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", pasi nuk është plotësuar asnjë nga anekset përkatëse. Nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezulton që raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit të jenë paraqitur në Këshill sipas përcaktimeve të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48. Kryetari i Bashkisë Selenicë nuk ka miratuar rregullat specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore".

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65; ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40,42,48.

Udhëzim i MFE nr. 09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3.

Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore".

Ndikimi: Realizim jo të kënaqshëm të shpenzimeve në disa zëra buxheti, raportim jo i rregullt i monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Shkaku: Mos programimi i buxhetit mbi bazë prioritetesh dhe nevojash reale dhe ndryshimet e shpeshta e bëjnë të paqëndrueshëm dhe jo efektiv procesin e buxhetimit, ndërsa mos likuidim i detyrimeve sjell rritjen e borxhit që ka Bashkia ndaj të tretëve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Financiare në bashkëpunim me Ekipet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara. Planifikimi të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim efiçent i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Shërbimeve Financiare të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

Të monitorohet me kujdes zbatimi i buxhetit si dhe të hartohen raportet periodike të monitorimit duke plotësuar të gjitha anekset përkatëse, të cilat më pas të paraqiten në Këshillin Bashkiak si dhe të dërgohen në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme lidhur me realizimin dhe zbatimin e buxhetit ngarkohen me përgjegjësi, Kryetari i Bashkisë Selenicë z. P. B. dhe Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare L. H..

7. Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre dhe borxhi tatimor

Struktura e Bashkisë Selenicë për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore
Për vitin 2021, Struktura organizative e Bashkisë Selenicë është miratuar me Urdhrin e Kryetarit nr. 08 datë 18.01.2021. Referuar këtij urdhri Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave ka patur në përbërjen e saj 7 punonjës, 1 Drejtor, 1 Përgjegjës Sektori dhe 7 specialistë/inspektor për taksat dhe tarifat vendore.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve
Titulli i gjetjes 6: *Mbi planifikimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Selenicë.*
Situata: Për vitin 2021 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Selenicë është miratuar me VKB-në nr. 71, datë 30.11.2020 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Selenicë, administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2021".
Tabela nr.2.2/1: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Selenicë, viti 2021 në lekë

Nr.	Lloji i Taksës	Viti 2021		
		Plan	Fakt	%
1	**Tokë Bujqësore**	**22,607,037**	**11,596,812**	**51,3%**
2	**Takse Ndërtese (Biznesi+familje)**	**5,695,438**	**5,274,847**	**92,6%**
a	Biznesi i madh	**610,200**		
b	Taksa biznesi vogël	1,410,238		
c	Familjet	3,675,000		
3	**Taksë Trualli**	**3,441,380**	**3,080,393**	**89,5%**
a	Biznesi i madh	2,794,320		
b	Biznesi i vogël	157,060		
c	Familje	490,000		
4	**Tarifë Pastrimi**	**11,362,000**	**8,406,908**	**74%**
a	Biznesi i madh	6,565,000		
b	Biznesi i vogël	2,087,000		
c	Familje	3,588,000		
5	**Tarifë Gjelberimi**	**3,725,000**	**1,618,250**	**43,4%**
a	Biznesi i madh	3,528,000		
b	Biznesi i vogël	97,000		
c	Familje	100,000		
6	**Tarifë Ndriçimi**	**80,000**	**85,241**	**106,6%**
a	Biznesi i madh	70,000		
b	Biznesi i vogël	50,600		
c	Familje	22,400		
7	**T. Ndk. infrastrukturë mjetet, ndërtesat**	**7,110,845**	**7,116,494**	**100%**
8	**Tarifë ndotje, përmirësim mjedisi**	**33,879,000**	**36,203,844**	**107%**
a	Biznesi i madh	33,555,000		
b	Biznesi vogël	324,000		
9	**Qira Kullote**	**5,247,300**	**5,463,123**	**104%**
a	Antenat	1,548,000		
b	Kullote	3,669,300		
10	**Hapësirë Publike**	**100,000**	**83,180**	**83,2%**
11	**Vaditje**	**2,500,000**	**3,535,855**	**142%**
12	**Leje Shfrytëzimi**	**1,200,000**	**555,000**	**45,8%**
13	**Tarifë për therje mishi**	**30,000**	**0**	**0%**
14	**Tarifë Shërbimi (Vërtetime etj)**	**6,000**	**7,350**	**122%**

15	**Leje Transporti**	**450,000**	**341,225**	**75,8%**
16	**Tarifë Parkimi**	**257,000**	**102,150**	**39,7%**
17	**Taksë Tabele**	**40,000**	**27,190**	**67,9%**
18	**Debitorë ndër vite**	**0**	**5,211**	
19	**Tatim i thjeshtuar mbi fitimin**	**50,000**	**147,190**	**294%**
20	**Taksë regjistrimi e mjeteve**	**2,000,000**	**2,892,506**	**144,6%**
21	**Renta Minerare**	**900,000**	**1,913,859**	**212%**
22	**T.A.P**	**0**	**5,438,723**	
23	**Gjoba Policia Bashkiake etj**	**50,000**	**445,567**	
	GJITHSEJ (1+2+3+... 23)	**100,731,000**	**94,335,918**	**94%**

Burimi: Bashkia Selenicë, përpunoi grupi i auditimit

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Selenicë paraqitet në masën 94%, nga 100,731 mijë lekë të parashikuara janë realizuar 94,336 mijë lekë (minus 6,359 mijë lekë).
Në qoftë se analizojmë të dhënat e tabelës më sipër vërehet se të ardhurat që kanë një tejkalim të realizimit në nivele shumë të larta janë të ardhurat nga taksat e ndara që nuk vilen nga bashkia apo nga gjobat e Policisë Bashkiake. Në taksat dhe tarifat që është drejtpërdrejtë përgjegjëse Drejtoria e të Ardhurave për vjeljen e tyre, nivelet e realizimit janë të ulta.
Gjithashtu, nga auditimi rezulton se procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore nuk është i dokumentuar. Nuk ka dokumentacion nëse Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave (DAPPLL) të ketë dërguar kërkesë për informacion në drejtoritë brenda bashkisë, njësitë apo strukturat në varësi për të grumbulluar informacion lidhur me hartimin e paketës fiskale për vitin 2021. Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstaton që metodologjia e përdorur nga DAPPLL për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmëritë lidhur me të ardhurat e veta të bashkisë. Veprime këto në kundërshtim me VKB-në nr. 71, datë 30.11.2020 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Selenicë, administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2021".
Kriteri: VKB-në nr. 71, datë 30.11.2020 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Selenicë, administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2021".
Ndikimi: Niveli i planifikimit të të ardhurave të bashkisë nga taksat dhe tarifat vendore ndikon direkt në hartimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Selenicë.
Shkaku: Strukturat brenda Bashkisë Selenicë si dhe institucionet në varësi nuk dërgojnë informacionin përkatës pranë DAPPLL sipas përcaktimeve të VKB-së për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Selenicë. DAPPLL nga ana e saj në mungesë të këtij informacioni si dhe nga mos kryerja e analizave të mirëfillta nuk arrin një planifikim efektiv.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucionet e varësisë me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar realizimin e saktë.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë
Titulli i gjetjes 7: *Mbi pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet.*
Situata: Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 3/c *"për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve*

të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi" dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014"Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5 "*Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njësive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi*".

Në Bashkinë Selenicë struktura që administron dokumentacionin dhe përllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Burimeve Natyrore, Mjedisit, Projekteve dhe Investimeve.

Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë konstatohet se, nga legalizimet e bëra ndër vite **nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë 225 individë/qytetarë për sipërfaqet e legalizuara me vlerë totale të detyrimeve 5,765,781 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Selenicë.**

Për vitin 2021, janë legalizuar gjithsej 59 objekte me vlerë totale të detyrimit për t'u paguar 1,569,709 lekë. Nga auditimi rezulton se, kanë paguar detyrimet 40 qytetarë/individë me vlerë 1,088,987 lekë dhe janë debitorë ndaj bashkisë **19 qytetarë me vlerë totale 485,846 lekë, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Selenicë.**

Nga auditimi rezulton se, qytetarët/individët që kanë përfituar legalizimin e sipërfaqeve të caktuara nuk kanë paguar rregullisht detyrimin ndaj Bashkisë Selenicë për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Përkatësisht për vitin 2021 nuk kanë paguar detyrimin 19 qytetarë me vlerë totale **485,846** lekë, ndërsa nuk kanë paguar ende detyrimin 225 individë/qytetarë për sipërfaqet e legalizuara përpara vitit 2021 me vlerë totale **5,765,781** lekë. **Në total vlera e detyrimeve nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton në 6,251,627 lekë për 244 objekte të legalizuara, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Selenicë.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" pika 5 si dhe VKB-së nr. 71, datë 30.11.2020 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Selenicë, administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2021".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. K. B. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Burimeve Natyrore, Mjedisit, Projekteve dhe Investimeve, dhe zj. Gj. Xh. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, për vitin 2021, z. E. F. me detyrë Kryeinspektor në Inspektoratin Tatimor të Kundërvajtjeve Administrative.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27.

Ligji nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c.
Ligji nr. 98/2020 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”.
VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5.
VKB-së nr. 71, datë 30.11.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Selenicë, administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2021”.
Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Selenicë, nga mos arkëtimi i vlerës prej **6,251,627 lekë** për ndërtimet e reja që legalizohen.
Shkaku: Mos marrje e masave efektive nga strukturat e Bashkisë Selenicë të bërë të mundur pagesën e taksës së legalizimeve.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 244 debitorë në vlerën 6,251,627 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Drejtoria e të Ardhurave të dërgojë informacion periodik në Drejtorinë e Financës lidhur me listën e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Selenicë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menaxhimi i borxhit
Titulli i gjetjes 8: *Mbi nivelin e borxhit tatimor në Bashkinë Selenicë dhe masat e marra për uljen e tij.*
Situata:
Taksat dhe tarifat familjare
Taksa mbi tokën bujqësore
Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, Aneksi 1. Referuar paketës fiskale Bashkia Selenicë ka miratuar taksën e tokës bujqësore lekë/ha në vit si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.2.2/2: Vlera e taksës së tokës bujqësore në lekë/hektar/vit

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas VKB-së (lekë/ha/vit) Selenicë	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas VKB-së (lekë/ha/vit) Njësitë Administrative
III	3,800	3,000
IV	3,300	2,600
V	2,700	2,100
VI	2,200	1,700
VII-X	1,700	1,300

Tabela nr.2.2/3: Detyrimi për taksën e tokës bujqësore

Nr.	Njësitë Administrative	Nr. Familjeve	Vlera
1	Selenicë	849	5,929,984
2	Sevaster	981	30,665,452
3	Brataj	1167	22,438,285
4	Kote	1239	29,650,807
5	Armen	1602	77,073,140
6	Vllahinë	1678	89,820,144
	Totali	**7516**	**255,577,812**

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë

Nga auditimi konstatohet se detyrimi që familjet kanë për taksën e tokës bujqësore në Bashkinë Selenicë më datë 31.12.2021 është 255,577,812 lekë për 7516 familje.

Taksa dhe tarifa të tjera familjare

Tabela nr. 2.2/4: Detyrimet për taksat dhe tarifat familjare të krijuara gjatë vitit 2021

Nr.	NjA	Tokë		Ndërtesa Familje		Truall-Pastrim-Ndricim-Gjelbërim-Ndërtese	
		Nr. Fam.	Vlera	Nr. Fam.	Vlera	Nr. Fam.	Vlera
1	Selenicë	840	277,570	1112	785,473	1068	242,433
2	Sevaster	953	616,248	506	371,705	993	563,700
3	Brataj	1172	1,192,042	988	641,186	862	368,718
4	Kote	1250	109,500	1100	909,001	1515	215,478
5	Armen	1606	4,169,977	1233	961,254	1339	573,200
6	Vllahinë	1637	2,304,446	1404	441,384	1778	789,139
	Totali	**7516**	**8,669,783**	**6343**	**4,110,003**	**7555**	**2,752,668**

Burimi: Bashkia Selenicë

Nga auditimi rezulton se më datë 31.12.2021 vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Selenicë për taksat dhe tarifat familjare është **285,198,646 lekë** dhe përbëhet nga:

- Detyrime për taksën e tokës bujqësore 7516 familje në vlerën **255,577,812 lekë**;
- Detyrime për taksën e ndërtesës 6343 familje në vlerën **4,110,003 lekë**;
- Detyrime nga taksa dhe tarifa të tjera vendore (truall,pastrim,ndriçim,gjelbërim) 7640 familje në vlerën **25,510,831 lekë**.

Në Bashkinë Selenicë referuar paketës fiskale familjet ngarkohen me detyrime për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, taksë trualli, dhe tarifën e pastrimit. Nga të dhënat e audituara rezulton se vlera e detyrimit që familjet kanë ndaj Bashkisë Selenicë më datë 31.12.2022 për këto taksa dhe tarifa është **285,198,646 lekë vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë.** Gjithashtu, nga analizimet që bëri grupi i auditimit konstatohet se Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave nuk ka regjistra të saktë, të plotë dhe të përditësuar lidhur me administrimin e të dhënave për taksat dhe tarifat vendore familjare. Të dhënat regjistrohen vetëm në programin excel dhe kanë pasaktësi në hedhjen apo përditësimin e tyre si dhe mospërputhje në vlera totale. Si rezultat i këtyre pasaktësive vlera e detyrimeve totale për taksat dhe tarifat familjare është rillogaritur nga grupi i auditimit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave.

Detyrimet nga subjektet fizikë/juridikë

Tabela nr. 2.2/5: Numri i bizneseve në Bashkinë Selenicë më datë 31.12.2021

			Gjendja	Regjistrime të	Mbyllur	Gjendja

Nr.	Lloji Biznesit	Viti	në fillim	reja	aktiviteti	në fund të Vitit
1	Biznesi vogël	2021	457	16	3	470
2	Biznes i madh	2021	20	-	5	15
	Gjithsej	**2021**	**477**	**16**	**8**	**485**

Burimi: Bashkia Selenicë

Nga të dhënat e mësipërme shikojmë se për vitin 2021 në Bashkinë Selenicë janë hapur 16 biznese të vogla dhe janë mbyllur 5 biznese të mëdha dhe 3 të vogla.

Nga auditimi i dokumentacionit që administron Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave u konstatua se subjektet janë njoftuar periodikisht për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, si dhe janë rinjoftuar në rastet e vonesave në pagesat e detyrimeve vendore.
Nga auditimi rezulton se më datë 31.12.2021 vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Selenicë për subjektet fizikë/juridikë është **76,812,363 lekë** dhe përbëhet nga:

- Detyrime nga biznesi i vogël për 470 subjekte në vlerën **38,882,100 lekë**;
- Detyrime nga biznesi i madh për 15 subjekte në vlerën **37,930,263 lekë**;

Tabela nr. 2.2/6: Përmbledhëse e borxhit tatimor në Bashkinë Selenicë

Përshkrimi	Nr.	Vlera e borxhit progresive më 31.12.2020	Nr.	Borxhi i krijuar gjatë vitit 2021	Nr.	Vlera e borxhit progresive më 31.12.2021
Debitorë taksa e ndërtesës familje	**6343**	**...**	**.....**	**4,110,003**	**6343**	**4,110,003**
Debitorët taksa e tokës familje	**7671**	**247,169,070**	**.....**	**7,477,741**	**7516**	**255,577,812**
Debitorët biznes i vogël	**457**	**38,174,183**	**.....**	**1,432,899**	**470**	**38,882,100**
Debitorët biznes i madh	**20**	**39,329,281**	**.....**	**15,802,900**	**15**	**37,930,263**
Debitorët taksat (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim) familje	**7242**	**22,758,163**	**.....**	**2,752,668**	**7640**	**25,510,831**
Debitorët taksa e ndikimit në infrast.	**246**	**6,370,105**	**19**	**485,846**	**244**	**6,251,627**
Debitorët tarifa e vaditjes	**5**	**45,150**	**.....**	**8,900**	**25**	**54,050**
Total Borxhi		**353,845,952**		**32,070,957**		**368,316,686**

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë, përpunoi grupi i auditimit

Për vitin 2020 taksa e ndërtesës ka qenë e përfshirë me taksat dhe tarifat e tjera familjare dhe nuk është regjistruar e ndarë dhe si rezultat nuk ka të dhëna. Ndërsa për vitin 2021 ka filluar regjistrimi i saj si taksë më vete.
Me shkresën nr. 2798/5 Prot. datë 31.12.2021 Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Licencave ka dërguar borxhin tatimor progresiv në Drejtorinë e Financave, në vlerën totale prej 375,334,216 lekë. Detyrimet janë dërguar vetëm si vlera totale sipas klasifikimit pa u shoqëruar me listat analitike përkatëse si dhe nuk është përfshirë detyrimi për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifën e vaditjes.

Nga auditimi rezulton se, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Selenicë paraqitet:
Për vitin 2020, borxhi tatimor në Bashkinë Selenicë është në vlerën **353,845,952 lekë** i përbërë nga:
- Detyrime për taksën e tokës bujqësore në vlerën **247,169,070** lekë;

- Detyrime nga biznesi i vogël për 457 subjekte në vlerën **38,174,183 lekë**;
- Detyrime nga biznesi i madh për 20 subjekte në vlerën **39,329,281 lekë**;
- Detyrime për taksat familjare (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim) për 7242 familje në vlerën **22,758,163 lekë;**
- Detyrime për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 246 subjekte në vlerën **6,370,105 lekë**;
- Detyrime nga tarfa e vaditjes në vlerën **45,150 lekë**.

Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2021 është **32,070,957 lekë** nga të cilat:
- Detyrime për taksën e ndërtesës në vlerën **4,110,003 lekë;**
- Detyrime për taksën e tokës bujqësore në vlerën **7,477,741 lekë**;
- Detyrime nga biznesi i vogël në vlerën **1,432,899 lekë**;
- Detyrime nga biznesi i madh në vlerën **15,802,900 lekë**;
- Detyrime për taksat familjare (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim) në vlerën **2,752,668 lekë;**
- Detyrime për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 19 subjekte në vlerën **485,846 lekë**;
- Detyrime nga tarfa e vaditjes në vlerën **8,900 lekë**.

Vlera totale e borxhit tatimor më datë 31.12.2021 në mënyrë progresive në Bashkinë Selenicë është **368,316,686 lekë** dhe përbëhet nga:
- Detyrime për taksën e ndërtesës për 6343 familje në vlerën **4,110,003 lekë;**
- Detyrime për taksën e tokës bujqësore për 7516 familje në vlerën **255,577,812 lekë**;
- Detyrime nga biznesi i vogël për 470 subjekte në vlerën **38,882,100 lekë**;
- Detyrime nga biznesi i madh për 15 subjekte në vlerën **37,930,263 lekë**;
- Detyrime për taksat familjare (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim) për 7640 familje në vlerën **25,510,831 lekë;**
- Detyrime për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 244 subjekte në vlerën **6,251,627 lekë** *(është audituar edhe e ndarë nga detyrimet totale)*;
- Detyrime nga tarfa e vaditjes në vlerën **54,050 lekë**.

Informacion më i detajuar lidhur me debitorët progresivë fizikë/juridikë paraqitet në Aneksin nr. 2.2/5 bashkëlidhur.

Masat e marra për uljen e borxhit

Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Selenicë është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
2. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
4. Sekuestrimi i pasurisë.

Referuar dokumentacionit të audituar lidhur me hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Selenicë rezulton se të gjitha bizneset debitorë janë njoftuar për kalimin e afatit për pagesat vendore.

Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, nuk janë marrë masa të tjera bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për*

Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. Përkatësisht, nuk janë dërguar shkresa bankave të nivelit të dytë për bllokimet e llogarive bankare të subjekteve debitore, nuk janë dërguar kërkesa në DRT për vendosjen e barrës siguruese për mjetet dhe në ASHK për pasuritë e paluajtshme.

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89,90,91,93.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Selenicë.

Shkaku: Mos zbatimi efektiv i kërkesave ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore nga debitorët.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën totale **362,065,059 lekë**, e përbërë nga:

- **4,110,003 lekë** detyrime për taksën e ndërtesës për 6343 familje;
- **255,577,812 lekë** detyrime për taksën e tokës bujqësore për 7516 familje;
- **38,882,100 lekë** detyrime nga biznesi i vogël për 470 subjekte;
- **37,930,263 lekë** detyrime nga biznesi i madh për 15 subjekte;
- **25,510,831 lekë** detyrime për taksat familjare (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim) për 7640 familje;
- **54,050 lekë** detyrime nga tarfa e vaditjes.

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e DAPPLL të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- DAPPLL të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Selenicë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Akt marrëveshjet për pagesën me këste të detyrimeve

Bashkia Selenicë ka lidhur një akt marrëveshje me nr. 1622 Prot. datë 27.05.2021, për pagesën me këste të detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore me subjektin "B. C." në vlerë 1,200,000 lekë me afat 7 muaj. Në momentin e lidhjes së akt marrëveshjes subjekti ka paguar vlerën 50,000 lekë ndërsa vlera e mbetur prej 1,150,000 lekë do të paguhet me këste, ku për 6 muaj do paguajë nga 150,000 dhe 1 muaj do paguajë 250,000. *Nga auditimi u konstatua se* subjekti "B. C." ka paguar vetëm 150,000 lekë në momentin e lidhjes së akt marrëveshjes dhe nuk ka vijuar më tej me pagesat sikurse është dakordësuar midis palëve. Rezulton se nga ana e Bashkisë Selenicë nuk janë marrë masa kundrejt subjektit në kundështim me kushtet e akt marrëveshjes nr. 1622 Prot. datë 27.05.2021.

Të ardhurat nga asetet e dhëna me qira që administrohen nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave

Bashkia Selenicë në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi[8] për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 5 kontrata për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi, me kompanitë e telefonisë celulare. Këto kontrata janë lidhur me afat kohor 10 vjet. Nga auditimi rezulton se pagesat e qirasë për vitin 2021 janë kryer për të gjitha kontratat.

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve

Titulli i gjetjes 9: *Mbi pagesën e autorizimit nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregtimin me pakicë të lëndëve djegëse.*

Situata: Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi përkatësisht:

- Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, neni 4, neni 20/pika 2;
- VKM nr. 344, datë 19.04.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", pika 2/9 "*Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera*".

Referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se, në territorin e Bashkisë Selenicë për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 5 subjekte të paraqitura në tabelën në vijim.

Tabela nr. 2.2/7: Subjektet që ushtrojnë aktivitet në shitjen e lëndëve djegëse me pakicë

Nr.	Subjekti	Nipt	Adresa	QKB	Autorizime	*Niveli tarifës sipas VKM nr. 344*	Pagesë deri në vitin 2021	Detyrime për t'u paguar për autorizimin
1	P. SHPK	K	Kotë	13.06.2002	31.07.2019-30.07.2024	1,000,000	600,000	400,000
2	D. Gj.SHPK	L	Vllahinë	23.04.2015	24.05.2019 23.05.2024	1,000,000	650,000	350,000
3	T. O.	L	Peshkëpi	29.05.2015	Aplikuar 2022	1,000,000	0	1,000,000
4	Xh. G.	L	Vllahinë	15.07.2015	Aplikuar 2022	1,000,000	0	1,000,000
5	M. O.	L	Selenicë	15.05.2015	Aplikuar 2022	1,000,000	0	1,000,000
								3,750,000

Burimi: Bashkia Selenicë

Nga auditimi rezultoi se, në Bashkinë Selenicë për vitin 2021 janë 3 subjekte (T. O., Xh. G., M. O.) që kanë ushtruar aktivitet të pa pajisur me autorizimin e nevojshëm edhe pse nga ekstrakti i

[8] Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjin nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".

QKB-së rezulton se kanë filluar aktivitetin në këtë bashki që në vitin 2015. **Të ardhurat e munguara vetëm për vitin 2021 nga mos pagesa për autorizimin llogariten në vlerën 600,000 lekë (3*200,000).**

Subjektet "P." SHPK dhe "D. Gj." SHPK janë pajisur me autorizim/licencë dhe me ato është lidhur akt marrëveshje për pagesën e detyrimit për autorizimin me këste. Marrëveshja konsiston në krijimin e mundësisë për subjektet që detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite ta paguajnë me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë. Vlera e mbetur ende për t'u paguar nga këto subjekte është **750,000 lekë**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore, përkatësisht:

- Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, neni 4 "*Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme*", neni 15 *"…Stacionet e shitjes së karburanteve lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë pajisur nga organi kompetent me autorizimin përkatës, sipas këtij ligji…",* neni 20-Autorizimet pika 2, "*Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11*[9]*, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë* ***deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje***";

- VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kreu II, pika 3 "*Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga organet e qeverisjes vendore*".

Kriteri: Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, neni 4, neni 15, neni 20, pika 2.

VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kreu II, pika 3.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Selenicë.

Shkaku: Puna jo efektive e DAPPLL në identifikimin në kohë të përfundimit të afateve të autorizimeve për ushtrimin e aktivitetit si dhe mos ndjekja e hapave ligjorë për subjektet që vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet pa autorizim.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që subjektet "T. O.", "Xh. G.", "M. O.", që ushtrojnë aktivitet në kundërshtim me dispozitat ligjore të pajiset menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke kryer pagesa të plota apo të pjesshme. Gjithashtu, DAPPLL të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për

[9]Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, neni 11-Personat juridikë, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon: ç) stacionet e shitjes se karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete; d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë".

subjektet “P.” SHPK dhe “D. Gj.” SHPK me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

Subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Selenicë gjatë vitit 2021
Lidhur me subjektet që janë shpallur fitues nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duke fituar të drejtën të kryejnë punime në territorin e Bashkisë Selenicë grupi i auditimit auditoi dokumentacionin mbi pagesën e detyrimeve të këtyre subjekteve për taksat dhe tarifat vendore për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.
Për periudhën nën auditim janë identifikuar 15 operatorë ekonomikë që kanë fituar të drejtën për të kryer punime të ndryshme në territorin e Bashkisë Selenicë. Pagesat për detyrimet vendore paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela nr.2.2/8: Subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Selenicë, viti 2021.

Nr.	Subjekti	NIPT	Vl.kont. (pa tvsh)	Afati i kontratës	Lloji i taksave dhe tarifave vendore						
					Taksë mjedisi	Taksë Tabele	Tarifë Pastr.	Tarifë Nd.rrug	Tatifë Gjelb.	Paguar	Debitor
1	S. Shpk	K		6 muaj	25,000		50,000	50,000	15,000	140,000	0
2	T.	K		6 muaj	25,000		50,000	50,000	15,000	140,000	0
3	A.	L		6 muaj	20,000		50,000		15,000	85,000	0
4	B.		78,548,974	3 muaj	5,000		30,000		9,000	44,000	0
5	B.			3 muaj	5,000		30,000		9,000		44,000
6	S. Shpk			3 muaj	5,000		30,000		9,000		44,000
7	E. K.	L		6 muaj	25,000		50,000	50,000	15,000	140,000	0
8	A.	K	1,782,495	2 muaj	6,600		16,600		5,000		28,200
9	I.	L	6,482,600	2 muaj	6,600		16,600		5,000		28,200
10	A.	K	14,388,000	2 muaj	10,000		25,000		7,500		42,500
11	Sh.	K		2 muaj	10,000		25,000		7,500		42,500
12	J. Shpk	J	8,007,600	3 muaj	10,000		25,000		7,500	42,500	0
13	2.	J	6,370,365	2 muaj	6,600		16,600		5,000	28,200	0
14	K.	K	7,245,617	2 muaj	5,000		12,500		3,800	21,300	0
15	A. Shpk	J	12,108,268	3 muaj	1,000		25,000		7,500		33,500
	Totali				**165,800**		**452,300**	**150,000**	**135,800**	**641,000**	**262,900**

Burimi: Bashkia Selenicë

Sikurse paraqitet në tabelën më sipër nga 15 subjekte të ngarkuara gjithsej, 7 subjekte nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Selenicë në vlerën totale **262,900 lekë**, vlerë kjo që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë dhe është e përfshirë në vlerën e borxhit të krijuar gjatë vitit 2021.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme lidhur me menaxhimin e të ardhurave në Bashkinë Selenicë ngarkohen me përgjegjësi zj. Gj. Xh. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, për vitin 2021, z. E. F. me detyrë Kryeinspektor në Inspektoratin Tatimor të Kundërvajtjeve Administrative, Menaxhimi i Debitorëve, Konfiskimi dhe Sekuestrimi, z. K. K., z. R. G., zj. E.H., z. V. T., z. S.H., z. V.S. me detyrë inspektorë.
Mbi realizimit e të ardhurave nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Selenicë
Titulli i gjetjes 10: *Mos vendosje e gjobave nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Selenicë për kundërvajtjet e konstatuara.*

Situata: Nga IMTV Selenicë gjatë vitit 2021 janë konstatuar 10 raste të shkeljes së legjislacionin në fushën e mbrojtjes së territorit. Inspektorët e IMTV-së për këto raste kanë mbajtur proces verbalet përkatëse të konstatimit të kundërvajtjes dhe në 4 raste kanë marrë vendim për pezullim punimesh. Për asnjë nga 10 shkeljet e konstatuara nuk është marrë vendim prishje apo masa e dënimit me gjobë, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", neni 52, pika 1, germa e, "*kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera*".
Mos dhënia e masës "Dënim me gjobë" për kundërvajtësit ka sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Selenicë në vlerën 5,000,000 lekë.**

Tabela nr.2.2/9: Lista e procesverbaleve të IMTV për vitin 2021

Nr.	Subjekti	Proces verbal Konstatimi	Objekti	Proces verbal Konstatimi	Vendim Pezullimi	Vendim Gjobe	Vendim Prishje
1	S. B.	Nr.98 datë 15.07.2021	Kryerje punimesh	Nr.98 Datë 15.072021	-	-	-
2	A.S.	Nr.99 datë 26.07.2021	Kryerje punimesh Riparim muri	Nr.99 Datë 26.07.2021	-	-	-
3	J.H.	Nr. 100 datë 03.08.2021	Ndërtim me beton dhe tulla	Nr. 100 Datë 03.08.2021	-	-	-
4	H. H.	Nr.94 datë 31.05.2021	Rrethim i kundraligjshëm	Nr.94 Datë 31.05.2021	Nr. 95 Datë 04.06.2021	-	-
5	A.K.	Nr.91 datë 07.05.2021	Ndërtim çatie	Nr.91 Datë 07.05.2021	Nr.91 Datë 14.05.2021	-	-
6	E. A.	Nr.92 datë 14.05. 2021	Kryerje punimesh ndërtim muresh	Nr.92 Datë 14.05. 2021	Nr.93 Datë 24.05.2021	-	-
7	R. A.	Nr.93 datë 18.05.2021	Kryerje punimesh rrethim me tel gabjon	Nr.93 Datë 18.05.2021	Nr.94 Datë 24.05.2021	-	-
8	A. M.	Nr.23 datë 04.02,2021	Vendosje porte hekuri	Nr.23 Datë 04.02,2021	-	-	-
9	M.A.	Nr.24 Datë 08.02.2021	Ndërtim stalle	Nr.24 Datë 08.02.2021	-	-	-
10	N. H.	Nr.105 Datë 07.10.2021	Rethim të paligjshëm	Nr.105 Datë 07.10.2021	-	-	-

Burimi: Bashkia Selenicë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, z. F. Xh. me detyrë Kryeinspektor i IMTV-së për vitin 2021, z. D. A. dhe z. L. B. me detyrë inspektorë.

Kriteri: Ligji 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", neni 52, pika 1, germa e.
Ndikimi: Nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore në marrjen e masave për veprimet e kundërligjshme të konstatuara në mbrojtjen e territorit.
Shkaku: Bashkia Selenicë nuk ka zbatuar detyrimet ligjore për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Selenicë të rivlerësojë shkeljet e konstatuara referuar kundërvajtjes dhe të marrë masat me gjobë bazuar në llojin e shkeljes së kryer. Gjithashtu, në vijimësi për çdo proces verbal të konstatimit të kundërvajtjes të vendosen masat administrative përkatëse.

2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2021.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël" dhe Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Hartimi i pasqyrave financiare

Për vitin 2021 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (CASH FLOW).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese (Format i cili nuk është hartuar nga Bashkia Selenicë).
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Titulli i gjetjes 11: Mos plotësim i formateve të pasqyrave financiare.

Situata: Nga auditimi i pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara të Bashkisë Selenicë për vitin ushtrimor 2021 konstatohet se nuk është hartuar formati i pasqyrës nr. 5, "Pyetësorë dhe shënime shpjeguese". Shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare janë element i rëndësishëm të cilat duhet ndër të tjera të sigurojnë edhe atë informacion shtesë që nuk mund të paraqitet në të gjitha formatet e pasqyrave financiare.

Kriteri: SKK nr. 1, "Kuadri i përgjithshëm i pasqyrave financiare", pikat 67-68, pikat 120-121, dhe Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", aneksi nr. 2, "Pasqyra nr. 5, Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare vjetore të njësisë raportuese".

Ndikimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Selenicë nuk kanë marrë shpjegimet e duhura në lidhje me ndryshimet e zërave të pasqyrave financiare.

Shkaku: Kjo vjen si pasojë e mos respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa që, gjatë hartimit të pasqyrave financiare ato të përfshijnë të gjitha formatet e tyre sipas përcaktimeve ligjore duke siguruar të dhëna dhe informacione të plota shpjeguese për përdoruesit e tyre.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara të Bashkisë Selenicë për vitin ushtrimor 2021 janë të nënshkruara nga z. P. B. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. L. H. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore në cilësinë e nëpunësit zbatues, të cilat janë depozituar pranë Degës së Thesarit Vlorë me shkresën nr. 816 prot., datë 29.03.2022, brenda afatit ligjor të protokolluar me nr. 38 prot., datë 30.03.2022.

Rakordimi i pasqyrave financiare me Thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit

Për vitin 2021 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

-Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

-Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

-Regjistrimet kontabël janë kryer me regjistra ose në programin Excel.

-Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

-Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.,. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

-Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

-Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban te dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato te vlerës, personat qe kane urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me te dhënat te nevojshme qe i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.,. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.,
-Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Selenicë për aktivitetin ekonomiko-financiare për periudhën 01.01.2021, deri më datën 31.12.2021.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2021 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2020.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2021 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të Degës së Thesarit Vlorë për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël ne llogarinë e 520 "Disponibilitete në Thesar" dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në formatin e pasqyrës së lëvizjes në Cash viti 2021.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2021, të pozicionit financiar Bashkia Selenicë, Formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme. Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2021, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

Në lekë

Aktivet	2,828,900,712
Pasivet	323,929,700
Aktivet Neto	2,504,971,012
Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasive = Aktivet Neto	**2,504,971,012**

A. AKTIVET

I. Aktivet Afat Shkurtra

Në lekë

Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.2021 paraqiten në vlerën	**456,406,932**
Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre"	129,042,931
Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues"	24,918,455

Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra"	302,445,546

1. Llogaritë e Klasës 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhen nga:

Në lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2021-2020
531	Mjete monetare ne arkë	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512	Mjete monetare në bankë	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	Disponibilitete në thesar	98,939,337	63,145,785	35,793,552
50	Letra me vlerë	Letra me vlerë	80,600	80,600	0
532	Vlera të tjera	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akreditiva dhe paradhënie	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provigjone zhvlerësimi	Provigjone zhvlerësimi	0	0	0
Totali			**99,019,937**	**63,226,385**	**35,793,552**

Vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" në shumën 98,939,337 lekë përbëhet nga: gjendja e llogarisë 85 "Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor" në shumën 77,535,783 lekë (fondi i trashëguar nga transferta e pakushtëzuar, në vlerën 27,989,784, transferta specifike në vlerën 44,092,217 lekë dhe të ardhurat e veta, në vlerën 5,453,781 lekë) dhe gjendja e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në shumën 21,403,554 lekë.

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

2. Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhet nga:

Në lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2021-2020
31	Materiale	3,482,374	1,442,642	2,039,732
32	Inventar i imët	11,195,733	11,123,028	72,705
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Gjë e gjalle në rritje e majmeri	0	0	0
37	Gjendje të pambritura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provigjone për vlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
Totali		**14,678,107**	**12,565,670**	**2,112,437**

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Selenicë në datë 31.12.2021, paraqitet në vlerën 14,678,107 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 3,482,374 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 "Inventar i imët" në vlerën 11,195,733 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 2,112,437 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" në shumën -2,112,437 lekë.

Në lekë

Llogaria 31 "Materiale"	
Çelje e vitit 2021	1,442,642
Shtesa (K)	23,991,059
Pakësime (D)	21,951,327
Gjendja në 31.12.2021	**3,482,374**
Llogaria 32 "Objekt Inventari"	
Çelje e vitit 2021	11,123,028
Shtesa (K)	271,200
Pakësime (D)	198,495
Gjendja në 31.12.2021	**11,195.733**

3. Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra" përbëhet nga:

Në lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2021-2020
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	70,005,368	70,005,368	0
431	Tatime e taksa	0	0	0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti	0	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma te tjerë shoqërore	0	0	0
44	Institucione te tjera publike	0	0	0
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlere vendosjes	0	0	0
468	Debitorë te ndryshëm	142,398,480	136,714,244	5,684,236
4342	Te tjera operacione me shtetin (debitor)	12,846,308	11,956,554	889,754
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0
49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
Totali		**225,250,156**	**218,676,166**	**6,573,990**
	Të tjera aktive afatshkurtra	0	0	0
409	Furnitorë (Debitorë),parapagime pagesa pjesore	0	0	0
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	0
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	77,195,390	98,988,441	-21,793,051
Totali		**77,195,390**	**98,988,441**	**-21,793,051**

Titulli i gjetjes 12: Mos kontabilizimi në bilanc i vlerës 191,868,902 lekë e cila është detyrim i debitorëve për taksat dhe tarifat vendore ndaj Bashkisë Selenicë.

Situata: Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" paraqitet më datë 31.12.2020, në vlerën 136,714,244 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2021, paraqitet në vlerën 142,398,480 lekë me një rritje në vlerë 5,684,236 lekë. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten të dhënat për Bashkinë Selenicë dhe Njësitë Administrative si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Emërtimi	Llogaria kontabël	Shuma	Llogaria kontabël	Shuma	Totali
1	Bashkia Selenicë	429	21,131,299	468	5,336,338	26,467,637
2	Bashkia Selenicë	429	1,476,794	468	0	1,476,794
3	Bashkia Selenicë viti 2020	429	139,502	468	0	139,502
4	Njësia Administrative Kotë 2017	429	1,737,620	468	0	1,737,620
5	Njësia Administrative Kotë	429	4,633,280	468	614,746	5,248,026
6	Njësia Administrative Vllahinë	429	0	468	147,574,705	147,574,705
7	Njësia Administrative Brataj	429	0	468	3,178,830	3,178,830
8	Njësia Administrative Sevaster	429	0	468	17,018	17,018
9	Njësia Administrative Armen	429	26,264,155	468	299,561	26,563,716
Totali			**55,382,650**		**157,021,198**	**212,403,848**

Në lekë

Nr.	Emërtimi	Llogaria kontabël 429	Llogaria kontabël 468
1	Çelje e vitit 2021	70,005,368	136,714,244
2	Pagesa gjatë vitit		0
3	Regjistrime të reja debitorësh gjatë vitit 2021		5,684,236
4	**Gjendja e debitorëve në 31.12.2021**	**70,005,368**	**142,398,480**

Vlera e mësipërme e pasqyruar në bilanc prej 212,403,848 lekë përbëhet nga:

Në lekë

Nr.	Emërtimi	Llogaria kontabël
1	Detyrime të biznesit të madh për taksa dhe tarifa vendore	65,592,638
2	Detyrime të biznesit të vogël për taksa dhe tarifa vendore	16,193,190
3	Detyrime të taksapaguesve familjar për taksën e tokës bujqësore	86,930,379
4	Debitorë të ndryshëm	43,687,641

Totali	212,403,848

Nga krahasimi i të dhënave të vlerës së debitorëve për taksa dhe tarifat vendore të paraqitur në bilanc, në listën e debitorëve të administruar nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në datën 31.12.2021, konstatohet se vlera e pasqyruar në bilanc nuk është e saktë. Në bilanc detyrimet për taksat dhe tarifat vendore janë në vlerën 212,403,902 lekë ndërkohë që vlera reale e këtyre detyrimeve është në vlerën 362,011,099 lekë me një diferencë paraqitje më pak në bilanc prej 191,868,902 lekë (vlerë 212,403,848 lekë përbëhet debitorë të ndryshëm dhe nga debitorë për taksa pjesa tjetër e pa kontabilizuar e taksa është në vlerën 191,868,902 lekë). Në total nga shuma prej 212,403,848 lekë të pasqyruar në bilanc në datën 31.12.2021, shuma prej 168,716,207 lekë ose 79.4% të debitorëve e zënë debitorët e taksave.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 5.

Ndikimi: Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi.

Shkaku: Mos zbatim nga nëpunësi zbatues i kërkesave ligjore të përshkruara më lart, në mbajtjen e sistemit të kontabilitetit. Mos vendosje e rregullave të shkruara nga menaxhimi i lartë, për përcaktimin e detyrimit të kalimit në mënyrë zyrtare të listës së debitorëve nga drejtoria e taksave dhe tarifave vendore në financë dhe kontabilizimin e tyre.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të sistemojë llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm", duke pasqyruar në të vlerën reale të debitorëve për taksat dhe tarifat vendore të kategorisë privat dhe familjar.

Nga të dhënat e Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave konstatohet se, në datën 31.12.2021, gjendja e debitorëve është si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Emërtimi	Llogaria kontabël
1	Detyrime të biznesit të madh për taksa dhe tarifa vendore	37,930,263
2	Detyrime të biznesit të vogël për taksa dhe tarifa vendore	38,882,100
3	Detyrime të taksapaguesve familjar për taksën e tokës bujqësore	25,557,7812
4	Debitorë të ndryshëm	29,620,834
Totali		**362,011,009**

Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" është mbajtur në mënyrë analitike, e cila në fund të vitit 2021 paraqitet me një rritje në vlerën 5,684,236 lekë. Nga verifikimi i pasqyrave financiare konstatohet se, totali i llogarisë analitike në fund të vitit 2021, kuadron me llogarinë sintetike në Aktivit të Pasqyrës së Pozicionit Financiar dhe me lëvizjet e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" të pasqyruara në Librin e Madh. Në total nga shuma prej 212,403,848 lekë të pasqyruar në bilanc në datën 31.12.2021, shuma prej 168,716,207 lekë ose 79.4% të debitorëve e zënë debitorët e taksave.

- **Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)",** në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 12,846,308 lekë. Vlera e financimit është e mbyllur me llogarinë 85 "Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor". Referuar trajtimit kontabël në fund të vitit konstatohet se, shpenzimet për llogarinë 600 "Paga dhe përfitimet e punonjësve" dhe 601 "Kontribute të sigurimeve" që ka për kundërparti llogaritë 421, 431, 435 dhe 436. Është kredituar në llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" dhe është debituar si e drejtë për punonjësit në fund të vitit, gjithashtu

veprimet janë mbyllur me llogarinë 85 "Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor" si llogaria e shpenzimeve dhe llogaria e financimit të pritshëm.

Në lekë

Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)	
Çelje e vitit 2021	11,956,554
Shtesa (K)	12,767,089
Pakësime (D)	11,877,335
Gjendja në 31.12.2021	**12,846,308**

- **Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme"** në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 77,195,390 lekë.

Në lekë

Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme"	
Çelje e vitit 2021	98988441
Shtesa (K)	39,396,395
Pakësime (D)	61,189,446
Gjendja në 31.12.2021	**77,195,390**

II. AKTIVET AFAT GJATA

1. Aktivet Afatgjata Jo materiale

Titulli i gjetjes 13: Mos sistemim i llogarisë 202 "Studime dhe kërkime", duke paraqitur në këtë llogari në mënyrë jo të drejtë edhe vlerën e projekteve prej 8,641,700 lekë, investimet e të cilave kanë përfunduar.

Situata: Nga auditimi i llogarisë 202 "Studime dhe kërkime" konstatohet se vlera prej 8,641,700 lekë e kësaj llogarie përbëhet nga 12 projekte, të cilat nuk duhet të regjistroheshin në këtë llogari pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e secilit investim për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Në lekë

Nr.	**Përshkrimi**	**Vlera**
1	Çelje datë 01.01.2021	17,892,280
2	Shtesë	+ 4,513,579
3	Pakësime (Veprim rregullues)	- 2,677,580
4	Studime-Projektime (kosto historike) analiza	**19,728,279**
	Harta e urbanistikës	150,000
	Projekti i zyrave të Bashkisë	2,760,100
	Studim Projektim i rrugës Treblovë-Peshkëpie dhe rruga Dushkarak kthesa e Shkozës	2,160,000
	Studim i veprave kulluese	2,400,000
	Studim projektim kanali ujitës Dushkarak kthesa e Shkozës	895,200
	Studim projektim i mbrojtjes nga erozioni i qytetit nga përroi i Oshtimës, rruga Shkozë Golimbas-Mesaplik	6,657,000
	Studim projektim rikonstruksion i linjës shpërndarëse Selenicë-Kotë-Armen	125,580
	Hartim projektim	2,292,000
	Studim projektim	354,000
	Studim projektim	98,400
	Plane rivelimi	936,000
	Projekt preventivi i kanaleve të dyta Lubonjë, Picar, Armen	899,999
Total		**19,728,279**
5	Amortizim i akumuluar	8,275,362
6	Amortizimi për periudhën nga data 01.01.2021-31.12.2021	2,811,217
7	**Gjendja më datë 31.12.2021**	**8,641,700**

Kriteri: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 7, dhe nenet 9-10, dhe Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Ndikimi: Aktivi i bilancit për llogarinë 202 "Studime dhe projekte" nuk pasqyron vlerën e saktë të kësaj llogarie, për rrjedhojë ulje e vlerës reale të investimeve të përfunduara dhe rritje artificialisht e vlerës së projekteve, deformim të dhënash për këto dy llogari.
Shkaku: Mos zbatimi i rregullave kontabël.
Rëndësia: E lartë.
Rekomandimi: Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 "Studime e kërkime", duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 8,641,700 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.

2. Aktivet Afatgjata Materiale

Titulli i gjetjes 14: Mos dokumentim i plotë në bilanc, i aktiveve të llogarisë 210 "Toka, troje, Terrene" dhe aktiveve të llogarisë 211 "Pyje, Kullota Plantacione" si dhe përllogaritje e gabuar të amortizimit të tyre.
Situata: 1. Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 "Toka, troje, terrene", për koston historike në vlerën 140,307,952 lekë Bashkia Selenicë nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001, "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjithave pronave të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu VI, "Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme", pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 35, germa "a", "b" dhe "c".
2. Gjithashtu Bashkia Selenicë nuk ka marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 "Toka, troje, terrene". Në këtë llogari pasqyrohen aktivet e ish-Bashkisë Selenicë të cilat janë zbërthyer në mënyrë analitike por jo ato të ish-komunave. Nuk disponohet një bilanc i saktë se cilat nga këto prona janë të regjistruara në ASHK dhe cilat janë të pa regjistruara.
3. Llogaria 211 "Pyje, plantacione" paraqitet me vlerën 0 lekë, ndërkohë në pasqyrat financiare të vitit 2021, nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe e kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Selenicë me VKM nr. 433, datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", pika 57, shtojca nr. 55, me listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Selenicë me numër nga 1 deri në 485. Duke u bazuar në vendimin e sipërcituar Bashkisë Selenicë i kanë kaluar në pronësi gjithsej 26,899.51 ha sipërfaqe nga të cilat: 16.633.1 ha sipërfaqe "Kullotë", 10,062.1 ha sipërfaqe "Pyll" dhe 204.31 ha sipërfaqe "Shkëmborë".
4. Nga auditimi i llogarisë 210 "Troje, toka, terrene" konstatohet se është përllogaritur normë amortizimi në vlerën 58,000 lekë konkretisht si më poshtë:

Në lekë

Referenca	Nr.	Përshkrimi	Vlera
D. Veprimeve	1	Kosto historike	140,307,952
	2	Amortizim i akumuluar	58,000
	3	**Çelje datë 01.01.2021**	**140,249,952**
	4	Shtesë apo pakësime	0
	6	Amortizimi për periudhën nga data 01.01.2021-31.12.2021	**0**
	7	**Gjendja më datë 31.12.2021**	**140,249,952**

Duke u bazuar në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit SKK nr. 5, afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale", i përmirësuar, pika 30, citohet se, "Vlera e amortizueshme e një elementi të AAM-së njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si shpenzim në mënyrë sistematike

përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivi. Përjashtime bëjnë aktivet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për groposje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen. Punimet e artit të marra për qëllime projektimi, si dhe veprat e muzeve dhe librat, që duhet të zëvendësohen pas një periudhe kohe të caktuar, amortizohen gjatë jetës së tyre të dobishme". Në kushte të tilla për këtë llogari nuk mund të aplikohet normë amortizimi.

Kriteri: SKK nr. 5, "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale" i përmirësuar, pika 30, VKM nr. 510, datë 14.08.2001, "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjithave pronave të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu VI, "Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme", pika 1 dhe 2, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 35, germa "a", "b" dhe "c".

Ndikimi: Pasqyrat financiare paraqesin informacion të gabuar për llogarinë 210 "Toka, troje, Terrene" dhe llogarinë 211 "Pyje, Kullota Plantacione", nuk pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e saktë të pasurisë së institucionit.

Shkaku: Mos krijim i regjistrit të aktiveve për pronat e mësipërme. Mos marrja e masave për inventarizimin e pasurisë që paraqitet në llogarinë 210 "Toka, troje, Terrene" dhe llogarinë 211 "Pyje, Kullota Plantacione", mos pasqyrimin e vlerave të tyre në aktivin e pasqyrave financiare. Mos marrja e masave për regjistrimin e pasurive të kësaj llogarie në ASHK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 "Toka, troje, Terrene" dhe llogarisë 211 "Pyje, Kullota Plantacione", duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore në pasqyrat e vitit 2022 të bëjë sistemimin e vlerës 58,000 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të normës së amortizimit për llogarinë 210 "Toka, troje, terrene" si dhe për këto llogari mos të aplikohet normë amortizimi referuar parashikimeve në dispozitat ligjore përkatëse.

- **Llogaria 212 "Ndërtime konstruksione"** në datën 01.01.2021, ka qenë në vlerën 323,232,273 lekë. Gjatë vitit 2021, është shtuar vlera 15,553,018 lekë (blerje e krijuar me pagesë) ndërsa më datë 31.12.2021, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 322,467,917 lekë (vlera 323,232,273 lekë çelje më datën 01.01.2021, + shtesa në vlerën 15,553,018 lekë-amortizimin vjetor në vlerën 16,317,374 lekë = 322,467,917 lekë gjendja më datë 31.12.2021), me një shtesë në vlerën 764,356 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Në lekë

Referenca	Nr	Përshkrimi	Vlera
D. Veprimeve	1	Kosto historike	425,328,945
	2	Amortizim i akumuluar	102,096,672
	3	**Çelje datë 01.01.2021**	**323,232,273**
	4	Shtesë (Mbikëqyrje Shkolla Armen)	+ 600,000
	5	Shtesë (Përmirësim i kushteve të banimit të komunitetit të paforizuar)	+ 14,953,018
	6	Amortizimi për periudhën nga data 01.01.2021-31.12.2021	- 16,317,374
	7	**Gjendja më datë 31.12.2021**	**322,467,917**

- **Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore"** në datën në datën 01.01.2021, ka qenë në vlerën 1,870,556,375 lekë. Gjatë vitit 2021, është shtuar vlera 132,746,985 lekë (blerje e krijuar me pagesë) ndërsa më datë 31.12.2021, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,905,636,411 lekë

(vlera 1,870,556,375 lekë çelje më datën 01.01.2021, + shtesa në vlerën 132,746,985 lekë - amortizimin vjetor në vlerën 97,666,949 lekë = 1,905,636,411 lekë gjendja më datë 31.12.2021), me një pakësim në vlerën 35,080,036 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Përshkrimi	Vlera
1	Kosto historike	2,470,742,788
2	Amortizim i akumuluar	600,186,413
3	**Çelje datë 01.01.2021**	**1,870,556,375**
	Shtesa	
4	Riparim Ujesjellësi	5,532,745
5	Supervizim Ujesjellësi	190,076
6	Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës Selenicë, Kotë, Armen	29,000,000
7	Supervizim punimesh "Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës Selenicë, Kotë, Armen"	400,000
8	Sistemim asfaltim rruga lagia Tobo Romes	9,606,170
9	Sistemim asfaltim shkolla e mesme qendër	10,000,000
10	Rikonstruksion Ura Brataj	1,968,000
11	Asfaltim rruga Kropisht	13,400,000
12	Rehabilitim rruge me beton Peshkëpi, Drashovicë, Brataj, Sevaster	11,000,000
13	Kolaudim rruga Kropisht	25,183
14	Kolaudim ura Treblovë	2,640
15	Rehabilitimi i rrjetit sekondar Fush-Shkozë Sevaster, Golimbas	6,036,437
16	Rehabilitim i kanalit ujitës Dusharak	11,219,510
17	Rehabilitimi i rrjetit ujitës rezervuari Pete-Mavrovë	10,544,135
18	Rehabilitimi i kanalit Hasomat	5,000,000
19	Kolaudim i rehabilitimit i pjesës së parë të rrjetit ujitës të rezervuarit Harvala	64,617
20	Kolaudim objekti rehabilitimi i rrjetit ujitës sekondar Golimbas e Shkozë-Sevaster	48,272
21	Kolaudim i riparimit të shkarkuesit të Harvalas	18,282
22	Supervizim rehabilitimi i kanalit Lepenicë Mesaplik	38,181
23	Kolaudim përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetin e varfër	37,563
24	Supervizim rehabilitim i rrjetit ujitës të rezervuarit pjesa e dytë dega Drashovicë	129,552
25	Supervizim rehabilitim i kanalit kullues Fushë Shkozë Sevaster	214,018
26	Supervizim punimi i rehabilitimi i kanalit ujitës dhe stacionit të pompimit Dushkarak kthesa e Shkozës	72,000
27	Supervizim punimi rehabilitimi pjesa e parë e rrjetit ujitës të rezervuarit të Harvalas 1800 ml	387,708
28	Rehabilitimi i kanalit vaditës Harvala	10,167,456
29	Riparim i shkarkuesit të rezervuarit të Harvalas	7,644,437
	Totali i shtesës	**+ 132,746,982**
30	Amortizimi për periudhën nga data 01.01.2021-31.12.2021	- 97,666,949
31	**Gjendja më datë 31.12.2021**	**1,905,636,411**

Titulli i gjetjes 15: Aktive të transferuara nga Bashkia Selenicë në Shoqërinë Ujësjellës Selenicë por të pasqyruara ende në pasqyrat financiare të Bashkisë.

Situata: Nga auditimi i llogarisë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore", konstatohet se në vitin 2016 janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 526,501,279 lekë në Ujësjellës Selenicë Sh.A, por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Selenicë kjo situatë e konstatuar edhe në auditimet e mëparshme të zhvilluara nga KLSH por e pa sistemuar, pra nuk janë marrë masa për hartimin e dokumentacionit të dorëzimit dhe marrjes së aktiveve midis Bashkisë Selenicë dhe Ujësjellësit Sh.A. Nuk janë hartuar procesverbale dorëzimi për aktivet transferuara nga dy institucionet. Pasqyra e aktiveve të cilat janë transferuar nga Bashkia Selenicë për Ujësjellës Sh.a për të cilat nuk janë bërë veprimet kontabël pasqyrohet si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Emërtimi i llogarisë	Vlera kontabël	Amortizimi	Vlera neto
1	213 "Rrugë rrjete vepra ujore"	515,755,627	141,986,982	373,768,645
2	214 "Instalime makineri pajisje"	9,831,852	3,056,769	6,775,083
3	218 "Inventar ekonomikë"	757,600	481,007	276,593
	Total	**526,345,079**	**145,524,758**	**380,820,321**

Kriteri: Udhëzimi e MF nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore

në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.
Ndikimi: Pasqyrat financiare për llogarinë 213 "Rrugë rjete vepra ujore", llogaria 214 "Instalime makineri e pajisje", llogaria 218 "Inventar ekonomik", llogaria 32 "Objekte inventari", përmbajnë në gjendjen e tyre kontabël vlera të aktiveve që në fakt janë transferuar nga Bashkia Selenicë në Shoqërisë Ujësjellës Selenicë dhe janë në administrim të kësaj të fundit, duke mos pasqyruar me vërtetësi vlerën e saktë të aktiveve të institucionit për këto llogari.
Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pasi nuk janë hartuar procesverbale dorëzimi për aktivet e mësipërme nga dy institucionet. Mos pasqyrim në librat e kontabilitetit të lëvizjes së aktiveve (pakësimet nga transferimet).
Rëndësia: E lartë.
Rekomandimi: Nga Bashkia Selenicë të hartohen procesverbalet e transferimit dhe të marrjes në dorëzim të aktiveve nga Bashkia në Shoqërinë Ujësjellës Selenicë për vlerën kontabël 526,501,279 lekë. Të bëhet pasqyrimi në kontabilitet i efekteve të transferimit.

- **Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune"** në datën në datën 01.01.2021, ka qenë në vlerën 7,139,734 lekë gjatë vitit 2021, është shtuar vlera 256,816 lekë (blerje e krijuar me pagesë) ndërsa më datë 31.12.2021, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 7,009,104 lekë (vlera 7,139,734l lekë çelje më datën 01.01.2021, + shtesa në vlerën 256,816 lekë - amortizimin vjetor në vlerën 378,446 lekë = 7,009,104 lekë gjendja më datë 31.12.2021), me një pakësim në vlerën 121,630 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Në lekë

Referenca	Nr	Përshkrimi	Vlera
D. Veprimeve	1	Kosto historike	14,367,085
	2	Amortizim i akumuluar	7,236,351
	3	**Çelje datë 01.01.2021**	**7,139,734**
	4	Shtesë vegla pune	+ 256,816
	5	Amortizimi për periudhën nga data 01.01.2021-31.12.2021	- 378,446
	6	**Gjendja më datë 31.12.2021**	**7,009,104**

- **Llogaria 215 "Mjete transporti"**, në datën në datën 01.01.2021, ka qenë në vlerën 16,778,772 lekë gjatë vitit 2021 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2021, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 13,422,978 lekë (vlera 16,778,772 lekë çelje më datën 01.01.2021- amortizimin vjetor në vlerën 3,55,744 lekë = 13,422,978 lekë gjendja më datë 31.12.2021), me një pakësim në vlerën 3,355,744 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Emërtimi	Përgjegjësi material	Targa	Vlera Kontabël
1	Autoveturë Policia Bashkiake	M. M.	AA	1,320,600
2	Kamion Man tre akse	K. M.	AA	4,440,000
3	Eskavator me zinxhir	P. L.	E pa targuar	9,055,196
4	Mini Fadrom	K. S.	E pa targuar	936,000
5	Fuoristrade	G.Sh.	AA	787,200
6	Eskavator me goma	I. J.	E pa targuar	3,724,846
7	Eskavator me zinxhir	L. Gj.	E pa targuar	7,195,154
8	Automjet me vinç dhe vetëshkarkues	A. E.	VL	3,420,000
9	Automjet me goma dhe gabinë teke	V. P.	AA	1,674,000
10	Automjet tip S...	Xh.Ll.	AA	300,000
11	Zjarrfikëse	Sh. J.	AA	3,780,000
12	Makinë me targë VL.....	Jashtë përdorimi	Vl	1,296,000
13	Fuoristrade	Jashtë përdorimi	E pa targuar	1,390,000
14	Makinë M. B.	Jashtë përdorimi	VL	1,788,000
15	Autoveturë	Jashtë përdorimi	E pa targuar	995,000
16	Autoveturë Ambulancë	Jashtë përdorimi	Vl	3,588,480

Totali i kostos historike	**45,690,476**
Amortizim i akumuluar	- 28,911,854
Çelje datë 01.01.2021	16,778,722
Amortizimi për periudhën nga data 01.01.2021-31.12.2021	- 3,355,744
Gjendja më datë 31.12.2021	**13,422,978**

Për llogarinë 215 "Mjete transporti" në pasqyrat financiare është regjistruar vlera 13,442,978 lekë. Në këtë vlerë janë përfshirë edhe 5 mjete të cilat nuk janë në gjendje pune duke u bazuar në procesin e inventarizimit për vitin 2021 konkretisht: 1. Makinë me targë VL 2. Fuoristradë pa targë, 3. Makinë M. B. me targë VL, 4. Autoveturë pa targë dhe 5. Autoveturë Ambulancë me targë Vl në vlerën 9,057,480 lekë kosto historike.
Në zbatim të Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Aneksi nr. 1, "Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)", 2.1, "Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2", vlera 9,057,480 lekë e cila i përket kostos historike mjete të dëmtuara duhej të debitohej në llogarinë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara". Pra nga llogaria 215 "Mjete transporti" duhet të zbritet vlera e automjeteve të dëmtuara dhe të regjistrohet në llogarinë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara". Gjithashtu nuk disponohet një analizë e detajuar mbi vlerën e mbetur kontabël për llogarinë 215 "Mjete transporti", për arsye se përllogaritja e amortizimit për këtë llogari është kryer në total dhe jo mbi vlerën respektive për çdo automjet.

- Llogaria 218 "Inventar ekonomik" në datën në datën 01.01.2021, ka qenë në vlerën 15,448,702 lekë. Gjatë vitit 2021 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 858,000 lekë dhe pakësim në vlerën 858,000 lekë (ky veprim ka të bëjë me sistemimin e vlerës 858,000 lekë faturë e cila është regjistruar në momentin e furnizimit me mallra sipas fletë-hyrjes përkatëse dhe regjistrim në momentin e likuidimit të shpenzimit si dhe zbritja është kryer në pasqyrat financiare të vitit 2021), ndërsa më datë 31.12.2021, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 12,261,140 lekë (vlera 15,448,702 lekë çelje më datën 01.01.2021- amortizimin vjetor në vlerën 3,187,562 lekë = 12,261,140 lekë gjendja më datë 31.12.2021), me një 3,187,562 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Në lekë

Referenca	Nr	Përshkrimi	Vlera
D. Veprimeve	1	Kosto historike	49,843,673
	2	Amortizim i akumuluar	34,394,971
	3	**Çelje datë 01.01.2021**	**15,448,702**
	4	Shtesë vegla pune	+ 858,000
	5	Pakësime	- 858,000
	6	Amortizimi për periudhën nga data 01.01.2021-31.12.2021	**3,187,562**
	7	**Gjendja më datë 31.12.2021**	**12,261,140**

Gjendja e **llogarisë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT"** në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 3,067,920 lekë, vetëm për një kontratës punimesh e cila është në proces zbatimi punimesh. Nga testimi i kontratave konstatohet se nuk ka kontrata punimesh të cilat janë ende të pa likuiduara nga viti 2021.

Në lekë

Referenca	Nr	Përshkrimi	Vlera
D. Veprimeve	1	Rehabilitimi i kanalit vaditës Mesaplik, Drashovicë	3,067,920
Totali			**3,067,920**

Procesi i inventarizimit

Titulli i gjetjes 16: Mungesa e një regjistri kontabël për aktivet për aktivet afatgjata apo afatshkurtra.
Situata: Bashkia Selenicë nuk disponon një regjistër aktivesh i cili hartohet në vartësi të llojit të aktiveve afatgjata apo afatshkurtra si dhe grupit përkatës brenda llojit. Gjithashtu ky regjistër duhet të përmbajë kërkesat minimale konkretisht, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datë e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.
Kriteri: Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26-30.
Ndikimi: Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj. Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së institucionit si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion.
Shkaku: Mos implementimi i dispozitave ligjore përkatëse.
Rëndësia: E lartë.
Rekomandimi: Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrin masa për hartimin e regjistrit të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre.

Titulli i gjetjes 17: Parregullsi në procesin e kryerjes së inventarizimit si dhe nuk ka procedurë për vlerësimin dhe ndikimin që kanë në mjedis, të materialeve elektronike që janë nxjerrë jashtë përdorimit.
Situata: 1. Për vitin 2021, Kryetari i Bashkisë Selenicë ka nxjerrë Urdhrin nr. 144, datë 19.11.2021, për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Selenicë dhe Njësive Administrative Armen, Vllahinë, Sevaster, Brataj dhe Kotë. Procesi i inventarizimit të aktiveve të institucionit është kryer dy herë radhazi nga i njëjti komision i cili ka ushtruar këtë funksion në vitin 2020, në zbatim të Urdhrit nr. 221, datë 18.11.2020, të Kryetarit të Bashkisë, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 84.
2. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t'i dorëzohej nëpunësit autorizues të institucionit, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 85, gërma "c".
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Komisioni i inventarizimit referuar Urdhrit nr. 144, datë 19.11.2021, të Kryetarit të Bashkisë Selenicë.
3. Me Urdhrin nr. 145, datë 19.11.2021, të Kryetarit të Bashkisë është krijuar komisioni për vlerësimin e aktiveve për vitin 2021, i përbërë nga z. L. H., znj. A. M. dhe z. D. D.. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të propozuara nga komisioni i

inventarizimit, në total nga komisioni i sipërpërmendur janë mbajtur 41 procesverbale të datave 20.12.2021, 21.12.2021, 22.12.2021, 24.12.2021, dhe 29.12.2021.
Duke u bazuar në procesverbalet e hartuara nga komisioni për vlerësimin e aktiveve është vlerësuar që të nxirren aktive jashtë përdorimit të Bashkisë Selenicë dhe Njësive Administrative në total në vlerën 770,089 lekë.
Me Urdhrin nr. 146, datë 19.11.2021, të Kryetarit të Bashkisë është krijuar komisioni për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit i përbërë nga znj. O. M., znj. E. K., z. E. F., z. M. H., znj. D. A. dhe znj. Sh. Xh.
Nga komisioni i sipërpërmendur janë mbajtur në total 41 procesverbale të datave 20.12.2021, 21.12.2021, 22.12.2021, 24.12.2021, dhe 29.12.2021, ku janë nxjerrë në total aktive jashtë përdorimit në vlerën 770,089 lekë.
Gjithashtu në listën e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit ka materiale të cilat konsiderohen të dëmshme konkretisht, stabilizator 1 copë, termometër 1 copë, rezistencë 14 copë, zgjatues prize 1 copë, petrogaz ndriçimi 2 copë, freskuese 1 copë, makinë shkrimi 1 copë, telefon zyre 2 copë, ngrohëse 2 copë dhe magnetofon 1 copë për të cilat hedhja apo asgjësimi i tyre, duhet të kryhet me një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të destinuara për asgjësim si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore.
Nga Kryetari i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e transportit, asgjësimit të tyre dhe nuk disponohet asnjë korrespodencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejimin e asgjësimit dhe groposjen e pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe impaktin që kanë në komunitet.
Në të gjitha procesverbalet citohet se, "Gjatë verifikimit të këtyre materialeve u konstatua se këto materiale nuk janë në gjendje për t'u përdorur dhe nuk përshtaten për përdorim. Materialet që dolën jashtë përdorimit u ndryshua forma dhe një pjesë e tyre u gropos dhe pjesa tjetër u dogj".
Referuar të dhënave të paraqitura në procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve konstatohet se, nuk vërtetohet me dokumentacion justifikues (procesverbal, fotografi) transporti si dhe vendi në të cilën është kryer asgjësimi i aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Komisioni për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit i ngritur me Urdhrin nr. 146, datë 19.11.2021, të Kryetarit të Bashkisë Selenicë i përbërë nga znj. O. M., znj. E. K., z. E. F., z. M. H., znj. D. A. dhe znj. Sh. Xh.
Kriteri: Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, Ligji nr. 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, VKM nr. 957, datë 19.12.2012, "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike", Kreu I, pikat 1-2 dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 84, pika 85, gërma "c", pika 122.
Ndikimi: Ndikimi negativ në përmirësimin e cilësisë së performancës mjedisore. Mos plotësim me dokumentacion të plotë të procesit të asgjësimit.
Shkaku: Kjo vjen si pasojë e mos respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi.
Rëndësia: E lartë.
Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë të marrë masa në të ardhmen që ngritja dhe përbërja e komisionit të inventarizimit të kryhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe nga komisionet e inventarizimit të hartohet raporti për inventarin fizik në përfundim të procesit të inventarizimit.

Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrin masa në të ardhmen që në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve të mbahet parasysh kuadri rregullativ ligjor për mbrojtjen e mjedisit gjithashtu të kërkohet plotësimi i saktë i dokumentacionit, të rregullt dhe justifikues, sipas përcaktimeve ligjore.

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Selenicë më 31.12.2021, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2021, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2021, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Në lekë

Llogari		Viti 2021	Viti 2020	Diferenca/Ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	5,911,523	6,158,973	(247,450)
42	Detyrime ndaj personelit	9,029,397	8,488,237	541,160
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	671,783	541,274	130,509
435	Sigurime shoqërore	2,762,354	2,570,322	192,032
436	Sigurime shëndetësore	382,774	356,721	26,053
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	21,403,554	14,136,033	7,267,521
467	Kreditorë të ndryshëm	71,283,867	92,829,468	(21,545,601)
Gjendja më fund të periudhës		**111,445,252**	**125,081,028**	**(20,176,776)**

- Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në datën 31.12.2021, është në vlerën 5,911,523 lekë paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Selenicë. Lëvizja e llogarisë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", paraqitet në tabelën si më poshtë:

Në lekë

Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"	
Çelje e vitit 2021	6,158,973
Shtesa (K)	25,282461
Pakësime (D)	25,529,911
Gjendja në 31.12.2021	**5,911,523**

Gjendja e llogarisë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" në shumën 5,911,526 lekë përbëhet nga:

Në lekë

Faturat e pa likuiduara deri më datë 31.12.2021				
Nr.	**Datë**	**Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"**	**Subjektet**	**Detyrimi**
97	26.11.2018	Blerje balester kamioni	P. B.	20,000
28	13.04.2017	Blerje vaj motori	D. G.	5,129
152	13.04.2017	Blerje filtra	G.	17,006
		Diference fature	A. G.	600
3	03.01.2019	Blerje gazoil	F. SHPK	834
275	12.11.2019	Materiale ndërtimi	S.	2,557,880
54	09.12.2021	Blerje boje printeri &fotokopje	B.	480,000
194	17.12.2021	Blerje material për Covid	M. V.	480,000
210	31.12.2021	Blerje karburanti	S. A.	760,556
191	30.12.2021	Blerje materiale elektrike	A. L.	985,354
192	31.12.2021	Blerje materiale elektrike	A. L.	505,764
45	24.02.2020	Studim projektim i Ujësjellësit Peshkëpi Kocul	C.	98,400
Shuma				**5,911,523**

Titulli i gjetjes 18: Detyrimet e prapambetura të pa likuiduara. Marrja e angazhimeve për kryerjen e shpenzimeve përtej kufirit të fondeve buxhetore të disponuara realisht, në llogarinë e thesarit.

Situata: Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" në datën 01.01.2021, ka qenë në vlerën 6,158,973 lekë. Gjatë vitit 2021 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 25,282,461 lekë dhe pakësim në vlerën 25,529,911 lekë ndërsa në datën 31.12.2021, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 5,911,523 lekë. Gjatë kësaj periudhe është likuiduar vlera minimale 247,450 lekë. Shtesa e detyrime të Bashkisë Selenicë për llogarinë 401-408 gjatë vitit 2021 është në vlerën 25,282461 lekë. Angazhime të marra mbi bazën e planifikimit të pritshëm për realizimin e të ardhurave të veta të Bashkisë por këto angazhime janë marrë pa u siguruar të ardhurat reale nga llogaria e njësisë vendore në thesar.
Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" në datën 31.12.2021, ka vlerën 71,283,867 lekë dhe përfaqëson detyrime për investime në vlerën 40,935,736 lekë, detyrime për vendime gjyqësore në vlerën 14,112,369 lekë si dhe shërbime në vlerën 16,235,762 lekë (analiza e së cilës paraqitet në vijim të materialit).
Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 50, Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pikat 82-91, VKM nr. 823, datë 21.10.2020, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 70.
Ndikimi: Krijimi i detyrimeve të prapambetura, duke mbartur këto detyrime për periudhat e tjera kontabël të mëvonshme, denatyrim i buxhetit koherent dhe atij pasardhës.
Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.
Rëndësia: E lartë.
Rekomandimi: Me qëllim që të mos krijohen detyrime të prapambetura dhe planifikimi i shpenzimeve të një viti buxhetor të mos rëndoj shpenzimet e vitit pas ardhës, Kryetari i Bashkisë Selenicë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 71,283,867 lekë gjithashtu të paraqesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

- **Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"** referuar pasqyrave financiare vlera 9,029,397 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2021 e cila mbetet për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Në lekë

Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Çelje e vitit 2021	8,488,237
Shtesa (K)	112,218,680
Pakësime (D)	111,677,520
Gjendja në 31.12.2021	**9,029,397**

- **Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa",** paraqitet në vlerën 671,783 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor.

Në lekë

Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Çelje e vitit 2021	541,274
Shtesa (K)	8,287,895
Pakësime (D)	8,157,386
Gjendja në 31.12.2021	**671,783**

- **Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"** dhe **llogaria 436 "Sigurime shëndetësore"** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2021 që

paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 2,762,354 lekë dhe 382,774 lekë.

Në lekë

Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2021	2,570,322
Shtesa (K)	33,906,430
Pakësime (D)	33,714398
Gjendja në 31.12.2021	**2,762,354**
Llogaria 436 "Sigurime shëndetësore"	
Çelje e vitit 2021	356,721
Shtesa (K)	4566244
Pakësime (D)	4,540,191
Gjendja në 31.12.2021	**382,774**

- **Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"** sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Selenicë në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerë 21,403,554 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Vlorë.

Në lekë

Llogaria 431 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Çelje e vitit 2021	14,136,033
Shtesa (K)	7,741,898
Pakësime (D)	474,377
Gjendja në 31.12.2021	**21,403,554**

Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në pasqyrën, si më poshtë:

Në lekë

Garanci punimesh			**Viti 2020**		
Nr.	**Datë**	**Urdhër shpenzimi**	**Objekti i shpenzimit**	**Debi**	**Kredi**
1		Pa origjin	Brataj		568,499
2	2016	J. Shpk	Rehabilitimi i qendrës Brataj		1
3	2006	E.	Rikonstruksioni Ujesjellësi Romes		158,552
4	2014	Xh. K.	Rikonstruksioni Rruga Romes Karbunar		599,533
5		R. shpk	Qendra Shëndetësore Sevaster		118,976
6		B. shpk	Ujesjellësi Golimbas		334,937
7		P. shpk	Rruga Plloçë Amonicë		413
8	2016	B. K.	Ujesjellësi Sevaster Amonicë		899
9	2006		Pa Origjin		80,222
10	2007	C.	Ndërtimi Rruga Vajze		19,775
11	2014	T.	Qendra Shëndetësore Kote		49,494
12	2015	S.	Ndërtim Ura Vodice		1
13		2	KUZ Drashovice		57,099
14		Pa origjin	Vllahinë		15,750
15	2009	B. K.	Ndërtim & Konstruksion Rruga Vllahinë		338,229
16	2010	B. K.	Sistemim i Qendrës Vllahinë		1,499,944
17	2011	A. shpk	Ambiente Çlodhëse Peshkepi Vllahinë		72,120
18	2011	A. shpk	Rikonstruksioni i Shkollës 9 Vjeçare Vllahinë		363,210
19	2006-2011	Mbyllura	Biznese të mbyllura të palikujduara		492,727
20	2011	G. P.	Rikonstruksioni Rruga Danaj & Përroi		37,343
21	2014	M. G.	Furnizim & Vendosje pompe		83,880
22	2014	H.	Blerje Auto veturë		50,000
23	2016	N. shpk	Blerje projekti		138,005
24	2016	A.	Rehabilitimi i sistemit te ujitjes		1
25	2016	S.	Mirëmbajtja e rrugëve me rërë bituminoze		441,000
26	2017	Ministria	Blerje ekskavator me zinxhira		452,760
27	2018	C.Group	Studim projektim i rrugës Treblovë-Peshkepi		108,000
28	2018	C.	Blerje automjet C. SHPK		83,700
29	2018	S.	Riparim pompa Lubonje		61,480
30	2018	M. G.	Riparim pompa Mavrovë		95,940
31	2018	C.shpk	Blerje automjet me zinxhira& goma		527,950
32	2018	S.	Rrjet shpërndarës furnizimi me ujë fshati Kote		200,000
33	2018	A.	Riparim I stacionit te ujit te pijshëm Armen		22,350
34	2018	B..	Mirëmbajtje e rrugëve te fshatrave		90,410
35		I.G.	Rehabilitimi I kanalit vaditës Dushkarak & pompa Shkoze I....		450,000

36	2019	B.	Sistemim asfaltim I rrugës Treblov -Peshkepi		91,859
37	2019	S.	Rrjet shpërndarës njësia Kote,Sevaster,Brataj		630,380
38	2019	Sh.	Rehabilitimi I rrjetit ujitës Pete dega Drashovice		300,000
39	2019	I.	Rehabilitim I kanalit Vaditës & pompa Dushkarak		1,490,802
40	2019	B.	Sistemim asfaltim shkolla e mesme qendër		1,575,000
41	2019	Sh.	Rehabilitim I rrjetit ujitës rezervuari Pete-Mavrove		925,456
42	2019	A.	Ndërtim ure ne Fshatin Mallkeq		142,155
43	2019	M. shpk	Rikonstruksion I sistemit te pompimit Selenice		94,100
44	2019	J.	Rehabilitimi I qendrës Brataj		140,350
45	2019	C. shpk	Blerje ekskavator		18,050
46	2020	B.	Rikonstruksion rrjet shpërndarës Selenice ,Kote, Armen		2,898,760
47	2020	I.	Rehabilitimi I rrjetit ujitës Fushe-Shkoze Sevaster, Golimbas		650,228
48	2020	2.	Rehabilitimi i pjese se pare rrjetit ujite Harvala		1,008,373
49	2020	J.	Riparim ujesjellësi		492,863
50	2021	J.	Sistemin asfaltim lagjja tubo-Romes		480,309
51	2021	A.	Rehabilitim Ura Brataj		98,400
52	2021	2.	Riparimi i shkarkuesit te rezervuarit te Harvalas		382,222
53	2021	J.	Përmirësimi i kushteve te banimit për komunitetin e pa favorizuar		747,651
54	2021	K.	Rehabilitimi i kanalit Hasomat		250,000
55	2021	I.	Riparim emergjent për kanalin Mesaplik		153,396
56	2021	A.shpk	Rikonstruksion rruga fshati Kropisht		670,000
57	2021	A.	Rruge te brendshme me beton		176,424
58	2021	Sh.	Rruge te brendshme me beton		373,576
Gjendje në datën 31.12.2021					**21,403,554**

Titulli i gjetjes 19: Mbi mangësitë e konstatuara në llogarinë 466 "Kreditorë për mjetet në ruajtje" në pasqyrat financiare.

Situata: Llogaria 466 "Kreditorë për mjetet në ruajtje" në pasqyrat financiare është në vlerën 21,403,554 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit. Gjatë vitit 2021 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 7,741,898 lekë dhe pakësim në vlerën 474,377 lekë ndërsa në datën 31.12.2021, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 21,403,554 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se janë ngurtësuar fonde në vlerën 18,071,576 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e para, të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Selenicë nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për kalimin e këtyre fondeve.

Kriteri: Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

Ndikimi: Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontrator për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

-Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2021 janë në vlerën 71,283,867 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Në lekë

Llogaria 431 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Çelje e vitit 2021	92,829,468
Shtesa (K)	47,584,722
Pakësime (D)	69,130,323
Gjendja në 31.12.2021	**71,283,867**

Këto vlera janë paraqitur në mënyrë analitike dhe përbëhen nga Fatura të palikujduara dhe vendime gjyqësore sipas pasqyrës si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Fatura	Lloji i shërbimit	Subjekti	Vlera
		Sistemim asfaltim rruga treblov-Peshkëpi (diferencë fature)	B.	349,752
220	28.12.2017	Supervizim i pastrimi të përroit Peshkëpi	D.	36,240
34	29.03.2018	Mbikqyrje (Supervizim) Rehabilitim i rrugëve të fshatit kotë	P.	27,000
29	12.09.2018	Mbikqyrje punimesh	P.	34,800
26	30.09.2018	Rehabilim i rrjetiti ujitës Drashovicë, Armen, Shkozë, Sevaster	2.	50,213
		Ndërtim i kanalit ujitës Lepenicë	C. SHPK	81,148
28	10.04.2018	Ndërtim ujësjellësi Drashovicë	I.	137,964
		Rrugë ëe brendshme dhe tumbino	B.	34,733
		Riparim ujësjellësi Romes -Karbunar	A.	2,732
		Investime të ndryshme në komunen Brataj		139,602
		Rrugë të brendshme Lepenicë		972,762
		N....		412,537
		A...		99,975
		Gjendje blerje projekte		432,840
4	18.04.2011	Projekte	E. v.	328,950
2	21.09.2017	Rehabilitimi i qendrës Brataj	J. SHPK	65,002
32	27.06.2019	Rikostruksion rruga hyrëse Selenicë	B...	5,599,254
35	01.01.2019	Rikostruksion shkolla Mynyr Xhindi	C. SHPK	13,352
28	01.10.2019	Kolaudim Objekti Shkolla 9 vjeçare Kotë	M. B.	87,624
40	08.06.2018	Supervizim riparime mirmbajtje të ujesjellësave të fshatrave Bashkia Selenicë dhe kanaleve Shkozë-Sevaster	H.	33,600
55	19.05.2020	Riparim mirmbajtje kanale në njësit administrative të Bashkise Selenicë	C.	1,149,100
22	18.12.2020	Supervizim ura Treblovë	N.	43,716
14	22.06.2021	Rehabilitimi i kanalit Hasomat	K.	3,687,494
56	28.07.2021	Rrugë të brendshme me beton	Sh. SHPK	3,317,248
31	03.08.2021	Asfaltim rruga kropisht	A. SHPK	1,129,924
24	28.09.2021	Rikostruksion i rrjetit të ujësjellësit Selenicë, Kotë, Armen	B.	4,375,254
27	26.12.2021	Rikostruksion i rrjetit të ujësjellësit Selenicë, Kote, Armen	S.	17,012,628
88	7.12.2021	Kolaudim rrjeti i ujësjëllësit Kot, Armen, Selenicë	DSHPK	285,331
34	29.12.2021	Supervizimm i rikostruksionit të rrjetit të ujësjellësit Kot, Armen, Selenicë	P.C.	994,961
Totali				**40,935,736**
Vendime Gjyqi				
231	28.10.2015	Vendime Gjyqi	S.	269,562
1548	15.03.2017	Vendime Gjyqi	N. M.	10,000
1371	27.06.2007	Vendime Gjyqi	H. M.	6,000
3759	09.05.2011	Vendime Gjyqi	T. A.	806,804
1687	23.09.2015	Vendime Gjyqi	V.A.	160
1869	23.06.2016	Vendime Gjyqi	F. M.	83,150
4251	17.10.2017	Vendime Gjyqi	I.B.	600
1545	12.04.2018	Vendime Gjyqi	A. H.	338,000
1540	12.04.2018	Vendime Gjyqi	M. L.	78,000
2006	16.05.2018	Vendime Gjyqi	P. A.	122,595
1066	20.07.2017	Vendime Gjyqi	A...	52,080
211	28.03.2019	Vendime Gjyqi	A. h.	419,768
1158	18.04.2019	Vendime Gjyqi	J. B.	100,000
175	12.03.2019	Vendime Gjyqi	A. M.	21,500
2010	27.06.2019	Vendime Gjyqi	M.Rr.	132,800
495	04.07.2019	Vendime Gjyqi	L. P.	350,000
447	20.06.2019	Vendime Gjyqi	J. B.	653,000
640	22.10.2019	Vendime Gjyqi	H.R.	620,000
680	31.10.2019	Vendime Gjyqi	Z.L.	110,700
722	14.11.2019	Vendime Gjyqi	J. K.	315,200
675	31.10.2019	Vendime Gjyqi	S. B.	490,603
73	23.01.2020	Vendime Gjyqi	F.L.	597,120
14	21.01.2020	Vendime Gjyqi	Dh. Z.	591,600
	03.07.2020	Vendime Gjyqi	F. shpk	5,846,170
635	04.11.2020	Vendime Gjyqi	E. M.	48,000
617	15.04.2021	Vendime Gjyqi	M. K.	1,168,107
5	17.03.2021	Vendime Gjyqi	N.V.	880,850
Totali				**14,112,3698**
Shërbime				
		Energji elektrike	O.	1,070,524

		Blerje materiale	E.	10,000
		Blerje materiale	L. V.	6,000
13	13.04.2011	Blerje materiale	E. Z.	54,500
42	18.04.2011	Blerje materiale	A. M.	31,500
4	20.12.2010	Blerje materiale	B. F.	30,000
5	15.02.2011	Blerje materiale	M.	10,000
		A.....		326,003
		C.....		3,078,149
		Qarku Vlore 5%		446,000
		C...		2,946,280
		Posta		376,338
		Sigurime		52,454
		Tatime		51,039
		Roje Pastrues 602(Arsimi)		838,000
		Mirëmbajtje pastrim		2,066,800
		Këshilltrët bordero		433,167
		Qarku Vlorë 5%		493,000
		Posta		94,350
		Sindikata		28,800
18	22.05.2019	Media	Vl.	20,000
		Sigurime	Tatimet	246,808
		Kryepleqtë		291,125
65	24.10.2020	Shërbim Media	O.	20,000
9	05.12.2020	Shërbim televiziv	T.	50,000
67	25.09.2020	Riparim kanalevaditëse të njësive administrative	C.shpk	1,321,366
15	16.12.2021	Qira zjarfiksja	K. H.	55,000
		Objekt me qira	V. H.	10,200
		Objekt me qira	U.Dh.	8,500
		Qira banes sociale	E. I.	5,100
		Qira banes sociale	V. H.	5,100
		Qira banes sociale	F. H.	5,100
		Këshilltaret		181,440
		Kryepleqtë		306,425
54	29.12.2021	Kanalizime	Ujesjelles kanalizime	360,000
		Energji elektrike	O.	556,694
136	02.12.2021	Shërbim media	T.	170,000
24	22.12.2021	Shërbim media	O.	180,000
Totali				**16,235,762**
Gjendja në 31.12.2021				**71,283,867**

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet

-Llogaria 70 "Të ardhurat nga taksat e tatimet", në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 50,114,725 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 70,777,647 lekë ose me rritje në vlerën 20,662,922 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Në lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2021	31.12.2020
70	**I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME**	**70,777,647**	**50,114,725**
700	**1. Tatimi mbi të ardhurat**	**267,190**	**62,933**
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0
7001	Tatimi mbi fitimin	147,190	60,933
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	120,000	2,000
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
702	**2. Tatimi mbi pasurinë**	**16,871,659**	**11,260,719**
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	16,871,659	**11,260,719**
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	0	0
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	0	0
703	**3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit**	**53,638,798**	**38,791,073**
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Taksë mbi shërbimet specifike	0	0
7035	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	53,628,798	38,791,076

2. Të ardhurat jo tatimore

Llogaria 71 "Të ardhura jo tatimore", në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 11,742,156 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 13,313,184 lekë se me rritje në vlerën 1,571,028 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Në lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2021	31.12.2020
71	**III. TË ARDHURA JO TATIMORE**	**13,313,184**	**11,742,156**
710	**1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia**	**3,582,123**	**3,486,324**
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare	0	0
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	3,582,123	3,486,324
711	**2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare**	**9,731,061**	**8,255,832**
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	8,708,283	6,551,030
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	27,211	114,402
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	550,000	300,000
7114	Të ardhura nga biletat	0	0
7115	Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	445,567	1,290,400
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
719	**3. Të tjera të ardhura jo tatimore**	**0**	**0**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.

3. Të ardhura të tjera

-Llogaria 72 "Grante korente", në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 385,123,752 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 369,804,558 lekë ose me ulje në vlerën 15,319,194 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Në lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2021	31.12.2020
72	**V. GRANTE KORENTE**	**369,804,558**	**385,123,752**
720	**1. Grant korent i brendshëm**		
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	369,804,558	385,123,752
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	359,559,470	209,446,843
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme te ISSH	212,665	168,228,344
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)	0	0
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	0	0
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	10,032,423	0
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	0	0
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	0	0
7209	Të tjera grante korente të brendshme	0	0
721	**2. Grant korent i huaj**	**0**	**7,448,565**

SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

Llogaria 600 "Pagat dhe përfitimet e punonjësve" në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 136,845,968 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 133,359,606 lekë ose me zbritje në vlerën 2,926,485 lekë.

Llogaria 601 "Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 21,112,645 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 23,259,187 lekë ose me rritje në vlerën 2,146,542 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Vlorë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Në lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2021	31.12.2020
6001	Paga, personel i përhershëm	133,919,483	136,845,968
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	20,989,091	18,962,504
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	2,270,096	2,150,141
Totali		**157,178,670**	**157,958,613**

2. Blerje mallra dhe shërbime

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 "Blerje mallra dhe shërbime", në datë 31.12.2020, ka qenë në vlerën 75,845,049 lekë ndërsa në datën 31.12.2021, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 63,371,063 lekë ose me zbritje në vlerën 12,473,986 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Vlorë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Në lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2021	31.12.2020
602	**Blerje mallra e shërbime**	**63,371,063**	**75,845,049**
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	8,655,881	12,763,285
6021	Materiale dhe shërbime speciale	0	0
6022	Shërbime nga të tretë	11,576,119	12,162,703
6023	Shpenzime transporti	16,516,480	12,706,266
6024	Shpenzime udhëtimi	195,280	976,020
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	3,440,004	16,695,187
6026	Shpenzime për qiramarrje	1,204,755	1,344,100
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	8,320,000	6,025,340
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	13,462,544	13,172,148

Për vitin 2021 totali i te ardhurave në vlerë është 453,895,389 lekë dhe totali shpenzimeve është 376,359,606 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 77,535,783 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 85 "Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor" në vlerë 77,535,783 lekë.

Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës.

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj.,. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

3. Subvencionet

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Selenicë nuk ka pasur subvencione.

4. Transferime korrente

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 "Transferime korrente të brendshme"** paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 300,000 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 "Transferime për Buxhetet familjare e Individë"** paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 155,509,873 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Në lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2021	31.12.2020
	V. TRANSFERIME KORENTE	**155,809,873**	**164,167,219**
604	**1. Transferime korente të brendshme**	300,000	2,247,502
6040	Transferime korente tek nivele të tjera të Qeverisë	300,000	2,247,502
6041	Transferime korente tek institucione të ndryshme	0	0
6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore	0	0
6044	Transferime korente tek Organizata jo fitimprurëse	0	0
605	**2. Transferime korente me jashtë**	**0**	**0**
6051	Transferime për Organizatat Ndërkombëtare	0	0
6052	Transferime për Qeveritë e Huaja	0	0
6053	Transferime për institucionet jo fitimprurëse të huaja	0	0
6059	Transferime të tjera korrente me jashtë shtetit	0	0
606	**3. Transferime për buxhetet familjare e individë**	**155,509,873**	**161,919,717**
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH	0	0
6061	Transferta të paguara nga institucionet e tjera Pushtetit Vendor	155,509,873	161,919,717

Për vitin 2021, numri i punonjësve është miratuar me shkresën nr. 170 prot., datë 18.01.2021, dhe Urdhrin nr. 8, datë 18.01.2021, të Kryetarit të Bashkisë "Për miratimin e numrit të punonjësve në total 245 punonjës", nga të cilët nga të cilët 17 drejtues, 85 specialist, 2 teknikë, 62 nëpunës të thjesht dhe 77 punëtorë me fond page gjithsej 132,191,484 lekë.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. P. B. me detyrë Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. L. H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore në cilësinë e nëpunësit zbatues.

2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve
Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për vitet ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendim të KB viti 2021, bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara
Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon:*

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Selenice *(regjistrat e parashikimit dhe realizmit)*, për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Procedura 01/01/2021 - 31/12/2021	Nr.	Vl.Fond Limit
GJITHESEJ	**37**	**95,011,957**
-Të hapura	3	40,262,857
- hapur thjeshtuar/Kërkesë për propozim	9	37,883,690
- vogla	25	16,865,410

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, janë realizuar gjithsej **37** procedura me fond limit 95,012 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 87,954 mijë lekë, me një diferencë për vlerën 7,058 mijë lekë, ose 7.4 % e fondit limit të prokuruar.
Janë audituar procedurat e prokurimit si më poshtë:

Nr	Objekti	Fondi limit	Operatori fitues	Shënime
1	"Përmirësimi I banesave ekzistuese për komunitetet evarfëra dhe të pafavorizuara	15,762,510	BOE "J." & "C."	Me shkelje
2	"Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë"	6,651,036	OE "I. G."	Me shkelje
3	Rikonstruksion rruge të brendshme me beton	12,000,347	"A."	Me shkelje
4	Rikonstruksion I ujësjellësit Vodicë	6,574,733	"A."	Me shkelje
5	Sistemim Asfaltim rruga tubo (rruga varreza, spital)	8,991,254	OE "J."	Me shkelje
6	Sistemim Asfaltim rruga Kropisht	12.500,000	OE "A."	Me shkelje
7	Rehabilitim ura Brataj	1,666,667	OE "A."	Me shkelje
8	Riparimi i shkarkuesit të rezervuarit të Harvalasë, Zgjerimi i rrugës Resulaj – Romës dhe punime gërmimi dhe riparimi në rrugën Bashaj - Vërmik	6,500,000	2" ShPK	Me shkelje
9	Rehabilitim I kanalit ujitës Hasomat Velçë dhe punime për rrjetin e kanalizimeve qendër Kotë	7,500,000	OE "K."	Me shkelje

Titulli i gjetjes 20: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP

1. Procedura e prokurimit me objekt "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara", Bashkia Selenicë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Përmirësimi I banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara", Nr. Ref. 84152, datë 01-17-2021.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 6, datë 08.02.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 31, datë 08.02.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 32, datë 08.02.2021
2. Lloji i Procedurës – "E Hapur"	Njësia e Prokurimit 1. M. H., Jurist 2. A. V., topograf 3. S. S., jurist	1. K. B. 2. L. H. 3. P. A.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 15,762,510 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE "J." ShPK& "C." ShPK me ofertë 12,467,844 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 1423 prot, dt. 10.05.2021 me afat 120 ditë nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 3,294,666 lekë ose 20.9 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 19.03.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit dhe i Bashkisë Selenicë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) S'kualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i "Hapur", me vlerë 15,762,510 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit.

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se preventivi i punimeve (pjesë integrale e dokumenteve të tenderit) është hartuar nga z. K. B., i cili me Urdhrin nr. 32, datë 08.02.2021, është caktuar të jetë edhe pjesë e KVO-së. Ky veprim është në kundërshtim me VKM

Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar Neni 58 "Komisioni i vlerësimit të ofertave", sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës".* ***Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave...***".

- Nuk është bërë përcaktimi i personit përgjegjës për prokurimet, Specialistit të fushës dhe ndarja e detyrave të Njësisë së Prokurimit
- Nuk është përcaktuar kryetari i KVO-së.

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Selenicë, z. P. B..

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë dokument për fillimin e këtij investimi.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Burimeve Natyrore,Mjedisit, Projekteve dhe Investimeve (ing. K. B. dhe topograf A.V.) dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Selenicë, z. P. B. në Prill 2020. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 3 muaj nga lidhja e kontratës.

Në dosjen teknike nuk administrohet leja e ndërtimit. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" Neni 39, "Leja e ndërtimit" sipas të cilit "*1.Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.*

2. Dokumenti i lejes së ndërtimit përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqërues të aplikimit dhe normave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

3. Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat "e" dhe "ë", të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit." dhe ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Selenicë, z. P. B., mbikëqyrësin e punimeve dhe kontraktorin e punimeve.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...". Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Selenicë, z. P. B..

Situata 1

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 15.01.2021.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit, datë 29.01.2021, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 61,

"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*
Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit".
- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:
1- Në pikën "Licenca profesionale", është vendosur NP-2A (Ndërtime civile dhe industriale) N.P – 11 A (Ndërtime për N/stacionet, kabinat, e transformatorëve linja e TN, e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë). Nga verifikimi i preventivit të miratuar, rezulton se këto punime nuk janë në preventivin e punimeve të hedhur në sistem dhe për pasojë, nuk janë të justifikuara teknikisht dhe nuk është në përpjesëtim me natyrën e objektit që prokurohet.
2- Është kërkuar "Një punësim mesatar i të paktën 50 (pesëdhjetë) punonjës, për periudhën Janar 2020– Nëntor 2020". Ky numër punonjësish nuk është i argumentuar dhe në përpjesëtim me volumin e objektit që prokurohet.
3- Në KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 3 inxhinierë të ndryshëm të jenë në listë pagesa, si dhe staf mbështetës 3 inxhinierë (restaurator, elektronik, hidroteknik) dhe teknik ndërtimi, të punësuar në periudhën Janar 2020– Nëntor 2020. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi referuar preventivit të punimeve që prokurohen, përveç inxhinierit të ndërtimit dhe inxhinierit të topograf, stafi tjetër nuk është i nevojshëm.
4- Është kërkuar që OE të ketë një nga inxhinieret me certifikate si Auditues energjetik ne ndërtesa, lëshuar nga agjencia për eficiencen e energjisë. Ky kriter nuk është në përpjesëtim me natyrën e objektit që prokurohet.
5- Operatori ekonomik duhet të disponojnë licencë QKL III.2.B "Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane". Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është sipas natyrës së punimeve.
6- Është kërkuar 1(një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Licence për ushtrimin individual te profesionit, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listë pagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2020 – Nëntor 2020. Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm. Ky kriter është argumentuar nëpërmjet një VKM-je të shfuqizuar, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.
7- Është kërkuar vetëm një kamion vetëshkarkues deri në 3.5 ton, i pamjaftueshëm për të realizuar punimet sipas preventivit.
8- Është kërkuar Certifikata **EN-ISO 3834-2: 2006 Për sistemimin e menaxhimit të cilësisë ne saldim**. Nga verifikimi i preventivit të objektit, rezulton se kjo certifikatë nuk është në natyrën e objektit që prokurohet.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe **krijojnë mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit, M.H., A. V. dhe S. S. (pasi nuk ka ndarje të detyrave nga Titullari i AK.

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Për argumentimin e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe preventivave, nuk ka asnjë dokument për ngritjen e grupit të punës.

Nga verifikimi me zgjedhje i zërave të preventivit të ofertës (ato me vlerë më të madhe), rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur". Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 01.03.2021.

Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë në pjesë në procedurë OE, me ofertën e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	C.	12,601,021
2	"A." SPK	13,539,069
3	BOE "J." ShPK& C. ShPK	12,467,844
4	"A." ShPK	11,841,120
5	B. ShPK	14,973,242

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë dhe SPE
Punoi: KLSH

Është mbajtur procesverbali për rivlerësimini e ofertave pa nr. prot, datë 10.03.2021.

Nga auditimi rezulton se në dosje administrohet Raporti Përmbledhës datë 10.03.2021, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Neni 68, "Raporti Përmbledhës", sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor*". Është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit, i cili është hedhur në SPE.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se nga KVO është skualifikuar:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
	"A." ShPK	11,841,120

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë dhe SPE
Punoi: KLSH

Nga verifikimi i Procesverbalit të Vlerësimit, datë 26.02.2021 (5 ditë para procesverbalit të hapjes ky ofertues është skualifikuar për arsyet e mëposhtme:

Në pikën 2.3.3. të dokumenteve standarde është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të ketë mesatarisht të punësuar jo më pak se 50 punonjës mesatar (janar - nëntor 2020) duke përfshirë drejtuesit ligjorë, teknik dhe stafin menaxherial. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për secilin muaj në periudhën e kërkuar
- Listë pagesat sipas formularit E-SIG, të plotësuara e dorëzuara rregullisht në Degën e Tatim Taksave ku OE është regjistruar
- Formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat shoqëruar me mandat pagesat e bankës.

Ky subjekt nuk dispononi numrin e këtyre punëtoreve dhe specialistëve në përputhje me kërkesat sa më sipër .
Në muajin janar ka 34 punonjës me gjithë stafin teknik, në muajin shkurt 36, mars 35, prill 46, maj 39, qershor 20, korrik 22, gusht 22, shtator 22, tetor 33 dhe nëntor 35 punonjës së bashku me gjithë stafin inxhiniero teknik në kushtet kur kërkohen 50 punonjës mesatar për janar nëntor.
Në pikën 2.3.5 në paragrafin e fundit është kërkuar që:
-1 inxhinier i certifikuar si ekspert privat zjarrfikës,të vërtetuar me dokumente, Kontratë Pune, Diplomë, i cili duhet të jetë në listë pagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar ose i kontraktuar
-Licencë lidhur me ndikimin në mjedis kodi III.2.B, Grumbullim transportim i mbetjeve urbane inerte
-Një nga inxhinierët të ketë certifikatë si Auditues energjetik në ndërtesa, lëshuar nga Agjencia për Eficencen e Energjisë
Ju nuk i dispononi këto liçenca në përputhje me specifikimet e kërkuara
Në dokumentet standarde 2.3.9 është kërkuar
Çdo ofertues do të paraqesë PLAN - ORGANIZIMIN e punimeve në çdo objekt ku të reflektojë të gjitha masat tekniko-organizative dhe elementet e tjerë që kërkon një plan organizimi i mirëfilltë.
Ju nuk keni një plan të mirëfilltë, gjë që dëshmoni mungesë organizimi në një objekt të rëndësisë së tillë.

Nga verifikimi në SPE i dokumentacionit të OE "A" ShPK, rezultoi si më poshtë:
Mungesat e evidentuara nga KVO, janë të sakta. Ndërkohë mungon edhe eksperienca e ngjashme, pasi nga shoqëria është paraqitur vetëm objekti "Ndërtim ure në fshatin Mallkeq dhe rikonstruksion i pasarelës në fshatin Vodicë", me vlerë 5,844,000 me TVSh (4,870,000 lekë pa TVSh), i cili nuk i plotëson kërkesat e vendosura në DT. Përsa sipër, ky OE është skualifikuar me të drejtë.
Kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në DT (sipas KVO-së,) dhe janë kualifikuar, si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	C.	12,601,021
2	"A." SHPK	13,539,069
3	**BOE "J." ShPK& C. ShPK**	**12,467,844**
4	B. ShPK	14,973,242

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë dhe SPE
Punoi: KLSH

Pas skualifikimit të OE "A" ShPK, KVO ka shpallur fitues BOE "J." ShPK& "C." ShPK dhe i ka kërkuar Titullarit të AK lidhjen e kontratës me këtë BOE në vlerën 14,961,413 lekë me TVSh.
Pas njoftimit të fituesit nga AK, për këtë procedurë prokurimi është bërë ankimim në KPP nga OE "A." SHPK, pas të cilit KPP ka marrë vendimin nr. 421/1, datë 19.03.2021, duke vendosur shqyrtimin në themel të ankesës.
Pas këtij Vendimi nga ana e Bashkisë Selenicë, me shkresën nr. 932/1, datë 01.04.20221 është vendosur në dispozicion të KPP-së dokumentacioni i kërkuar për shqyrtimin e kësaj ankese.
Me Vendimin nr. 179/2021, datë 27.04.2021, KPP ka vendosur të mos pranojë ankesën e OE "A." ShPK me objekt "*Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e OE "C." ShPK dhe "J." ShPK* për këtë procedurë, duke i kërkuar AK që të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
Pas këtij vendimi, AK ka lidhur kontratën me nr. 1423 prot., datë 10.05.2021 me vlerë 14,961,413 lekë me TVSh me BOE "J." ShPK& "C." ShPK.
Sa sipër, vlerësimi i kësaj procedure konsiderohet i drejtë.

Ndikimi: Vendosja e kritereve të kualifikimit në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Selenicë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit.

Titulli i gjetjes 21: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP

2. Procedura e prokurimit me objekt "Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë", Bashkia Selenicë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë", Nr. Ref. 91642, datë 03-29-2021.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 57, datë 29.03.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 57, datë 29.03.2021 Njësia e Prokurimit 1. M. H., Jurist 2. A. V., topograf 3. E. F., ekonomist	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 28, datë 29.03.2021 4. K. B., 5. K. S. 6. P. A.
2. Lloji i Procedurës – "Kërkesë për propozim"		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 6,651,036 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "I..G." SHPK me ofertë 6,482,600 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 1456 prot., datë 12.05.2021 me afat 60 ditë nga lidhja e kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 168,436 lekë ose 2.5 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 12.04.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Selenicë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) S'kualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është tender i "Kërkesë për propozim", me vlerë 6,651,036 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga fondet e Bashkisë Selenicë.
Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se preventivi i punimeve, relacioni teknik dhe specifikimet teknike (pjesë integrale të dokumenteve të tenderit), janë hartuar nga ing. K. B., i cili me Urdhrin nr. 58, datë 29.03.2021, është caktuar të jetë edhe pjesë e KVO-së. Ky veprim është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar Neni 58 "Komisioni i vlerësimit të ofertave", sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës".* ***Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave...***".
- Nuk është bërë përcaktimi i personit përgjegjës për prokurimet, Specialistit të fushës dhe ndarja e detyrave të Njësisë së Prokurimit
- Nuk është përcaktuar kryetari i KVO-së.
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Selenicë, z. P. B..

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë dokument për iniciimin e kryerjes së këtij investimi.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Në SPE janë hedhur një gjurmë e kanalit të fshatit Mesaplik dhe gjurmë e stacionit të pompave (marrë nga google earth), specifikimet teknike dhe relacioni teknik (të padetajuara), të hartuara nga ing. K. B. dhe preventivi i punimeve. Nga sa sipër, projekti është i paplotë dhe mbart riskun e realizimit jocilësor të objektit. Nga sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi hartuesi i projektit dhe NjP.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...". Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Selenicë, z. P. B.

Mbi përcaktimin e fondit limit

Nga auditimi i preventivit të punimeve, rezulton se nuk është hartuar konform UKM Nr.2, date 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", pasi vlera e pajisjeve prej 2,490,000 lekë (ose 37.4% e vlerës së objektit) është ngarkuar me vlerën e TVSH-së **prej 498,000 lekë**. Kjo vlerë është shtuar fiktivisht në vlerën e fondit limit dhe përbën përdorim pa ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Selenicë.

Nga verifikimi i çmimeve të preventivit të administruar në dosje, rezulton se 15 zëra të preventivit me vlerë **3,559,744 lekë**, janë të shënuar "an" dhe nuk janë shoqëruar me analiza çmimi, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar Neni 59 "Përllogaritja e vlerës limit të kontratës", sipas të cilit "....*Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës...*"

Situata 1

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 29.03.2021.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit, datë 19.04.2021, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit".

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:

1- Në pikën "Licenca profesionale", është vendosur Ndërtimi civile industriale NP-2 Klasifikim A, Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile NP-3 Klasifikimi A, Punime nëntokësore ura

e vepra arti NP5 Klasifikim A, Punime te inxhinierisë së mjedisit NP-12 Klasifikim A, Punime rifiniture të muraturës dhe te lidhura me to etj NS-4 Klasifikim A, Ndërtime parafabrikat beton arme ,struktura metalike dhe druri NS-8Klasifikim A. Nga verifikimi i preventivit të miratuar, rezulton se këto punime nuk janë në preventivin e punimeve të hedhur në sistem dhe për pasojë, nuk janë të justifikuara teknikisht dhe nuk është në përpjesëtim me natyrën e objektit që prokurohet.
2- Është kërkuar "Një punësim mesatar i të paktën 40 (dyzetë) punonjës me kohë të plotë, për periudhën Shtator 2020– Shkurt 2021". Ky numër punonjësish nuk është i argumentuar dhe në përpjesëtim me volumin e objektit që prokurohet.
3- Në pikën 2.3.3 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 5 inxhinierë të ndryshëm të jenë në listë pagesa dhe licencën e shoqërisë, si dhe staf mbështetës 3 teknikë të tjerë të ndryshëm, të punësuar në periudhën Shtator 2020– Shkurt 2021. Për stafin e inxhinierëve është kërkuar një deklaratë që nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve që prokurohen, përveç inxhinierit të ndërtimit/inxhinierit hidroteknik dhe inxhinierit të topograf, stafi tjetër nuk është i nevojshëm. Gjithashtu, kërkesa që gjithë stafi prej 5 inxhinierësh, të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, krijon mundësinë e përjashtimit të OE që janë të angazhuar në kontrata të tjera.
4- Është kërkuar që Operatori ekonomik duhet te ketë në licencën profesionale një inxhinier mjedisi me certifikatë për hartimin e Raporteve të VNM-së dhe licenca kategoria 5C "Ujësjellës kanalizime urbane-rurale". Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është sipas natyrës së punimeve. Kategoria 5 C ka të bëjë me licencën e shoqërisë dhe jo të inxhinierit të mjedisit.
5- Është kërkuar që Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar nje mjek, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figuroje në listë pagesa për periudhën Shtator 2020–Shkurt 2021 Ky kriter është argumentuar nëpërmjet një VKM-je të shfuqizuar, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.
6- Janë kërkuar Kamion vetëshkarkues (kapacitet mbajtës mbi 20 ton, 2 Kamionë vetëshkarkues me vinç (kapacitet mbajtës mbi 3.5ton), Autobot Uji mbi 5000 litra, Betoniere 3 m3, Depozite uji (5000 litra), Vibrator betoni cope 1(një), Elektrobetoniere 0.33 m3. Ky kriter nuk është i justifikuar teknikisht, pasi në preventivin e punimeve nuk ka zëra pune që të kryhen me makineritë/pajisjet e mësipërme.
7- Është kërkuar që në rast të BOE, të gjitha Certifikatat ISO të jenë nga të gjitha antarët e BOE. Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht, pasi kapacitetet teknike dhe profesionale mund të bashkohen.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe **krijojnë mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit, M. H., A.V. dhe E. F. (pasi nuk ka ndarje të detyrave nga Titullari i AK.

Situata 2
Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "Kërkesë për propozim". Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 19.04.2021.
Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë në pjesë në procedurë OE, me ofertën e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	"I.G." SHPK	6,482,600

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë dhe SPE
Punoi: KLSH

Nga auditimi rezulton se në dosje nuk administrohet Raporti Përmbledhës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Neni 68, "Raporti Përmbledhës", sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor*", duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KVO-së, K. B., P. A., K. S. dhe Titullari i AK z. P. B.. Është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit, i cili është hedhur në SPE.
Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se:
Nga KVO, është konstatuar se nuk ka të skualifikuar:
Ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT (sipas KVO-së,) dhe është kualifikuar:

Nr.	OE të kualifikuar	Vlera e Ofertës
1	"I.G." SHPK	6,482,600

Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të Operatori ekonomik fitues, rezultoi si më poshtë:
- Nisur nga fakti që KVO-ja me të njëjtën përbërje me KVO-në e objektit **"Rikonstruksion i ujësjellësit Vodicë", Bashkia Selenicë,** e ka bërë llogaritjen e fuqisë mesatare punëtore me shumën e ditëve të punës në listë pagesa / 22 ditë pune që i takon një punëtori, nëse nga KVO do të bëhej llogaritja e fuqisë mesatare punëtore në këtë mënyrë edhe për këtë objekt, OE "I. G." SHPK, nuk e plotëson kriterin e disponimit të numrit mesatar mujor të fuqisë punëtore prej 40 punonjësish.
- Në ofertën ekonomike, zëri i punës "tubo llamarine e zezë", e cila në preventivin e fondit limit ka vlerën 275,000 lekë, ose 4.1% e fondit limit, është paraqitur pa vlerë ekonomike (zero) dhe nga KVO, nuk rezulton të jetë kërkuar sqarim, apo të jetë refuzuar si ofertë.
- Inxhinierja e ndërtimit I. B., e cila rezulton të jetë një nga drejtuesit teknikë të shoqërisë, nuk figuron në listë pagesat e periudhës Shtator 2020 - Dhjetor 2020.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*".
Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 7,779,120 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP.
Ndikimi: Vendosja e kritereve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Selenicë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Titulli i gjetjes 22: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP

3. Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion rruge të brendshme me beton", Bashkia Selenicë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion rruge të brendshme me beton, Nr. Ref. 86812, datë 02-11-2021.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 31, datë 08.02.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 31, datë 08.02.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 32, datë 08.02.2021
2. Lloji i Procedurës – "E Hapur"	Njësia e Prokurimit 1. M. H., Jurist 2. A. V., topograf 3. E. F., ekonomist	7. K. B., 8. L. H. 9. P. A.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 12,000,347 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "A." SHPK me ofertë 11,990,000 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 1031 prot, dt. 06.04.2021 me afat 90 ditë nga lidhja e kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 10,347 lekë ose 0.09 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 19.03.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Selenicë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) S'kualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i "Hapur", me vlerë 12,000,347 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë.

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se preventivi i punimeve (pjesë integrale e dokumenteve të tenderit) është hartuar nga z. K. B., i cili me Urdhrin nr. 32, datë 08.02.2021, është caktuar të jetë edhe pjesë e KVO-së. Ky veprim është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar Neni 58 "Komisioni i vlerësimit të ofertave", sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës".* ***Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave...***".

- Nuk është bërë përcaktimi i personit përgjegjës për prokurimet, Specialistit të fushës dhe ndarja e detyrave të Njësisë së Prokurimit
- Nuk është përcaktuar kryetari i KVO-së.

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Selenicë, z. P. B.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë dokument për inicimin e kryerjes së këtij investimi.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Relacioni teknik dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Burimeve Natyrore,Mjedisit, Projekteve dhe Investimeve (ing. K. B. dhe topograf A. V.) dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Selenicë, z. P. B. në Prill 2020. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 3 muaj nga lidhja e kontratës.
-Në dosjen teknike nuk administrohet leja e ndërtimit/infrastrukturës. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" Neni 39, "Leja e ndërtimit" sipas të cilit "*1.Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.*
2. Dokumenti i lejes së ndërtimit përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqërues të aplikimit dhe normave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
3. Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat "e" dhe "ë", të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit." dhe ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Selenicë, z. P. B. mbikëqyrësin e punimeve dhe kontraktorin e punimeve.
-Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...". Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Selenicë, z. P. B.

Situata 1
Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:
Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 11.02.2021, si më poshtë:
-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit, datë 11.02.2021, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*
Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit".
- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:
1- Në pikën "Licenca profesionale", është vendosur N.P – 12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit), N.S - 1A (Punime prishje ndërtimore), N.S - 20 A (Shpime gjeologo-inxhinierike). Nga verifikimi i preventivit të miratuar, rezulton se këto punime nuk janë në preventivin e punimeve

të hedhur në sistem dhe për pasojë, nuk janë të justifikuara teknikisht dhe nuk është në përpjesëtim me natyrën e objektit që prokurohet.
2- Është kërkuar "Një punësim mesatar i të paktën 70 (Nëntëdhjetë) punonjës me kohë të plotë, për periudhën Janar 2020– Nëntor 2020". Kjo kërkesë është bërë me një gabim në të shkruar, ku numri nuk përputhet me shprehjen me fjalë (70 (nëntëdhjetë)). Gjithashtu ky numër punonjësish (nëntëdhjeta merret në konsideratë) nuk është i argumentuar dhe në përpjesëtim me volumin e objektit që prokurohet.
3- Në pikën 2.3.3 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 5 inxhinierë të ndryshëm të jenë në listë pagesa, si dhe staf mbështetës 3 inxhinierë dhe 6 teknikë të tjerë të ndryshëm, të punësuar në periudhën Janar 2020– Nëntor 2020. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve që prokurohen, përveç inxhinierit të ndërtimit/inxhinierit të transportit dhe inxhinierit të topograf, stafi tjetër nuk është i nevojshëm.
4- Është kërkuar që OE duhet kenë apo që mund t'i vihen në dispozicion me kontrate 1(një) nyje thyerje materiale inerte cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodiIII.1.B, 1(një) fabrikebetoni e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodi III.1.B.
Në rastin kur ka një kontratë qiraje/furnizimi me prodhuesin, bashkë me lejen mjedisore të prodhuesit, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimi te vlefshme. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.
Shënim: Për fabrikën e asfaltobetonit bazuar ne VKM Nr 628 date 15.07.2015 nga koha e prodhimit, transportit, shtrimit nuk duhet qe te kaloje me shume se 2 ore ose 60 km larg objektit.
Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi kërkohet për një subjekt që nuk është pjesëmarrës në tender. Gjithashtu kërkesa për fabrikën e asfaltobetonit, kur në preventiv ky zë nuk figuron, tregon për vendosje kriteresh copy-paste, apo më keq.
5- Është kërkuar që OE të ketë të punësuar një ekspert zjarrfikëse të shoqëruar me: kontratë noteriale pune, certifikatën e zjarrfikësit, librezë pune, cv, te jete ne liste pagesa për periudhën 12 muajt e fundit, gjithashtu operatori ekonomik ose eksperti zjarrfikës te jete te i pajisur me Kodi 1.2.A lëshuar nga QKL (kjo pikë kërkohet duke qenë se në objektet do përdoret praimer/bitum këto material konsiderohen lende e rrezikshme për zjarr). Ky kriter nuk është në përpjesëtim me natyrën e objektit që prokurohet.
6- Është kërkuar që OE duhet të ketë licence lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL. Kodi III.1.A në mbështetje të vendimit të Këshillit te Ministrave VKM Nr. 419, Date 25/6/2014 dhe Ligj Nr. 104448, Date 9/6/2011. Ky kriter nuk është në përpjesëtim me natyrën e objektit që prokurohet.
7- Operatori ekonomik duhet te ketë licence lidhur me ndikimin ne mjedis të lëshuar nga QKL. Kodi III.2.B autoriteti kontraktor kërkon që kjo të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe konkretisht në ligjin 10081 datë 23.02.2003, nga ku rrjedhimisht operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë licencë QKL III.2.B "Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane". Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është sipas natyrës së punimeve.
8- Është kërkuar 1(një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Licencë për ushtrimin individual te profesionit, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listë pagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2020 – Nëntor 2020. Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm. Ky kriter është argumentuar nëpërmjet një VKM-je të shfuqizuar, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.

9- Janë kërkuar Autofshese për pastrim rrugësh, Sistem wellpoint/ekuivalent për heqje ujërash, Kamion me Vinc kapacitet mbajtës(6.5-8.5 ton), Cekic pneumatik për prishje, Autobitumatrice, Rimorkiator, Makineri vijezimi bikoponente. Ky kriter nuk është i justifikuar teknikisht, pasi në preventivin e punimeve nuk ka zëra pune që të kryhen me makineritë/pajisjet e mësipërme.
10- Është kërkuar Certifikata **ISO DS CET/TR 15128:2005 "**Realizimi I riparimeve kanalizuese për shkarkime dhe kullime te ujrave". Nga verifikimi i preventivit të objektit, rezulton se kjo certifikatë nuk është në natyrën e objektit që prokurohet.
11- Është përcaktuar që "***Operatorët ekonomikë, të cilët nuk kane përmbushur realizimin e kontratave në Bashkinë Selenicë brenda afatit kontraktual dhe nuk kanë lidhur kontratë kur është shpallur fitues pa dhënë shpjegime për mos lidhjen e kontratës, do të përbejnë kusht për skualifikim"***. Ky kusht është i pambështetur në legjislacionin e prokurimeve dhe në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 77, "Mbikëqyrja e kontratës", sipas të cilit "…*2. Mos përmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç të nenit 13 të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i afatit të zbatimit të saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë*…". Sipas nenit të sipërcituar, nuk është AK që bën penalizimin në këtë mënyrë të OE, por APP me propozim të AK.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe **krijojnë mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit, M. H., A. V. dhe E. F. (pasi nuk ka ndarje të detyrave nga Titullari i AK.

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Për argumentimin e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe preventivave, nuk administrohet asnjë dokument për ngritjen e grupit të punës.
Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se janë ngatërruar dy numra të analizave të çmimit, por çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur". Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 19.03.2021.
Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë në pjesë në procedurë OE, me ofertën e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	"A." SHPK	11,990,990

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Është mbajtur procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave pa nr. prot, datë 19.03.2021.

Nga auditimi rezulton se në dosje nuk administrohet Raporti Përmbledhës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Neni 68, "Raporti Përmbledhës", sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor*", duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KVO-së, K. B., L. H., P. A. dhe Titullari i AK z. P. B.. Është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit, i cili është hedhur në SPE.
Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se nuk ka të skualifikuar.
Ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT (sipas KVO-së,) dhe është kualifikuar:

Nr.	OE të kualifikuar	Vlera e Ofertës
1	"A" SHPK	11,990,990

Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të Operatori ekonomik fitues, rezultoi si më poshtë:
- Si analiza çmimesh, ka sjellë analizat për zëra pune që nuk janë në preventivin e ofertës (FV tuba plastikë) dhe nuk ka sjellë asnjë analizë çmimi për zërat e preventivit,
- Tek eksperienca e paraqitur nga "A" SHPK, për objektin "Ndërtim ura dhe mure mbajtëse bashkia Selenicë", nuk janë paraqitur faturat tatimore, si është kërkuar në KVK. Objekti i paraqitur "Rikonstruksion ura Mallkeq dhe pasarela Vodicë" e ka vlerën 4,870,000 lekë pa tvsh, vlerë e cila është më e vogël se ajo e kërkuar në KVK, 50% e fondit limit të objektit të prokuruar.
- Mungon ndarja e punimeve me zëra punimesh
- Si plan veprimi nga "A" SHPK është paraqitur plani i veprimit të objektit "Sistemim asfaltim Lagjja tubo Selenicë". Mungon Plani i Veprimit të OE "Sh." SHPK.
- Mungon sistemi wellpoint

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*".
Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 14,388,000 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP.
Ndikimi: Vendosja e kritereve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Selenicë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Titulli i gjetjes 23: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP

4. Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i ujësjellësit Vodicë", Bashkia Selenicë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i ujësjellësit Vodicë", Nr. Ref. 09846, datë 10-28-2021.

1. Urdhër Prokurimi Nr. 48, datë 13.10.2021 2. Lloji i Procedurës – "E Hapur e thjeshtuar"	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 48, datë 13.10.2021 Njësia e Prokurimit 1. M. H., Jurist 2. A. V., topograf 3. E. F., ekonomist	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 130, datë 08.11.2021 10. K. B., Kryetar 11. K. S. 12. P. A.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 6,574,733 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "A" SHPK me ofertë 5,880,840 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 472 prot, dt. 16.02.2022 me afat 60 ditë nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 693,893 lekë ose 10.6 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 10.11.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Selenicë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) S'kualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime; ka ankesë në KPP datë 09.12.2021	12. Përgjigje Ankesës	13. Përgjigje Ankesës Vendimi Nr. 96/2022, datë 26.01.2022

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është tender i "E Hapur e thjeshtuar", me vlerë 6,574,733 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë.

- Nuk është bërë përcaktimi i personit përgjegjës për prokurimet, Specialistit të fushës dhe ndarja e detyrave të Njësisë së Prokurimit
- Nuk është përcaktuar kryetari i KVO-së.

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Selenicë, z. P.B.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë dokument për inicimin e kryerjes së këtij investimi.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga ing. N. J. dhe topograf R. V. dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Selenicë, z. P. B. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 2 muaj nga nënështkrimi i kontratës.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...". Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Selenicë, z. P. B.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, pa datë, i cili ka ndryshuar me shtojcën e modifikimeve të hedhur në SPE.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit nuk është mbajtur asnjë procesverbal, veprim në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 2

"Dokumentimi i procesit", sipas të cilit **"** *1. Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera.*

2. Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:

a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;

b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar, nëse është rasti;

c) argumentimin e kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit;

ç) vlerën dhe mënyrën e përllogaritjes së vlerës, në përputhje me parashikimet e LPP-së dhe parashikimet në këto rregulla;

d) *të gjitha kërkesat për sqarim për dokumentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe modifikimet e bëra në këto dokumente, nëse është rasti.*.....".

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura (edhe në shtojcën nr. 1), u konstatua se:

1- Në pikën 2.3.3 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 5 inxhinierë të ndryshëm të jenë në listë pagesa, si dhe staf mbështetës 2 teknikë të tjerë të ndryshëm, të punësuar në periudhën 6 (gjashtë) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve që prokurohen, pasi nuk është në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet. Gjithashtu kërkesa për të qenë në licencën e shoqërisë inxhinierët mekanik, elektrik, është e paargumentuar teknikisht.

2- Është kërkuar që për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht për:

a. Tubo HDPE dhe PVC.

Kur operatorët ekonomikë janë prodhues të paraqitet katalogu përkatës, leje mjedisore kodi KODI III.1.B (riciklim plastik), KODI III.1.A (prodhimi I produkteve plastike), KODI III.2.B (përpunimi i plastikes) dhe certifikatën e cilësisë ISO 9001/ekuivalente e vlefshme. Kur operatorët ekonomikë nuk janë vetë prodhues të paraqitet kontrata paraprake e furnizimit e vlefshme dhe katalogu përkatës, leje mjedisore KODI III.1.B (riciklim plastik), KODI III.1.A (prodhimi i produkteve plastike), KODI III.2.B (përpunimi i plastikës),certifikatën e cilësisë ISO9001/ekuivalente e vlefshme të prodhuesit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

b. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka ne pronësi apo me qira një ambient për prodhimin e inerteve, parafabrikate, granil dhe të garantojnë furnim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit si dhe te jetë i pajisur me licence QKL Kodi IV.1.B.2

c. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka ne pronësi apo me qira një **impiant betoni** dhe të garantojnë furnizim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit si dhe të jetë i pajisur me licence QKL Kodi IV.1.B.2

e. Operatori ekonomik duhet të ketë licencë lidhur me ndikimin ne mjedis të lëshuar nga QKL. Kodi III.2.B autoriteti kontraktor kërkon që kjo të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe konkretisht në ligjin 10081 datë 23.02.2003, nga ku rrjedhimisht operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë licencë QKL III.2.B "Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane".

Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi nuk është në përpjesëtim me natyrën e objektit që prokurohet dhe kërkohet për një subjekt që nuk është pjesëmarrës në tender. Gjithashtu, është kërkuar impiant betoni, kur në preventivin e punimeve nuk ka zë pune që të nevojitet furnizimi me beton dhe .
3- Certifikatat e kërkuara ISO, nuk e kanë të përcaktuar titullin.
4- Është kërkuar 1(një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Licence për ushtrimin individual te profesionit, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listë pagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2020 – Nëntor 2020. Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm. Ky kriter është argumentuar nëpërmjet një VKM-je të shfuqizuar, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.
5- Janë kërkuar Furgon për transport të punonjësve, Auto Betoniere, Autobot Uji, kalandër për punimet e metalit. Ky kriter nuk është i justifikuar teknikisht, pasi në preventivin e punimeve nuk ka zëra pune që të kryhen me makineritë/pajisjet e mësipërme.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe **krijojnë mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit, M. H., A.V. dhe E. F. (pasi nuk ka ndarje të detyrave nga Titullari i AK).

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Për argumentimin e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe preventivave, nuk është ngritur grupi i punës me urdhër të titullarit të AK.
Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se janë ngatërruar dy numra të analizave të çmimit, por çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur". Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 19.03.2021. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë në pjesë në procedurë OE, me ofertën e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	"A" SPK	5,880,840
2	BOE "S." ShPK & "K." ShPK	5,052,600

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Është mbajtur procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave pa nr. prot, datë 01.12.2021.
Nga auditimi rezulton se nga KVO nuk është hartuar Raporti Përmbledhës, por është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit, i cili është nënshkruar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. P. B. dhe është hedhur në sistem.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se:
Është konstatuar se nga KVO është skualifikuar:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	BOE "S." SHPK & "K." SHPK	5,052,600

Nga verifikimi i Procesverbalit të Hapje-Vlerësimit, ky ofertues është skualifikuar për arsyet e mëposhtme:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **30** *(tridhjetë)* **punonjës** për periudhën **6** *(gjashtëmujore)* nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. **Për vërtetimin e këtij kushti të paraqiten:**
- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
- Listë pagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.
- Kjo periudhë përkon 1 Prill deri 30 Shtator 2021

Subjekti "S." ShPK, në bazë të kontratës bashkëpunimit Nr. 1626, datë 9.11.2021 zotëron 80% të kësaj kontrate dhe 20% subjekti "K." SHPK, kjo në bazë të nenit nr. 3 me objekt ndarja e punëve të kësaj kontrate me objekt Rikonstruksion i Ujësjellësit Vodicë.
Subjekti "S." duhet të plotësojë në bazë të kësaj kontrate minimumi:
-80% të fuqisë punëtore
-80 % të kapacitetit ekonomik e financiar
-80 % të kapacitetit teknik
Fuqia punëtore për periudhën e kërkuar nuk përmbush kërkesën sipas pikës në dok. standarde :
2.3.1 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **30** *(tridhjetë)* **punonjës** për periudhën **6** *(gjashtëmujore)* muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. **Për vërtetimin e këtij kushti të paraqiten:**
4. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
Listë pagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme
Punëtor mesatar mujor quhet një punëtor i cili ka futur minimalisht 22 dite pune në muaj.
Subjekti "S." duhet të ketë 80% x 30 punonjës të kërkuar =24 punonjës mesatar
Subjekti "K." shpk duhet të ketë minimumi 6 punonjës mesatar për pjesën e kontratës që mbulon në bazë të aktmarrëveshjes së firmosur nga palët.
Subjekti S. ka :
Muaji prill 2021 ka 21 punonjës mesatar të siguruar Nga këta: 20 punonjës me 22 ditë pune dhe 12 punonjës me 2 ditë pune .
Muaji Maj 2021 ka mesatarisht 21 punonjës të siguruar . Nga këta : 14 punonjës me 22 ditë pune, 11 me 3 ditë pune dhe 6 me 20 ditë pune.
Muaji Qershor 2021 ka 16 punonjës mesatar të siguruar. Nga këta:14 punonjës me 22 ditë pune, 11 punonjës me 3 ditë pune ,4 punonjës me 4 dite pune, dhe një punonjës me 5 ditë pune.
Muaji korrik 2021 ka mesatarisht 17 punonjës të siguruar. Nga këta: 14 punonjës me 22 ditë pune dhe 65 ditë të futura nga punëtorët e tjerë ose 3 punëtor mesatar nga të tjerët.
Muaji gusht 2021 ka 19 punëtor mesatar të siguruar. Nga këta: 16 punëtor me 22 ditë pune dhe 69 ditë punonjës nga të tjerët e barabartë me 3 punonjës mesatar.
Muaji shtator ka mesatarisht 19 punonjës. Nga këta 15 punonjës me ditë të plota 22 ditë pune dhe 96 ditë të siguruara nga të tjerë ose 4 punonjës mesatar (96:22=4)

Këto të dhëna janë nxjerrë nga borderotë e dorëzuara në sistemin e tatim taksave të hedhura nga subjekti përkatës .
Që të përmbush kontratën subjekti i mësipërm në bazë të bashkëpunimit duhet të ketë mesatarisht min 24 punëtorë.
Në këto kushte subjekti "S." SHPK nuk përmbush në asnjë muaj kërkesën e dokumenteve standarde.
Në pikën 2.3.7/ e. kërkohet**:**
Operatori ekonomik duhet të ketë licencë lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL. Kodi III.2.B autoriteti kontraktor kërkon që kjo të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe konkretisht në ligjin 10081 datë 23.02.2003, nga ku rrjedhimisht operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë licencë QKL III.2.B "Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane
Nga ana e këtij Bashkimi operatoresh nuk ka licencë të tillë që në përputhje me kërkesën duhet që në bazë të % përkatëse duhet të plotësojnë këtë kërkesë (verifikuar në Qendrën Kombëtare të Licencave)
Kontrata e shërbimit të lidhur për këtë licencë me subjekt tjetër pa miratim të autoritetit dhe të jetë si kërkesë e dokumenteve standarde është e pa vlefshme. Kontratë e lidhur me 3.11.2021 e pavlefshme .
Delegimi me kontratë shërbimi me të tretë është e papajtushme me kërkesën në dokumente standarde.

Nga verifikimi ne SPE i dokumentacionit të BOE "S." SHPK & "K." SHPK, rezultoi si më poshtë:
- Nga KVO është llogaritur dhe arsyetuar gabim në lidhje me numrin e punonjësve, pasi numri i punonjësve të kërkuar, është ndryshuar me shtojcën e modifikimeve, nga 30 punëtorë në 25 punëtorë. Kështu llogaritja e numrit të punonjësve që kërkohen për anëtarin e BOE "S." ShPK, i cili do të kryejë 80% të punimeve, nuk është 25 punëtorë, por 20 punëtorë. Nga kontrolli i listë prezencave të këtij subjekti, rezulton se numri mesatar mujor i punonjësve, i llogaritur sipas KVO-së, është 19 punonjës me 22 ditë pune. Ndërkohë që ky ofertues është paraqitur si bashkim operatorësh dhe OE "K." ShPK e ka numrin e punëtorëve, disa herë më të lartë se ai i kërkuar në DT dhe marrëveshjen e bashkëpunimit. Për këtë arsye, ky devijim duhej konsideruar si devijim i vogël, në përputhje me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 92 "Shqyrtimi i ofertave", sipas të cilit "*Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit*".
- Nga ana e BOE "S." SHPK & "K." SHPK, për kriterin e disponueshmërisë së licencës nga QKL III.2.B "Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane", nuk është paraqitur një licencë e tillë, por është paraqitur një kontratë shërbimi datë 3.11.2021, me një shoqëri që e ka këtë licencë.
Nga ana e KVO-së, në zbatim të nenit 2, pika a,b, të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale*;..." ky devijim duhej konsideruar si devijim i vogël.
Përsa sipër, ky ofertues duhej kualifikuar e shpallur fitues dhe KVO duhet t'i kishte propozuar Titullarit të AK për lidhjen e kontratës.
Ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT (sipas KVO-së,) dhe është kualifikuar:

Nr.	OE të kualifikuar	Vlera e Ofertës
1	"A." SHPK	5,880,840

Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të Operatori Ekonomik fitues "A." SHPK, rezultoi si më poshtë:
- Mungon situacioni përfundimtar i objektit "Ujësjellësi Bishqem", i paraqitur si eksperiencë e ngjashme.
- Mungojnë leje mjedisore kodi KODI III.1.B (riciklim plastik), KODI III.1.A (prodhimi I produkteve plastike), KODI III.2.B (përpunimi I plastikes) i furnizuesit me tubo HDPE dhe PVC.
- Mungojnë dokumentet e mjeteve;
- Mungojnë taksat vendore nga Bashkia Berat, në të cilën, sipas ekstraktit historik, ka patur veprimtari ekonomike në vitin 2019.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 92 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 82, "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*"* sipas të cilit "*2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*
Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:
i. "Devijimi" është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;
ii. "Rezervimi" është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe
iii. "Mospranimi" është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.
Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë".

Për sa sipër, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 92 "Shqyrtimi i ofertave" dhe të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 82, "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me BOE "S." SHPK & "K." ShPK me ofertë ekonomike 5,052,600 lekë pa TVSH, ose 828,240 lekë më pak se oferta ekonomike e OE të shpallur fitues. Ky mosveprim ka sjellë përdorim pa ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Selenicë në vlerën 828,240 lekë dhe lidhjen e një kontrate me vlerë 7,057,008 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP.

Për këtë procedurë prokurimi është bërë ankesa në KPP nga OE "S." SHPK. Me Vendimin Nr. 96/2022, datë 26.012022, KPP ka vendosur të mos pranojë ankesën me objekt "Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për këtë procedurë", pasi OE nuk ka bërë pagesën e ankimimit, duke i lejuar AK të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
Ndikimi: Vendosja e kritereve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Selenicë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Titulli i gjetjes 24: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP
5. Procedura e prokurimit me objekt "Sistemim Asfaltim rruga tubo (rruga varreza, spital)", Bashkia Selenicë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Sistemim Asfaltim rruga tubo (rruga varreza, spital)", Nr. Ref. 86811, datë 02-11-2021.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 29, datë 08.02.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 29, datë 08.02.2021 Njësia e Prokurimit 1. M. H., Jurist 2. A. V., topograf 3. E. F., ekonomist	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 30, datë 08.02.2021 13. K. B. 14. L. H. 15. P. A.
2. Lloji i Procedurës – "Kërkesë për propozim"		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 8,991,254 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "J." SHPK me ofertë 8,007,600 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 830 prot, dt. 17.03.2021 me afat 90 ditë nga lidhja e kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 983,654 lekë ose 10.94 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 26.02.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Selenicë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE b) S'kualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 3 OE/BOE
11. Ankimime; ka ankesë në AK për DT nga OE H.	12. Përgjigje Ankesës dt. 19.02.2021	13. Përgjigje Ankesës

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është tender i "Kërkesë për propozim", me vlerë 8,991,254 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxhet i Bashkisë.

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se preventivi i punimeve dhe relacioni teknik (pjesë integrale të dokumenteve të tenderit) është hartuar nga z. K. B., i cili me Urdhrin nr. 34, datë 08.02.2021, është caktuar të jetë edhe pjesë e KVO-së. Ky veprim është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar Neni 58 "Komisioni i vlerësimit të ofertave", sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës.* ***Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave...***".
- Nuk është bërë përcaktimi i personit përgjegjës për prokurimet, Specialistit të fushës dhe ndarja e detyrave të Njësisë së Prokurimit
- Nuk është përcaktuar kryetari i KVO-së.
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Selenicë, z. P.B.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë dokument për inicimin e kryerjes së këtij investimi.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit (vetëm gjurma e nxjerrë nga google earth dhe relacioni teknik i paplotë) dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është firmosur nga ing. K. B. e ing. A. V. dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Selenicë, z. P. B.. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 3 muaj nga lidhja e kontratës.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...". Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Selenicë, z. P. B.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 11.02.2020, si më poshtë:

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit, datë 11.02.2021, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit".

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:

1- Në pikën "Licenca profesionale", është vendosur N.P – 12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit), Nga verifikimi i preventivit të miratuar, rezulton se këto punime nuk janë në preventivin e punimeve të hedhur në sistem dhe për pasojë, nuk janë të justifikuara teknikisht dhe nuk është në përpjesëtim me natyrën e objektit që prokurohet.

2- **Janë kërkuar vetëm dy kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri 12 ton dhe dy kamionë me Vinç me kapacitet mbajtës deri 8.5 ton.** Kërkesa për kamionët më vinç nuk është i justifikuar teknikisht, pasi në preventivin e punimeve nuk ka zë pune që të kryhet me këtë mjet. Gjithashtu duhet të ishin kërkuar mjete/pajisje që janë të domosdoshme për kryerjen e punimeve rrugore (Grejder, Autobot uji, Rrul, bitumatriçe, asfaltoshtruese).

3- Në KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 3 inxhinierë të ndryshëm të jenë në listë pagesa, si dhe staf mbështetës një inxhinier, 1 teknik dhe dy karpentierë të punësuar në periudhën Janar 2020 — Nëntor 2020. Kriteri për inxhinierin e mjedisit është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve që prokurohen, përveç inxhinierit të ndërtimit

dhe inxhinierit të topograf, stafi tjetër nuk është i nevojshëm. Gjithashtu, nuk rezulton të ketë punime që duhet të kryhen nga karpentierë.

4- Është kërkuar që OE pjesëmarrës në këtë procedurë të kenë ekspërience në ndërtim pasarelash dhe ky kusht është skualifikues.

Ky kriter nuk është i justifikuar teknikisht, pasi në preventivin e punimeve nuk ka zë pune pasarelë.

5- Është kërkuar 1(një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Licence për ushtrimin individual te profesionit, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listë pagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2020 – Nëntor 2020. Ky kriter është argumentuar nëpërmjet një VKM-je të shfuqizuar, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.

6- Është kërkuar një Inxhinier Mjedisi që është drejtues teknik, me Certifikate nga Ministria e Mjedisit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, për hartim ekspertize për probleme mjedisore, ekspert i vlerësimit të ndikimit në mjedis si dhe të jetë në listë pagesat e shoqërisë. Ky kriter nuk është i justifikuar teknikisht, pasi nuk është në përpjesëtim me natyrën e objektit që prokurohet.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe **krijojnë mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit, M. H., A. V. dhe E. F. (pasi nuk ka ndarje të detyrave nga Titullari i AK.

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Për argumentimin e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe preventivave, nuk ka dokumentacion për ngritjen e grupit të punës.

Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "Kërkesë për propozim". Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 26.02.2021.

Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë në pjesë në procedurë OE, me ofertën e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	"A." SPK	8,529,530
2	"J." ShPK	8,007,600
3	"A." ShPK	8,956,270

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë, SPE
Punoi: KLSH

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën pa nr. prot., datë 11.03.2021 dhe është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit, i cili është nënshkruar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. P. B. dhe është hedhur në sistem.

Është konstatuar se nga KVO nuk është skualifikuar asnjë OE pjesëmarrës në tender

Kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në DT (sipas KVO-së,) dhe janë kualifikuar:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	"A." SPK	8,529,530
2	**"J." ShPK**	**8,007,600**
3	"A." ShPK	8,956,270

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë, SPE
Punoi: KLSH

Nga verifikimi ne SPE i dokumentacionit të OE të shpallur fitues "J." SHPK, rezultoi se dokumentacioni i paraqitur në SPE është konform kritereve të përcaktuar në DT.

Ndikimi: Vendosja e kritereve të kualifikimit në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Selenicë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit.

Titulli i gjetjes 25: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP

6. Procedura e prokurimit me objekt "Sistemim Asfaltim rruga Kropisht", Bashkia Selenicë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Sistemim Asfaltim rruga Kropisht, Nr. Ref. 87143, datë 02-16-2021.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 33, datë 08.02.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 33, datë 08.02.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 34, datë 08.02.2021
2. Lloji i Procedurës – "E hapur"	Njësia e Prokurimit 1. M. H., Jurist 2. A.V., topograf 3. E. F., ekonomist	16. K. B., 17. L. H. 18. P. A.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 12.500,000 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "A." SHPK me ofertë 12,108,268 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 1246 prot, dt. 27.04.2021 me afat 90 ditë nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 391,732 lekë ose 3.13 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 11.03.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Selenicë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE b) S'kualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është tender i "E hapur", me vlerë 12.500,000 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë.
Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se preventivi i punimeve dhe relacioni teknik (pjesë integrale të dokumenteve të tenderit) është hartuar nga z. K. B., i cili me Urdhrin nr. 34, datë 08.02.2021, është caktuar të jetë edhe pjesë e KVO-së. Ky veprim është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar Neni 58 "Komisioni i vlerësimit të ofertave", sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës".* ***Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave...***".

- Nuk është bërë përcaktimi i personit përgjegjës për prokurimet, Specialistit të fushës dhe ndarja e detyrave të Njësisë së Prokurimit
- Nuk është përcaktuar kryetari i KVO-së.
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Selenicë, z. P. B.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi
Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë dokument për kryerjen e këtij investimi.
Mbi projektpreventivin e zbatimit:
- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Burimeve Natyrore,Mjedisit, Projekteve dhe Investimeve (ing. K. B. dhe topograf A.V.) dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Selenicë, z. P. B. në Prill 2020. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 3 muaj nga lidhja e kontratës.
Në dosjen teknike nuk administrohet leja e ndërtimit. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" Neni 39, "Leja e ndërtimit" sipas të cilit "*1.Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.*
2. Dokumenti i lejes së ndërtimit përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqërues të aplikimit dhe normave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
3. Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat "e" dhe "ë", të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit." dhe ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Selenicë, z. P. B. mbikëqyrësin e punimeve dhe kontraktorin e punimeve.
Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...". Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Selenicë, z. P. B.
Situata 1
Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:
Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 11.02.2020.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit, datë 11.02.2021, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit".

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:

1- Në pikën "Licenca profesionale", është vendosur N.P – 12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit), NS — 6 A (Sinjalistika rrugore jo driçuese). Nga verifikimi i preventivit të miratuar, rezulton se këto punime nuk janë në preventivin e punimeve të hedhur në sistem dhe për pasojë, nuk janë të justifikuara teknikisht dhe nuk është në përpjesëtim me natyrën e objektit që prokurohet.

2- Është kërkuar "Një punësim mesatar i të paktën 30 (tridhjetë) punonjës, për periudhën Gusht 2020 — Dhjetor 2020". Ky numër punonjësish nuk është i argumentuar dhe në përpjesëtim me volumin e objektit që prokurohet.

3- Në pikën 2.3.3 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 3 inxhinierë të ndryshëm të jenë në listë pagesa, si dhe staf mbështetës 1 teknik të punësuar në periudhën Gusht 2020 — Dhjetor 2020. Kriteri për inxhinierin e mjedisit është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve që prokurohen, përveç inxhinierit të ndërtimit dhe inxhinierit të topograf, stafi tjetër nuk është i nevojshëm.

4- Është kërkuar që për të përmbushur kërkesat e STASH 660-87 dhe STASH 5fil-87, duke patur në konsideratë se përgatitja e asfaltit në fabrikë realizohet në temperaturë 155º C deri né 170 ° C, operatori ekonomik duhet të disponojë fabrikë asfaltobetoni dhe/ose me qira dhe/ose të ketë kontratë furnizim të vlefshme për periudhën e ekzekutimit të kontratës dhe sipas formës së kërkuar nga ligji minimalisht për sasinë e kërkuar në preventiv me një fabrikë asfalto betoni me vendndodhje jo më shumé se 25 km nga objekti që prokurohet

Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi në kërkesat e STASH është e përcaktuar temperatura e hedhjes në vepër të asfaltobetonit. Mënyra e transportit të asfaltit është çështje e kontraktorit dhe temperatura e hedhjes së asfaltit në vepër, ndiqet nga mbikëqyrësi dhe nuk duhet të jetë pjesë e kritereve kualifikuese.

5- Është kërkuar 1(një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Licence për ushtrimin individual te profesionit, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listë pagesat e shoqërisë për periudhën Gusht 2020 – Dhjetor 2020. Ky kriter është argumentuar nëpërmjet një VKM-je të shfuqizuar, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.

6- Është kërkuar Makineri për vijëzim me bojë bikomponente. Ky kriter nuk është i justifikuar teknikisht, pasi në preventivin e punimeve nuk ka zë pune që të kryhet me këtë pajisje.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe **krijojnë mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit, M. H., A. V. dhe E. F. (pasi nuk ka ndarje të detyrave nga Titullari i AK.

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Nuk është ngritur urdhër i titullarit të AK për argumentimin e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe preventivave.

Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "Kërkesë për propozim". Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 31.03.2021.

Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë në pjesë në procedurë OE, me ofertën e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	"A." SHPK	12,108,268
2	"B." ShPK	12,143,466
3	"B."	7,943,599

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë, SPE
Punoi: KLSH

Nga auditimi rezulton se nga KVO nuk është hartuar Raporti Përmbledhës, por është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit, i cili është nënshkruar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. P. B. dhe është hedhur në sistem.

Nga auditimi rezulton se në dosje nuk administrohet Raporti Përmbledhës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Neni 68, "Raporti Përmbledhës", sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor*", duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KVO-së, K. B., L. H., P. A. dhe Titullari i AK z. P. B.. Është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit, i cili është hedhur në SPE.

Është konstatuar se nga KVO është skualifikuar:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE "B." ShPK	7,943,599

Nga verifikimi i Procesverbalit të Hapje-Vlerësimit, ky ofertues është skualifikuar për arsyen e mëposhtme:

> Në zbatim të ligjit nr 162/2020 "Për Prokurimin Publik" neni 76, "Kriteret detyruese për skualifikim", pika dh, ku thuhet:
> Operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontrates në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoritetit kontraktor. Ky rast zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja.
> Ju nuk jeni paraqitur për lidhjen e kontratës me nr Ref-75542-10-14-2020 me objekt "Rikonstruksion rruge të brendshme".

Arsyeja e mësipërme e skualifikimit nuk është e justifikuar dhe në kundërshtim me LPP në fuqi në kohën e zhvillimit të kësaj procedure prokurimi (Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 58, pika 5, sipas të cilit "…Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese "çmimi më i ulët" dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë do të jetë jo më e madhe se 2 për

qind e fondit limit. *Kjo nuk cenon të drejtën e autoritetit kontraktor, sipas nenit 24 të këtij ligji, për të refuzuar të gjitha ofertat e mbetura dhe për të anuluar procedurën e prokurimit. Njoftimi, sipas pikes 1 të këtij neni, i dërgohet ofertuesit, oferta e të cilit është përzgjedhur sipas kësaj pike*")", pasi kjo procedurë është shpallur dhe zhvilluar pa hyrë në fuqi Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, të cilit i është referuar KVO-ja për skualifikimin e OE "B.".
Kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në DT (sipas KVO-së) dhe janë kualifikuar:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	"A." SPK	12,108,268
2	"B." ShPK	12,143,466

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë, SPE
Punoi: KLSH

Nga verifikimi ne SPE i dokumentacionit të OE të shpallur fitues "A." SHPK, rezultoi se dokumentacioni i paraqitur në SPE është konform kritereve të kualifikimit të hedhura në SPE.

Sa sipër, skualifikimi i OE "B." është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*".
Nëse do të kishte bërë kualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me këtë OE, me ofertë ekonomike 9,532,318.8 lekë me TVSH, **ose 4,997,602.2 lekë më pak se vlera e kontratës së lidhur me OE " A." ShPK**. Ky mosveprim ka sjellë përdorimin pa ekonomicitet të fondeve të Buxhetit të Bashkisë Selenicë dhe lidhjen e një kontrate me vlerë 14,529,921 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP.

Ndikimi: Vendosja e kritereve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Selenicë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Titulli i gjetjes 26: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP

7. Procedura e prokurimit me objekt "Rehabilitim ura Brataj", Bashkia Selenicë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rehabilitim ura Brataj", Nr. Ref. 86657, datë 02-10-2021.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 26, datë 05.02.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 26, datë 05.02.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 27, datë 05.02.2021
2. Lloji i Procedurës – "Kërkesë për propozim"	Njësia e Prokurimit 1. M. H., Jurist 2. A. V., topograf 3. E. F., ekonomist	19. K. B. 20. L. H. 21. P. A.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 1,666,667 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "A." SHPK me ofertë 1,640,600 lekë pa tvsh,	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)

	sipas kontratës nr. 818/1 prot, dt. 16.03.2021 me afat 90 ditë nga lidhja e kontratës.	26,067 lekë ose 1.56 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 23.02.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Selenicë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) S'kualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është tender i "Kërkesë për propozim", me vlerë 12,000,347 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë.
Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se preventivi i punimeve (pjesë integrale e dokumenteve të tenderit) është hartuar nga z. K. B., i cili me Urdhrin nr. 27, datë 05.02.2021, është caktuar të jetë edhe pjesë e KVO-së. Ky veprim është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar Neni 58 "Komisioni i vlerësimit të ofertave", sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës".* ***Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave...***".
- Nuk është bërë përcaktimi i personit përgjegjës për prokurimet, Specialistit të fushës dhe ndarja e detyrave të Njësisë së Prokurimit
- Nuk është përcaktuar kryetari i KVO-së.
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Selenicë, z. P. B.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi
Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë dokument për inicimin e kryerjes së këtij investimi.
Mbi projektpreventivin e zbatimit:
- Projekti i zbatimit (vetëm profili gjatësor) dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Burimeve Natyrore,Mjedisit, Projekteve dhe Investimeve (ing. K. B. dhe topograf A.V.) dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Selenicë, z. P. B. në Prill 2020. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 2 muaj nga lidhja e kontratës.
Në dosjen teknike nuk administrohet leja e ndërtimit. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" Neni 39, "Leja e ndërtimit" sipas të cilit "*1.Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.*
2. Dokumenti i lejes së ndërtimit përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqërues të aplikimit dhe normave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
3. Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat "e" dhe "ë", të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e

ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit." dhe ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Selenicë, z. P. B., mbikëqyrësin e punimeve dhe kontraktorin e punimeve.
Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...". Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Selenicë, z. P. B.

Situata 1
Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:
Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 10.02.2020, si më poshtë:

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit, datë 10.02.2021, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2.

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:
1- Në pikën "Licenca profesionale", është vendosur N.P – 4A (Rruge ,autostrade,...), N.P – 12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit), N.S - 1A (Punime prishje ndertimore), N.S - 20 A (Shpime gjeologo-inxhinierike). Nga verifikimi i preventivit të miratuar, rezulton se këto punime nuk janë në preventivin e punimeve të hedhur në sistem dhe për pasojë, nuk janë të justifikuara teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e objektit që prokurohet. Gjithashtu nuk është kërkuar NP-5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti, në përputhje me natyrën e objektit që prokurohet.
2- Është kërkuar "Një punësim mesatar i të paktën 20 (Njëzetë) punonjës me kohë të plotë, për periudhën Janar 2020– Nëntor 2020". Ky numër punonjësish nuk është i argumentuar dhe në përpjestim me volumin e objektit që prokurohet.
3- Në pikën 2.3.3 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 3 inxhinierë të ndryshëm të jenë në listëpagesa, si dhe staf mbështetës 1 inxhinier dhe 1 (katër!!!) teknikë ndërtimi, të punësuar në periudhën Janar 2020– Nëntor 2020. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve që prokurohen, përveç inxhinierit të ndërtimit/inxhinierit infrastrukturë transporti dhe inxhinierit të topograf, stafi tjetër nuk është i nevojshëm.
4- Është kërkuar 1(një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Liçense per ushtrimin individual te profesionit, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhen Janar 2020 – Nentor 2020. Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm. Ky kriter është argumentuar nëpërmjet një VKM-je të shfuqizuar, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.
5- Janë kërkuar dy kamionë me vinç, me kapacitet mbajtës deri në 8.5 ton. Ky kriter nuk është në përputhje me volumin e punimeve që prokurohen.

6- Është kërkuar një Inxhinier Mjedisi që është drejtues teknik, në mbështje të VKM Nr. 268 date 24.04.2003 "Për ndikimin në mjedis dhe auditimin mjedisor" të paraqitet, Certifikate nga Ministria e Mjedisit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, për hartim ekspertize për probleme mjedisore, eksperti vlerësimit të ndikimit në mjedis si dhe të jetë në listëpagesat e shoqërisë. Ky kriter nuk është në përputhje me natyrën dhe volumin e punimeve që prokurohen.
7- Është kërkuar që "*në punët e ngjashme për vete natyren e punës duhet të ketë ndërtim pacarelash për lartesine qe ka kjo pacarele është e domosdoshme një experience e tillë dhe përbën kusht për skualifikim për subjektin që nuk disponon një punë të ngjashme të tillë*". Ky kriter është në kundërshtim me DST, pasi kërkon punë të njëjtë dhe jo të ngjashme.
Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe **krijojnë mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit, M. H., A. V. dhe E. F. (pasi nuk ka ndarje të detyrave nga Titullari i AK.

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike
Për argumentimin e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe preventivave, nuk administrohet asnjë dokument për ngritjen e grupit të punës.
Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre". Për katër zëra, nga 9 gjithsej, të cilat janë me nr analize "An", në dosje nuk administrohen analizat teknike të çmimit. Përsa sipër ngarkohen me përgjegjësi preventivueit K. B. dhe A.V.
Mbi vlerësimin e ofertave
AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "Kërkesë për propozim". Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 26.02.2021.
Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë në pjesë në procedurë një OE, me ofertën e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	"A." SHPK	1,640,600

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Është mbajtur procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave pa nr. prot, datë 26.02.2021.
Nga auditimi rezulton se në dosje administrohet Raporti Përmbledhës datë 11.03.2021, në në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Neni 68, "Raporti Përmbledhës", sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor*".

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se:
- Nuk ka të skualifikuar:
- Ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT (sipas KVO-së,) dhe është kualifikuar:

Nr.	OE të kualifikuar	Vlera e Ofertës
1	"A." SHPK	1,640,600

Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të Operatori ekonomik fitues, rezultoi si më poshtë:
- Bilanceve të viteve 2017 dhe 2018 i mungojnë ekspertizat e ekspertit kontabël, siç kërkohet ne DT.

- Mungojnë 4 teknikët e ndërtimit. Është paraqitur vetëm B. E., teknik topograf, i cili nuk rezulton të jetë në të gjitha listëpagesat.
- Mungon inxhinieri i ndërtimit profil infrastrukturë transporti
- Ing. S. Gj., i paraqitur si drejtues teknik dhe përgjegjës për sigurimin në punë nuk figuron në licencën e shoqërisë.
- Inxhinierja e ndërtimit S. H. nuk është në licencën e shoqërisë dhe në listëpagesa
- Mjekja T. T. figuron në listëpagesat e shoqërisë vetëm muajin Nëntor 2020.
- Nga 2 objektet që janë paraqitur si eksperiencë e ngjashme, betëm objekti "Ndërtim ura Mallkeq dhe rikonstruksioni i pasarelës fshati Vodicë", ka në situacion ndërtim pasarele. Ky objekt ka probleme me dokumentacionin, pasi në kontratën e paraqitur, sipërmarrësi i punimeve është BOE "A." SHPK & "B." SHPK, ndërsa në formularin e vlerësimit është vetëm "A." SHPK. Mungon kontrata e bashkëpunimit të BOE për të parë se cili nga antarët e BOE ka realizuar pasarelën, si dhe prokura e posaçme.
- Dy karpentierëve dhe hekurkthyesit të paraqitur, i mungojnë dëshmitë e sigurimit teknik.
- Nuk ka dokumente të sakta për dy kamionët vinç dhe nuk ka asnjë foto për mjetet e kërkuara.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*".
Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 1,968,720 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP.
Ndikimi: Vendosja e kritereve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Selenicë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Titulli i gjetjes 27: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP

8. Procedura e prokurimit me objekt "Riparimi i shkarkuesit të rezervuarit të Harvalasë, Zgjerimi i rrugës Resulaj – Romës dhe punime gërmimi dhe riparimi në rrugën Bashaj - Vërmik", Bashkia Selenicë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Riparimi i shkarkuesit të rezervuarit të Harvalasë, Zgjerimi i rrugës Resulaj – Romës dhe punime gërmimi dhe riparimi në rrugën Bashaj Vërmik", Nr. Ref. 93456, datë 04-19-2021.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 60, datë 13.04.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 60, datë 13.04.2021 Njësia e Prokurimit 1. M. H., Jurist 2. A. V., topograf 3. E. F., ekonomist	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 61, datë 13.04.2021 1. K. B., 2. K. S. 3. P. A.
2. Lloji i Procedurës – "Kërkesë për propozim"		

5. Fondi Limit (pa TVSh) 6,500,000 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "2" SHPK me ofertë 6,370,365 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 1752 prot, dt. 24.06.2021 me afat 60 ditë nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 129,635 lekë ose 2 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 27.04.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Selenicë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) S'kualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është tender i "Kërkesë për propozim", me vlerë 6,500,000 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë.
Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se preventivi i punimeve (pjesë integrale e dokumenteve të tenderit) është hartuar nga ing. K. B., i cili me Urdhrin nr. 61, datë 13.04.2021, është caktuar të jetë edhe pjesë e KVO-së. Ky veprim është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar Neni 58 "Komisioni i vlerësimit të ofertave", (meqënëse në periudhën e hartimit të DT, kjo VKM ka qenë në fuqi), sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës".* ***Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave...***", por edhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 75, sipas të cilit "*1. Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit/entit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës, nëse nevojitet për objektin e prokurimit.*
2. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.
3. Një prej anëtarëve të komisionit caktohet kryetar dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit".
- Nuk është bërë përcaktimi i personit përgjegjës për prokurimet, Specialistit të fushës dhe ndarja e detyrave të Njësisë së Prokurimit
- Nuk është përcaktuar kryetari i KVO-së.
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Selenicë, z. P. B..

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi
Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë dokument për iniciimin e kryerjes së këtij investimi.
Mbi projektpreventivin e zbatimit:
- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar në nga shoqëria "S." ShPK dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Selenicë, z. P. B. në 2021. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 2 muaj nga fillimi i punimeve.
Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të

përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...". Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Selenicë, z. P.B.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, pa datë, i cili ka ndryshuar me shtojcën e modifikimeve të hedhur në SPE si më poshtë:

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 19.04.2021.

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:

1- Në pikën 2.3.3 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 4 inxhinierë të ndryshëm të jenë në licencë, si dhe staf mbështetës 2 inxhinierë, 2 teknikë të tjerë të ndryshëm, elektricist, saldator. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve që prokurohen, pasi nuk është në përpjestim me volumin dhe naturën e punimeve në objektin që prokurohet. Gjithashtu kërkesa për të qenë në licencën e shoqërisë inxhinierët mekanik, strukturist, materialesh dhe mjedisi është e paargumentuar teknikisht.

2- Certifikatat e kërkuara ISO, si: Çertifikata ISO 27001:2013, Certifikata ISO 50001:2011, Certifikata ISO 3834-2:2006, Certifikata ISO 28001:2007, nuk janë në përpjestim me naturën e punimeve në objektin që prokurohet.

3- Është kërkuar 1(një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Liçense per ushtrimin individual te profesionit, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhen Janar 2020 – Nentor 2020. Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm. Ky kriter është argumentuar nëpërmjet një VKM-je të shfuqizuar, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.

4- Janë kërkuar AutoSondë shpimi, Pirun, Prefëse bari, Vidator, Troko, Saldatrice. Ky kriter nuk është i justifikuar teknikisht, pasi në preventivin e punimeve nuk ka zëra pune që të kryhen me makinerite/pajisjet e mësipërme.

5- Janë kërkuar kategoritë e licencave "Ndertimi civile industriale NP-2 Klasifikim A", "Punime te inxhinierise se mjedisit NP-12 Klasifikim A", "Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to etj NS-4Klasifikim A", "Punime Struktura Speciale NS-9 Klasifikimi A", "Punime Topogjeodezike NS-18 KlasifikimA", "Shpim gjeologo-inxhinierike NS-20 Klasifikimi A". Të cilat nuk janë në përpjestim me natyrën e objektit që prokurohet dhe nuk është kërkuar kategoria NP-4 për ndërtimin e rrugëve.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe **krijojnë mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit, M. H., A. V. dhe E. F. (pasi nuk ka ndarje të detyrave nga Titullari i AK).

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Për argumentimin e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe preventivave, nuk administrohet asnjë dokument për ngritjen e grupit të punës.
Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se zëri i punës "Ndërtim mur mbajtës e përforcues" me njësi matëse "ml", është cituar që do të shoqërohet me analizë, e cila është hedhur në SPE, por e pashoqëruar me vizatimet. Çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Situata 2
Mbi vlerësimin e ofertave
AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "Kërkesë për propozim". Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 03.05.2021. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ë marrë në pjesë në procedurë OE, me ofertën e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	"G." ShPK	6,434,550
2	"2" ShPK	6,370,365

Burimi i të dhënave: SPE

Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe vlerësimit të ofertave pa nr. prot, datë 03.05.2021.
Nga auditimi rezulton se nga KVO nuk është hartuar Raporti Përmbledhës, por është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit, i cili është nënshkruar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. P. B. dhe është hedhur në sistem.
Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se:
Kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në DT (sipas KVO-së,) dhe janë kualifikuar:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	"G" ShPK	6,434,550
2	"2" ShPK	6,370,365

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të Operatori Ekonomik fitues "2" SHPK, rezultoi se i plotëson kriteret e vendosura ne DT dhe është kualifikuar me të drejtë.

Ndikimi: Vendosja e kritereve të kualifikimit në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Selenicë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit.

Titulli i gjetjes 28: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP
9. Procedura e prokurimit me objekt "Rehabilitim i kanalit ujitës Hasomat Velçë dhe punime për rrjetin e kanalizimeve qendër Kotë", Bashkia Selenicë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rehabilitim i kanalit ujitës Hasomat Velçë dhe punime për rrjetin e kanalizimeve qendër Kotë", Nr. Ref. 88992, datë 03-04-2021.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 49, datë 25.02.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 49, datë 25.02.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 50, datë 25.02.2021
2. Lloji i Procedurës – "Kërkesë për propozim"	Njësia e Prokurimit 1. M. H., Jurist	1. K. B. 2. L. H.

	2. A. V., topograf 3. E. F., ekonomist	3. P. A.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 7,500,000 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "K." SHPK me ofertë 7,245,617 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 1212 prot., datë 21.04.2021 me afat 45 ditë nga lidhja e kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 254,383 lekë ose 3.4 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 12.04.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Selenicë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) S'kualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është tender i "Kërkesë për propozim", me vlerë 7,500,000 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga fondet e Bashkisë Selenicë.
Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se preventivi i punimeve, (pjesë integrale të dokumenteve të tenderit), është hartuar nga ing. K. B., i cili me Urdhrin nr. 50, datë 25.02.2021, është caktuar të jetë edhe pjesë e KVO-së. Ky veprim është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar Neni 58 "Komisioni i vlerësimit të ofertave", sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës".* ***Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave...***".
- Nuk është bërë përcaktimi i personit përgjegjës për prokurimet, Specialistit të fushës dhe ndarja e detyrave të Njësisë së Prokurimit
- Nuk është përcaktuar kryetari i KVO-së.
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Selenicë, z. P. B.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi
Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë dokument për inicimin e kryerjes së këtij investimi.
Mbi projektpreventivin e zbatimit:
- Në SPE janë hedhur projekti i zbatimit pa përcaktuar se kush janë autorët dhe preventivi i punimeve.
Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...". Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Selenicë, z. P. B.

Mbi përcaktimin e fondit limit
Për argumentimin e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe preventivave, nuk ka dokumentacion për ngritjen e grupit të punës.

Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Situata 1

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 29.03.2021, si më poshtë:

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit, datë 03.03.2021, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2.

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:

1- Në pikën "Licenca profesionale", është vendosur NP. 5-A, Punime nentokesore, ura dhe vepra arti, NS. 8-A, Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri dhe NS. 9-A, Punime strukturore speciale. Nga verifikimi i preventivit të miratuar, rezulton se këto punime nuk janë në preventivin e punimeve të hedhur në sistem dhe për pasojë, nuk janë të justifikuara teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e objektit që prokurohet.

2- Është kërkuar "Një punësim mesatar i të paktën 30 (tridhjetë) punonjës me kohë të plotë, për periudhën Gusht 2020– Janar 2021". Ky numër punonjësish nuk është i argumentuar dhe në përpjestim me volumin e objektit që prokurohet.

3- Në pikën 2.3.3 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 4 inxhinierë të ndryshëm të jenë në listëpagesa dhe licencën e shoqërisë, si dhe staf mbështetës 3 inxhinierë të tjerë të ndryshëm, të punësuar në periudhën Gusht 2020– Janar 2021. Për stafin e inxhinierëve është kërkuar një deklaratë që nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve që prokurohen, përveç inxhinierit të ndërtimit/inxhinierit hidroteknik dhe inxhinierit topograf, stafi tjetër nuk është i nevojshëm. Gjithashtu, kërkesa që gjithë stafi prej 4 inxhinierësh, të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, krijon mundësinë e përjashtimit të OE që janë të angazhuar në kontrata të tjera.

4- Është kërkuar që Operatori ekonomik të ketë 2 saldatorë. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht pasi në preventiv nuk ka punime saldimi.

5- Është kërkuar që Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar një mjek, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figuroje në listë pagesa për periudhën Gusht 2020–Janar 2021. Ky kriter është argumentuar nëpërmjet një VKM-je të shfuqizuar, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.

6- Janë kërkuar Autobetoniere me kapacitet mbajtës mbi 16 Ton, Rimorkio për lëvizjen e mjeteve me kapacitet mbajtëse jo me të vogël se 23 ton. Ky kriter nuk është i justifikuar teknikisht, pasi në preventivin e punimeve nuk ka zëra pune që të kryhen me makineritë/pajisjet e mësipërme.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe **krijojnë mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit, M. H., A.V. dhe E. F. (pasi nuk ka ndarje të detyrave nga Titullari i AK.

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "Kërkesë për propozim". Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 31.03.2021.

Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë në pjesë në procedurë OE, me ofertën e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	"B. K." SHPK	5,322,467
2	"K." ShPK	7,245,617

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë dhe SPE

Punoi: KLSH

Nga auditimi rezulton se në dosje nuk administrohet Raporti Përmbledhës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Neni 68, "Raporti Përmbledhës", sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor*", duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KVO-së, K. B., P. A., L. H. dhe Titullari i AK z. P. B.. Është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit, i cili është hedhur në SPE.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se nga KVO, është skualifikuar:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	"B. K." SHPK	5,322,467

Sipas njoftimit të fituesit, rezultoi se ky OE është skualifikuar për arsyet e mëposhtme:

1. Për të provuar se ka përvojën e duhur, Operatori duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht të paktën 30 (tridhjetë) persona e përllogaritur mbi bazën e kohës së plotë të punës duke përfshirë edhe stafin tekniko menaxherial, për periudhën Gusht 2020 ÷Janar 2021 të dëshmuar me;

- **a.** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj në **periudhën e mësipërme.**
- **b.** Listë pagesat e punonjësve të plotësuar rregullisht sipas formatit e përcaktimeve që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për secilin nga muajt në p**eriudhën e mësipërme.**

Subjekti nuk përmbush këtë kriter bazë ku numri i punonjësve mesatar në muajin Dhjetor 2020 dhe Janar 2021 janë përkatësisht nga 14 punonjës të deklaruar në listë pagesën e hedhur në SPE.

II. Në ofertën e paraqitur në Historikun e QKR administrator është E. B. me 100% ndërsa oferta plotësuar me firmën e M. B.

Nga auditimi në SPE i dokumentacionit të shoqërisë "B. K." ShPK, rezultoi se numri mesatar i punonjësve të këtij OE për periudhën e kërkuar është 33 punonjës. Pra ky kriter plotësohet.

Përsa i përket nënshkrimit të ofertës, z. M. B. ka nënshkruar si përfaqësues me prokurë dhe KVO duhet të kishte kërkuar sqarime. Kjo mangësi, nisur nga fakti që z. M. B. është djali i administratorit dhe i punësuar gjatë gjithë periudhës së kërkuar në DT, mund të ishte trajtuar si devijim i vogël.

Ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT (sipas KVO-së,) dhe është kualifikuar:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	"K." ShPK	7,245,617

Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të Operatori ekonomik fitues, rezultoi si më poshtë:
- Nuk ka paraqitur analizat e çmimeve për zërat kryesorë të preventivit.
- Kamionçina e marrë me qera nga F. C. me targa A dhe me kod karrocerie B, si dhe ajo e marrë me qera nga Sh.D.me targa A me kod karrocerie E nuk janë vetëshkarkuese, siç është kërkuar në DT.
- Autopompa e betonit nuk vërtetohet që është me krahë deri ne 36 m.

Sa sipër, skualifikimi i OE "B. K." është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit*" dhe nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2016 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj*".
Nëse do të kishte bërë kualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me këtë OE, me ofertë ekonomike 6,386,960 lekë me TVSH, **ose 2,307,781 lekë më pak se vlera e kontratës së lidhur me OE "K." ShPK**. Ky mosveprim ka sjellë përdorimin pa ekonomicitet të fondeve të Buxhetit të Bashkisë Selenicë dhe lidhjen e një kontrate me vlerë 8,694,741 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP.
Ndikimi: Vendosja e kritereve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Selenicë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Mbi auditimin e procedurave "Blerje të vogla"
Titulli i gjetjes 29: Parregullsi në zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlera të vogla.
Situata: Për vitin 2021 janë realizuar 24 procedura prokurimi me vlera të vogla të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik të APP-së me fond limit 15,865,410 lekë pa TVSH dhe realizim kontrate në vlerën 12,337,782 lekë pa TVSH. Me zgjedhje janë audituar 9 procedura me fond limit në vlerën 6,400,000 lekë pa TVSH ose në masën 40.3% të vlerës totale të fondit limit ku janë konstatuar parregullsitë si më poshtë:
-Në 2 raste janë realizuar 4 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit në vlerën totale 3,200,000 lekë pa TVSH duke shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit pra këto procedura duhet të kryheshin me tenderim konkretisht,

a. “Letër fotokopje” me fond limit 800,000 lekë pa TVSH dhe “Tonera për printera e fotokopje” me fond limit 800,000 lekë pa TVSH të cilat i përkasin të njëjtit objekt prokurimi, Materiale Kancelarie.
b. “Furnizim vendosje pjesë këmbimi” me fond limit 800,000 lekë pa TVSH dhe “Goma e bateri për automjete” me fond limit 800,000 lekë pa TVSH të cilat i përkasin të njëjtit objekt prokurimi, Shërbime për Automjete.
-Në 9 raste nuk dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit i cili duhet të administrojë dokumentacionin e çdo procedure prokurimi.
-Në 4 raste nuk argumentohet dhe dokumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit.
-Në 9 raste nuk është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla.
-Në 5 raste në sistemin e prokurimit elektronik nuk është respektuar afati i kalimit nga një operatorë ekonomikë tek tjetri.
-Në 2 raste në dosjet e procedurave me objekt “Furnizim vendosje pjesë këmbimi” me fond limit 800,000 lekë pa TVSH dhe “Lyerje shkolle” me fond limit 800,000 lekë pa TVSH nuk disponohet i gjithë dokumentacioni i përcaktuar në kriteret e ftesës për ofertë konkretisht, Certifikata ISO 3834-2:2006, ISO 9001:2008, BS OHSAS 18001:2007, EN-ISO 9001:2015, EN-ISO 14001:2015, BS PAS 99:2012, vërtetime që OE nuk është në proces falimentimi, pagesat mbi detyrimeve të kontributeve për sigurimet shoqërore, deklarata për përmbushjen e specifikimeve teknike, kontrata pune, libreza pune, dëshmitë profesionale të lëshuara nga institucione shtetërore ose private të akredituara në Republikën e Shqipërisë, kjo për arsye se të gjitha riparim-shërbimet e MMR dhe të MT, kërkojnë cilësi dhe specialiste përkatës, me përvoje pune dhe besueshmëri në kryerjen e riparim-shërbimit të kërkuar, të cilat përbëjnë skualifikim të operatorëve ekonomikë për mos plotësimin e tyre ndërkohë që nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla edhe pse këto kritere nuk janë përmbushur operatorët janë shpallur fitues.
-Në 1 rast objekti i prokuruar për procedurën “Ndërtim çezme dhe shtrim sheshi me pllaka guri” me fond limit 800,000 lekë pa TVSH nuk është realizuar brenda afateve të përcaktuar në kontratën dypalëshe për realizimin e punimeve. Gjithashtu nga operatori ekonomikë nuk është lëshuar asnjë situacion punimesh ndërkohë që afati i realizimit të kontratës ka përfunduar. Nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla nuk është mbajtur asnjë procesverbal mbi dokumentimin e kësaj situate.
-Në 2 raste mallrat nuk janë bërë hyrje në institucion brenda afateve të përcaktuara në kriteret e ftesës për ofertë.
-Në 2 raste fatura tatimore nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit.
-Në 4 raste kanë rezultuar vonesa në likuidimin e faturave tatimore ndaj operatorë ekonomikë duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.
-Në 9 raste dosjet e procedurave të prokurimit me vlera të vogla nuk janë të inventarizuara dhe arkivuara.
Kriteri: Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, VKM nr. 823, datë 21.10.2020, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, pika 3, pika 8, neni 56, neni 59, pika 2, Udhëzimi nr. 3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar, pikat 11-12, pika 19, Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 1 dhe Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë neni 3, neni 29,

miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për arkivat".
Ndikimi: Procedurat e prokurimit paraqesin një shmangie apo neglizhencë duke mos respektuar rregullat e procedurave të prokurimit publik.
Shkaku: Kjo situatë vjen si pasojë e mos respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi.
Rëndësia: E lartë.
Rekomandimi: Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore përgjatë zhvillimit të procedurave të prokurimeve me vlera të vogla të marrë masa që:
-Përgjatë hartimit të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve, të shmanget mundësia e copëzimit të fondeve për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh.
-Përpara fillimit të procedurës të argumentojë dhe të dokumentojë nevojat e institucionit për mallra dhe shërbime.
-Të argumentohet dhe dokumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit.
-Të hartohen dhe nënshkruhen deklaratat e konfliktit të interesit nga të gjithë anëtarët e komisionit të prokurimit me vlera të vogla.
-Të respektohet afati njoftimit për kalimin nga një operatorë ekonomikë tek tjetri në rastet e tërheqjes apo skualifikimit të tyre për procedurat të cilat zhvillohen në Sistemin e Prokurimit Elektronik të APP-së.
-Për rastet në të cilat nga operatorët ekonomikë nuk paraqesin dokumentacionin e përcaktuar në kriteret e ftesës për ofertë si dhe për rastet që mallrat e prokuruara nuk paraqiten nga operatori ekonomikë brenda afateve të përcaktuara në ftesën për ofertë, të bëhet skualifikimi i tyre.
-Për çdo rast faturat tatimore të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit referuar përcaktimeve ligjore.
-Për çdo rast likuidimi i faturave të kryhet brenda afateve ligjore duke shmangur krijimin e detyrimeve kontraktuale.
-Për çdo dosje të procedurave të prokurimit me vlera të vogla pas përfundimit të vitit ushtrimor të inventarizohen si dhe të kryhet arkivimi i tyre.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. P. B. me detyrë Kryetar i Bashkisë në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, z. L. H. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore në cilësinë e nëpunësit zbatues (për vonesat në likuidimin e OE) dhe znj. A. M., z. M. H. dhe z. A. V. në cilësinë e komisionit të prokurimit me vlera të vogla.

2.4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.

Nga analiza e regjistrit të investimeve në Bashkinë Selenicë janë përzgjedhur për auditim në bazë të vlerës së kontratës objektet si vijon:

Nr	Objekti	Vlera e kontratës	Kontraktori	Shënime
1	"Përmirësimi I banesave ekzistuese për komunitetet evarfëra dhe të pafavorizuara	14,961,413	BOE "J. & "C."	Me shkelje
2	"Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë"	7,779,120	OE "I. G."	Me shkelje
3	Rikonstruksion rruge të brendshme me beton	14,388,000	"A."	Me shkelje
4	Sistemim Asfaltim rruga tubo (rruga varreza, spital)	9,609,120	OE "J."	Me shkelje
5	Sistemim Asfaltim rruga Kropisht	14,529,921	OE "A."	Pa shkelje

6	Rehabilitim ura Brataj	1,968,720	OE "A."	Me shkelje
7	Rehabilitim i kanalit ujitës Hasomat Velçë dhe punime për rrjetin e kanalizimeve qendër Kotë	8,694,741	OE "K."	Pa shkelje

1. "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara", Bashkia Selenicë.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1423 prot datë 10.05.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Selenicë, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. P. B. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë "J." ShPK, me përfaqësues z. I. B., me licencë profesionale N. & "C." ShPK, me përfaqësues z. E. Ç., me licencë profesionale N. Vlera e kontratës është 14,961,413 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 120 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 871/1 prot, datë 23.03.2021, është lidhur kontrata me OE "N. G." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 742,012 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 3053/1 prot., datë 12.10.2021, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi OE "I.." ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK., dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 37,563 lekë me TVSH.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në zbatim të Urdhrit të TAK me nr. 127, datë 03.10.2019, nga grupi i punës me përbërje ing. K. B. dhe ekonomist B. K., është hartuar Akti i Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 16.06.2021.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, nuk administrohet në dosje Leje Infrastrukturore. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" Neni 39, "Leja e ndërtimit" sipas të cilit "*1.Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.*

2.Dokumenti i lejes së ndërtimit përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqërues të aplikimit dhe normave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

3.Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat "e" dhe "ë", të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit." dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Bashkisë Selenicë z. P. B., mbikëqyrësin e punimeve dhe kontraktorin e punimeve.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 17.05.2021 dhe kanë përfunduar me datë 16.09.2021, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Pas kërkesës së mbikëqyrësit për miratimin e preventivit të përmirësuar datë 12.08.2021, është mbajtur procesverbali datë 12.08.2021 "Për preventivin e përmirësuar në objektin "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara", Bashkia Selenicë" ndërmjet

mbikëqyrësit dhe sipërmarrësit të punimeve (i panënshkruar nga përfaqësues të investitorit Bashkia Selenicë). Pas këtij procesverbali të ndryshimit të punimeve, është hartuar tabela e ndryshimit të volumeve, me punime që shtohen/hiqen në vlerën 1,986,000 lekë/lekë pa TVSH, duke përdorur edhe fondin rezervë me vlerë 593,707 lekë pa TVSH.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

<table>
<tr><td colspan="5">Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara”, Bashkia Selenicë</td></tr>
<tr><td>14.Lidhja e kontratës
Nr. 1423 prot datë 10.05.2021</td><td colspan="2">15.Vlera e kontratës (me tvsh) 14,961,413 lekë
BOE fitues “J.” ShPK & “C.” ShPK</td><td colspan="2">16.Likuiduar deri dt</td></tr>
<tr><td>17- Situacioni Përfundimtar
-Vlera me tvsh 14,953,018 lekë
-Vlera pa tvsh 12,460,848 lekë</td><td colspan="2">18.Afati i kontratës në dite
Parashikuar 120 ditë , Zbatuar 120 ditë.
Fillimi punimeve: 17.05.2021
Perfundimi punimeve : 16.09.2021</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës
Nuk ka</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
OE “N.G.” SHPK</td><td>Licenca Nr: MK.</td><td>Kontrata me nr 871/1 prot, datë 23.03.2021</td><td>Likuiduar lekë</td><td>Pa likuiduar</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve
“I.” ShPK</td><td>Licenca Nr: MK.</td><td>Kontrata nr. 3053/1 prot., datë 12.10.2021</td><td>Likuiduar (.....lekë)</td><td>Pa likuiduar (..... lekë)</td></tr>
<tr><td>22.Akt Kolaudimi
Pa date</td><td colspan="2">23.Akt i marrjes në dorëzim
Nuk ka</td><td colspan="2">24. Fletë Hyrja Nr.... datë .....lekë
(për mallrat)</td></tr>
</table>

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **508,648 lekë pa tvsh**.

Titulli i gjetjes 30: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “*Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara*”, Bashkia Selenicë, nga zbatuesi i punimeve BOE “J.” ShPK & “C.” SHPK, për zërat e punimeve 2.1, 2.3, 2.5, 2.7, 2.10, 2.11 dhe 2.34..
Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:
-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Suva e zakonshme fasade mur tulle h 8 m”, “Bojë hidroplastike importi, cilësia I”, “Shtresë me pllaka mermeri 2 cm, çmimi”, “Dritare duralumini dyfish xham”, “Suva me grafiato h>4 m”, etj., për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1423 prot datë 10.05.2021.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3053/1 prot., datë 12.10.2021.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 2382 prot., datë 29.07.2021.
Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Selenicë.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia: E mesme
Rekomandime: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 508,648 lekë pa tvsh nga BOE "J." ShPK & "C." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1423 prot datë 10.05.2021 me objekt "*Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara*", *Bashkia Selenicë,* vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 508,648 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Z. V. B. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Zj. A. N. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

2. "Rehabilitim Ura Brataj", Bashkia Selenicë.
Kontratat
Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 818/1 prot datë 16.03.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Selenicë, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. P. B. dhe Operatorit Ekonomik "A." SHPK, me përfaqësues z. A. Gj. me licenca profesionale respektivisht Z... Vlera e kontratës është 1,968,720 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 60 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 871/1 prot, datë 23.03.2021, është lidhur kontrata me OE "N. G." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK... dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 742,012 lekë me tvsh.
Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi ing. T. N., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK....
Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në zbatim të Urdhrit të TAK me nr. 127, datë 03.10.2019, nga komisioni i përbërë prej z. K. B. dhe z. L. H., si dhe nga titullari i Bashkisë z. P. B., është nënshkruar Akti i Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 26.05.2021.
Projektpreventivi
- Për këtë objekt, nuk administrohet në dosje Leje Infrastrukturore. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" Neni 39, "Leja e ndërtimit" sipas të cilit "*1.Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.*
2.Dokumenti i lejes së ndërtimit përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqërues të aplikimit dhe normave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

3.Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat "e" dhe "ë", të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit." dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Bashkisë Selenicë z. P.B., mbikëqyrësin e punimeve dhe kontraktorin e punimeve.

- Në dosje administrohet si projekt i zbatimit vetëm një fletë me profil gjatësor dhe një prerje tërthore, si dhe një hartë nga google për vendndodhjen. Nuk rezulton që të ketë asnjë detaj për betonin dhe hekurbetonin e strukturave, profilat metalikë, morsetat, riparimin e parapeteve anësorë, etj. Sa sipër ngarkohet me përgjegjësi sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 25.03.2021 dhe kanë përfunduar me datë 25.05.2021, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve. Është hartuar procesverbali i ndryshimit të punimeve me datë 26.05.2021 (një ditë pas njoftimit për përfundimin e punimeve) dhe miratuar tabela e ndryshimit të volumeve, me punime që shtohen/hiqen në vlerën 130,800 lekë/131,400 lekë me TVSH.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rehabilitim Ura Brataj", Bashkia Selenicë				
14.Lidhja e kontratës Nr. 818/1 prot datë 16.03.2021	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 1,968,720 lekë **OE fitues "A." SHPK**		**16.Likuiduar deri dt**	
17- Situacioni Përfundimtar **-Vlera me tvsh 1,968,000 lekë** **-Vlera pa tvsh 1,640,000 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 60 ditë , Zbatuar 60 ditë. Fillimi punimeve: 25.03.2021 Perfundimi punimeve : 25.05.2021		**19. Zgjatja e kontratës** Nuk ka	
20. **Mbikëqyrësi i punimeve** OE "N. G." SHPK	Licenca Nr: MK.	Kontrata me nr 871/1 prot, datë 23.03.2021	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. **Kolaudatori i punimeve** Ing. T. N.	Licenca Nr: MK.	Kontrata nr. 2382 prot., datë 29.07.2021	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Pa datë	**23**.**Akt i marrjes në dorëzim** Datë 26.05.2021		**24**. Fletë Hyrja Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **138,400 lekë pa tvsh**.

Tabela nr. 1

Nr	**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
							Vol.	**Vlera**
7	Morseta për kavot metalike	copë	800	283	283	110	173	138,400
							Total	**138,400**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

1. Zëri 7. Morseta për kavot metalike. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 400 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 283 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 283 copë. Në fakt, nga verifikimi i projektit të azhurnuar dhe verifikimi në terren, rezulton se janë vendosur 110 copë, ose 183 copë më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Titulli i gjetjes 31: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rehabilitim Ura Brataj", Bashkia Selenicë, nga zbatuesi i punimeve OE "A." SHPK, për zërin e punimeve 7.
Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:
-Ka patur diferenca në volume në zërin e punës "Morseta për kavot metalike", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 818/1 prot datë 16.03.2021.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 871/1 prot, datë 23.03.2021.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 2382 prot., datë 29.07.2021..
Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Selenicë.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia: E ulët
Rekomandime: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 138,400 lekë pa tvsh nga OE "A." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 818/1 prot datë 16.03.2021 me objekt "Rehabilitim Ura Brataj", *Bashkia Selenicë,* vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.
Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 138,400 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Z. V. B. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. T. N. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

3. "Sistemim-Asfaltim lagjja Tubo – Rromës (rruga e varrezave, spitalit", Bashkia Selenicë.

Kontratat
Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 830 prot datë 17.03.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Selenicë, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. P. B. dhe Operatorit Ekonomik "J." SHPK, me përfaqësues z. A. J., me licencë profesionale

NZ.Vlera e kontratës është 9,609,120 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 90 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 871/1 prot, datë 23.03.2021, është lidhur kontrata me OE "N. G." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 742,012 lekë me tvsh.
Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1228 prot., datë 23.04.2021, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria "D." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 28,719 lekë me TVSH.
Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në zbatim të Urdhrit të TAK me nr. 127, datë 03.10.2019, është hartuar Akti i Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., pa datë, i nënshkruar edhe nga titullari i Bashkisë Selenicë, z. P. B.
Projektpreventivi
- Për këtë objekt, nuk administrohet në dosje Leje Infrastrukturore. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" Neni 39, "Leja e ndërtimit" sipas të cilit "*1.Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.*
2.Dokumenti i lejes së ndërtimit përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqërues të aplikimit dhe normave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
3.Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat "e" dhe "ë", të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit." dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Bashkisë Selenicë z. P. B., mbikëqyrësin e punimeve dhe kontraktorin e punimeve.
- Në dosje nuk administrohet projekti i zbatimit. Në SEP është gjurma e investimit e marrë nga google dhe relacioni teknik, i cili është hartuar nga grupi i projektimit nga administrata e Bashkisë Selenicë me përbërje ing. K. B. dhe topograf A.V., i panënshkruar.
Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 17.03.2021 dhe kanë përfunduar me datë 05.05.2021, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve. Me shkresën me nr. extra prot, datë 16.04, mbikëqyrësi i punimeve ka bërë kërkesën për ndryshimin e projektit. Pas kësaj kërkese, është hartuar procesverbali i ndryshimit të punimeve dhe miratuar tabela e ndryshimit të volumeve, me punime që shtohen/hiqen në vlerën 583,900 lekë/586,400 lekë pa TVSH, i nënshkruar edhe nga titullari i Bashkisë Selenicë, z. P.B..
- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Sistemim-Asfaltim lagjja Tubo – Rromës (rruga e varrezave, spitalit", Bashkia Selenicë		
14.Lidhja e kontratës Nr. 830 prot datë 17.03.2021	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 9,609,120 lekë **OE fitues "J." SHPK**	**16.Likuiduar deri dt**
17- Situacioni Përfundimtar **-Vlera me tvsh 9,606,120 lekë** **-Vlera pa tvsh 8,005,100 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 90 ditë , Zbatuar 58 ditë. Fillimi punimeve: 07.03.2021	**19. Zgjatja e kontratës** Nuk ka

	Perfundimi punimeve : 05.05.2021			
20. **Mbikëqyrësi i punimeve** OE "N. G." SHPK	Licenca Nr: MK	Kontrata me nr 871/1 prot, datë 23.03.2021	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. **Kolaudatori i punimeve** OE "D." SHPK	Licenca Nr: MK	Kontrata nr. 1228 prot., datë 23.04.2021	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 11.05.2021	**23**.**Akt i marrjes në dorëzim** pa date		**24**. Fletë Hyrja Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **254,080 lekë pa tvsh**.

Titulli i gjetjes 32: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Sistemim-Asfaltim lagjja Tubo – Rromës (rruga e varrezave, spitalit", Bashkia Selenicë, nga zbatuesi i punimeve OE "J." SHPK, për zërat e punimeve II.1 dhe II.2+3.
Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:
-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës "Shtresë stabilizanti t=1o cm" dhe "Shtresë asfaltobetoni + shtresë binderi me granil", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve..
Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 830 prot datë 17.03.2021.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 871/1 prot, datë 23.03.2021.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 1228 prot., datë 23.04.2021.
Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Selenicë.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia: E ulët
Rekomandime: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 254,080 lekë pa tvsh nga OE "J." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 830 prot datë 17.03.2021, me objekt "Sistemim-Asfaltim lagjja Tubo – Rromës (rruga e varrezave, spitalit", *Bashkia Selenicë,* vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 254,080 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Z. V. B. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. V. T. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

4. "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme me beton", Bashkia Selenicë.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1031 prot datë 06.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Selenicë, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. P. B. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë "A." SHPK, me përfaqësues z. A. Gj. & "Sh." ShPK, me përfaqësues z. Y. B., me licenca profesionale respektivisht NZ dhe NZ. Vlera e kontratës është 14,388,000 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 90 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 871/1 prot, datë 23.03.2021, është lidhur kontrata me OE "N. G." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 742,012 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2409/1 prot, datë 02.08.2021, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi ing. T. N., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK....., dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 29,992 lekë me TVSH.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në zbatim të Urdhrit të TAK me nr. 127, datë 03.10.2019, nga titullai i Bashkisë z. P.B., është nënshkruar Akti i Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 15.06.2021.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, nuk administrohet në dosje Leje Infrastrukturore. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" Neni 39, "Leja e ndërtimit" sipas të cilit "*1.Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.*

2.Dokumenti i lejes së ndërtimit përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqërues të aplikimit dhe normave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

3.Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat "e" dhe "ë", të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit." dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Bashkisë Selenicë z. P. B., mbikëqyrësin e punimeve dhe kontraktorin e punimeve.

- Në dosje nuk administrohet projekti i zbatimit. Administrohet vetëm një shkresë me specifikime teknike me emrat e hartuesve dhe e pafirmosur prej tyre, si dhe disa harta nga google për vendndodhjen e nënobjekteve. Nuk rezulton që të ketë projekt edhe për murin mbajtës në fshatin Kocul, me fond limit 678,000 lekë pa tvsh (ose 5.6% e fondit limit). Sa sipër ngarkohet me përgjegjësi sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 06.04.2021 dhe kanë përfunduar me datë 24.06.2021, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar dhe nuk administrohet korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me UKM Nr .2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu I, pika7, sipas të cilës " Sipërmarrësi nuk mund të

ndryshojë me nismën e vet, të subjektit projektues a mbikëqyrës, projektin dhe përshkrimet teknike të tij" dhe ngarkon me përgjegjësi sipërmarrësin, mbikëqyrësin e punimeve, kolaudatorin dhe grupin e marrjes në dorëzim të objektit.
Është hartuar procesverbali i ndryshimit të punimeve me datë 24.06.2021 dhe miratuar tabela e ndryshimit të volumeve, me punime që shtohen/hiqen në vlerën 209,338 lekë/212,218 lekë me TVSH. Edhe këto shkresa nuk janë të miratuara nga investitori.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

<table>
<tr><td colspan="5">Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme me beton", Bashkia Selenicë</td></tr>
<tr><td colspan="2">14.Lidhja e kontratës
Nr. 1031 prot datë 06.04.2021</td><td colspan="2">15.Vlera e kontratës (me tvsh) 14,388,000 lekë
BOE fitues "A" SHPK & "Sh." ShPK</td><td>16.Likuiduar deri dt</td></tr>
<tr><td colspan="2">17- Situacioni Përfundimtar
-Vlera me tvsh 14,385,120 lekë
-Vlera pa tvsh 11,987,600 lekë</td><td colspan="2">18.Afati i kontratës në dite
Parashikuar 90 ditë , Zbatuar 80 ditë.
Fillimi punimeve: 06.04.2021
Perfundimi punimeve : 26.06.2021</td><td>19. Zgjatja e kontratës
Nuk ka</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
OE "N. G." SHPK</td><td>Licenca Nr:
MK</td><td>Kontrata me nr 871/1 prot, datë 23.03.2021</td><td>Likuiduar
lekë</td><td>Pa likuiduar</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve
Ing.T. N.</td><td>Licenca Nr:
MK</td><td>Kontrata nr. 2409/1 prot, datë 02.08.2021</td><td>Likuiduar
(.....lekë)</td><td>Pa likuiduar (.....
lekë)</td></tr>
<tr><td>22.Akt Kolaudimi
Datë 15.06.2021</td><td colspan="2">23.Akt i marrjes në dorëzim Datë 15.06.2021</td><td colspan="2">24. Fletë Hyrja Nr.... datë .....lekë
(për mallrat)</td></tr>
</table>

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **471,240 lekë pa tvsh**.

Titulli i gjetjes 33: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme me beton", Bashkia Selenicë, nga zbatuesi i punimeve OE "A." SHPK, për punimet në segmentin rrugor Drashovicë 300 ml dhe zërin "FV zgarë metalike Ø 6 mm, 15 x 15 cm" në të gjithë segmentet rrugorë.
Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:
-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërin e punës "FV zgarë metalike Ø 6 mm, 15 x 15 cm" në të gjithë segmentet rrugorë, si dhe në të gjitha zërat e punës të realizuara në segmentin rrugor Drashovicë, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1031 prot datë 06.04.2021.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 871/1 prot, datë 23.03.2021.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 2409/1 prot, datë 02.08.2021..

Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Selenicë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

Rëndësia: E mesme

Rekomandime: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 471,240 lekë pa tvsh nga BOE "A" SHPK & "Sh." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1246 prot datë 27.04.2021 me objekt "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme me beton", *Bashkia Selenicë,* vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 471,240 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. V. B. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. T. N. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

5. "Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë", Bashkia Selenicë.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1456 prot datë 12.05.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Selenicë, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. P. B. dhe Operatorit Ekonomik "I.G." ShPK, me përfaqësues z. E. Z. me licencë profesionale NZ. Vlera e kontratës është 7,779,120 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 60 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës. Pas kërkesës së mbikëqyrësit të punimeve datë 25.06.2021 për shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve për shkak të disa problemeve teknike dhe lënies së ujit për vaditje gjatë sezonit të verës, është mbajtur Amendamenti i kontratës me nr. 1456/2 prot, datë 01.07.2021, sipas të vilit është miratuar shtyrja e kontratës deri në datën 01.06.2022.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1584/1 prot, datë 24.05.2021, është lidhur kontrata me OE "I." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 76,363 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1467/2 prot., datë 07.06.2022, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi OE "K" ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 28,731 lekë me TVSH.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në zbatim të Urdhrit të TAK me nr. 127, datë 03.10.2019, nga grupi i punës me përbërje ing. K. B., I. D. dhe ekonomist L. H., është hartuar Akti i Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 17.06.2021.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, nuk administrohet në dosje Leje Infrastrukturore. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" Neni 39, "Leja e ndërtimit" sipas të cilit "*1.Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim*

apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.
2.Dokumenti i lejes së ndërtimit përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqërues të aplikimit dhe normave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
3.Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat "e" dhe "ë", të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit." dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Bashkisë Selenicë z. P. B., mbikëqyrësin e punimeve dhe kontraktorin e punimeve.
- Në dosje nuk administrohet projekti i zbatimit. Administrohet vetëm një shkresë me specifikime teknike me emrat e hartuesve dhe e pafirmosur prej tyre, si dhe disa harta nga g.... për vendndodhjen e nënobjekteve.
Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 24.05.2021 dhe kanë përfunduar me datë 01.06.2022, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve (përfshirë edhe amendamentin nr. 1456/2, datë 01.07.2021).

Nga auditimi u konstatua se ka ndryshime në volume ndërmjet preventivit të ofertës dhe situacionit përfundimtar. Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar dhe nuk administrohet korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me UKM Nr .2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu I, pika7, sipas të cilës " Sipërmarrësi nuk mund të ndryshojë me nismën e vet, të subjektit projektues a mbikëqyrës, projektin dhe përshkrimet teknike të tij" dhe ngarkon me përgjegjësi sipërmarrësin, mbikëqyrësin e punimeve, kolaudatorin dhe grupin e marrjes në dorëzim të objektit.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

<table>
<tr><td colspan="5">Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë", Bashkia Selenicë</td></tr>
<tr><td>14.Lidhja e kontratës
Nr. 1456 prot datë 12.05.2021</td><td colspan="2">15.Vlera e kontratës (me tvsh) 7,779,120 lekë
OE fitues "I. G." ShPK</td><td colspan="2">16.Likuiduar deri dt</td></tr>
<tr><td>17- Situacioni Përfundimtar
-Vlera me tvsh 7,779,120 lekë
-Vlera pa tvsh 6,482,600 lekë</td><td colspan="2">18.Afati i kontratës në dite
Parashikuar 60 ditë , Zbatuar 372 ditë.
Fillimi punimeve: 24.05.2021
Perfundimi punimeve : 01.06.2022</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës
Amendamentin nr. 1456/2, datë 01.07.2021, shtyrje afatit të punimeve deri në datën 01.06.2022</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
OE "I" SHPK</td><td>Licenca Nr: MK</td><td>Kontrata me nr 1584/1 prot, datë 24.05.2021</td><td>Likuiduar lekë</td><td>Pa likuiduar</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve
"K. C." ShPK</td><td>Licenca Nr: MK</td><td>Kontrata nr. 1467/2 prot., datë 07.06.2022</td><td>Likuiduar (.....lekë)</td><td>Pa likuiduar (..... lekë)</td></tr>
<tr><td>22.Akt Kolaudimi
Datë 17.06.2022</td><td colspan="2">23.Akt i marrjes në dorëzim
Datë 17.06.2022</td><td colspan="2">24. Fletë Hyrja Nr.... datë .....lekë
(për mallrat)</td></tr>
</table>

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **486,900 lekë pa tvsh**.

Titulli i Gjetjes 34: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë", Bashkia Selenicë, nga zbatuesi i punimeve OE "I. G." SHPK, për zërat e punimeve I.1., I.7, I.10 dhe I.14.
Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:
-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës "Gërmim kanalesh me krahë", "FV kabëll 20 kv 400", "FV kabëll 4/50" dhe "FV fllanxha DN 400, çmimi", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1456 prot datë 12.05.2021.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1584/1 prot, datë 24.05.2021.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 1467/2 prot., datë 07.06.2022.
Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Selenicë.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia: E mesme
Rekomandime: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 486,900 lekë pa tvsh nga OE "I. G." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1456 prot datë 12.05.2021 me objekt "Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë", *Bashkia Selenicë,* vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 486,900 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Z. A.N. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. I. A. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

2.5 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme
1. Auditimi i fundit në Bashkinë Selenicë.

Auditimi i fundit në Bashkinë Selenicë është kryer në vitin 2021 për periudhën 01.01.2019-31.12.2020, raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën 588/7 datë 08.11.2021, protokolluar në subjekt me shkresën nr. 2798/1, datë 09.11.2021.
Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:
- 20 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 3 masa shpërblim dëmi me vlerë 6,029,810 lekë, pranuar nga subjekti;
- 3 masa për përdorimin e fondeve në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit;
- Masa disiplinore për 10 punonjës, nga të cilët 6 punonjës nëpunës civil dhe 4 punonjës me kod pune.

2. Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, germa j, Bashkia Selenicë duhet të hartojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit. Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Selenicë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën 588/7 datë 08.11.2021 ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 2798/4 datë 07.12.2021, 30 ditë nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Ndërkohë rezulton se ka hartuar Planin e Veprimit nr. 2798/2 datë 07.12.2021 për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse sipas llojit të rekomandimit.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Referuar shkresës nr. 588/7 datë 08.11.2021 për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve të KLSH-së, rezulton se nga Bashkia Selenicë nuk është raportuar në KLSH brenda 6 muajve lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30, pika 2, "*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*".

4. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH

Titulli i gjetjes 35: *Mos raportim në KB mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.*

Situata: Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Selenicë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 588/7 datë 08.11.2021, por nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 50, pika 5, *"Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ..., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij"*.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 50, pika 5.

Ndikimi: Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit sjell që disa aktivitete në Bashkinë Selenicë të kryhen në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe të kenë ndikime financiare në vijimësi.

Shkaku: Mos angazhim sa duhet i strukturave të Bashkisë Selenicë me qëllim zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.
Rëndësia: E mesme
Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

5. Mbi nivelin e zbatimin të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit në Bashkinë Selenicë.
Në përfundim të auditimit janë rekomanduar masat si vijon:
Masa organizative
Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Selenicë 20 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht.
1. Gjetje nga auditimi: Gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, kuptohen dhe funksionojnë jo mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë, pavarësisht përpjekjeve të këtij institucioni për të shkuar drejt konsolidimit. Konkretisht:
-Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk është mbledhur për hartimin e planit strategjik dhe PBA për vitin 2019 dhe 2020.
-Në lidhje me komponentin e menaxhimit të riskut:
-Nuk është caktuar koordinatori i riskut, nuk ka një strategji të miratuar të risqeve, nuk është hartuar regjistri i riskut, nuk ka të përcaktuar adresim te riskut, nuk është kryer asnjë procedurë për menaxhimin e riskut.
-Nuk ka evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit/ose jo të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe që pengojnë marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.
Në lidhje me komponentin e aktivitetit të kontrollit;
-Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.
Në lidhje me komponentin e Monitorimit, nuk ka:
-Raportime të menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakt dhe produkti.
- Rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
- Plan të veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
Në lidhje me komponentin e informimit dhe komunikimit
- Nuk ka sistem të raportimit, ku të ofroj aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të Bashkisë dhe të njësive të varësisë të saj
Veprimet si më sipër janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar neni 8, pika 8/b, neni 27, pika 1 dhe 2, neni 10, pika 1,2,3, neni 11, pika 2, neni 4, pika 20, neni 23, pika 1,2,3, Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli II, pika 2.2.6, pika 2.2.7/e, Kapitulli III, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.4, nënpikat 1,2,3,4,5, pika 2.3, 3.2.3, pika 4, pika 2.2
1.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Selenicë, me atributet e Kryetarit të Grupi të Menaxhimit Strategjik (në vijim GMS), si dhe Nëpunës Autorizues, të merre masa për përmbushjen e detyrimit

ligjor të GMS për hartimin e planit strategjik dhe PBA, për caktimin e koordinatorit të riskut, për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherë të programeve për realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë**.**

Brenda muajit Dhjetor 2021

1.1 Nga verifikimi rezultoi se:

Me Urdhër nr. 152 datë 26.11.2021 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik si dhe kryerjen e procedurave për menaxhimin e riskut, por nuk ka dokumentacion justifikues lidhur me punën e kryer nga ky grup për hartimin e PBA-së, raportimi mbi realizimin e objektivave etj.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2019 dhe 2020, Grupit të Menaxhimit Strategjik, nuk ka kryer përcaktimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve të dy viteve dhe përcaktimin e tendencave dhe politikave të shpenzimeve sipas funksioneve prioritare, si dhe nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në hartimin e programeve buxhetore.

Nga Këshilli Bashkiak për vitin 2019 është kryer miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit me VKB nr. 93, datë 21.12.2018, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë, me shkresën nr. 2599/1, datë 15.01.2019, ndërsa për vitin 2020 nuk është kryer miratimi i buxhetit faktik.Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", pika 17, Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", Shtojca 6, Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", pika 14.

2.1 Rekomandimi: Për shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara në hartimin e programeve buxhetore është e domosdoshme marrja e masave urgjente për korrigjimin e kësaj praktike, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla. Kryetari i Bashkisë të krijoj lehtësira dhe të rrisë impaktin e shoqërisë civile për diskutime, sugjerime dhe reflektime në hartimin e programeve buxhetore. GMS të konsiderojë moment kyç, jo vetëm përcaktimin e tendencave dhe politikave të shpenzimeve sipas funksioneve prioritare, por dhe monitorimin dhe zbatimin e buxhetit, me nevojë reale për indikatorë të qartë e të matshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

***2.1 Nga verifikimi rezultoi se*:**

Janë marrë disa masa gjatë vitit 2021 për hartimin e PBA-së 2022-2024, janë bërë dëgjesa publike në muajin Prill dhe Tetor, janë përcaktuar tavanet e buxhetit afatmesëm 2022-2024 në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 22 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" me shkresën nr. 1712 Prot. datë 01.06.2021 janë dërguar në MFE tavanet buxhetore 2022-2024. Nuk është dokumentuar puna e Grupit të Menaxhimit Strategjik lidhur me hartimin e PBA-së.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

3. Gjetje nga auditimi: Buxheti vjetor për vitin 2019 është në pamjaftueshmëri për aktivitetin Bashkisë, për arsye të mos realizimit të të ardhurave. Konkretisht nga 101,034 mijë lekë të ardhura të programuara janë realizuar 76,737 mijë lekë, dhe ky fakt nuk është raportuar në Këshillin Bashkiak. Buxheti vjetor për vitin 2019-2020, është në pamjaftueshmëri për aktivitetin Bashkisë për arsye të mos realizimit të të ardhurave. Konkretisht: për vitin 2020, nga 125,981 mijë lekë të ardhura të programuara janë realizuar 70,217 mijë lekë dhe ky fakt nuk është raportuar në Këshillin Bashkiak, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 6, pika ç dhe për vitin 2019 janë kryer 2 shtesa në vlerë 35.054 mijë lekë, për vitin 2020 janë kryer 4 shtesa në vlerën 39.801 mijë lekë, ndërsa pakësime janë bërë në vitin 2019 ne vlerën 32.131 dhe ne vitin 2020 ne vlerën 33,410 mijë lekë, çka tregojnë qartë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit si edhe atë të përllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.
Mosrealizimet dhe ndryshimet e mëdha dhe të shpeshta në programet kryesore të veprimtarisë së bashkisë tregon se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 6, pika ç dhe d, neni 40, 48, Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" nenet 42,43,47,50,52 dhe 65.
3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore, të marrë në shqyrtim rastet e rishikimeve buxhetore (shtesa/pakësime dhe rishpërndarje) për të analizuar ato sipas llojit, kronologjisë dhe në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli me numrin më të lartë të kërkesave për rishikim dhe argumentimin shoqërues të tyre, me qëllim përmirësimin e perfomancës në programimin buxhetor, implementimin e sistemeve të reja të kontrollit për të shmangur risqet që këto rishikime të shpeshta mbartin në zbatimin e procedurave për zbatimin e buxhetit në përputhje me parashikimet për disiplinimin fiskal dhe financiar.

Në vijimësi

3.2 Rekomandimi: Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim efiçent i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Në vijimësi

***3.1-3.2 Nga verifikimi rezultoi se*:**
Gjatë vitit buxhetor 2021 ka patur lëvizje të konsiderueshme, gjë që tregon se planifikimi i buxhetit nuk është plotësisht efektiv. Ndryshimet nuk janë shoqëruar me relacion shpjegues lidhur me arsyet e ndryshimit. Nuk ka një analizë se si ndikon ky ndryshim në realizimin e objektivave të synuar të bashkisë.

Rekomandimet 3.1-3.2 nuk janë zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2019 në *61 raste në vlerën 32,617 mijë lekë* dhe për vitin 2020 *në 100 raste në vlerë 47,492 mijë lekë,* faturat janë dorëzuar në Degën e Thesarit Vlorë jashtë afatit 30 ditor. Nga auditimi i transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës u konstatua se për vitin 2019 janë kryer pagesa me urdhër-shpenzime në *55 raste në vlerën 32,617 mijë, për vitin 2020 se janë kryer pagesa me urdhër-shpenzime në 64 raste në vlerën 50039 mijë lekë* mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime dhe investime të mbërritura në institucion. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit

buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52, Ligjin nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", neni 7, pika, i, ii dhe iii, Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", KREU II, pika 184.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të kryejë veprimet e kontabilizimit në rastet e kryerjes së veprimeve ekonomike për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe me investimet në momentin e mbërritjes së faturës dhe çeljes së fondeve, për njohjen e detyrimeve ndaj furnitorëve, duke prekur llogaritë përkatëse në mënyrë që në fund të vitit të ushtrimor të paraqiten në bilanc detyrimet reale ndaj të tretëve në llogaritë e detyrimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

***4.1 Nga verifikimi rezultoi se*:**

Gjatë vitit 2021 janë konstatuar raste të vonesave në likuidimin mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime dhe investime të mbërritura në institucion.

Rekomandimi nuk është zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Databaza e të dhënave gjyqësore për vitin 2020, nuk është hartuar referuar Urdhrit Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 5151 datë 28.10.2015 për "Zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil", KREU II, pika 2. Në të nuk janë përshirë: Numri dhe data e vendimit gjyqësor, palët ndërgjyqës, objektin e paditës, diapozitivin e vendimit, aktin e largimit ose lirimit të nëpunësit civil, fakte dhe rrethana të lindura, në lidhje me pozicionin e punës, pas dhënies së vendimit të formës së prerë etj, por është modifikuar sipas një grafiku ku nuk prezanton gjendjen gjyqësore në vlerë dhe pagesat për vitin ushtrimor, grafik i cili është publikuar në faqen zyrtare të bashkisë, ku vlera totale e vendimeve gjyqësore është 4,500 mijë lekë, vlerë e cila është miratuar me vendim të këshillit bashkiak me nr. 63, datë 19.12.2019.

5.1 Rekomandimi: Për shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara në mbajtjen e databazës së të dhënave gjyqësore, është e domosdoshme marrja e masave urgjente për korrigjimin e kësaj praktike, duke bërë përmirësimet përkatëse.

Menjëherë

***5.1 Nga verifikimi rezultoi se*:**

Baza e të dhënave mbi vendimet gjyqesore është plotësuar me të gjitha të dhënat.

Rekomandimi është zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për periudhën vitin 2019-2020 nga Bashkia Selenicë janë zhvilluar *37 prokurime* për vitin 2019 dhe 73 procedura prokurimi për vitin 2020, pa marrë autorizimin nga Dega e Thesarit Vlorë, përpara se të fillojë procesi i prokurimit. Veprime këto që janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9/1 datë 20.03.2018, pjesa III, "Procedurat për kryerjen e shpenzimeve", dhe pika 15.1.

6.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa më qëllim fuqizimin e kontrollit të brendshëm në drejtim të monitorimit sistematik të procedurave të prokurimit për të siguruar që realizimi i tyre, të jetë në përputhje me disponilitetin e fondeve me qëllim marrjen në kohë të masave për mënjanimin problematikave të konstatuara dhe raportimin e saktë të treguesve të buxhetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

***6.1 Nga verifikimi rezultoi se*:**

Për 4 procedura prokurimi të vitit 2021 (Sistemim, asfaltim, riparim Rruga Tubo, Sistemim asfaltim Rruga Kropisht, Rikonstruksion rruge të brendshme me beton, dhe Rehabilitim Ura Brataj) është marrë konfirmimi i thesarit për disponilitetin e fondeve. Për 4 procedura të tjera (Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë, Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e pafavorizuara, Rikonstruksion Ujësjellësi Vodicë, Rehabilitim i Kanalit Hasomat Velçë) procedurat janë kryer pa marrë konfirmimin e thesarit për disponilitetin e fondeve.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

7. Gjetje nga auditimi: Stoku i detyrimeve (të prapambetura dhe afatshkurtra) deri në dhjetor të vitit 2019 për Bashkinë Selenicë është në vlerën 102,878 mijë lekë sipas shkresës nr. 3642 prot., datë 27.12.2019 dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me një vështirësi financiare 15.98%, ku totali i shpenzimeve për Bashkinë Selenicë është në vlerën 643,745 mijë lekë. Stoku i detyrimeve (të prapambetura dhe afatshkurtra) deri në dhjetor të vitit 2020 për Bashkinë Selenicë është në vlerën 98,988 mijë lekë sipas shkresës nr. 328/1 prot., datë 22.01.2021 dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me një vështirësi financiare 18.51%, ku totali i shpenzimeve për Bashkinë Selenicë është në vlerën 534,915 mijë lekë.

Për vitin 2019 dhe 2020, nuk është kryer në mënyrë periodike kontabilizimi i detyrimeve të prapambetura në momentin e krjimit të tij, por është bërë në fund të vitit, pra mbas ndodhjes së veprimit.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8 datë 09.03.2018 "Për Procedurat e Përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme", pika 3.1, nënpika 32 paragrafi 2.

7.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore, të merren masa për të mbajtur nën kontroll evidentimi jo real të detyrimeve në marrëdhëniet e shtetit me njësitë e qeverisjes së përgjithshme (llogaria 4341"Operacione me shtetin (detyrime)", si dhe kontabilizimi i detyrimeve të prapambetura të bëhet në momentin e krijimit të tyre.

7.2 Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë të merren masa për realizimin e të ardhurave për vitin 2021, si vetmja rrugë për të menaxhuar situatën e detyrimeve të prapambetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

***7.1-7.2 Nga verifikimi rezultoi se*:**

- Drejtoria e Financës nuk ka bërë kontabilizimin e borxhit tatimor për taksat dhe tarifat vendore edhe pse nga Drejtoria e të Ardhura është dërguar me shkresën nr. 2798/5 Prot. datë 31.12.2021 borxhi tatimor progresiv në vlerën totale *prej 375,334,216 lekë.*

- Janë ngritur grupe pune për çdo Njësi Administrative, për shpërndarjen e njoftim detyrimit me afat deri më 31.12.2021, dhe në vazhdim.

- Me mbylljen e vitit ushtrimor 2021 janë hartuar listat përfundimtare për debitorët e biznesit të vogël dhe të madh.

- Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, <u>nuk janë marrë masa të tjera</u> bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89,90,91,93.

Rekomandimet 7.1-7.2 nuk janë zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer në lidhje me procedurën e prokurimit për objektin "Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Selenicë, Kote dhe Armen, Bashkia Selenicë", rezultoi se: Fondi i këtij i këtij investimi është akorduar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe infrastrukturës së Mbetjeve me shkresën nr. 442 prot., datë 11.02.2020,

protokolluar në Bashkinë Selenicë me nr. 692 prot., datë 19.02.2020 dhe shkresën nr. 508 prot, datë 14.02.2020 protokolluar në Bashkinë Selenicë me nr. 693 prot, datë 19.02.2020 në vlerën 95,673,558 lekë me destinacion rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Selenicë, Kote dhe Armen, Bashkia Selenicë. Nga kjo 93,486,000 lekë ndërtim montim, 1,902,226 lekë drejtim punimesh dhe 285,332 lekë kolaudim punimesh. Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Selenicë, Kote dhe Armen, është kryer pa leje ndërtimi, si dhe shpim pusi h/gjeologjik në fshatin Kotë, është kryer pa leje nga organet e menaxhimit të burimeve ujore.
Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", me ndryshimet vijuese të tij, neni 28, pika 1 dhe 2, neni 38 pika 1 dhe 2, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", me ndryshimet vijuese të tij, neni 19, pika 1/nj, pika 3, neni 25, pika, pika 1, a,b, 7, a,b,c, dhe pika 8, Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.6.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të këshillit të ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, pika 4, Ligji nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"., nenin 56 pika 1, 2, 5, 6.
8.1 Rekomandimi: Nga Këshilli Bashkiak të analizohet dhe të dalë përgjegjësia për ndërtimin pa leje të rikonstruksionit të rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Selenicë, Kote dhe Armen, si dhe shpimi i pusit gjeologjik në fshatin Kotë, kryer pa leje nga organet e menaxhimit të burimeve ujore dhe të merren masa për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.1 Nga verifikimi rezultoi se:
Nuk janë marrë masa për të analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për ndërtimin pa leje të rikonstruksionit të rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Selenicë, Kote dhe Armen.

Rekomandimi nuk është zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer në procedurën e prokurimit me objekt: "Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Selenicë, Kote dhe Armen, Bashkia Selenicë", rezultoi se në hartimin e Dokumenteve të tenderimit (DT) , ato janë hartuar dhe miratuar me procesverbalin e datës 26.02.2020. Në këto kërkesa nuk janë dhënë arsye konkrete në argumentimin e kritereve të vlerësuara për objektin e prokurimit, në raport me natyrën dhe përmasat e këtij objekti.
Nga Autoriteti Kontraktor nuk është përcaktuar që ISO (certifikata) të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akreditуar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe çertifikatat kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit ose/dhe në afatin e zbatimit të kontratës.
Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 30, pika 1.
Çertifikata: DS CEN /TR 15128:2005, ka të bëjë "Survey of european standards for rehabilitation of drain and seëer systems / Studim i standardeve evropiane për rehabilitimin e sistemeve të kullimit dhe kanalizimeve", jo vetëm është ç'fuqizuar me datë 02.02.2016, por është kërkesë e ekzagjeruar dhe nuk është në proporcion me objektin e prokurimit, pasi zërat e punës objekt prokurimi plotësohen nga Çertifikata: ISO 1452-1:2009 "Plastics piping systems for ëater supply and for buried and above-ground drainage and seëerage under pressure — Sistemet e tubacioneve të plastikës për furnizimin me ujë dhe për kullimin e groposur dhe mbi tokë dhe kanalizimin nën

presion” dhe Çertifikata: BE-EN 13331-1:2002 “Trench lining systems / Sistemet e rreshtimit të llogoreve (kanaleve).
Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 46, pika 1, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 30, pika 2.
- Në piken 2.3, të DT, është kërkuar që:
Operatori ekonomik duhet të ketë një drejtuesit teknik të jetë i Certifikuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit me titull “Specialist për testimin e performancës së produkteve të ndërtimit “.
Operatori ekonomik duhet të ketë një drejtuesit teknik të jetë i Certifikuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë me “Leje Profesionale Tipit B. Për Veprimtari Studiuese – Projektuese dhe Zbatuese “:
B.4. Çertifikata , si studiues, mbikëqyrës, monitorues në matjet topomarkshederike në tunele dhe punime kapitale në infrastrukturës rrugore, hidrocentrale, nafte gazësjellësa, ujësjellës depo të lëndëve plasëse dhe objekte të tjera me karakter civil.
Operatori ekonomik duhet të ketë 1 drejtues teknik inxhinier elektrik përfshirë në licencën e shoqërisë, si dhe të figuroje në listpagesat e shoqërisë i certifikuar me certifikatë “Specialist për verifikimet inspektive elektrike në tension të ulet sipas direktivës 2006/95/CE të datës 12.12.2006“ dëshmuar me Diplome, kontrate pune të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës.
Këto kritere janë të ekzagjeruara dhe të pa argumentuara, pasi: Zotësia profesionale e operatorëve ekonomik është e ezauruar në kategoritë e zërave të punimeve të kërkuara si: N.P.1/B, N.P.2/B, NP.3A, N.P.4/A, N.P.5/B,NP-11/A, N.P.12/A, N.S.4/A, N.S.8/B, N.S.9/A, N.S.10/A, N.P. 7/C,N.S.- 16/A , NS-18/B, NS-20.
Veprime në kundërshtim me nenin 46, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2009 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 5, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”,* kreu III, pika 1/a .
Në pikën 2.3 të DT, është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion një laborator të çertifikuar dhe akreditуar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit me pajisje dhe instrumente me qellim qe ti përdor për inspektimin e ndryshme të materialeve dhe punimeve të ndërtimit, mikrobiologjike, mekanike, elektrike, etj. Lidhur me këtë pike duhet të paraqitet një Akt – Marrëveshje Noteriale e cila duhet të jetë e vlefshme gjate gjithë kohës se ekzekutimit të procedurës objekt prokurimi, është kërkesë e ekzagjeruar.
Në pikën 2.3 të DT, është kërkuar që operatori ekonomik duhet të paraqes një kontrate furnizimi me subjekt qe ka mbi 5 vjet eksperience me fushë veprimtari tregtim të tubove të ujësjellësve HDPE 100 Ø 20 deri Ø 200 dhe 10 PN deri 25 PN, Saraçineska, fllanxha ,matësa uji , FV.E/P zhytëse në madhësinë sipas preventivit dhe të jetë i çertifikuar me ISO 9001: 2015 ,ISO 14001:2015,te jetë i pajisur me Leje Mjedisore të Tipit C dhe të jetë i autorizuar nga një prodhues i certifikuar dhe akreditуar nga DAK me ISO 9001:2015 ,OHSAS 18001:2007,ISO 14001:2015. Lidhur me këtë pike duhet të paraqitet kontrate noteriale furnizimi me emër objekti dhe të mbuloj afatin e përcaktuar për realizimin e punimeve të cila duhet të jetë e vlefshme gjate gjithë kohës se ekzekutimit të proçedurës objekt prokurimi dhe të paraqiste dhe çertifikata komformiteti sipas standardeve të cilësisë të BE nga autorizuesi , katalogët e pompave me fuqi sipas preventivit, është kërkesë e ekzagjeruar.

Veprime në kundërshtim me nenin 46, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2009 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26, pika 5.
Edhe pse në preventivin e punimeve të fshatit Kotë, është përcaktuar, citojmë:" Pika 1; "Shpim pusi" h/gjeologjik q=15 litra sekondë, në **vlerën 1,020,568 lekë**, në kërkesat për kualifikim, nuk është përcaktuar që operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi një sonde me kapacitet ngritës, pesha tërheqëse jo me pak se ton, e vërtetuar kjo në certifikatën e origjinës, Sondat duhet të jenë Hidraulike të tipit ose të ngjashëm me rrotullim, etj".
Veprime të cilat janë në kundërshtim me nenin 46, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2009 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26, pika 5.
Në pikën 2.3 të DT, është kërkuar që është kërkuar mjek 1, referuar VKM Nr. 742, datë 6.11.2003 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë" të vërtetuar me kontratë noteriale pune, diplomë, licence lëshuar nga sipas urdhrit të mjekut, të jete i përfshirë në listë pagesë.
Veprim i cili është në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 108, datë 09.02.2011,"Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", i ndryshuar, sipas të cilit, shërbimet mjekësore për punëmarrësin, mund të sigurohen jo vetëm me anë të mjekut të punësuar, por edhe me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.
Veprim në kundërshtim me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018, pasi nuk duhet përcaktuar që është realizuar gjatë tre viteve të fundit të veprimtarisë së operatorit, por të tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit 6.
9.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë të ndershme. Kërkesat/specifikimet teknike duhet të jenë të shkruara në mënyrë të tillë që të argumentohet nevoja që dikton vendosjen e këtyre kritereve, duke parandaluar në këtë mënyrë para përzgjedhjen paraprake të kandidatit fitues, në zbatim me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

***9.1 Nga verifikimi rezultoi se*:**
Nga auditimi i zhvillimit të procedurave të prokurimit publik si një nga pikat e programit të auditimit nr. 799/1 datë 02.09.2022 rezulton se Bashkia Selenicë nuk ka argumentuar vendosjen e kritereve dhe specifikimeve teknike që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë të ndershme.

Rekomandimi nuk është zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit në procedurën e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i ujësjellësit Selenicë, ARMEN, dhe Kote" rezultoi se dokumentacioni që shoqëron ofertën e paraqitur nga, operatori ekonomik "S." shpk konstatohet se nga KVO, është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht në piken 2.3, të DT, është kërkuar që: Shoqëria duhet të jete e pajisur me çertifikatat: ISO 9001-2015,çertifikatë: ISO14001-2015,

Çertifikatë:ISO45001-2018, Çertifikatë: ISO 1452-1:2009, Çertifikatë: BE-EN 13331-1:2002, Certifikatë: DS CEN / TR 15128:2005, Çertifikatë: EN ISO 3834-2:2006, Çertifikatë: ISO 50001 – 2011, Çertifikatë: ISO 39001:2012. Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s'kualifikim.
Ky operator nuk e ka përmbushur këtë kërkesë, pasi:
Nuk ka paraqitur:
- a. Çertifikatën: ISO 1452-1:2009,
-b. Çertifikatën: BE-EN 13331-1:2002,
-c. Çertifikatën: DS CEN / TR 15128:2005
Për sa më sipër, në opinionin e grupit të auditimit, çertifikatat si më poshtë **janë dokumente të pa besueshëm për tu marrë në konsideratë nga KVO për kualifikimin e operatorit ekonomik.**
-1. Çertifikata ISO 14001-2015, e lëshuar nga Kompania "I.", për operatorin ekonomik "S." Shpk me nr. AL, me datë regjistruese fillestare 11.12.2018, datë certifikate 11.12.2018, auditi i mbikëqyrjes në ose përpara datë 06.12.2019 ***dhe datë ri-çertifikim i detyrueshëm/ skadimi i certifikatës datë 10.12.2021***, referuar Website të kësaj kompanie (V), jo vetëm nuk është me statusin aktiv (tërhequr ose pezulluar), që prej datës 10.12.2020, por kjo certifikatë është paraqitur në tender e modifikuar, pasi referuar Website të kësaj kompanie data e ***ri-çertifikimit të detyrueshëm/ skadimi i certifikatës nuk është data 10.12.2021, por data 10.12.2020.***
Kjo certifikatë ka të bëjë me "Environmental management systems / Sistemet e menaxhimit mjedisor".
-2. Çertifikata ISO 50001:2011, e lëshua nga Kompania "L.", për operatorin ekonomik "S." Shpk me nr. A, me datë regjistruese 28.12.2018, datë certifikate 01.01.2019, auditi i mbikëqyrjes në ose përpara datës 27.12.2019 dhe ri-çertifikim i detyrueshëm/ skadimi i certifikatës datë 27.12.2021, referuar Website të kësaj kompanie (V), nuk është me statusin aktiv (tërhequr ose pezulluar).
-3. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Certifikatë: ISO 45001-2018, "por ka paraqitur certifikatën **OHSAS 18001:2007** (or equivalent (for each bidder in caseof JV).
-Certifikatë OHSAS 18001:2007, lëshuar nga Kompania "I.", për operatorin ekonomik "S." Shpk me nr. A, me datë regjistruese fillestare 24.12.2018, datë certifikate 24.12.2018, auditi i mbikëqyrjes në ose përpara datë 19.12.2019 ***dhe datë ri-çertifikim i detyrueshëm/ skadimi i certifikatës datë 23.12.2021***, referuar Website të kësaj kompanie (V), është paraqitur në tender e modifikuar, pasi referuar Ëebsite të kësaj kompanie data e ***ri-çertifikimit të detyrueshëm/ skadimi i certifikatës nuk është data 23.12.2021, por data 11.03.2021.***
Theksojmë se në deklaratën noteriale datë 27.03.2020, bashkëlidhur prokurës së posaçme me nr. Repertori 289, nr. Koleksioni 168, datë 28.03.2020 neni 3 "Ndarja e punimeve", llojet e punimeve që do të kryejë secila palë është përcaktuar, operatori ekonomik "S." shpk do të kryej 50.0% të punimeve, operatori ekonomik "B93" shpk do të kryej 35.0 % të punimeve, operatori ekonomik "B" shpk do të kryej 15.0 % të punimeve.
Ndërsa në Aneksin I "Llojet e punimeve", bashkëlidhur kësaj deklarate noteriale, nuk ka ndarje të zërave të punimeve sipas përqindjes së përcaktuar, por secili zë punimi është ndar, operatori ekonomik "S." shpk do të kryej 50% të zërave të punës, operatori ekonomik "B" shpk do të kryej 35.0 % të zërit të punës, operatori ekonomik "B" shpk do të kryej 15.0 % të zërit të punës. Konkretisht: Punime montimi Kompletim me pompa zhytëse për stacionin e pompave të ujit Selenicë, në puset e ujit me ulje H= -70 metra; Tobo çeliku 6' (3-metra/copa) me fileto +manikota

për puse uji, tipi ASTM A53 GRB,n GRADE B. Standarti MANESMMAN copë 46, nga këto "S." shpk 50.0% = 23 copë, "B" shpk 35.0 % =16.1 copë, "B.." shpk 15.0 % =6.9 copë.
FV. Tuba PE për kollonat dhe matësa uji tek pallatet 2-4-5 kat: Prishje suvatim muri A-15, m^2 2394, nga këto "S." shpk 50.0% = 1197 m^2, "B.." shpk 35.0 % =837 m^2, "B" shpk 15.0 % =359.1 m^2, ***dhe kështu me radhë për të gjitha zërat e punimeve***.
Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", i ndryshuar, neni 74 pika 1 dhe 2 dhe shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018, secili operator duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes".
Theksojmë se ky operator referuar prokurës së posaçme me nr. Repertori 289, nr. Koleksioni 168, datë 28.03.2020 neni 3 "Ndarja e punimeve", do të kryej 50 % të zërave të punës.
Për sa trajtuar mësipërm, kualifikimi dhe shpallja fitues e bashkimit të operatorëve ekonomik "B" shpk & "B" shpk dhe "S.", është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", i ndryshuar, neni 63 pika 3, neni 67, Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" nenet 108-118 6.
10.1 Rekomandimi: Nga Autoriteti kontraktor dhe titullari i saj në Bashkinë Selenicë të merren masadhe t`i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi rëndësia e procesit të shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale dhe ka cënuar besushmërinë e procesit të prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.1 Nga verifikimi rezultoi se:
Nga auditimi i zhvillimit të procedurave të prokurimit publik si një nga pikat e programit të auditimit nr. 799/1 datë 02.09.2022 rezulton se Bashkia Selenicë/KVO ka kualifikuar dhe lidhur kontrata publike me OE në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor për prokurimet publike.

Rekomandimi nuk është zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit të KLSH-së konstatoi se, niveli i realizmit të investimeve të planifikuara është shumë i ulët e cila vjen nga planifikim i procedurave pa fonde në dispozicion, në fazën e hartimit dhe miratimit të buxheteve, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura *(investime/shërbime/blerje malli),* në raport me nivelin e planifikimit të të ardhurave, por mbi bazën e realizmit faktik të tyre, nivel ky i cili nuk kalon limitet e 85% për asnjërin nga vitet objekt auditimi.
Gjithashtu, bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) **gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës,** kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.
11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financë/Buxhetit Bashkia Selenicë, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe për çdo program, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

11.2 Rekomandimi: Planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizmit të të ardhurave dhe jo të planifikimit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të palikuiduara), në fund të periudhës, duke planifikuar ato shërbim dhe investime më të domosdoshme për nevojat e bashkisë Selenicë.

Menjëherë dhe në vijimësi

***11.1-11.2 Nga verifikimi rezultoi se*:**

Gjatë vitit 2021 Drejtoria e Financës ka likuiduar detyrime të prapambetura për kontrat e investimeve nga buxheti i bashkisë në vlerën 103,411,803 lekë dhe mbetet për t'u likuiduar vlera 27,872,961 lekë. Gjithashtu, likuidime janë bërë edhe për zërat e tjera të detyrimeve si për mallra dhe shërbime apo për vendimet gjyqësore të cilat janë trajtuar në mënyrë me të detajuar në pikën e programit të auditimit "Mbi zbatimin e buxhetit", rubrika "Detyrimet e prapambetura". Në fund të periudhave ushtrimore 2020-2021, Bashkia Selenicë ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në vlera relativisht të konsiderueshme, përkatësisht në fund të vitit 2020 detyrimet janë në vlerën 98,988,441 lekë, dhe në fund të vitit 2021 janë në vlerën 77,195,390 lekë nga të cilat 54,527,216 lekë detyrime nga buxheti i bashkisë dhe 22,668,174 lekë detyrime nga buxheti i shtetit. Detyrimet e prapambetura janë rregjistruar në kontabilitet si dhe janë raportuar në MFE në vlerën e saktë të tyre që rezulton nga lista analitike e detyrimeve të prapambetura që Drejtoria e Financave në Bashkinë Selenicë administron.

Rekomandimet 11.1-11.2 janë zbatuar pjesërish

12. Gjetje nga auditimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm në punën audituese të kryer në periudhën 2019 - 2020, nuk i ka plotësuar objektivat e përcaktuara nga Institiucioni dhe ka munguar vlerësimi i përgjegjshmërisë maksimale nga drejtuesit e Bashkisë. Nuk ka pasqyruar aktivitetin e drejtorive me risk të lartë si Taksat, Prokurimet,Tarifat e sherbimeve, ujitjes e kullotave dhe administrimi i lëvizjes së vlerave materiale e monetare. Kjo ka ardhur dhe nga mos vlerësimi nga drejtuesi i njësisë publike dhe mos përmbushja e angazhimeve për auditim sipas planifikimit të bërë nga pengesa burokratike e subjektive, në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore për auditimin e brendshëm.

12.1 Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryeja procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim. Njëkohësisht të paraqesë para Kryetarit të bashkisë një plan strategjik auditimi për risqet e evidentuara nga auditimi i KLSH-së dhe të thellojë auditimet në fushat me rrisk më të lartë si Taksat, Prokurimet,Tarifat e sherbimeve, ujitjes e kullotave dhe administrimi i lëvizjes së vlerave materiale e monetare (harxhimi i Naftës, etj.)

Menjëherë dhe në vijimësi

12.2 Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Selenicë në vijim të punës për rekomandimet që do lërë në subjekt të hartojë program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, si dhe nuk ka bërë kontrollin e cilësisë për çdo auditim, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Menjëherë dhe në vijimësi

***12.1-12.2 Nga verifikimi rezultoi se*:**

Njësia e Auditit të Brendshëm ka hartuar programin nr. 3492 Prot, datë 03.12.2021 me objekt "Analizën e kreditorëve dhe verifikimin e realizimit të rekomandimeve". Më datë 08.02.2022 ka hartuar raportin nr. 942 Prot, "Mbi ecurinë dhe realizimin e rekomandimeve të lëna në raportet

përfundimtare nga NJAB për vitin 2021", raport i cili është përcjellë edhe në MFE me shkresën nr. 942/1 Prot, datë 08.04.2022.
Në programin e angazhimeve të vitit 2021 nuk është planifikuar auditim në fushën e prokurime.
Është hartuar plani strategjik i subjekteve të synuara për t'u audituar për periudhën 2022-2024, si dhe është bërë vlerësimi i përgjithshëm i nivelit të riskut për subjektet për vitin 2022.

Rekomandimet 12.1-12.2 janë zbatuar pjesërisht

13. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Selenicë, në vitet 2019 dhe 2020 për llogaritë, 210 "*Toka, troje, terrene*", 211 "*Pyje Plantacione*", 212 "*Ndërtesa e Konstruksione*", 213 "*Rruge, rrjete, vepra ujore*", 214 "*Instalime teknike, makineri e pajisje*", 215 "*Mjete transporti*" dhe aktivet afatshkurtra, nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.
- Për periudhën 2019 dhe 2020 mungojnë relacionet për rezultatet e inventarëve nga krahasimi i gjendjes kontabël me gjendjen fizike si dhe kushtet e ruajtjes së aktiveve.
- Amortizimi i llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Jo-Materiale është kryer në grup aktivesh sipas llojit dhe jo për çdo aktiv në mënyrë të vecantë siç e kërkon Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2021 "Mbi menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik.
13.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Selenicë, të merren masa nga Nëpunësi Zbatues ku të krijohet e mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Brenda vitit 2021

***13.1 Nga verifikimi rezultoi se*:**
Nga Bashkia Selenicë, nuk janë marrë masa për të krijuar regjistrin e aktiveve të qëndrueshme.

Rekomandimi nuk është zbatuar

14. Gjetje nga auditimi: Komisioni për Blerjet e Vogla, për gjithë periudhën abjekt auditimi ka kryer me mangësi procedurën e blerjeve duke mos argumentuar përllogaritjen e fondit limit, nuk ka hartuar procesverbalet e hapjes dhe vlerësimit të ofertave për operatorët ekonomik deri në vendin e 10-të, nuk ka firmosur faturat e tvsh-së për blerjen e mallit apo shërbimit, nuk ka përcaktuar fondin e përllogaritur në urdhrin e prokurimit, ka kryer procedura me fonde të copëzuara. Gjithashtu, u konstatuan pagesa me urdhër shpenzimi mbi afatin 30 ditor të faturave pr mallra dhe shërbime. Të gjitha procedurat e ndjekura nga KBV, nuk janë administruar në dosje të veçanta, por mbahen nëpër librat e bankës.
14.1 Rekomandimi: Struktura e kryerjes së procedurës së Blerjeve me Vlera të Vogla në Bashkinë Selenicë :
1.Të marrë masa për administrimin e çdo procedure në dosje të veçanta.
2.Të hartojë fondin limit duke pasqyruar metodën e ndjekur dhe dokumentacionin provues.

3.Të hartojë procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave për operatorët ekonomikë të renditur.
4. Komisioni i Blerjeve të Vogla, të firmosë faturat e tvsh-së për blerjen e mallit ose shërbimit të kryer.
5. Komisioni i Blerjeve të Vogla, të përcaktojë në urdhrin e prokurimit fondin e përllogaritur.
6. Autoriteti Kontraktor, të marrë masa për planifikimin e blerjeve dhe shërbimeve, duke mos kryer copëzim të fondeve.

Menjëherë e në vijimësi

***14.1 Nga verifikimi rezultoi se*:**
Struktura e blerjeve të vogla nëpërmjet planit të buxhetit afatmesem ka bërë një planifikim racional duke hartuar në bazë të nevojave të blerjeve të vogla regjistrin përkatës në përputhje me fondet në dispozicion. Blerjet e vogla janë trajtuar më hollësisht në pikën e programit të auditimit të procedurave të prokurimit publik.

Rekomandimi është në proces

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstauar se nga Bashkia Selenicë nuk janë llogaritur e paguar drejt paga e plotë e punonjësit të Bashkisë z. L. M. i cili punon Roje e godinës së Bashkisë për periudhën dyvjeçare 01.01.2019 – 31.12.2020 në vlerën **474,600 lekë,** duke i hequr të drejtën e pagesës së punës natën (ndërkohë që dy punonjësit e tjerë janë paguar në të njëjtat kushte). Veprime këto në kundërshtim me si pagesë e papaguar në kundërshtim me Kodin e Punës në RSH Nr. 7961/1995, i ndryshuar për herë të fundit me Ligjin Nr. 136/2015, neni 80 e 81 dhe VKM nr.165, datë 02.03.2016 *"Për grupimin e njësivë të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njesive të Vetëqeverisjes vendore" ndryshuar.*
15.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore, të marë masa që të rillogarisë dhe të kryejë pagesën e punonjësit **L. M.** për vlerën e papaguar prej **474,600 lekë,** për punë të papaguar me orë nate sipas Kodit të punës në RSH.

Brenda muajit Nëntor 2021

***15.1 Nga verifikimi rezultoi se*:**
Referuar listëpagesave që administron Drejtoria e Financës është bërë likuidimi i vlerës 474,600 lekë për punonjësin L. M..

Rekomandimi është zbatuar

16. Gjetje nga auditimi. Bashkia Selenicë nuk ka zbatuar në mënyrë të plotë rekomandimet e KLSH-së të lëna në auditimin e mëparshëm të rikërkuara me shkresën nr. 390/66 prot., datë 22.10.2019. Konkretisht janë rikërkuar zbatimi i rekomandimeve për 5 masa organizative, nga të cilat 2 masa nuk janë zbatuar, 2 masa janë zbatuar plotësisht, ndërsa 1 masë është zbatuar pjesërisht.
Është rikërkuar për zbatim rekomandimi i 1 masë për shpërblim dëmi me vlerë totale 508,682 lekë, e cila është pranuar dhe zbatuar plotësisht.
Për të rritur performanëcn në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhurat e munguara) është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve për 5 masa në vlerën 595,831,697 lekë, nga të cilat: 1 masë për vlerën **582,869,000 lekë** nuk është pranuar, 3 masa në vlerën 12,962,697 lekë janë pranuar dhe nuk janë zbatuar, ndërsa 1 masë është pranuar
16.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë nëpërmjet Këshillit Bashkiak të marrë masa për analizimin dhe vlerësimin më përgjegjësi ligjore, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës dhe brenda kopetencave detyrimet e lëna duke argumentuar ato rekomandime që nuk

ka fushë zbatimi dhe pjesa tjetër të kërkohet zbatimi i plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara.
Të hartohet plan pune i veçantë e të marren të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre.

Brenda muajit Dhjetor 2021

16.1 Nga verifikimi rezultoi se:
Nuk janë marrë masa për të nxjerrë përgjegjësitë lidhur me mos zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e KLSH dhe të pa zbatuara si dhe nuk është raportuar në Këshillin Bashkiak lidhur me statusin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së. Rekomandimi për marrjen e masave për arkëtimin e vlerës 582,869,000 lekë nuk është pranuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

B. Masa për Shpërblim Dëmi
KLSH ka kërkuar që nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Selenicë), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe nga Nëpunësi Zbatues të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **6,029,810 lekë** për **15 persona,** si më poshtë:
1. Gjetje nga auditimi. Sipas dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronës Publike, Lejeve dhe licencave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Selenicë dhe në Njësitë Administrative në vartësi, na u vunë në dispozicion 5 dosje të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, ku rezultoi: Subjektet "D. Gj." shpk me afat autorizimi 5 vjecarë nga data 24.05.2019-23.05.2024, subjekti "P." shpk me nipt K. me afat nga 31.07.2019-30.07.2024. Subjekti tatimpagues "T." shpk me nipt L, subjekti "Xh. G." shpk me nipt L, dhe subjekti "M. O." me nipt L nuk janë paisur me (autorizim) 5 vjeçarë.
1.1 Rekomandimi: Bashkia Selenicë të marrë masa dhe të zbatojë procedurat administrative e ligjore për kërkimin e detyrimit në vlerën **4,500,000 lekë nga subjektet:** "D. Gj." SHPK me nipt, subjekti "P." shpk me nipt K, subjekti "T." Shpk me nipt L, subjekti "Xh. G." SHPK me nipt L, dhe subjekti "M. O." me nipt L.

Brenda muajit Dhjetor 2021

1.1 Nga verifikimi rezultoi se:
Gjatë vitit 2021 nga subjekti "P." SHPK është paguar vlera 200,000 lekë dhe nga subjekti D. Gj. SHPK është paguar vlera 150,000 lekë. Nga këto dy subjekte mbetet ende për t'u paguar vlera 400,000 lekë nga P. SHPK dhe vlera 350,000 nga "D. Gj." SHPK. Bashkia Selenicë me subjektet "T." SHPK, "Xh. G." SHPK dhe "M. O." ka nënshkruar akmarrëveshjet për pagesën me këste të detyrimit për autorizimet (Akt marrëveshja nr. 1160/1 Prot, datë 04.05.2022, nr. 1097/1 Prot. Datë 28.04.2022, nr. 187/1 Prot. Datë 08.06.2022) si dhe është pajisur me autorizim një vjeçar 06.05.2022-05.05.2023, subjekti "M. O." dhe kanë kryer pagesa të pjesëshme nga 100,000 lekë secili. Deri më tani është arkëtuar në total vlera 650,000 lekë. Më gjerësisht kjo problematikë është trajtuar edhe në çështjen e të ardhurave si pjesë e pikës 2 të programit të auditimit.

Rekomandimi është në proces

2. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi rezultoi se, nuk justifikohet përdorimi i vlerës ***863,952 lekë,*** *si vlerë e përfituar padrejtësisht nga subjekti A. shpk për blerje mallra e materiale për riparimin Ura Treblovë, dhe dokumentacioni i hartuar për këtë shpenzim nuk është i plotë dhe nuk e justifikon e vërteton shërbimin e kryer dhe procedurë formale blerje kompjutera 4 copë.* Mangësitë dhe shkeljet e trajtuara dhe që janë në kundërshtim të hapur me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, kanë sjellë pasojë mos respektimin e ligjit dhe shkelje financiare me pasoja negative në buxhetin e Bashkisë Selenicë e shpërdorim i parasë publike në vlerë ***963,952 lekë*** *(100,000 + 863,952 lekë,* vlerë kjo që duhet të arkëtohet nga personat përgjegjës z. L. H., K. B., A. M., M. I., A. V. dhe L. B. magaziniere.

2.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Selenicë duhet të nxirret përgjegjësia dhë të kërkohet arkëtimi i dëmit shkaktuar në mënyrë përpjestimore shuma ***963,952 lekë*** (100,000 + 863,952) lekë, **vlerë** kjo që duhet të arkëtohet nga personat përgjegjës, përkatësisht: **L. H. vlerë 160,659 lekë, K. B. vlerë 160,659 lekë, A. M. vlerë 160,659 lekë, M. H. vlerë 160,659 lekë, A. V. vlerë 160,659 lekë dhe L. B. vlerë 160,659 lekë.**

Brenda muajit Mars 2022

2.1 Nga verifikimi rezultoi se:

Me shkresën nr. 541 Prot. datë 23.02.2022 është bërë njoftimi i punonjësve L. H., A. M., L. B., M. H., K. B. dhe A. V. lidhur me vlerën e dëmit që duhet të paguajnë ndaj Bashkisë Selenicë. Rezulton se këto punonjës më datë 24.03.2022 kanë bërë kërkesë padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ndaj Bashkisë Selenicë për shfuqizimin e aktit administrativ të nxjerrë nga Bashkia Selenicë që i njofton për kthimin e vlerës ***160,659 lekë secili.***

Rekomandimi është në proces

3. **Gjetje nga auditimi**. Nga auditimi rezultoi se në përdorimin e mjetit H. me targë A (benzinë) dispozicion të Policisë bashkiake dhe lëvizjet e bëra në teritorin e bashkisë nuk janë dokumentuar me fletë udhëtimi, pasqyre llogaritje, kuponët e lëshuar nga subjekti furnizues me karburant, mënyrën e administrimit, llogaritjes dhe mënyra e konsumit nga mjeti i përdorur për përiudhën 01.01.2019 deri me 31.12.2020, që është 100% e materialitetit të kësaj ngjarje ekonomike(pergatitur dhe pasqyra e konsumit dhe e identifikimit të personave konkretë përgjegjës që kanë urdhëruar dhe personave përgjegjës materialisht që kanë konsumuar karburantin dhe nuk kanë dokumentuar atë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi(të trajtuara gjërësisht në mëposhtë), konkretisht;

1.z. F.V. ish kryeinspektor i Policisë Bashkiake për periudhën nga data 01.01.2019 deri më 31.01.2020 për vlerën *317,761 lekë* (*1970 litra x 161.3 lekë/litra),*

2. z. S. H. ish Drejtor i Territorit për periudhën nga data 01.02.2020 deri më 28.02.2020 për vlerën *13,857 lekë (101litra x 137.2 lekë/litra)* ,

3.z. M. B. me detyrë shofer administrate për periudhën nga data 01.03.2020 deri më 30.04.2020 ish kryeinspektor i Policisë Bashkiake për vlerën *36,358 lekë (265 litra x 137.2 lekë/litra),*

4. z. M. M. kryeinspektor i Policisë Bashkiake për periudhën nga data 01.05.2020 deri më 31.12.2020, për vlerën *196,882 lekë(1435litra x 137.2 lekë/litra).*

3.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës të marrin masa:

a. Për të krijuar marrëdhënie ligjore të drejta me punonjësit e policisë bashkiake me çdo marrëdhënie për automjete e mjete transporti dhe të hartojnë dokumentacionin tip siç e kërkon dispozita ligjore, të llogarisin normativat e konsumit litra|100 km dhe të kryhen llogaritjet mujore sipas normativave të miratuara ligjërisht, pra sipas librezës mjetit ku përcaktohet normativat e harxhimit karburantit (kur janë mjete të reja).

b. Në mungesë të mjeteve nga Bashkia Selenicë, të krijohen marrëdhenie të drejta ligjore me personat nënpunës që përdorin mjetet e veta, duke bashkëlidhur leje Qarkullimit të mjetit për vënien në dispozicion të mjetit me ose pa pagesë, proces verbalin e llogaritjes së normës së harxhimit të karburantit për njësi matëse litra/ 100km, litra/ore, litra/ ton/ km, etj., e miratimin si procedure e procese në Këshillin Bashkiak.
c.Të merren masa për zbatimin e procedurave ligjore dhe të kërkohet zhdëmtimi i vlerës së karburantit të pajustifikuar me dokumente për këta persona:
1. z. F.V. ish kryeinspektor i Policisë Bashkiake për periudhën nga data 01.01.2019 deri më 31.01.2020 për vlerën *317,761 lekë* (*1970 litra x 161.3 lekë/litra),*
2. z. S. H. ish Drejtor i Territorit për periudhën nga data 01.02.2020 deri më 28.02.2020 për vlerën *13,857 lekë(101litra x 137.2 lekë/litra),*
3.z. M. B. me detyrë shofer administrate për periudhën nga data 01.03.2020 deri më 30.04.2020 ish kryeinspektor i Policisë Bashkiake për vlerën *36,358 lekë (265 litra x 137.2 lekë/litra),*
4. z. M. M. kryeinspektor i Policisë Bashkiake për periudhën nga data 01.05.2020 deri deri më 31.12.2020, për vlerën *196,882 lekë (1435litra x 137.2 lekë/litra).*

Brenda muajit Mars 2022

3.1 Nga verifikimi rezultoi se:
Titullari i Bashkisë Selenicë me Urdhrin nr. 93 datë 19.07.2021 "Për procedurën e konsumit të karburantit nga mjetet e bashkisë" ka urdhëruar të hartohen normativat e karburantit për çdo mjet nga një komision teknik, ndërsa me Urdhrin nr. 94 datë 26.07.2021 është ngritur grupi i punës për llogaritjen e normës së harxhimit të karburantit për mjetet e administratës së bashkisë. Me shkresën nr. 541 Prot. datë 23.02.2022 është bërë njoftimi i punonjësve M. M. dhe M. B. lidhur me vlerën e dëmit që duhet të paguajnë ndaj Bashkisë Selenicë. Rezulton se këto punonjës më datë 24.03.2022 kanë bërë kërkesë padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ndaj Bashkisë Selenicë për shfuqizimin e aktit administrativ të nxjerrë nga Bashkia Selenicë që i njofton për kthimin e vlerës përkatësisht M. B. ***36,358 lekë*** *dhe M. M.* ***196,882 lekë****. Për dy punonjësit e tjerë F.V. dhe S. H. nuk është marrë asnjë masë.*

Rekomandimi është në proces

C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me Ekonomicitet, Eficence dhe Efektivitet të fondeve publike.
1. Gjetje nga auditimi: Në prokurimin me objekt "Blerje karburant ", viti 2020, kanë marrë pjesë vetëm 2 Operatorë Ekonomikë dhe operatori "F." SHPK, me Nipt J, me ofertën marzh fitimi 10.9 % për naftë dhe benzinë, nuk ka plotësuar pikën 2.3 Kapaciteti Teknik, për "Qendër gazoili me kartë elektronike jo më larg se 23 km nga qendra e qytetit Selenicë ose qendër karburanti me kartë elektronike me kontratë brenda kësaj rrezeje për të qenë në funksion të këtij institucioni" dhe është shpallur **fitues shoqëria "S. A." SHPK me ofertën me marzh fitimi më të lartë dhe konkretisht 13 % si për naftë dhe për benzinë, e cila plotëson kushtin e sipërcituar.**
Sa më sipër, është në kundërshtim me Nenin 27, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, në kundërshtim me Neni 10 të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", ndryshuar, me Nenin 46, pika 1, shkronja (b), të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, me Nenin 1 pika 2 shkronja (c) dhe (ç), të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.
Vendosja e një kërkesë të veçantë teknike "të dallueshme", e cila nuk ka lidhje me natyrën dhe kërkesat për zbatimin e prokurimit, ka sjellë si pasojë kufizimin e pjesëmarrjes në tender dhe mungesën e konkurencës së nevojshme në procesin e tenderimit. për shkak të një kërkesë të

veçantë teknike "të dallueshme" me një **efekt negativ prej 96,710.52 lekë** për periudhën deri në 31 Dhjetor 2020, duke e krahasuar me marzhin e fitimit 10.9 % për të njëjtën sasi karburanti.
1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të autoritetit kontraktor të marrë masa dhe të vlerësojë efektin negativ të krijuar nga kjo procedurë prokurimi **96,710.52 lekë** dhe të nxjerë përgjegjësinë për anëtarët e KVO-së, si dhe të marrë masa që shkelje të kësaj natyre mos të përsëriten.

Brenda muajit Dhjetor 2021 dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit të ndërtimit të ujësjellësit Armen Kotë e Selenicë është konstatuar se në preventivin e punimeve të fshatit Kotë, është përcaktuar , Pika 1 "Shpim pusi" h/gjeologjik q=15 litra sekondë, në **vlerën 1,020,568 lekë**, vlerë kjo që trajtohet si vlerë e përdorur pa efektivitet, pasi nuk vërtetohet ky shërbim sipas DST, në kërkesat për kualifikim, paraqitura në tender nuk është përcaktuar që operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi një sonde me kapacitet ngritës, me peshë tërheqëse të përcaktuar, e vërtetuar kjo në certifikatën e origjinës, Sondat duhet të jenë Hidraulike, etj.
Veprime të cilat janë në kundërshtim me nenin 46, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2009 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26, pika 5.
2.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të marrë masa dhe të vlerësojë vlerën e punimeve që duhet të ishin kryer dhe rezultojnë si përdorim i fondeve publike pa efektivitet në vlerën **1,020,568 lekë** hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë. Kërkesat/specifikimet teknike duhet të jenë të shkruara në mënyrë të tillë që të argumentohet nevoja që dikton vendosjen e këtyre kritereve, duke parandaluar në këtë mënyrë para përzgjedhjen paraprake të kandidatit fitues, në zbatim me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Për procedurat e prokurimit me objekt:
-"***Ndërtim Ure në fshatin Mallkeq - Lezhan dhe rikonstruksion i pasarelës fshati Vodic***ë" rezulton se nuk janë zbatuar kërkesat ligjore nga KVO dhe ka skualifikuar pa arsye OE "Sh." SHPK, i cili ka përmbushur kriterin e vlerësimit si oferta me cmimin më të ulët e po ashtu dhe kushtet e tjera të përcaktuara në DST. Megjithëse nuk ka pasur ankesa nga ky OE, Komisioni Vlerësimit të Ofertave me skualifikimin e OE "Sh." pa arsye thelbësore të cilat nuk do cënonin zbatimin e kësaj kontrate, ka krijuar **efekte negative në buxhetin e Bashkisë në shumën 376,900** lekë**.**
-"*Blerje karburant (naftë, vaj Benzine)*" me procedurë prokurimi për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, është pranuar **çmimi më i ulët.**
Njoftimi i fituesit, është publikuar në datën 15.03.2020, dhe "F."shpk, me nipt J, është identifikuar si oferta e suksesshme. KVO ka skualifikuar OE "S. A." sh.p.k, me nipt. K, pa ndonjë arsye thelbësore të cilat nuk do cënonin zbatimin e kontratës pasi ky operator është Kontraktues me Bashkinë Selenicë po për të njëjtin objekt si i vitit 2019. Ky OE ka paraqitur dhe ofertën më të favorshme ekonomike duke u bazuar në marzhin më të ulët të fitimit
Për pasojë ka sjellë dhe efekte negative në buxhetin e Bashkisë në shumën **1,140,750 lekë,** efekt i shkaktuar nga menaxhimi jo me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet i fondeve publike.Këto veprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, udhëzimeve të Agjensisë së Prokurimit Publik.

-Përdorimi i fondeve publike jo me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në shumën **1,140,750 +376,900 = 1,517,650 lekë në total**.

3.1 Rekomandimi: Bashkia Selenicë, për çdo procedurë prokurimi të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitetit, eficensës dhe efektivitetit, bazuar në kritere të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar kështu kontrata me çmimin më të ulët dhe duke kursyer fondet e Buxhetit të Bashkisë, njëkohësisht të analizojë procedurën dhe të nxjerrë përgjegjësinë e anëtarëve të KVO-së.

Brenda muajit Dhjetor dhe vijimësi

1.1-2.1-3.1 Nga verifikimi rezultoi se:

Nga ana e Titullarit të Bashkisë Selenicë nuk janë marrë masa për të nxjerrë përgjegjësitë lidhur me efektet negative të krijuar në administrimin e fondeve publike në procedurat e prokurimit . Veprimi i vetëm që është marrë ka qenë ndryshimi i KVO-së. Por nga auditimi i procedurave të prokurimit si një nga pikat e programit të auditimit nr. 799/1 Prot. datë 02.09.2022 rezulton që kjo shkelje të jetë prezente në procedura të ndryshme.

Rekomandimi nuk është zbatuar

D. Masa Disiplinore

D.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të nenit 58, "llojet e masave disiplinore" të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015,datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", **i rekomandojmë** Kryetarit së Bashkisë Selenicë, që të ngrejë grup pune dhe të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë individuale për çdo punonjës administrate të trajtuar gjërësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në përfundim: Ti kërkojë Komisionit Disiplinor që të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore: **për punonjës** si më poshtë:

Nga "***Vërejtje me paralajmërim***" deri në "***Largim nga shërbimi civil***", **për punonjësit e mëposhtëm:**

1. Z. L.H., me detyrë Drejtor i Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore, për veprime dhe mosveprime të kryera gjatë përmbushjes së detyrës së ngarkuar në cilësinë e nënpunësit zbatues, për mosorganizimin dhe mos funksionimin e kontrollit të brendshëm, dokumentimin ligjor të vlerave materiale e monetare, si karburant, mallra dhe materiale ndertimi, mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në administrimin e pasurisë publike, , mos arkëtim të ardhurash në vlera të konsiderueshme nga përdorimi i pasurisë publike. Për mos kryerjen e detyrës si antar i KVO në disa procedura prokurimi, mos regjistrim e vleresim i aseteve të tarnsferuara Bashkisë Selenicë, etj.

Në cilësinë e Kryetarit të KVO-së në procedurën e prokurimit **"Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Selenicë, Kote dhe Armen, Bashkia Selenicë" me fond limit (pa tvsh) në vlerë 79,476,130** lekë, për shkelje në procedurën e prokurimit, mos vlerësim objektiv të dokumentacionit të paraqitur nga OE, pranuar dokumente me skadencë vlefshmërie dhe veçanërisht në shpalljen e fituesit dhe mungesë konkurence.

2. Z. K. S. me detyrë Drejtor i Shërbimeve Publike, për mos kryerje të detyrës në administrimin dhe përdorimin e vlerave materiale (karburantit) , moszbatim ligji dhe lejimi i shpërdorimeve të

karburantit dhe përdorimi pa dokumente ligjore dhe vërtetues. Pa hartuar kontrata të lidhur nga Bashkia me poseduesin e mjetit dhe nuk ka proces verbal të llogaritjes së normës harxhimit të karburantit, përgjegjësi kjo e personave të ngarkuar për menaxhimin e karburantit dhe K. S. Drejtor i Sherbimeve Publike. Nuk është vlerësuar e dokumentuar sipas ligjit konsumi i karburantit duke lënë hapësira për shpërdorime materiale e financiare, dhe kryer shkelje të disiplinës financiare me pasoja negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën 27,967,430 lekë .

3. Z. I. D. me detyrë zv/kryetar i Bashkisë Selenicë, për mos kryerjen e detyrës ngarkuar dhe hartimin e dokumenteve si urdhra pune, për mjetet e transportit, makineri, etj., në kundershtim me ligjin dhe me mungesë përgjegjësie, urdhëruar përdorim karburanti pa zbatuar procedurat ligjore dhe hartuar dokumentacionin e nevojshëm. Nuk është vlerësuar e dokumentuar sipas ligjit, konsumi i karburantit duke lënë hapësira për shpërdorime materiale e financiare, dhe kryer shkelje të disiplinës financiare me pasoja negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën 27,967,430 lekë .

4. Z. K. B., me detyrë Drejtor i Planifikimit të Territorit, Burimeve Natyrore, Mjedisit, Projekteve dhe Investimeve, për mos kryerjen e detyrës ngarkuar dhe hartimin e dokumenteve teknik në kundërshtim me aktet nënligjore, për investime e shërbime të ndryshme , si urdhera pune punimesh e perdorim mjete transporti e makineri, pa kryer matjet e duhura.Për hartimin e dokumenteve fiktivë për "Blerje materiale në Ura Treblovë" me fond të përdorur 1,000,000 lekë, vlerë e cila nga grupi i auditimit është konsideruar e argumentuar si dëm ekonomik dhe kemi kërkuar zhdëmtimin nga personat përgjegjës. Për moskryerje procedura prokurimi me leje për shpim pusi, rrjetit Ujësjellësit e rrugëve, pjesëmarrje në procedura prokurimi të cilat kanë rezultuar me shkelje ligjore e shmangje konkurence, etj.

Në kundërshtim të hapur me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, ka sjellë pasojë mos respektimin e ligjit dhe shkelje financiare me pasoja negative në buxhetin e Bashkisë Selenicë në vlerën totale prej ***13,806,503 lekë***, ku nga kjo shpërdorim i parasë publike në vlerë ***963,952 lekë*** *(100,000 + 863,952 lekë),* ***vlerë kjo që duhet të arkëtohet nga personat përgjegjës, ku dhe ju jeni ngarkuar për zhdëmtim.***

Në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit **"Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Selenicë, Kote dhe Armen, Bashkia Selenicë" me fond limit (pa tvsh) në vlerë 79,476,130** lekë, për shkelje të rënda në procedurën e prokurimit, mos vlerësim objektiv të dokumentacionit të paraqitur nga OE, pranuar dokumente me skadencë vlefshmërie dhe veçanërisht në shpalljen e fituesit dhe mungesë konkurence.

5. Z. P. A. me detyrë përgjegjës i sektorit të pyjeve e kullotave, në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit **Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Selenicë, Kote dhe Armen, Bashkia Selenicë" me fond limit (pa tvsh) në vlerë 79,476,130** lekë, për shkelje të rënda në procedurën e prokurimit, mos vlerësim objektiv të dokumentacionit të paraqitur nga OE, pranuar dokumente me skadencë vlefshmërie dhe veçanërisht në shpalljen e fituesit dhe mungesë konkurence.

6. Z. M. M. kryeinspektor i Policisë Bashkiake për periudhën nga data 01.05.2020 deri më 31.12.2020, ka tërhequr e konsumuar benzinë në sasinë 1435 litra naftë me vlerë ***196,882 lekë*** *(1435litra x 137.2 lekë/litra)* dhe paraqitur 23910 km të përshkuara (sipas shënimeve ne fletë udhëtimet e paraqitura), vlerë e cila i është ngarkuar për zhdëmtim.

D.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", shkronjat "e" dhe "ç" të nenit 1, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144

të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe **të nenit 13** të kontratës individuale të punës, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë,** që bazuar në performancën e punonjësit dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, **për 4 punonjës si më poshtë:**
Nga *"Vërejtje"* deri në *"Paralajmërim për largim nga puna*" për:
1. Z. M. H., me detyrë jurist, në cilësinë e anëtarit të komisionit për hartimin e DST dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla dhe komisionit marrjes në dorëzim në procedurën e blerjeve të vogla .
2. Zj. A. M. me detyrë përgjegjëse e sektorit të financës, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla dhe komisionit marrjes në dorëzim në procedurën e blerjeve të vogla .
3. Z. A. V., Topograf në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla dhe komisionit marrjes në dorëzim, për: Mangësitë dhe shkeljet e trajtuara në këtë Akt konstatim dhe që janë në kundërshtim të hapur me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, kanë sjellë pasojë mos respektimin e ligjit dhe shkelje financiare me pasoja negative në buxhetin e Bashkisë selenicë në vlerën totale prej ***13,806,503 lekë***, ku nga kjo shpërdorim i parasë publike në vlerë ***963,952 lekë*** *(100,000 + 863,952) lekë,* ***vlerë kjo që duhet të arkëtohet nga personat përgjegjës.***
4. Zj. L. B. me detyrë magaziniere , për paaftësi të theksuar në punë, mungesë njohje të legjislacionit të administrimit, ruajtjes dhe lëvizjes së vlerave materiale dhe për përgatitje dokumentavioni fiktiv si në dokumentimin e lëvizjes së karburantit, por dhe në dokumentimin e ruajtjen e mallrave dhe materialeve të ndërtimit, duke u bërë pjes ë e shp1rdorimit të fondeve të bashkisë. Mos respektimin e ligjit dhe shkelje financiare me pasoja negative në buxhetin e Bashkisë selenicë në vlerën totale prej ***13,806,503 lekë***, ku nga kjo shpërdorim i parasë publike në vlerë ***963,952 lekë*** *(100,000 + 863,952) lekë,* ***vlerë kjo që duhet të arkëtohet nga personat përgjegjës.***

D.3. Për punonjësit që aktualisht rezultojnë në marrëdhënie pune me Bashkinë Selenicë, të cilët edhe pse janë identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit për disa të meta e mangësi që janë larguar dhe nuk kemi adresim institucional, ku do të propozonim masë disiplinore **"Vërejtje me paralajmërim**" konsiderojmë të ezauruar për:
1. Z. Xh. M. agronom, në cilësinë e ish anëtar i KVO-së;
2. Z. A. I., kryetar i KVO-së;
3. Z. K. B., anëtar i KVO-së, për shkelje në procedurën e prokurimit, mos vlerësim objektiv të dokumentacionit të paraqitur nga OE, pranuar dokumente me skadencë vlefshmërie dhe veçanërisht në shpalljen e fituesit dhe mungesë konkurence.
4. Z. P. Sh. ish kryetar i Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për shkelje të konstatuara në procedurën e prokurimit publik në tenderat e vitit 2019 dhe për mangësi e shkelje në përdorimin e karburantit dhe kryerjes së shërbimeve, mungesë të ardhurash , etj.
5. Zj. Gj. Xh. me detyrë Drejtor i Drejtorisë e të Ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Licensave, aktualisht ka dalë në pension pleqërie, për mangësitë e konstatuara në mos realizimin e të ardhurave, trajtuar hollësisht në pikën 2.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.
6. Z. F. V. ish kryeinspektor i Policisë Bashkiake për periudhën nga data 01.01.2019 deri më 31.01.2020 tërhequr e konsumuar benzinë në sasinë 1970 litra naftë me vlerë ***317,761 lekë***(*1970 litra x 161.3 lekë/litra)* dhe paraqitur 32833 km të përshkuara(sipas shënimeve ne fletë udhëtimet e paraqitura),

7. **Z. S. H. ish Drejtor i Territorit** për periudhën nga data 01.02.2020 deri më 28.02.2020 tërhequr e konsumuar benzinë në sasinë 101 litra me vlerë ***13,857 lekë****(101litra x 137.2 lekë/litra)* dhe paraqitur 1683 km të përshkuara(sipas shënimeve ne fletë udhëtimet e paraqitura),
8. Z. M. B. me detyrë shofer administrate për periudhën nga data 01.03.2020 deri më 30.04.2020 ish kryeinspektor i Policisë Bashkiake tërhequr e konsumuar naftë në sasinë 265 litra naftë me vlerë ***36,358 lekë*** *(265 litra x 137.2 lekë/litra)* dhe paraqitur 4416 km të përshkuara(sipas shënimeve ne fletë udhëtimet e paraqitura).

D.4. Për punonjësit e identifikuar me përgjegjësi për shkeljet e konstatuara, Kryetari i Bashkisë Selenicë, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:
a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.
b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

D.1-D.2-D.4 Nga verifikimi rezultoi se:
Janë ngritur Komisionet Disiplinore me urdhrat nr. 40, 41, 42, 43, datë 11.02.2022 dhe urdhrat nr. 55 datë 07.02.2022, nr. 104 datë 27.06.2022, për fillimin e procedurave disiplinore për punonjësit K. S., A. M., L. H., K. B., M. M.. Nga Komisionet Disiplinore janë marrë vendimet nr. 581 Prot. datë 25.02.2022, nr. 580 Prot. datë 25.02.2022, nr. 579 Prot. datë 25.02.2022, nr. 578 Prot. datë 25.02.2022, ku ndaj punonjësve L. H., A. M., K. B. dhe K. S. Komisioni ka vendosur mos marrjen e masave disiplinore. Këto vendime nuk përmbajnë asnjë analizë të shkeljeve të konstatuara nga auditimi i KLSH-së si dhe nuk është argumentuar vendimmarrja për mos dhënie mase disiplinore ndaj punonjësve. Ndërsa rezulton se nuk janë marrë masa për punonjësit, I. D., P. A., M. M., M. H., A. V. dhe L. B., si dhe nuk është njoftuar DAP për rregjistrimin e masave disiplinore.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

Në përfundim rezulton se:
- **<u>Janë zbatuar</u> vetëm 2 rekomandime organizative**, përkatësisht me numër 5.1 dhe 15.1;
- **<u>Janë zbatuar pjesërisht</u> 7 rekomandime organizative**, përkatësisht me numër 1.1, 1.2, 6.1, 11.1, 11.2, 12.1, 12.2 si dhe **rekomandimet për masat disiplinore** D.1, D.2, D.4.
- **<u>Nuk janë zbatuar</u> 10 rekomandime organizative**, përkatësisht me numër 3.1, 3.2, 4.1, 7.1, 7.2, 8.1, 9.1, 10.1, 13.1, 16.1 si dhe **3 rekomandimet për eleminimin e efekteve negative** të konstatuara në administrimin e fondeve publike, 1.1, 2.1, 3.1.
- **<u>Janë në proces zbatimi</u> 1 rekomandim organizativ**, 14.1 dhe **3 rekomandime për shpërblim dëmi në vlerën 6,029,810**, 1.1, 1.2, 1.3.

Tabela nr.2.5/1: Përmbledhëse e zbatimit të rekomandimeve

Lloji i rekomandimeve	Rekomandime të dhëna	Vlera	Rekomandime të pranuara						Pa pranuar
			Zbatuar plotësisht	Vlera	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar	Vlera	
Masa organizative	**20**		**2**	**.....**	**7**	**1**	**10**	**.....**	**.....**

Masa shpërblim dëmi	**3**	**6,029,810**	**.....**	**.....**	**.....**	**3**	**.....**	**6,029,810**	**.....**
Masa për eliminimin e efekteve negative	**3**	**2,634,928**	**.....**	**.....**	**.....**	**.....**	**3**	**2,634,928**	**.....**
Masa disiplinore	**10 (6 SHC+4 KP)**		**4**	**.....**	**.....**	**.....**	**6**	**.....**	**.....**

Punoi: Grupi i auditimit

Titulli i Gjetjes 36: *Mos zbatim i rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit në KLSH.*

Situata: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nuk janë zbatuar 10 rekomandime organizative, përkatësisht me numër 3.1, 3.2, 4.1, 7.1, 7.2, 8.1, 9.1, 10.1, 13.1, 16.1 si dhe 3 rekomandimet për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike, 1.1, 2.1, 3.1.

Periudha nga auditimi në auditim është një vit dhe të gjitha rekomandimet e lëna nga auditimi i fundit paraqesin çështje të cilat janë trajtuar edhe në auditimin e kryer referuar programit aktual të auditimit. Rekomandimet e lëna nga auditimi i fundit që rezultojnë të pazbatuara janë problematika në vijimësi në aktivitetin e Bashkisë Selenicë dhe janë përfshirë në auditimin e secilës pikë të programit aktual të auditimit. Si rrjedhojë zbatimi i këtyre rekomandimeve nuk mund të kërkohet më vete kur situatat janë të njëjta apo të ngjashme me ato të konstatuara gjatë auditimit aktual, të cilësuara në gjetjet aktuale dhe për të cilat janë dhënë rekomandimet përkatëse.

Rekomandimet organizative të pa zbatuara që nuk rikërkohet zbatimi i tyre pasi janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual janë:

- **3.1** lidhur me rishikimet buxhetore;
- **3.2** lidhur me planifikimin e të ardhurave mbi baza reale dhe një përdorim efiçent i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta;
- **4.1** lidhur me kontabilizimin e veprimeve në momentin e mbërritjes së faturës;
- **7.1** lidhur me kontabilizimin e detyrimeve;
- **7.2** lidhur me realizimin e të ardhurave;
- **8.1** lidhur me analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për ndërtimin pa leje të rikonstruksionit të rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Selenicë, Kote dhe Armen;
- **9.1** lidhur me hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë;
- **10.1** lidhur me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik;
- **13.1** lidhur me krijimin e regjistrit të aktiveve;
- **16.1** lidhur me nxjerrjen e përgjegjësive për rekomandimet e lëna në auditimin e parafundit në Bashkinë Selenicë si dhe për marrjen e masave për arkëtimin e vlerës 582,869,000 lekë rekomandim i cili nuk është pranuar nga subjekti(viti 2019).

Rekomandimet për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike të pa zbatuara që nuk rikërkohet zbatimi i tyre pasi janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual janë:

- **1.1** lidhur me vlerësimin e efekteve negative të ardhura nga procedura e prokurimit "Blerje karburanti";
- **2.1** lidhur me vlerësimin e efekteve negative në procedurën e ndërtimit të ujësjellësit Armen Kotë e Selenicë si dhe hartimi i kërkesa të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike;
- **3.1** Bashkia Selenicë, për çdo procedurë prokurimi të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitetit, eficensës dhe efektivitetit, bazuar në kritere të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë.

Rekomandimet të cilat i rikërkohen për zbatim Bashkisë Selenicë në përfundim të auditimit të kësaj pike të programit të auditimit janë:

Rekomandimi Organizativ 8.1: Nga Këshilli Bashkiak të analizohet dhe të dalë përgjegjësia për ndërtimin pa leje të rikonstruksionit të rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Selenicë, Kote dhe Armen, si dhe shpimi i pusit gjeologjik në fshatin Kotë, kryer pa leje nga organet e menaxhimit të burimeve ujore dhe të merren masa për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Rekomandimet për shpërblim dëmi:

- **3.1** Të merren masa për zbatimin e procedurave ligjore dhe të kërkohet zhdëmtimi i vlerës së karburantit të pajustifikuar me dokumente për këta persona:

1. F. V. ish kryeinspektor i Policisë Bashkiake për periudhën nga data 01.01.2019 deri më 31.01.2020 për vlerën *317,761 lekë;*

2. S. H. ish Drejtor i Territorit për periudhën nga data 01.02.2020 deri më 28.02.2020 për vlerën *13,857 lekë.*

Për personat e tjerë të kërkuar në rekomandime procedurat janë në proces pasi ato kanë paraqitur kërkesë padi në gjykatë ndaj Bashkisë Selenicë

Rekomandimi masa disiplinore D.1-D.2-D.4 Bashkia Selenicë të marrë masat që të njoftojë Departamentin e Administratës Publike lidhur me marrjen e masave disiplinore për nëpunësit e bashkisë referuar shkeljeve të konstatuara nga auditimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil.

Kriteri: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit", neni 15, germa j dhe neni 30 pika 2.

Ndikimi: Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit ka sjellë që strukturat e Bashkisë Selenicë në fusha dhe aspekte të caktuara vijojnë veprimtarinë në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

Shkaku: Mos angazhim sa duhet i strukturave të Bashkisë Selenicë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit që rezultojnë të pa zbatuara ende si vijon:

Rekomandimi Organizativ 8.1: Nga Këshilli Bashkiak të analizohet dhe të dalë përgjegjësia për ndërtimin pa leje të rikonstruksionit të rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Selenicë, Kote dhe Armen, si dhe shpimi i pusit gjeologjik në fshatin Kotë, kryer pa leje nga organet e menaxhimit të burimeve ujore dhe të merren masa për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Rekomandimet për shpërblim dëmi:

- **3.1** Të merren masa për zbatimin e procedurave ligjore dhe të kërkohet zhdëmtimi i vlerës së karburantit të pajustifikuar me dokumente për këta persona:

1. F. V. ish kryeinspektor i Policisë Bashkiake për periudhën nga data 01.01.2019 deri më 31.01.2020 për vlerën *317,761 lekë;*

2. S. H. ish Drejtor i Territorit për periudhën nga data 01.02.2020 deri më 28.02.2020 për vlerën *13,857 lekë.*

Rekomandimi masa disiplinore D.1-D.2-D.4 Bashkia Selenicë të marrë masat që të njoftojë Departamentin e Administratës Publike lidhur me marrjen e masave disiplinore për nëpunësit e bashkisë referuar shkeljeve të konstatuara nga auditimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil.

2.6 Çështje të lëna për trajtim referuar Vendimit nr. 177, datë 20.10.2021 të Kryetarit të KLSH-së, mbi administrimin e aseteve të Bashkisë Selenicë.

2.6.1 Mbi administrimin e aseteve të Bashkisë Selenicë

Titulli i gjetjes 37: *Mos inventarizim apo përditësuar i pronave të paluajtshme në Bashkinë Selenicë.*

Situata: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga strukturat e Bashkisë Selenicë rezulton se, Bashkia Selenicë nuk ka një regjistër në nivel bashkie për të gjitha asetet që ajo zotëron (*trajtuar më gjerësisht në pikën e programit që auditon Pasqyrat Financiare*).

Aktualisht nga strukturat e bashkisë administrohen lista të plota apo të pjesshme të pronave që ka bashkia sikurse janë:

- Lista e pronave të paluajtshme të NJA Selenicë, të transferuara me VKM nr. 195, datë 06.03.2013 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Selenicë, të Qarkut Vlorë". Pronat që tranferohen janë 109, të klasifikuara në 11 kategori sikurse janë: Në përdorim - Prona të lira dhe hapësira të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji; Në pronësi - Infrastrukturë rruge vendore, lulishte, sheshe dhe shërbime publike, Shërbime funerale, Prona në fushën e mbrojtjes civile, prona për funksione të shërbimit social, Prona social-kulturore dhe sportive, Prona për zhvillimin ekonomik, për shëndetin publik, për realizimin e programeve arsimore, Prona në fushën e bujqësisë tokë bujqësore dhe jo bujqësore, Prona në fushën e ujësjellës kanalizimeve.
- Lista e pronave të paluajtshme të NJA Vllahinë e cila përmban 826 prona.
- Lista e pyjeve dhe kullotave të transferuara me VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive", ndryshuar me VKM nr. 684 datë 02.09.2020 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike" ku numri i pronave pyje dhe kullota që ka Bashkia Selenicë është 485, me sipërfaqe totale 26,899.51 ha.

Nga auditimi rezulton se Bashkia Selenicë nuk ka listë të pronave të paluajtshme për Njësitë e tjera Administrative, NjA Armen, NjA Kotë, NjA Sevaster, NjA Brataj.

Nga auditimi rezulton se, Bashkia Selenicë nuk ka inventarizuar apo përditësuar pronat e paluajtshme në asnjë nga Njësitë e saj Administrative.

- Për NJA Selenicë, bashkia administron listën me 109 prona që i janë transferuar me VKM nr. 195, datë 06.03.2013 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Selenicë, të Qarkut Vlorë".
- Për NjA Vllahinë, bashkia administron listën me 826 prona e përgatitur nga komisioni i ngritur për të kryer këtë proces.
- Për Njësitë e tjera Administrative, Armen, Kotë, Sevaster, Brataj nuk ka një listë të pronave të paluajtshme si dhe nuk është marrë asnjë masë për të hartuar këtë listë në secilën njësi administrative.
- Gjithashtu, lidhur me listat e pronave të paluajtshme të NjA Selenicë dhe Vllahinë nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentet e pronësisë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" datë 05.03.2020, Neni 37 "*Përditësimi nga institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore 1. Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. 2. Procedura e përditësimit mbështetet në: a) verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së; b) verifikimin e gjendjes juridike të pronës. Institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligj. 3. Në përfundim të këtyre verifikimeve, institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i paraqet për shqyrtim ASHK-së listën e pronave shtetërore të përditësuar, pjesë e detyrueshme e së cilës është dokumentacioni hartografik*".

Kriteri: Ligji 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" datë 05.03.2020, neni 37.

Ndikimi: I lartë

Shkaku: Titullari i Bashkisë Selenicë nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të filluar procesin e përditësimit dhe inventarizimit të aseteve të bashkisë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Titullari i Bashkisë Selenicë të marrë të gjitha masat për të filluar procesin e inventarizimit dhe përditësimit të pronave/pyjeve/kullotave si vijon:

- Të ngrejë një grup pune për verifikimin dhe përditësimin e të gjitha pronave që ka bashkia dhe NJA të transferuara në favor të tyre.
- Të vendosë komunikim me ASHK-në me qëllim arritjen e një bashkëpunimi për të marrë asistencën e tyre për verifikimin e gjendjes faktike të pronave.
- Të angazhojë Drejtorinë Juridike për verifikimin e gjendjes juridike të pronave.
- Të dokumentohen me kujdes të gjitha hapat e këtij procesi të gjatë dhe të rëndësishëm për secilën Njësi Administrative dhe në nivel bashkie.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, z. P.B. Kryetari i Bashkisë Selenicë.

Bashkia Selenicë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave për asetet që ka në pronësi referuar kuadrit ligjor të cituar më sipër edhe pse të pa regjistruara dhe të pa pajisura me certifikatat e pronësisë ka dhënë me qira disa asete të grupuara si vijon:

1. Janë lidhur 18 kontrata për tokat e pandara bujqësore që aktualisht janë në pronësi të bashkisë me afat 99 vjet dhe sipërfaqja totale është 47.75 ha;
2. Janë lidhur 84 kontrata me blektorët për kullota si dhe, priten fatura për 118 blektorë të tjerë që përdorin kullota por nuk kanë lidhur kontrata me bashkinë;
3. Janë lidhur disa kontrata me subjekte që ushtrojnë aktivitet në fusha të ndryshme si:
    a. vjelje dhe grumbullim i bimëve medicinale;
    b. përdorim të ujit të pijshëm;
    c. përdorim rruge të subjekteve, shfrytëzim karriera guri;
    d. shesh depozitimi për karriera rëre bituminoze;
    e. përpunim inertesh;
    f. shfrytëzim materiali gëlqeror.

Titulli i gjetjes 38: *Parregullsi në procesin e dhënies me qira të tokave bujqësore të lira.*
Situata:

1. Tokat e lira bujqësore

Referuar të dhënave që administron Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave (DZHBAPK), Bashkia Selenicë ka gjithsej 14,854 ha tokë bujqësore, nga të cilat 11,650 ha është marrë nga banorët dhe 3,283 ha është tokë e pa ndarë në pronësi të bashkisë.

Tabela nr. 2.6/1: Sipërfaqja e tokës bujqësore në Bashkinë Selenicë

Nr.	Njësia Administrative	Tokë gjithsej	Tokë e marrë me AMTP (ha)	Sipërfaqe e pandarë në pronësi të bashkisë (ha)
1	NjA Selenicë	706	429	277
2	NjA Armen	3141	2733	408
3	NjA Vllahinë	4317	3520	797
4	NjA Kotë	3278	2459	898
5	NjA Sevaster	2006	1436	570
6	NjA Brataj	1406	1073	333
Shuma		***14854***	**11650**	***3283***

Burimi: Bashkia Selenicë

Bashkia Selenicë në zbatim të përcaktimeve të Udhëzimit nr. 1 datë 18.07.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", ka iniciuar procesin për dhënien me qira të këtyre sipërfaqeve duke paraqitur një relacion në Këshillin Bashkiak për të miratuar dhënien me qira të tokave bujqësore të lira me qëllim sigurimin e të ardhurave. KB me VKB nr. 48 datë 25.08.2020 "Për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, pasuri shtetërore", e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 885/1 Prot. datë 15.09.2020, ka miratuar listën me 47 pasuri të disponueshme për t'u dhënë me qira.

Pas miratimit të kësaj liste rezulton se janë lidhur gjithsej 18 kontrata për dhënie me qira të tokës bujqësore për mbjellje me ullinj apo arrorë. Qiramarrësit kanë lidhur kontrata për sipërfaqe nga 0.7 ha deri në 11.2 ha me afat 99 vjet. Në total sipërfaqja e dhënë me qira për këto 18 kontrata është 47.75 ha, dhe pagesa për 1 ha është 6,000 lekë. Vlera vjetore që pritet të arkëtohet nga këto kontrata është 286,500 lekë.

Procedura e ndjekur për lidhjen e kontratave

- Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave ka përgatitur një relacion për Këshillin Bashkiak për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara pronë e bashkisë i cili shoqërohet edhe me listën e sipërfaqes së tokës bujqësore sipas njësive administrative. Referuar kësaj liste sipërfaqja e lirë për t'u dhënë me qira është 3,284 ha.
- Me VKB nr. 48 datë 25.08.2020 "Për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, pasuri shtetërore", e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 885/1 Prot. datë 15.09.2020, KB ka miratuar listën me 47 pasuri të disponueshme për t'u dhënë me qira.
- Bashkia me shkresën nr. 2821 Prot. datë 25.09.2020 ka bërë njoftimin e të gjitha njësive administrative për marrjen e masave për dhënien me qira të tokave bujqësore të lira në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", nenit 35-36.
- Me shkresën nr. 3333 Prot, datë 05.10.2020 është bërë njoftim për shpalljen publike të qiradhënies së tokave bujqësore të lira në të gjitha NJA. Njoftimi nuk shoqërohet me informacion

lidhur me kriteret dhe dokumentet që duhet të plotësojnë të interesuarit për marrjen me qira të sipërfaqeve bujqësore të lira.
- Me urdhrin nr. 204 datë 12.10.2020 është ngritur Komisioni i Qiradhënies së Tokave Bujqësore të Pandara (KQTBP) i përbërë nga 5 anëtarë. Në urdhër nuk përcaktohet se cilat do të jenë detyrat e këtij komisioni në procesin e dhënies me qira të tokave bujqësore të lira.
- Procedura e konkurimit dhe vlerësimit të aplikantëve është zhvilluar më datë 03.12.2020 në ambientet e bashkisë. Nuk ka dokumentacion që të vërtetojë se si është kryer procesi i detajuar i vlerësimit. Është plotësuar një tabelë vlerësimi të kërkesë - ofertave me të dhëna në fusha si: afati, kultivari, investimi mbi token, vlera e investimit, ujitja, numri i të punësuarve dhe çmimi i ofruar, por nuk është e qartë se në çfarë dokumentacioni është bazuar komisioni që ka bërë këto vlerësime.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 1 datë 18.07.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", Kreu II, pika 7 "*KQTBP-ja i vlerëson kërkesë - ofertat e paraqitura bazuar në kriteret e mëposhtme:*
a) Teknologjinë që do të aplikohet në kultivimin e bimëve si dhe në përpunimin e produkteve;
b) Investimet kryesore mbi infrastrukturën (kullim, ujitje, sistemimin etj.), të shprehura në tregues, fizikë dhe monetarë, si dhe investimet e lidhura me mbjelljen e kultivimin e bimëve dhe me përpunimin e produkteve etj;
c) Ndikimin e investimit në rritjen e numrit të të punësuarve në komunën ose bashkinë përkatëse;
ç) Propozimin për çmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (lekë/ha në vit)".
- Me Vendimin nr.1 datë 03.12.2020 të Titullarit të Bashkisë Selenicë është miratuar lista me 24 aplikues të vlerësuar me pikë nga 0 deri në 100.
Nga auditimi i procesit të dhënies me qira të tokave bujqësore të lira konstatohet se nga Bashkia Selenicë, KQTBP nuk janë zbatuar përcaktimet e Udhëzimit nr. 1 datë 18.07.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara".
- Me urdhrin nr. 232 datë 04.12.2020 të Titullarit të Bashkisë Selenicë është miratuar kontrata tip që do të lidhet me qiramarrësit.
- Referuar Udhëzimit nr. 1 datë 18.07.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", kreu II, pika 1 subjektet e interesuara duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë: "*Çdo subjekt, i përcaktuar në pikën 6, të kreut I, të këtij udhëzimi, i cili kërkon të marrë me qira një tokë bujqësore të pandarë, paraqet pranë komunës ose bashkisë, e cila ka në përdorim tokën bujqësore, një kërkesë me shkrim drejtuar kryetarit të komunës ose bashkisë, ku të përfshihen edhe:*
- të dhënat e kërkuesit;
- sipërfaqja dhe vendndodhja e tokës bujqësore, e cila kërkohet të merret me qira, e identifikuar me numrat kadastralë përkatës të reflektuar në dokumentacionin e DAMT-së së qarkut ose me numrin e pasurisë të reflektuar në dokumentacionin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme (ZVRPP);
- afati i qirasë;
- veprimtaria bujqësore që do të zhvillohet mbi tokën e marrë me qira duke përcaktuar kulturat bujqësore ose speciet e bimëve me të cilat lidhet kjo veprimtari;
- aspektet kryesore të teknologjisë që do të aplikohet në kultivimin e bimëve si dhe përpunimin e produkteve;
- investimet kryesore mbi infrastrukturën (kullim, ujitje, sistemimin etj), të shprehura në tregues, fizikë dhe monetarë, si dhe investimet e lidhura me mbjelljen e kultivimin e bimëve dhe me përpunimin e produkteve etj;

- burimet e financimit që garantojnë investimin, të shprehura në vlerë monetare;
- ndikimin e investimit ne rritjen e numrit të të punësuarve në komunën ose bashkinë përkatëse;
- propozimin për çmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (lekë/ha në vit)".

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të qiramarrësve konstatohet se të vetmet dokumente që janë në dosje janë: të dhënat personale të aplikuesit, formulari i kërkesës, kontrata, harta me planin e rilevimit si dhe plani i biznesit. Konstatohet se përgjithësisht planet e biznesit nuk kanë informacion të plotë lidhur me përcaktimet që kërkohen nga Udhëzimi nr. 1 datë 18.07.2012. Nuk ka të dhëna lidhur me propozimin për çmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (lekë/ha në vit) etj.

Monitorimi
Me Urdhrin nr. 351 Prot. datë 07.12.2021 Titullari i Bashkisë Selenicë ka kërkuar verifikimin në terren të zbatimit të kontratave për dhënie toke bujqësore me qira. Verifikimi është bërë nga specialistët e DZHBAPK të cilët kanë hartuar informacionin përkatës ku rezulton se:

4. 5 qiramarrës kanë zbatuar kushtet e kontratës duke mbjellë sipërfaqen e marrë me qira (K. Sh., A.Sh., Z.K., A. K. dhe E. M.);
5. 4 qiramarrës janë në fazën e kryerjes së punimeve (Sh. Xh., L. Xh., I. B. dhe S. Rr.);
6. 4 qiramarrës nuk kanë filluar kryerjen e punimeve për mbjelljen e sipërfaqes së marrë me qira (D. I., M. M., M. M. dhe I. S.);
7. 5 qiramarrësit e tjerë nuk kanë filluar kryerjen e punimeve për mbjelljen e sipërfaqes së marrë me qira për arsye të ndryshme si, kanë bërë kërkesë për shtyrje afati (E. O.), probleme në rimenaxhim (Xh. V., S. M. dhe U. K.), kërkesë për pezullim kontrate (A. H.).

Referuar përcaktimeve të kontratave nëse subjektet nuk fillojnë aktivitetitn brenda një viti bujqësor (1 Korrik-30 Qershor) duhet të bëhet ndërprerja e kontratës.

Nga auditimi i pagesave të kontratave të qirave rezulton se, qiramarrësit kanë paguar detyrimet e qirasë për vitin 2021 dhe në rastet kur pagesa është bërë jashtë afatit është llogaritur kamatëvonesa referuar kushteve të kontratave. Informacion më i detajuar lidhur me qiramarrësit e tokës bujqësore për kultivimin e ullinjëve dhe arroreve gjendet në Aneksin nr.2.6/1 bashkëlidhur.
Kriteri: Udhëzimi nr. 1 datë 18.07.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara".
Ndikimi: Në dosjet e fituesve ka mungesë dokumentacioni.
Shkaku: Komisioni i Qiradhënies së Tokave Bujqësore të Pandara nuk ka dokumentuar të gjitha hapat e ndjekura për përzgjedhjen e fituesve.
Rëndësia: E mesme
Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masa që të monitorojë rregullisht zbatimin e kushteve të kontratave të qiramarrësve, të dokumentojë këtë proces si dhe të veprojë në kohë ndaj të gjithë qiramarrësve që nuk respektojnë përcaktimet në kontratë. Gjithashtu, në rastet e lidhjes së kontratave të tjera të këtij lloji, Komisioni i Qiradhënies së Tokave Bujqësore të Pandara të kryejë dhe të dokumentojë procesin e vlerësimit në të gjitha hapat e zhvillimit të tij si dhe dosjet e aplikuesve/fituesve të jenë të plotësuara me dokumentacionin përkatës.

2. Administrimi i sipërfaqeve kullosore
Titulli i gjetjes 39: *Përdorim i sipërfaqes kullosore në kundërshtim me përcaktimet rregullative.*

Situata: Referuar VKM-së nr. 433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive", ndryshuar me VKM nr. 684 datë 02.09.2020 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike" Bashkia Selenicë ka në pronësi 16,633.1 ha kullota.
Këto kullota administrohen nga strukturat e Bashkisë Selenicë dhe sipërfaqe të caktuara të tyre jepen me qira në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi si, Ligji Nr.9693, datë 19.3.2007 "Për Fondin Kullosor", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 2 datë 20.07.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari".
Sa më sipër, Bashkia Selenicë me VKB nr. 12, datë 25.02.2021, konfirmuar nga Prefekti i qarkut Vlorë me shkresën 209/1 Prot, datë 11.03.2021, ka miratuar listën e sipërfaqeve të gatshme për kullotje dhe kositje bari për sezonin përkatës së bashku me sipërfaqet që përjashtohen nga kullota. Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se, nga sipërfaqja totale kullosore prej 16,633.1 ha **janë përjashtuar nga kullotja 1,050 ha**. Përjashtimi i kësaj sipërfaqe nga kullotja është bërë pasi ato janë konsideruar si të pa dobishme referuar vlerësimit të realizuar nga DZHBAPL me arsyetimin se:
- Mungojë planet e mbarështimit;
- Mungon përmirësimi i kullotave që nga viti 1985;
- Shfrytëzimi pa kriter, mbikullotja dhe djegia e kullotave;
- Mungesa e riparimit të lerave, pjesa më e madhe e tytre janë jashtë funksionit.

Gjithashtu, në nivel bashkie nga inspektorët e zonës janë identifikuar në total 66,182 krerë bagëti. Është parashikuar që të lidhen kontrata dhe të jepen me qira sipërfaqe për 36,753 krerë bagëti, ndërsa për diferencën prej 29,429 krerë që janë të njohura nga bashkia nuk është parashikuar lidhje e kontratave për kullotje.

Në zbatim të kuadrit ligjor të sipër cituar, Bashkia Selenicë ka planifikuar që për vitin 2021 të përfitojë të ardhura nga dhënia me qira e sipërfaqeve kullosore në vlerën 3,699,300 lekë. Kjo vlerë është planifikuar referuar të ardhurave të realizuara nga viti paraardhës dhe numrit të krerëve të njohura nga bashkia.
Pas shpalljes së procedurës për dhënien me qira të kullotave, DZHBAPK ka lidhur 84 kontrata me blektorët për dhënien me qira të sipërfaqes kullosore prej 1,939 ha.
Gjithashtu, konstatohet se Bashkia Selenicë ka lejuar edhe 118 blektorë të tjerë të përdorin kullotat pa lidhur kontratat përkatëse. Këto blektorë faturohen nëpërmjet prerjes së faturave për secilin prej tyre. Sipërfaqja kullosore e përdorur nga këto blektorë është 2,615.5 ha.
Arsyet që Bashkia paraqet lidhur me faktin e mos nënshkrimit të kontratave me këtë kategori blektorësh është se ato nuk plotësojnë kriteret ligjore për lidhjen e kontratës sikurse janë mos pajisja me Nipt apo mos regjistrimi i bagëtive në Sistemin e Informacionit Blektoral dhe Veterinar "R..".

Tabela nr . 2.6/2: Plani dhe realizimi i të ardhurave nga kullotat e dhëna me qira për vitin 2021

Nr.	Njësia Administrative	Kullota gjithsej/ha	Planifikimi i të ardhurave	Sip. e dhënë me kontratë	Të ardhurat	Sip. me faturë	Të ardhurat	Të ardh.tot.
1	Selenicë	229.89	74,000	70	30,000	3	7,000	**37,000**
2	Armen	150	0	8	4,000	15	6,000	**10,000**
3	Kotë	4566.93	1,165,100	555.05	311,900	1123.75	483,600	**795,000**
4	Vllahinë	1403.42	368,000	148	70,000	14	51,500	**121,500**
5	Sevaster	1832.32	443,200	1129	331,620	170	68,500	**400,120**

6	Brataj	8450.54	1,649,000	988	462,350	1189.8	452,600	**915,950**
		16,633.1	**3,699,300**	**2898.05**	**1,209,870**	**2615.5**	**1,069,200**	**2,279,570**

Burimi: Bashkia Selenicë, përpunoi grupi i auditimit

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën më sipër rezulton se të ardhurat nga kullotat për vitin 2021 janë realizuar në masën 62%, nga 3,699,300 lekë të planifikuara janë realizuar 2,279,570 lekë.

Konkluzion:

Nga auditimi mbi administrimin e sipërfaqes kullosore rezulton se Bashkia Selenicë:

- **Nuk ka hartuar planet e mbarështimit të kullotave** në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, "Për Fondin Kullosor", i ndryshuar me Ligjin nr. 49/2016, neni 26, "*Bashkitë janë pronarë të kullotave që gjenden brenda territorit administrativ të tyre dhe kanë për detyrë të a) ruajnë, administrojnë dhe i përdorin kullotat dhe livadhet, në përputhje me kërkesat e këtij ligji e të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij; b) hartojnë, me shpenzimet e veta, planet e mbarështimit të kullotës apo livadhit, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për kullotat dhe livadhet*".
- **DZHBAPK ka lidhur kontrata për përdorimin e sipërfaqeve kullosore pa patur të hartuar dhe miratuar planet e mbarështimit**, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për Fondin Kullosor", neni 14, "*Planet e mbarështimit 1. Kullotat dhe livadhet trajtohen dhe përdoren në përputhje me planet e mbarështimit dhe të inventarizimit. 2. Planet e mbarështimit hartohen nga strukturat përkatëse të pyjeve dhe kullotave, njësitë e qeverisjes vendore, pronarët privatë dhe miratohen nga drejtoria që mbulon kullotat në ministri*", si dhe Udhëzimit nr. 2 datë 20.07.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari", kreu II, pika 1 "*Dhënia e kullotave e livadheve për kullotjen e bagëtive e për kositje bari, bëhet sipas treguesëve teknik të planeve të mbarështimit të kullotave...".*
- **DZHBAPK ka dhënë në përdorim 2,615.5 ha kullotë për 118 blektorë pa lidhur kontratat përkatëse**. Këto blektorë faturohen nëpërmjet prerjes së faturave për secilin prej tyre. Veprime në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për Fondin Kullosor", neni 15, pika 4, "*Dhënia për kullotje e kullotave dhe e livadheve bëhet në bazë të një kontrate....*" si dhe Udhëzimit nr. 2 datë 20.07.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari", kreu II, pika 3 *"Për marrjen me qira të kullotave e livadheve publike për kullotje e kositje që janë shpallur në listë, në çdo rast kërkuesit (personat fizikë apo juridikë) paraqesin kërkesën me shkrim në drejtoritë përkatëse të shërbimit pyjor",* pika 4*. "Kërkesa përmban:*

a. të dhënat e kërkuesit, gjeneralitetet, vendbanimin, adresën e saktë, pikën e kontaktit;
b. ekonominë kullosore që kërkohet, numurin e parcelës, sipërfaqen e saj:
c. llojin e bagëtive dhe numurin e krerëve që do të kullosin;
ç. kohën e përdorimit të kullotës",
pika 5*, "Bashkangjitur kërkesës janë:*
a. çertifikata veterinare e cila lëshohet çdo vit nga shërbimi veterinar për gjëndjen epizootike të fermës së bagëtive,
b. vërtetimi nga njësia administrative/ bashkia për vendbanimin dhe numërin e bagëtive që kërkuesi ka të regjistruar në pronësi, c. lista e objekteve që kërkohet të ndërtohen në ndihmë të kullotjes, si stane, kasolle per blegtorët, mjedis për përpunimin e bulmetit, etj të tilla, sipas rastit".

Kriteri: Ligji nr. 9693, datë 19.3.2007, "Për Fondin Kullosor", i ndryshuar me Ligjin nr. 49/2016, neni 14, neni 15, neni 26 si dhe Udhëzimit nr. 2 datë 20.07.201 6 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari".
Ndikimi: Shfrytëzimi pa kriter dhe në kundërshtim me përcaktimet ligjore i sipërfaqeve kullosore.
Shkaku: Mungesa e planve të mbarështimit të kullotave si dhe mungesa e investimeve nga ana e Bashkisë Selenicë.
Rëndësia: E mesme
Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masa që:
- Të hartojë planet e mbarështimit të kullotave që ka në administrim;
- Të nxisë blektorët që ju jep në përdorin kullota pa lidhur kontratat përkatëse që të pajisen me Nipt si dhe të fillojnë rregjitrimin e bagëtive në Sistemin e Informacionit Blektoral dhe Veterinar;
- Të sigurohet që të gjithë blektorët të lidhin kontrata për shfrytëzimin e sipërfaqeve kullosore; - Të planifikojë dhe të kryejë investime në përmirësimin e kullotave, riparimin apo ndërtimin e lerave.

Mbi transferimin dhe regjistrimin e pyjeve dhe kullotave publike në pronësi të bashkisë.
Referuar VKM-së nr. 433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive", është bërë transferimi i kullotave të ish-komunave në pronësi të Bashkisë Selenicë. Referuar pikës 57 të VKM-së Nr. 433, datë 8.6.2016 dhe shtojcës 55 Bashkisë Selenicë i kalojnë në pronësi lista e inventarit që fillon me numrin rendor 1 (një) deri në 500 (pesëqind). VKM Nr. 433, datë 8.6.2016 është ndryshuar me VKM nr. 684 datë 02.09.2020 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike" dhe si rezultat numri i pronave pyje dhe kullota që ka Bashkia Selenicë shkon nga 500 në **485**, e përbërë nga, 16,633.1 ha kullota, 10,062.1 ha pyll dhe 204.31 ha sipërfaqe shkëmbore, në **total 26,899.51 ha**.
Nga auditimi rezulton se Bashkia Selenicë që nga transferimi i këtyre sipërfaqeve me VKM-në nr. 433, datë 8.6.2016, nuk ka iniciuar asnjë procedurë për verifikimin në terren dhe regjistrimin e kësaj sipërfaqe dhe më pas kalimin në fazën tjetër atë të pajisjes me certifikatën e pronësisë për sipërfaqet pyjore, kullosore dhe shkëmbore që administron.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 20/20 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" datë 05.03.2020, Neni 37 "*Përditësimi nga institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore 1. Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. 2. Procedura e përditësimit mbështetet në: a) verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së; b) verifikimin e gjendjes juridike të pronës. Institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligj. 3. Në përfundim të këtyre verifikimeve, institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i paraqet për shqyrtim ASHK-së listën e pronave shtetërore të përditësuar, pjesë e detyrueshme e së cilës është dokumentacioni hartografik*".

Mbi administrimin dhe përdorimin e fondeve nga buxheti i shtetit dhe të ardhurave nga aktivitetet në fondin pyjor dhe kullosor.
Titulli i gjetjes 40: *Mungesë financimi për pyjet dhe kullotat.*

Situata: Referuar përcaktimeve të Ligjit Nr. 57/2020 "Për Pyjet" neni 13, pika 2, burimet e financimit të sektorit të pyjeve janë "*a) buxheti i shtetit; b) buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore; c) donacionet dhe grantet e ndryshme; ç) të ardhurat nga të gjitha aktivitetet e mundshme në fondin pyjor*" ndërsa referuar Ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për Fondin Kullosor" neni 27, pika 1, *Ministria dhe organet e qeverisjes vendore, që zotërojnë kullota e livadhe, sigurojnë fonde dhe mbështetje financiare nga Buxheti i Shtetit e nga donacione të ndryshme, për ruajtjen dhe përmirësimin e fondit kullosor*.
Sa më sipër, me shkresën nr. 23727 Prot, datë 21.12.2020 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është dërguar transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2021 për Bashkinë Selenicë. Referuar tabelës bashkëlidhur kësaj shkrese, transferta e pakushtëzuar sektoriale për administrimin e pyjeve për vitin 2021 për Bashkinë Selenicë është në vlerën totale **4,583,392 lekë**. Gjithashtu, nga transferta totale e pakushtëzuar për Bashkinë Selenicë për vitin 2021 në vlerën 170,738,078 lekë, nga ndarja që është bërë ka kaluar në zërin e fondit pyjor dhe kullosor vlera **7,789,221 lekë** duke sjellë që vlera totale e planifikuar e fondit pyjor të arrijë në shumën **12,372,613 lekë.**

Tabela nr .2.6/3: Analiza e fondit Pyjor dhe Kullosor

Fondit Pyjor-Kullosor	**Plan**	**Fakt**
Trasfertë e pakushtëzar sektoriale specifike	4,583,392	4,421,610
Trasfertë fondi nga granti i pakushtëzuar	7,789,221	4,000,000
Shuma	**12,372,613**	**8,421,610**
Shpezuar për fond page pyjor	8,411,200	6,658,951
Shpezuar Sigurime shoqërore	1,405,000	1,067,979
Shpenzime operative	2,556,413	694,680

Burimi: Bashkia Selenicë

Referuar të dhënave të tabelës më sipër rezulton se për vitin 2021, Bashkia Selenicë ka planifikuar financim për pyjet në vlerën totale **12,372,613 lekë.** Ky fond është shpenzuar në vlerën **8,421,610 lekë ose 68%.** Rezulton se shpezimet për zërin paga dhe sigurime shoqërore janë planifikuar në vlerën 9,816,200 lekë dhe janë realizuar në vlerën 7,726,930 lekë, ose **92%** e faktit. Referuar dokumentacionit të audituar vlera 694,680 lekë e përdorur për shpenzime operative ka shkuar për blerjen e 200 tumbinosh për bujqësinë.

Mbi të ardhurat e veta të bashkisë nga ushtrimi i aktiviteteve në sipërfaqen pyjore dhe kullosore
Nga auditimi i kontratave që ka lidhur Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave të trajtuara gjerësisht më sipër rezulton se të ardhurat që ka siguruar Bashkia Selenicë për vitin 2021 nga aktivitet e ushtruara në **fondin pyjor janë 1,436,067 lekë** dhe nga aktivitetet e ushtruara në **fondin kullosor janë 2,279,570 lekë**, **në total 3,715,637 lekë**.

Konkluzion:
Nga auditimi i dokumentacionit dhe analizimi i të dhënave rezulton se për vitin 2021:
- Bashkia Selenicë ka kryer financim për pyjet dhe kullotat në vlerën totale **8,421,610 lekë. S**hpezimet për zërin paga dhe sigurime shoqërore janë në vlerën 7**,726,930 lekë**, ose **92%** e buxhetit.
- Bashkia Selenicë nuk ka planifikuar dhe përdorur fonde për mbrojtjen e pyjeve, florës dhe faunës, punime për përmirësimin e gjendjes së pyjeve, investime për shtimin e sipërfaqes dhe volumit, hartimin e planeve të mbarështimit etj. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 57/2020 "Për Pyjet" neni 13, pika 7, "*Burimet financiare në dispozicion të ministrisë (përfshirë agjencitë) dhe të bashkive për pyjet publike përdoren për: a) mbrojtjen e pyjeve, florës, faunës së egër, mjedisit dhe biodiversitetit, si dhe parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve, dëmtuesve dhe*

zjarreve; b) punimet e mirëmbajtjes dhe të përmirësimit të gjendjes së pyjeve, ndërtimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës pyjore; c) investime të ndryshme në fondin pyjor publik për trajtimin, zhvillimin dhe shtimin e sipërfaqes së pyjeve dhe volumit të tyre; ç) hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit dhe monitorimin e pyjeve, studime e kërkime shkencore, si dhe për mbështetjen e bashkive si njësi të vetëqeverisjes vendore dhe pronarëve privatë; d) organizimin e fushatave periodike për edukimin dhe ndërgjegjësimin publik për mbrojtjen dhe mirëqeverisjen e pyjeve".

- Nga ana tjetër të ardhurat e siguruara nga aktivitetet në sipërfaqet pyjore-kullosore për vitin 2021 janë në vlerën totale **3,715,637 lekë**. Kjo vlerë gjatë planifikimit të buxhetit është ndarë nëpër zëra të ndryshëm të buxhetit të bashkisë së bashku me të ardhurat e tjera të vitit 2021. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 57/2020 "Për Pyjet" neni 13 pika 1, "*Financimi i sektorit të pyjeve bazohet në parimin e qëndrueshmërisë, i cili nënkupton ekuilibrimin e shpenzimeve që kryhen për ruajtjen, rigjenerimin dhe zhvillimin e fondit pyjor kombëtar me të ardhurat që sigurohen nga shfrytëzimi i tij dhe shërbimet që ofron. Të ardhurat nga aktivitetet në fondin pyjor kombëtar përdoren vetëm dhe në funksion të rimëkëmbjes së pyjeve*", pika 3 "*Të ardhurat e krijuara sipas përcaktimeve në shkronjën "ç" të pikës 2 (të ardhurat nga të gjitha aktivitetet e mundshme në fondin pyjor), përdoren 100% nga strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki, kryesisht për investime në fondin pyjor*", si dhe Ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për Fondin Kullosor" i ndryshuar, neni 27 pika 1, "*Ministria dhe organet e qeverisjes vendore, që zotërojnë kullota e livadhe, sigurojnë fonde dhe mbështetje financiare nga Buxheti i Shtetit e nga donacione të ndryshme, për ruajtjen dhe përmirësimin e fondit kullosor*", pika 2, "*Fondet e siguruara për investime në kullota e livadhe përdoren për: a) hartimin e planeve të mbarështimit; b) punimet e pastrimit, të mirëmbajtjes e të përmirësimit rrënjësor të tyre; c) ndërtimin e veprave për shfrytëzimin racional të tyre dhe për përmirësimin e infrastrukturës; ç) mbrojtjen e mjedisit dhe të biodiversitetit; d) parandalimin dhe shuarjen e zjarreve; dh) studime e kërkime shkencore*".

Kriteri: Ligji nr. 57/2020 "Për Pyjet" neni 13.

Ndikimi: Dëmtim dhe pakësim i sipërfaqes dhe volumit të pyjeve .

Shkaku: Mungesa e investimeve nga Bashkia Selenicë.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masa që të ardhurat e siguruara nga përdorimi i fondit pyjor dhe kullosor të përdoren në funksion të mbrojtjes dhe rimëkëmbjes së pyjeve, ndërtimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës pyjore, zhvillimin dhe shtimin e sipërfaqes së pyjeve dhe volumit të tyre, hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit, kryerjen e punimeve të pastrimit, të mirëmbajtjes e të përmirësimit, etj.

Detyrimet e subjekteve në marrëdhënie me DZHBAPK-në

Sikurse është trajtuar më hollësisht përgjatë këtij akt konstatimi Bashkia Selenicë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave ka lidhur kontrat për toka bujqësore dhe sipërfaqet pyjore dhe kullosore si më poshtë:

1. 18 kontrata për tokat e pandara bujqësore;
2. 84 kontrata me blektorët për kullota si dhe, priten fatura për 118 blektorë të tjerë që përdorin kullota por nuk kanë lidhur kontrata me bashkinë;
3. Janë lidhur 12 kontrata qiraje me subjekte që ushtrojnë aktivitet në fusha të ndryshme si, grumbullim i bimëve medicinale, përdorim të ujit të pijshëm, përdorim rruge të subjekteve, shfrytëzim karriera guri, shesh depozitimi për karriera rëre bituminoze, përpunim inertesh dhe shfrytëzim materiali gëlqeror.

Nga auditimi rezulton se për vitin 2021 gjendja e pagesave për kontratat e qirave është:

1. Për tokat e lira bujqësore të dhëna me qira të 18 qiramarrësit kanë paguar detyrimet e qirasë për vitin 2021 dhe në rastet kur pagesa është bërë jashtë afatit është llogaritur kamatëvonesa referuar kushteve të kontratave. Vlera e arkëtuar për vitin 2021 është **534,727 lekë.** Këto 18 kontrata nuk kanë qenë aktive para vitit 2021 kështu që nuk kanë detyrime të mbartura. Informacion më i detajuar lidhur me pagesat gjendet në Aneksin nr. 2.6/1 bashkëlidhur.
2. Të gjithë blektorët që kanë lidhur kontrata për marrjen me qira të kullotave kanë paguar detyrimet e kontratës që kanë siguruar të ardhura në vlerën 1,209,870 lekë. Ndërsa të ardhurat nga kullotat që janë trajtuar me faturë janë në vlerën 1,069,200 lekë. Në total të ardhurat nga kullotat për vitin 2021 janë vlerën **2,279,570 lekë**. Nuk ka detyrime të mbartura nga kontrat e qirave për vitet paraardhëse.
3. Nga 12 subjektet që kanë lidhur kontrata për sipërfaqe me qira për ushtrim aktiviteti në fusha të ndryshme kanë paguar detyrimet e qirasë 11 subjekte për të cilët në rastet kur pagesa është bërë jashtë afatit është llogaritur kamatëvonesa referuar kushteve të kontratave. Vlera e arkëtuar për vitin 2021 është **1,436,067 lekë.** Rezulton se subjekti "B. A." SHPK nuk ka paguar detyrimet ndaj Bashkisë Selenicë për vitin 2021 në vlerën 115,500 lekë pasi referuar të dhënave të përditësuara që ka paraqitur në DZHBAPK vendndodhja e ushtrimit të aktivitetit i përket Bashkisë Vlorë dhe jo Bashkisë Selenicë. Procedura nuk ka përfunduar ende. Informacion më i detajuar jepet në Aneksin nr. 2.6/2 bashkëlidhur.

Mbi detyrimet për taksat dhe tarifat vendore

Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve që janë në marrëshënie me DZHBAPK-në lidhur me pagesën e taksave dhe tarifave vendore rezulton se për vitin 2021 janë debitorë 7 subjekte ("*N." SHPK, "A. I." SHPK, "A." SHA, "A. I.", "B...C.", "Z." SHPK, "B. A."*) në vlerën totale 15,090,000 lekë, ndërsa detyrime të mbartura kanë 15 subjekte ("*S. B." SHA, "M. B." SHA, "A.I. SHPK, A. SHPK, N. SHPK, M. SHPK, A. SHPK, B. G. SHPK, R. SHPK, P. P.SHPK, A.I., A. C., Z." SHPK, "B." SHPK*) me vlerë totale 21,407,363 lekë. Detyrimi total që këto subjekte kanë ndaj bashkisë është në vlerën **36,497,363 lekë**. Informacion më i detajuar gjendet në Aneksin nr. 2.6/3 bashkëlidhur.

Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore që subjektet e cituara më sipër dhe që janë në marrëdhënie me DZHBAPK kanë ndaj Bashkisë Selenicë, janë trajtuar më gjerësisht në auditimin e pikës së programit mbi administrimin e të ardhurave në Bashkinë Selenicë si dhe janë të përfshira në listën e debitorëve progresiv që administron Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, z. P. B. Kryetari i Bashkisë Selenicë, z. L. H. me detyrë Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare, z. B. K., zj. Gj. Xh. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, për vitin 2021, z. E. F. me detyrë Kryeinspektor në Inspektoratin Tatimor të Kundërvajtjeve Administrative.

2.6.2 Prerjet rigjeneruese dhe shfrytëzimi i lëndës drusore në fondin pyjor

Titulli i gjetjes 41: *Parregullsi në procesin e kryer në fondin pyjor lidhur me prerjet rigjeneruese të pyjeve dhe shfrytëzimin e lëndës drusore*

Situata:

A. Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave në Bashkinë Selenicë më datë 30.03.2018 ka hartuar Proces Verbalin nr. 37 "Për ngjarje të jashtëzakonshme në fondin Pyjor/Kullosor", i firmosur nga Inspektor Zone Ç. H., Përgjegjës Kontrolli P. H., Inxhinier i Kadastrës Sh. D.. Referuar proces verbalit nr. 37 datë 30.03.2018 në vendin e quajtuar Ana e Lumit në ngastrën nr. 37 nga verifikimi në vendngjarje ka rezultuar thyerje dhe shkulje e drurit të llojit pishë e egës, **96 copë**, mosha 40 vjeç, **vëllimi 46,12 m^3**, lëndë punimi 18 m^3 dhe dru zjarri 28,12 m^3. Materiali drusor i vlerësuar është 18 m^3. Dëmtimi është shkatuar nga një stuhi natyrore.

Sa më sipër, nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave në Bashkinë Selenicë, më datë 08.06.2018 është hartuar Projekti teknik i shëndetësimit të pyjeve (nga ngjarjet e jashtëzakonshme në pyje) -Për ekonominë Pyjore Selenicë, ngastra nr. 37. Projekti është hartuar nga: z. P. H. (Inspektor Kontrolli), z. Sh. D. (Specialist i Kadastrës Pyjore), z. G. L. (Drejtor) miratuar nga Kryetari z. P. Sh.. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektit konstastohet ai është i hartuar për Njësinë Administrative Kotë pasi përshkruan zonën e lumit Shushicë nga Drashovica e lartë dhe vetëm 2 faqe (21-22) lidhen me ngastrën nr. 37.

Më datë 11.06.2018 Bashkia Selenicë ka lidhur kontratën me nr. 1538 Prot. për "Shfrytëzim të lëndës drusore nga pyjet bashkiake" me objekt shfrytëzimi i lëndës drusore në ngastrën 37, lloji pishë e egër, lëndë drusore në këmbë me vëllim 46.12 m^3, lëndë punimi 18 m^3 dhe dru zjarri 28.12 m^3 me afat 11.06.2018-10.07.2018.
Për dorëzimin e ngastrës është nxjerrë urdhri nr. 8 datë 13.06.2018.

Më datë 13.06.2018, Drejtoria e Pyjeve Kullotave ka hartuar Proces Verbalin nr. 108 Prot. "Për dorëzimin e ngastrës/nënngastrës pyjore për shfrytëzim" ku i dorëzohen subjektit "L." SHPK ngastra nr. 37 me sipërfaqe 0.1 ha për shfrytëzim dhe ruajtje në të cilën do të aplikohet faza shëndetësore e prerjes **me volum gjithsej 46.12 m^3**, të ndarë në pishë e egër lëndë punimi e hollë 9 m^3, lëndë punimi e mesme 9 m^3, dru zjarri 28.12 m^3. Përfaqësuesit e Bashkisë Selenicë që kanë bërë dorëzimin e sipërfaqes janë Inspektor Kontrolli P. H., Përgjegjës Sektori B.D. dhe Inspektor Zone Ç. H.. Po më datë 13.06.2018 është hartuar proces verbali nr. 108/1 i firmosur vetëm nga Inspektori i Kontrollit P. H. i cili konstaton se "*pishave të rrëzuara nga fatkeqësia natyrore nuk mund t'ju vendoset damkë sepse janë të vendosura njëra mbi tjetrën*".
Për ushtrimin e aktivitetit Bashkia Selenicë ka pajisur subjektin "L." SHPK me leje shfrytëzimi nr. 1539 Prot. datë 11.06.2018, të shfrytëzojë si më poshtë:

Nr. ngastrës/n.ngastër	Lloji drusor	Lëndë punimi m^3	Dru zjarri m^3	Totali m^3
37	Pishë e egër	18	28.12	46.12

Më datë 04.07.2018 nga Inspektori i Kontrollit P.H., Inspektori i Zonës Ç. H. dhe Përgjegjësi i Sektorit B.D. është hartuar proces verbal me shkrim dore dhe i pa protokolluar ku është konstatuar se subjekti "L." SHPK ka prerë në ngastrën nr. 37, **20 m^3 dru zjarri më tepër se sasia e lidhur**

<u>në kontratë</u>. Kjo sasi është vlerësuar nga verifikimi i fletëve të transportit. Për këtë sasi të prerë më tepër nga kontrata e lidhur inspektorët kanë vendosur që subjekti të paguajë 4,000 lekë në arkën e bashkisë, vlerë e cila është paguar.

Më datë 27.07.2018 nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave (Inspektor Kontrolli P.H., Përgjegjës Sektori B. D., Inxhinier Kadastre Sh. D.) është hartuar proces verbali përfundimtar me nr. 145 Prot. në të cilin vlerësohet se janë prerë **<u>96 drurë të damkosur</u>** të llojit Pishë mesdhetare duke nxjerrë **<u>në total 48.12 m^3</u>** dru zjarri dhe trupa të ndryshëm lëndë punimi në këmbë **<u>18 m^3</u>**.
Nga auditimi i dokumentacionit që administrohet në dosjen e subjektit "L." SHPK u konstatua si më poshtë:
1. Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave (DZHBAPK) nuk ka dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit Projektin teknik të shëndetësimit të pyjeve të hartuar më datë 08.06.2018. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 2, datë 03.03.2017 "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje", Kreu I, <u>pika 15</u> "*Sigurimi i druve të zjarrit për ngrohje nga banorët e fshatrave malore dhe në brendësi të pyjeve kryhet dhe nëpërmjet mbledhjes (vlerësimit) së materialit drusor nga drurët e rrëzuar (shkulur e thyer), nga furtunat e zjarret dhe punimet e trajtimet rigjeneruese të pyllit me rrallime e prerje sanitare dhe shëndetësimi sipas projekteve të hartuara dhe vlerësimit paraprak në vëllim të materialit drusor. <u>Projektet e hartuara do të miratohen nga Drejtoria e Mbrojtjes dhe Trajtimit të Pyjeve në Ministrinë e Mjedisit";</u>*
Kreu III, <u>pika 13</u> "*<u>Ndalohet fillimi i punimeve për prerjen e materialit drusor pa miratuar projektin teknologjik dhe tekniko-ekonomik të trajtimit/prerjeve ripërtëritëse të grup-/ngastrës apo nënngastrës pyjore</u>*".
2. Studimi teknik i shëdetësimit të sipërfaqes në ngastrën nr. 37 është kryer jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 2 datë 03.03.2017, Kreu II, pika 1. Studimi i ngastrave dhe nënngastrave që do të trajtohen me prerje të lejuara kryhet nga strukturat e shërbimit pyjor në bashki deri në datën 30 të muajit prill të çdo viti, ndërsa në fakt studimi mban datën 08.06.2018.
3. Proces verbalet me nr. 108 datë 13.06.2018, "Për dorëzimin e ngastrës/nënngastrës pyjore për shfrytëzim" dhe nr. 108/1 datë 13.06.2018 bien në kundërshtim me njëri tjetrin pasi në proces verbalin nr. 108 datë 13.06.2018 përcaktohet se subjekti "L." SHPK duhet *të presë vetëm drurët e shënuar me damkë, drurët e rrëzuar, të thatë e të vlerësuar në lista damkë si dhe të ruajë nga dëmtimet drurët që janë të padamkosur, drurët e rinj dhe filizerinë*. Në proces verbalin nr. 108/1 i firmosur vetëm nga Inspektori i kontrollit P. H. përcaktohet se *pishave të rrëzuara nga fatkeqësia natyrore nuk mund t'ju vendoset damkë sepse janë të vendosura njëra mbi tjetrën*. Gjithashtu, në proces verbalin përfundimtar nr. 145 Prot datë 27.07.2018 është vlerësuar se janë prerë **<u>96 drurë të damkosur</u>** të llojit Pishë Mesdhetare. Nga sa më sipër rezulton se informacioni i paraqitur në këto proces verbale nuk është i saktë dhe nga DZHBAPK është lejuar që subjekti "L." SHPK të presë dru pa damkë në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimin nr. 2 datë 03.03.2017, Kreu III, pika 1 "*<u>Prerja e drurëve në fondin pyjor kombëtar bëhet pas shënimit të tyre me damkë të veçantë nga strukturat e shërbimit pyjor në bashki</u>*".
4. Në dosjen e audituar nuk administrohet një urdhër i titullarit të bashkisë për organizimin e procesit të damkimit, veprime në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. nr. 2 datë 03.03.2017, Kreu III, pika 4.
5. Në proces verbalin e datës 04.07.2018 është konstatuar se subjekti "L." SHPK ka prerë **20 m^3 dru më tepër se janë planifikuar në kontratë** *(nga 28.12 m^3 që janë vlerësuar janë 48.12 m^3).*

Për këtë volum nga inspektorët është vlerësuar që subjekti duhet t'i paguajë bashkisë vlerën 4,000 lekë. Nuk rezulton që inspektorët të kenë vlerësuar më tej këtë sasi druri lidhur me llojin, moshën etj, si dhe të kenë argumentuar arsyet e prerjes mbi sasinë e nënshkruar në kontratë. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 2 datë 03.03.2017, Kreu I, pika 10, "*Kompania është e detyruar të shfrytëzojë vetëm vëllimin drusor që është damkosur dhe cilësuar në lejen e shfrytëzimit*". Gjithashtu, në proces verbalin fillestar të kësaj procedure nr. 37 datë 30.03.2018 janë vlerësuar se duhet të priten **96 dru me volum gjithsej 46.12 m^3, dru zjarri 28.2 m^3 dhe lëndë punimi 18 m^3**, ndërsa në proces verbalin përfundimtar nr. 145 datë 27.07.2018 përcaktohet se janë prerë **96 dru me volum gjithsej 66.12 m^3**, dru zjarri **48.12 m^3, pra 20 m^3 më shumë dhe lëndë punimi 18 m^3**. Ky ndryshim në volum tregon se inspektorët ose nuk kanë qenë të saktë në llogaritjen e volumit të drurëve në proces verbalin fillestar ose nuk kanë vlerësuar shtesën prej 20 m^3.

B. Bashkia Selenicë ka lidhur kontratën nr. 308 dhe 308//1 Prot. datë 24.01.2019 për "Shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë" në ngastrat e ekonomisë pyjore Cepin dhe Mali Bratit-Gumenicë me subjektin "L." SHPK si më poshtë:

Ekonomia Pyjore	Numri i ngastrës /nënngastrës	Lloji	Lëndë drusore në këmbë gjithsej m3	Dru zjarri m3	Vlera
Cepin	20/a	Prrall	140	140	70,000
Cepin	21	Prall, mare	120	120	60,000
Cepin	22/a	Prall, mare	80	80	40,000
Cepin	22/b	Mare, Prall	30	30	15,000
Cepin	23/a	Mare, Prall	130	130	65,000
Mali Bratit-Gumenicë	69/a	Prall, Shqopë	222	222	111,000
Totali			**722**	**722**	**361,000**

Afati i kontratës është 1 vit nga data 24.01.2019-23.01.2020.
Për ushtrimin e aktivitetit subjekti është pajisur me leje shfrytëzimi nr. 450 Prot. datë 18.02.2019. Leja është dhënë për shfrytëzimin e të gjitha ngastrave të cituara në kontratën e sipër cituar. Nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave është përgatitur Projekti Teknik i Shëndetësimit të Pyjeve (nga ngjarjet e jashtëzakonshme në pyje) për ekonomitë pyjore Cepin dhe Mali Bratit-Gumenicë ngastrat 20/a, 21, 22/a, 22/b, 23/a dhe 69/a. Projekti nuk përmban datë se kur është hartuar, është firmosur vetëm nga Specialisti P. H. dhe Inxhinier Sh. D., Përgjegjësi i Sektorit B. K. nuk ka firmosur.
Më datë 20.02.2019 nga specialistët e Bashkisë Selenicë (Sh. D., B. K., P. H.) është hartuar proces verbali i dorëzimit të ngastrës/nënngastrës pyjore për shfrytëzim, Proces verbali është draft dhe është për dorëzimin e ngastrës nr. 69/a dhe nuk përfshin ngastrat e tjera të paraqitura në projektin teknik apo të përfshira në kontratën e lidhur me subjektin "L." SHPK nr. 308 dhe 308/1 Prot. datë 24.01.2019 për "Shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë" në ngastrat e ekonomisë pyjore Cepin dhe Mali Bratit-Gumenicë.

Me urdhërin nr. 396, datë 19.10.2018 nga Ministri i MTM janë miratuar për shfrytëzim vetëm ngastrat nr. 20/a, 21, 22/a, 22/b, 23/b në Ekonominë Pyjore Çipin. Shfrytëzimi në ngastrën 69/a është miratuar me Urdhërin nr. 159 datë 19.05.2017 të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit ndërsa për ngastrën nr. 23/a nuk ka dokumentacion të jetë miratuar shfrytëzimi në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 2, datë 03.03.2017 "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave,

grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje", Kreu I, pika 15.
Në akt konstatimin nr. 719 Prot. datë 21.02.2020 lidhur me aktivitetin e subjektit "L." SHPK në ngastrën nr. 69/a është konstatuar se subjekti nuk ka realizuar në kohë transportin dhe depozitimin e sasisë prej 200 m^3 dru në sheshin e depozitimit të përcaktuar, duke mos zbatuar kështu detyrimet e përcaktuara në kontratë.
Gjatë periudhës së lidhjes së kontratës strukturat e bashkisë duhet të ushtrojnë kontrolle periodike me qëllim verifikimin e zbatimit të kushteve të kontratës.
Nga auditimi i dokumentacionit në dosje konstatohet se lidhur me këtë kontratë strukturat e bashkisë kanë mbajtur vetëm një akt verifikim në kundërshtim me përcaktimet e kontratës nr. 308/1 Prot. datë 24.01.2019, Kreu IV, pika a.

C. Bashkia Selenicë me shkresën nr. 1111 Prot. datë 30.04.2019, ka dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit Projektin Teknik të shëndetësimit të pyjeve nga ngjarjet e jashtëzakonshme për Ekonominë Pyjore Kotë-Sevaster, ngastra nr. 11/c dhe nr. 16. Në dokumentacionin shoqërues të Projektit Teknik gjenden dy proces verbale të mbajtura më datë 10.09.2018 lidhur me thyerje dhe shkulje të drurëve të llojit pishë e egër të shpërndara në sipërfaqe 10 ha në ngastrat nr. 11/b dhe nr. 16. Në këto dy proces verbale komisioni (Përgjegjës Sektori B. D., Specialist P. H. dhe Inxhinier i Pyjeve Sh. D.) herë i referohet ngastrës nr. 11/b dhe herë ngastrës nr. 11/c ndërsa të dhënat e tjera lidhur me materialin drusor që vlerësohet janë të njëjta.
Me urdhër të Ministrit të MTM-së nr. 189, datë 11.06.2019 janë miratuar për shfrytëzim ngastrat nr. 11/c dhe nr. 16 në Ekonominë Pyjore Kotë-Sevaster.
Pas miratimit të këtyre ngastrave për shfrytëzim Bashkia Selenicë me shkresën nr. 1807 datë 19.07.019 ka dërguar në APP njoftimin dhe ftesën për Ankandin me nr. REF 2-A/2019. Ankandi është anulluar me Vendimin nr. 2 datë 09.08.2019 me argumentimin se vlerësimi i materialit drusor është bërë pa damkë pasi Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave nuk disponon mjetin përkatës për damkosje. Njoftimi për anullimin e ankandit është dërguar në APP me shkresën nr. 2024 Prot. datë 13.08.2019.
Në vijim Drejtori i Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave në Bashkinë Selenicë me shkresën nr. 212 Prot. datë 20.11.2019 ka krijuar grupin e punës së përbërë nga 6 punonjës (Sh. D., P. H., O. Gj., Xh. I., Ç. H., M. H.) për të bërë verifikimin dhe damkosjen e pishave të rrëzuara në Ekonominë Pyjore Kotë-Sevaster, ngastra nr. 16. Nuk disponohet dokumentacion në dosje lidhur me përfundimin e këtij procesi.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 2, datë 03.03.2017 "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje", Kreu III, pika 1, pika 4, pika 8, pika 9.

D. Bashkia Selenicë me shkresën nr. 541 Prot. datë 10.02.2020 ka dërguar në APP njoftimin për publikim ankandi me nr. REF 1-A/2020 për volumin 426.56 m^3 dhe vlerë fillestare 178,492 lekë pa TVSH.
Në përfundim të procedurave të ankandit Bashkia Selenicë ka lidhur kontratën me nr. 1152 Prot. datë 02.04.2020 me subjektin "L." SHPK për shfrytëzimin e lëndës drusore të rrëzuar në Ekonominë Pyjore Kotë-Sevaster, ngastrat nr. 11/c dhe nr. 16 për volumin total 426.56 m^3 e llojit pishë e egër. Afati i kontratës është 1 vit nga data 02.04.2020-01.04.2021. Kontrata parashikon të priten dhe asortohen vetëm drurët e damkosur.

Dorëzimi i ngastrës pyjore për shfrytëzim është bërë me proces verbalin e mbajtur më datë 09.04.2020 firmosur nga Përgjegjës Sektori P. A., Inspektor A. Ç. dhe Inxhinier Sh. D.. Vëllimi për prerje është vlerësuar 69.82 m^3 në ngastrën nr. 11 dru zjarri e llojit pishë e egër dhe 325.68 m^3 në ngastrën nr. 16 dru zjarri e llojit pishë e egër dhe lëndë punimi 31.06 m^3 e llojit pishë e egër.
Në dosje nuk gjendet i dokumentuar zhvillimi i procesit të damkimit për ngastrën nr. 11/c, ndërsa për ngastrën nr. 16 ka vetëm një urdhër për fillimin e procesit të damkimit dhe nuk ka dokumente të tjera që të vërtetojnë se ky proces është kryer, p.sh të jenë hartuar listëdamkat në secilën ngastër sipas llojeve drusore. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e e Udhëzimit nr. 2, datë 03.03.2017, Kreu III, pika 1, pika 4, pika 8, pika 9.

Në akt konstatimin e mbajtur nga Inspektori i zonës A. Ç. me nr. 50 Prot. datë 25.06.2020 mbi kontrollin e ushtruar në veprimtarinë që ushtron subjekti "L." SHPK në ngastrën nr. 16 janë vërejtur dëmtime të damkave dhe prerje të disa pishave të njoma.

Më datë 22.07.2020 Inspektori A. Ç. ka mbajtur proces verbalin për prerjen e 3 pishave pa damkë nga subjekti "L." SHPK, në ngastrën nr. 16, ky dëm është vlerësuar 60,000 lekë.
Më datë 27.07.2020 Inspektori A. Ç. për shkeljet e konstatuara në ngastrën nr. 16 ka vendosur gjobë në vlerën 5,000 lekë ndaj subjektit "L." SHPK.
Me Vendim nr. 1 datë 30.07.2020 komisioni (B. K., J. N., P. A.) referuar shkresave të sipër cituara ka vedosur që subjekti "L." SHPK për dëmin e shkaktuar duhet të paguajë ndaj bashkisë vlerën 65,000 lekë.

Në akt konstatimin me nr. 85 Prot. datë 20.07.2020 mbi kontrollin e ushtruar më datë 17.07.2020 në veprimtarinë që ushtron subjekti "L." SHPK në ngastrën nr. 11 nga Inspektori i zonës A. Ç., Përgjegjësi i Sektorit P. A. dhe Inxhinieri Sh. D. i cili nuk ka firmosur, është konstatuar se subjekti "L." SHPK ka prerë 9 pisha të njoma dhe pa damkë, ndërsa për ndërtimin e rrugës ka prerë 14 pisha të pa damkosura. Gjithshtu, nga kontrolli i pishave të damkosura rezulton se janë damkosur pisha të njoma të drejta që nuk janë objekt i projektit të përmirësimit të pyllit. Në këto kushte grupi i verifikimit ka vendsur të kërkojë pezullimin e prerjes së mëtejshme të drurëve.
Lidhur me konstatimet e bëra më sipër Kryetari i Bashkisë ka vendosur të bëhet verifikimi nga një grup tjetër me argumentimin se Akt konstatimi nuk është i qartë dhe se Inxhinieri Sh. D. nuk ka firmosur. Më datë 22.07.2020 grupi i ri i punës (B. K., Sh. D., A. Ç.) ka verifikuar konstatimet e bëra në akt konstatimin nr. 85 Prot. datë 20.07.2020. Në këtë akt konstatim grupi shprehet se konstatimet e bëra në aktin nr. 85 datë 20.07.2020 nuk qëndrojnë. Në akt konstatimin e datës 22.07.2020 pishat e njoma të damkosuara nuk klasifikohen si të njoma, pishat e pa damkosura të prera janë vlerësuar që pengojnë rrugën, nga 9 pisha të prera pa damkë vlerësohet se janë prerë 3.
Ajo që vlen të theksohet është se:
- Pretendimi i Kryetarit të Bashkishë se akt konsatimi nr. 85 është i pa kuptueshëm nuk qëndron pasi për grupin e auditimit akti është shumë i qartë;
- Verifikimi i dytë është bërë 5 ditë pas verifikimit të parë dhe në grupin e dytë të verifikimit dy nga tre anëtarët janë të njëjtë (Sh. D. i cili nuk ka firmosur akt konstatimin e parë dhe A. Ç.). Inspektori A.Ç. në një periudhë 5 ditore ka firmosur për të njëjtin proces verifikimi dy proces verbale me përmbajtje të ndryshme duke cituar një herë që janë prerë pisha të njoma, të pa damkosura apo janë damkosur pisha të njoma dhe një herë pothuajse të kundërtën.
Më datë 03.08.2020 Bashkia Selenicë ka njoftuar subjektin "L." SHPK me shkresën nr. 1152/1 Prot. datë 03.08.2020 për ndërprerjen e kontratës me argumentimin se gjatë akt konstatimeve në

vend janë vërejtur prerje dhe dëmtim i drurëve pa damkë. Për konfiskimin e materialit drusor të prodhuar deri në ndërprerjen e kontratës është mbajtur proces verbali me nr. 2524 Prot. datë 31.08.2020 ku është konfiskuar sasia prej 135 m^3 dru zjarri.

Konkluzion:
Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me aktivitetin e kryer nga Bashkia Selenicë në fondin pyjor me objekt "Prerjet rigjeneruese dhe shfrytëzimin e lëndës drusore në fondin pyjor" konstatohen parregullsi në të gjitha hapat e zhvillimit të këtij procesi si më poshtë:
1. Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave (DZHBAPK) nuk ka dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit Projektin teknik të shëndetësimit të pyjeve për ngastrën nr. 37, të hartuar më datë 08.06.2018 dhe ka vijuar me procesin e prerjeve të lëndës drusore pa marrë miratimin nga MTM.
2. Studimi teknik i shëndetësimit të sipërfaqes në ngastrën nr. 37 është kryer jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 2 datë 03.03.2017, Kreu II, pika 1.
3. Në dosjen e audituar për shfrytëzimin në ngastrën nr. 37 nuk administrohet një urdhër i Titullarit të Bashkisë për organizimin e procesit të damkimit;
4. Proces verbalet me nr. 108 datë 13.06.2018, "Për dorëzimin e ngastrës/nënngastrës pyjore për shfrytëzim" dhe nr. 108/1 datë 13.06.2018 bien në kundërshtim me njëri tjetrin pasi në proces verbalin nr. 108 datë 13.06.2018 përcaktohet se subjekti "L." SHPK duhet...*të presë vetëm drurët e shënuar me damkë, drurët e rrëzuar, të thatë ..., ndërsa në* proces verbalin nr. 108/1 përcaktohet se *... pishave të rrëzuara nga fatkeqësia natyrore nuk mund t'ju vendoset damkë sepse janë të vendosura njëra mbi tjetrën*;
5. Nuk ka dokumentacion që të jetë miratuar nga MTM shfrytëzimi në ngastrën nr. 23/a.
6. Është ngritur grupi i punës për të bërë verifikimin dhe damkosjen e pishave të rrëzuara në Ekonominë Pyjore Kotë-Sevaster, ngastra nr. 16, por në dosje nuk disponohet dokumentacion lidhur me përfundimin e këtij procesi, p.sh të jenë hartuar listëdamkat sipas llojeve drusore;
7. Në dosje nuk gjendet i dokumentuar zhvillimi i procesit të damkimit për ngastrën nr. 11/c;
8. Nga akt konstatimet e mbajtura nga inspektorët e bashkisë konstatohet se subjekti "L." SHPK në ngastrën nr. 16 dhe nr. 11 nuk ka respektuar kushtet e kontratës: janë vërejtur dëmtime të damkave dhe prerje të disa pishave të njoma pa damkë. Gjithashtu, është konstatuar se nga grupi i punës janë damkosur pisha të njoma të drejta që nuk janë objekt i projektit të përmirësimit të pyllit.
9. Bashkia Selenicë nuk kryen periodikisht procesin e vlerësimit të fondit pyjor me prerje rigjeneruese, por edhe në rastet kur janë kryer disa vlerësime në ngastra të caktuara ato nuk janë miratuar të gjitha në MTM. Për ato ngastra që është miratuar nga MTM që të kryehet procesi i shëndetësimit të sipërfaqeve pyjore nuk janë marrë masa për të zhvilluar më tej procedurat.
10. Bashkia Selenicë nuk ka plane mbarështimi të pyjeve të cilat të shërbejnë si bazë për proceset që do të zhvillohen lidhur me trajtimin dhe shrytëzimin e fondit pyjor me qëllim sigurimin e nevojave për ngrohje, rigjenerimin dhe shëndetësimin e pyjeve.

Për sa më sipër rezulton se Bashkia Selenicë në menaxhimin e fondit pyjor për zhvillimin e procesit të prerjeve rigjeneruese dhe shfrytëzimin e lëndës drusore nuk ka ndjekur përcaktimet e VKM-së nr. 438, datë 08.06.2016, "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jo pyjore", e ndryshuar, Kreu III, pikat 1,3,6,15,16,18, Kreu V pikat 24,25, si dhe Udhëzimit nr. 2 datë 03.03.2017, "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese,

rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje", Kreu I pika 15, Kreu II pika 1, Kreu III pika 1, pika 4, pika 8, pika 9, pika 13.
Kriteri: VKM nr. 438, datë 08.06.2016, "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jo pyjore", e ndryshuar. Udhëzimi nr. 2 datë 03.03.2017, "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje".
Ndikimi: Si rezultat i të gjitha problematikave të konstatuara më sipër për të cilat Bashkia Selenicë nuk ka vepruar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ gjendja e pyjeve të bashkisë nuk ka patur përmirësim dhe shëndetësim pasi edhe në rastet kur janë miratuar projekte shëndetësimi ato nuk janë zbatuar.
Shkaku: Bashkia Selenicë nuk ka zbatuar kuadrin ligjor dhe rregullativ në shëndetësimin e pyjeve dhe në shfrytëzimin e lëndës drusore.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave të marrin masa që:
- Të hartojnë Planet e mbarështimit të pyjeve që kanë në territorin e bashkisë;
- Të kryejnë periodikisht procesin e vlerësimit të fondit pyjor me prerje rigjeneruese duke hartuar projektet teknike të shëndetësimit të pyjeve rast pas rasti;
- Të fillojnë procedurat e ankandit për ato ngastra që është miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit projekti për shëndetësimin e sipërfaqeve pyjore;
- Të dokumentohet i gjithë procesi në çdo hap të tij;

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z. P. Sh. me detyrë ish Kryetar i Bashkisë Selenicë, z. P. B. Kryetari i Bashkisë Selenicë, z. G. L. me Detyrë ish Drejtor i DZHBAPK, z. B. K. me detyrë Drejtor i DZHBAPK, z. B. D. me detyrë ish Përgjegjës Sektori, z. Sh. D. me detyrë Inxhinier Pyjesh, z. Ç. H., z. O. Gj. z. Xh. I., z. M. H., z. A. Ç., z. P. H. me detyrë inspektorë.

Sa trajtuar më sipër nga Bashkia Selenicë janë paraqitur observacione me shkresën nr. 2116/44 Prot, datë 09.12.2022, protokolluar në KLSH me nr. 799/13 Prot, datë 21.12.2022.
Pretendimet e subjektit:
Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyje/Kullotave i përmbahet shpjegimeve të dërguara mbi akt konstatimet.
Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:
Lidhur me pretendimet e subjektit të paraqitura mbi akt konstatimet grupi i auditimit ka shprehur qëndrimin e tij të cilin e ka reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit, rrjedhimisht edhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

2.6.3 Shfrytëzimi për veprimtari ekonomike i fondit pyjor

Titulli i gjetjes 42: *Parregullsi në procedurat e ndjekura nga Bashkia Selenicë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave në shfrytëzimin për veprimtari ekonomike në fondin pyjor.*
Situata: Procesi i përcaktimit të tokës dhe pronave shtetërore dhe ndarja e tyre në mes të agjencive shtetërore dhe njësive të qeverisjes vendore (NJQV) është një proces i cili ka nisur që nga viti

2001. Ky proces duhej zbatuar në bazë të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 *"Për pronat e paluajtshme të shtetit",* të ndryshuar dhe Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 *"Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore"*, të ndryshuar.
Ligji i fundit që trajton problematikën e procesit të pronësisë për NJQV është ligji nr. 20/2020 *"Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" i cili në nenin 37 përcakton se: "Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit",* proces i cili duhet të përfundonte në Nëntor të vitit 2021.
Bashkisë Selenicë i janë transferuar me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive" e ndryshuar, 485 prona me sipërfaqe totale 26,899.51 ha.
Nga auditimi rezulton se në Bashkinë Selenicë nuk është realizuar inventarizimi i pasurive (pyje/kullota) ku ushtrohet veprimtaria minerare. Pra nuk ka nisur procesi i transferimit të pronës që kalon në tre faza:
1. Identifikimi i statusit të inventarizimit, transferimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore drejt njësisë së qeverisjes vendore, Bashkisë Selenicë;
2. Problematikat e procesit të transferimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore;
3. Identifikimi dhe analizimi i opsioneve të përdorimit dhe menaxhimit të pronës shtetërore.

Nga grupi i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit u audituan dosjet e subjekteve që ushtrojnë veprimtari minerare në territorin e Bashkisë Selenicë të administruara nga Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave.
Grupi i auditimit i është referuar lejeve minerale aktive të paraqitura në faqen zyrtare të AKBN-së nga ku konstatohen lejet e paraqitura në tabelën përmbledhëse si më poshtë:
Tabela nr. 2.6/4: Lista e lejeve minerare aktive në territorin e Bashkisë Selenicë, referuar AKBN-së

Nr.	Leje	Datë	Subjekti	Sip. e hequr nga fondi Ha	Emërtimi i Vb	Minerali	Sipërfaqe Km^2
1	355/1	14.10.2016	S. B.	154.30	Selenicë	Bitum, Zhavor Bitum.	1.543
2	390/1	22.01.1998	"R." Shpk	9.90	Vidhat e Haxhiut	Zhavor bituminoz	0.099
3	552/1	08.11.2011	"S." Shpk	2.50	Kava e Azines	Gur gëlqeror	0.025
4	594/1	25.01.2012	"N." Shpk	14	Drashovicë.	Gur gëlqeror	0.14
5	641	16.08.2001	"A." Shpk	142	Treblovë	Rërë bituminoze	1.42
6	1115	12.12.2007	"T. I." Shpk	109	Resulaj	Zhavor Bituminoz	1.09
7	1371	22.09.2009	"M. B." Shpk	32.40	Kume Murriz	Bitum, Zhavor Bituminoz	0.324
8	1496/2	10.07.2013	"B. M. I." Shpk	163.80	Treblovë, Romës	Rërë Bituminoze	1.638
9	1496/3	20.11.2013	"B. M. I." Shpk	117.10	Treblovë, Romës	Rërë Bituminoze	1.171
10	1578	07.09.2012	"B. M. I." Shpk	13.70	Zona e II Resulaj	Zhavor Bituminoz	0.137
11	1644	02.07.2013	"A.I." Shpk	36	Selenicë	Zhavor Bituminoz	0.36
12	1753	15.05.2015	"B.. C." Shpk	32.20	Selenicë	Zhavor Bitum&Bitum	0.322
13	1754	21.05.2015	B. G.	25.10	Selenicë	Zhavor Bitum&Bitum	0.251
14	1789	14.01.2016	"Y. S." Shpk	19.80	Lepenicë	Gëlqeror Dekorativ	0.198
15	1792	10.03.2016	"A..." Shpk	14	Lepenicë	Gëlqeror Dekorativ	0.14
16	1826	12.12.2016	"M.P."	99.70	Lepenicë	Gëlqeror i mermerizuar	0.997
17	1844	13.09.2017	"T. E." Shpk	12.70	Gumenicë	Gëlqeror i mermerizuar	0.127
18	1845	13.09.2017	"T. E." Shpk	100	Gjorm	Gëlqeror i mermerizuar	1.00
19	563	16.07.2018	"S. M."	132.90	Brataj	Gëlqeror i mermerizuar	1.329
				1,231.1 ha			**12.311**

Burimi: AKBN, përgatiti grupi i auditimit

Në zbatim të urdhrit të punës nr. 547 prot., datë 17.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Selenicë *"Për verifikimin dhe matjen e sipërfaqeve të karrierave të firmave nxjerrëse të qymyreve bitumine dhe*

guroreve në territorin e Bashkisë Selenicë", është ngritur grupi i punës me përbërje Z. I. D. (Zv. Kryetar), Z. E.F. (Përgjegjës Tatim Taksa), Z. P. A. (Përgjegjës Pyje/Kullota) e z. A. K. (Specialist Topograf). Nga grupi i punës janë realizuar matjet në terren dhe rezultatet e paraqitur për veprimtarinë dhe sipërfaqet respektive janë marrë si sipërfaqe referimi nga grupi i auditimit për përllogaritjen e vlerës së qerasë vjetore të subjekteve që ushtrojë veprimtari minerare në Bashkinë Selenicë.

Tabela nr. 2.6/5:Verifikimi në terren i subjekteve që ushtrojnë aktivitet në nxjerrje të mineraleve

	Subjektet:	**Sipërfaqet m^2**
I	**Q..**	
1	"B. P." Shpk	3,000
2	"Z." Shpk (Nënkontraktor)	2,500
3	"B..C." Shpk	2,300
4	"A..I." Shpk	3,500
5	"S. B." Shpk	1,000
6	"M. B." Shpk	4,300
II	**GURORE**	
1	"M. P." Shpk	2,500
2	"Y. S." Shpk	1,000
3	"S. M." Shpk	1,000
4	"A.." Shpk	3,000
5	"B. A." Shpk	4,000
6	"T.E." Shpk	2,000
7	"N." Shpk	3,000

Burimi: Bashkia Selenicë

Nga auditimi rezulton se në zonën Pyjore e Kullosore pronë/aset i Bashkisë Selenicë janë aktive leje minerare që kryejnë aktivitetin shfrytëzim Bitum, Rërë Bituminoze, Zhavor bituminoz, Gur gëlqeror, e Gëlqeror i mermerizuar 19 subjekte si më poshtë:

1. Subjekti "S. B." Shpk me Nipt K, ka marrë leje shfrytëzimi për bitum, zhavor bituminoz me nr. 355/1, datë 14.10.2016, për sipërfaqe 1.543 km^2, vendburimi Selenicë. (leja e mëparshme me nr. 355, datë 17.06.199, për sipërfaqe 1.70 km^2, me administratorë P. P.).

Nga ana e Bashkisë Selenicë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me llojin e pasurisë ku ushtrohet veprimtaria minerare (pyje/kullota), statusin e pasurisë dhe vlerën e përllogaritur për të paguar nga OE "S. B. Shpk", për sipërfaqen 154.30 ha ku ushtrohet veprimtaria minerare.

Në lidhje me veprimtarinë e "S. B. Shpk", grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me statusin e pronës ku subjekti "S. B. Shpk" ushtron veprimtarinë minerare.

Vlera e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguajë OE "S. B." Shpk për aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 153.30 ha, në Bashkinë Selenicë është **12,071,600 lekë.**

Nga Bashkia Selenicë nuk është zbatuar tarifa dysheme e qirasë vjetore për sipërfaqen e shfrytëzimit **153.30 ha** me vlerë ekonomike **12,071,600 lekë/vit.**

2. Subjekti "R." Shpk me Nipt J, ka marrë leje shfrytëzimi për zhavor bituminoz në fond pyjor/ kullosor nr. 390/1, datë 20.01.1998, për sipërfaqe 0.099 km^2, vendburimi "Vidhat e Haxhiut".

Nga Drejtoria e Pyjeve/Kullotave është përgatitur raporti *"Mbi studimin tekniko ekonomik për dhënien në përdorim nga fondi pyjor të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Selenicë"* me nr. 779/1 prot., datë 27.03. 2019 *(Z. Sh. D. inxhinier pyjesh, Z. P. H. Përgjegjës Kontrolli e Z. B. D. Përgjegjës Sektori z. G. L. Drejtor).*

Nga Drejtoria e Pyjeve nuk është formuluar/nënshkruar raportin tekniko ekonomik dhe nuk është përllogaritur qiraja (lekë/ha) për përdorimin e sipërfaqes e lejes minerare, në zbatim të tarifave dysheme, referua pikës 2 të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, *"Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave"*

*Për përdorim sipërfaqesh të fondit pyjor e kullosor publik, zbatohen **tarifat dysheme, që llogariten duke mbajtur parasysh përdorimin aktual të territorit dhe kohëzgjatjen e veprimtarisë së parashikuar**, sipas lidhjes 2 të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.*

Nga Bashkia Selenicë nuk është lidhur kontratë qiraje duke zbatuar tarifa ***minimale*** ligjore për zbatimin e kontratave të shfrytëzimit/kërkim për vlerën vjetore për sipërfaqen 9.90 ha. Për sipërfaqen 9.90 ha, qiraja vjetore minimale është **613,600** lekë/vit (9.90 ha x 62,000 lekë/ha.vit).
Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguajë OE "R." Shpk për aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 9.90 ha, në Bashkinë Selenicë është 613,600 lekë.
Nga Bashkia Selenicë nuk është zbatuar tarifa dysheme e qirasë vjetore për sipërfaqen e shfrytëzimit **9.90 ha** me vlerë ekonomike **613,600 lekë/vit.**

Në dosjen që administron bashkia gjendet Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 12, datë 28.09.2015 *"Për lirimin e hapësirës nga mineralet bituminoze",* dhe në mbështetje të kërkesës nr. 51, datë 07.03.2019 të OE "R." Shpk, për marrjen me qira për shesh depozitimi të materialeve minerare të zhavorrit bituminoz sipas lejes minerare të MIE.
Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 27, datë 28.03.2019 e nr. 848 Prot., datë 02.04.2019 është shprehur dakordësia për dhënien në përdorim të sipërfaqes 0.85 ha, të fondit pyjor, sipërfaqe inproduktive zhavorrishte e cila ndodhet ne ekonominë pyjore Selenicë, në ngastrën nr. 17a pronë publike ne administrim të Bashkisë Selenicë. Sipërfaqja që kërkohet për marrjen me qera nga verifikimi në terren rezulton sipërfaqe inproduktive, zhavorishte, ndërsa referuar regjistrit kadastral pasuria VL, parcela 17a, rezulton kullotë.

Me subjektin "R." Shpk, është lidhur kontrata me nr. 1144 prot., datë 06.05.2019 "Kontratë qiraje për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik *(për shesh depozitimi të materialit minerar zhavor bituminoz)" ndërmjet Bashkisë Selenicë e përfaqësuar nga Kryetari Z. P. Sh. dhe OE "R." Shpk përfaqësuar nga z. N. B.. Afati është për 10 vjet (nga data 06.05.2019 deri më 05.05.2029)*, vlera e qirasë vjetore është 85,000 lekë në vit.
Grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me statusin e ngastrës nr. 17a, ku ushtron aktivitet leja për shfrytëzim minerar nr. 390/1, datë 20.01.1998, për sipërfaqe 0.099 km^2. *(Në informacionin e datës 17.02.2021, nuk jepet sipërfaqe karriere në shfrytëzim nga ky subjekt).*
3. Subjekti "S." Shpk me Nipt J, me administrator z. G. H. ka marrë leje shfrytëzimi për gur gëlqeror nr. 552/1, datë 08.11.2011, për sipërfaqe **0.25 km^2,** vendburimi Kava e Azinës.
Nga raporti i datës 17.02.2021, nuk jepet informacion për sipërfaqen e karrierës në shfrytëzim.
Nga Bashkia Selenicë, nuk ka asnjë informacion në lidhje me sipërfaqen e lejes minerare në vendburimin "Kava e Azinës", nuk është lidhur kontratë qiraje duke zbatuar tarifa ligjore për zbatimin e kontratave të shfrytëzimit/kërkim-zbulimit për vlerën vjetore për sipërfaqen 25 ha.
- Për sipërfaqen **2.50 ha**, qiraja minimale/dysheme vjetore është **1,550,000** lekë (2.50ha x 62,000 lekë/ha.vit).
Nga grupi i auditimit është marrë në konsideratë vlera minimale 62,000 lekë/ha/vit, nuk është përllogaritur vlera e karrierës, pasi nuk disponohet informacion në lidhje me sipërfaqen e saj.
Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguajë OE "S." Shpk për aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 2.50 ha, në Bashkinë Selenicë është **155,000 lekë.**
Nga Bashkia Selenicë nuk është zbatuar tarifa dysheme e qirasë vjetore për sipërfaqen e shfrytëzimit **2.50 ha** me vlerë ekonomike **155,000 lekë/vit.**
4. Subjekti "N." Shpk me Nipt K, ka marrë leje shfrytëzimi për Gur Gëlqeror fond pyjorë nr. 594/1, datë 25.01.2012, për sipërfaqe 0.14 km^2 vendburimi Drashovicë.
Nga raporti i datës 17.02.2021 konstatohet se sipërfaqja e karrierës është 3,000 m^2.
Nga Bashkia Selenicë nuk është lidhur kontratë qiraje duke zbatuar tarifa ***minimale*** ligjore për zbatimin e kontratave të shfrytëzimit/kërkim-zbulimit për vlerën vjetore për sipërfaqen 14 ha.
a. Për karrierën 0.30 ha (3,000 m^2) qiraja vjetore është 132,000 lekë/vit (0.30hax440,000 lekë/ha.vit).

b. Për sipërfaqen **13.70** ha (14ha – 0.30ha), qiraja vjetore është 849,400 lekë/vit (13.70ha x 78,000 lekë/ha.vit).
Vlera e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguajë OE "N." Shpk për aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 14 ha, në Bashkinë Selenicë është **981,400 lekë.**
Nga Bashkia Selenicë nuk është zbatuar tarifa dysheme e qirasë vjetore për sipërfaqen e shfrytëzimit **14 ha** me vlerë ekonomike **981,400 lekë/vit.**
5. Subjekti "A." Shpk me Nipt K, administrator z. P. P. ka marrë leje shfrytëzimi për rërë bituminoze nr. 641, datë 16.08.2001, për sipërfaqe 1.42 km^2 vendburimi Treblovë.
Nga raporti i datës 17.02.2021, nuk jepet informacion për sipërfaqen e karrierës në shfrytëzim.
Nga Bashkia Selenicë nuk është lidhur kontratë qiraje duke zbatuar tarifa ***minimale*** ligjore për zbatimin e kontratave të shfrytëzimit/kërkim-zbulimit për vlerën vjetore për sipërfaqen 142 ha.
Për sipërfaqen **142 ha**, qiraja vjetore është **8,804,000** lekë/vit (142ha x 62,000 lekë/ha.vit).
Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguajë OE "A." Shpk për aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 142 ha, në Bashkinë Selenicë është **8,804,000 lekë.**
Nga Bashkia Selenicë nuk është zbatuar tarifa dysheme e qirasë vjetore për sipërfaqen e shfrytëzimit **142 ha** me vlerë ekonomike **8,804,000 lekë/vit.**
6. Subjekti "T. I." Shpk me Nipt L, administrator z. D. I. ka marrë leje shfrytëzimi për zhavor bituminoz fond pyjorë nr. 1115, datë 12.12.2007, për sipërfaqe 1.09 km^2 vendburimi Resulaj.
Nga raporti i datës 17.02.2021, nuk jepet informacion për sipërfaqen e karrierës në shfrytëzim.
Nga Bashkia Selenicë nuk është lidhur kontratë qiraje duke zbatuar tarifa ***minimale*** ligjore për zbatimin e kontratave të shfrytëzimit/kërkim-zbulimit për vlerën vjetore për sipërfaqen 109 ha.
Për sipërfaqen **109 ha**, qiraja minimale vjetore është **6,758,000** lekë/vit (109 ha x 62,000 lekë/ha.vit).
Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguajë OE "T. I." Shpk për aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 109 ha, në Bashkinë Selenicë është **6,758,000 lekë.**
Nga Bashkia Selenicë nuk është zbatuar tarifa dysheme e qirasë vjetore për sipërfaqen e shfrytëzimit **109 ha** me vlerë ekonomike **6,758,000 lekë/vit.**
6/1. Subjekti "M. B." Shpk ka marrë leje shfrytëzimi për zhavor bituminoz fond pyjorë nr. 1371, datë 22.09.2009, për sipërfaqe 1.09 km^2 vendburimi Resulaj.
Nga Bashkia Selenicë nuk është lidhur kontratë qiraje duke zbatuar tarifa ***minimale*** ligjore për zbatimin e kontratave të shfrytëzimit/kërkim-zbulimit për vlerën vjetore për sipërfaqen 32.40 ha.
a. Për karrierën 0.43 ha (4,300 m^2) qiraja vjetore është 189,200 lekë (0.43ha x 440,000 lekë/ha.vit).
b. Për sipërfaqen 31.97 ha (32.40ha – 0.43ha), qiraja vjetore është 1,982,140 lekë/vit (31.97ha x 62,000 lekë/ha.vit).
Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguajë OE "M. B." Shpk për aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 32.40 ha, në Bashkinë Selenicë është **2,171,000 lekë.**
Nga Bashkia Selenicë nuk është zbatuar tarifa dysheme e qirasë vjetore për sipërfaqen e shfrytëzimit **32.40 ha** me vlerë ekonomike **2,171,000 lekë/vit.**.
7. Subjekti "B. M. I." Shpk me Nipt K, administrator z. E. Ç. ka marrë leje shfrytëzimi për rërë bituminoz fond pyjor nr. 1496/2, datë 10.07.2013, për sipërfaqe 1.638 km^2 vendburimi Treblovë Romës.
Nga materiali i datës 17.02.2021, nuk ka sipërfaqe karriere në shfrytëzim nga subjekti.
Nga Bashkia Selenicë nuk është lidhur kontratë qiraje duke zbatuar tarifa ***minimale*** ligjore për zbatimin e kontratave të shfrytëzimit/kërkim-zbulimit për vlerën vjetore për sipërfaqen 163.80 ha.
Për sipërfaqen **163.80 ha**, qiraja vjetore është **10,155,600** lekë (163.80ha x 62,000 lekë/ha.vit).
Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguajë OE "B. M. I." Shpk për aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 163.80 ha, në Bashkinë Selenicë është **10,155,600 lekë.**
Nga Bashkia Selenicë nuk është zbatuar tarifa dysheme e qirasë vjetore për sipërfaqen e shfrytëzimit **163.80 ha** me vlerë ekonomike **10,155,600 lekë/vit.**
8. Subjekti "B. M. I." Shpk me Nipt K, administrator z. E. Ç. ka marrë leje shfrytëzimi për rërë bituminoz fond pyjor nr. 1496/2, datë 10.07.2013, për sipërfaqe 1.171 km^2 vendburimi Treblovë Romës.
Nga materiali i datës 17.02.2021, nuk ka sipërfaqe karriere në shfrytëzim nga subjekti.

Nga Bashkia Selenicë nuk është lidhur kontratë qiraje duke zbatuar tarifën *dysheme* ligjore për zbatimin e kontratave të shfrytëzimit/kërkim-zbulimit për vlerën vjetore për sipërfaqen 117.10 ha.
b. Për sipërfaqen **117.10 ha**, qiraja vjetore është **7,260,200** lekë (117.10ha x 62,000 lekë/ha.vit).
Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguajë OE "B. M. I." Shpk për aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 117.10 ha, në Bashkinë Selenicë është **7,260,200 lekë.**
Nga Bashkia Selenicë nuk është zbatuar tarifa dysheme e qirasë vjetore për sipërfaqen e shfrytëzimit **117.10 ha** me vlerë ekonomike **7,260,200 lekë/vit.**
9. **Subjekti "B. M. I." Shpk** me Nipt K, administrator z. E. Ç. ka marrë leje shfrytëzimi për zhavor bituminoz fond pyjorë/kullosor nr. 1578, datë 07.09.2012, për sipërfaqe 0.137 km^2 vendburimi Zona II Resulaj.
Konstatohet që OE "B. M. I." Shpk me Nipt K, administrator z. E. Ç. ka marrë leje shfrytëzimi për zhavor bituminoz fond pyjorë/kullosor nr. 1578, datë 07.09.2012, për sipërfaqe 0.137 km^2 vendburimi Zona II Resulaj, (pra leje minerare është aktive).
Subjekti i sipërcituar nuk ka lidhur kontratë qiraje për sipërfaqet pyjore dhe kullosore, por që i shfrytëzojnë këto pasuri për qëllime biznesi (nën kontraktim), nuk paguan asnjë taksë e tarifë vendore pasi nuk ka NIPT Sekondar për veprimtarinë minerare në Bashkinë Selenicë.
Nga informacioni i datës 17.02.2021, nuk jepet asnjë tregues për funksionimin e karrierës së shfrytëzimit.
Nga Bashkia Selenicë nuk është lidhur kontratë qiraje duke zbatuar tarifa ligjore *minimale* për zbatimin e kontratave të shfrytëzimit/kërkim-zbulimit për vlerën vjetore për sipërfaqen 13.70 ha.
b. Për sipërfaqen **13.70 ha**, qiraja vjetore është **849,400** lekë (13.70ha x 62,000 lekë/ha.vit).
Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguajë OE "B. M. I." Shpk për marrje me qira të sipërfaqes 13.70 ha, në Bashkinë Selenicë është **849,400 lekë/vit.**
Nga Bashkia Selenicë nuk është zbatuar tarifa dysheme e qirasë vjetore për sipërfaqen e shfrytëzimit **13.70 ha** me vlerë ekonomike **849,400 lekë/vit.**

9/1. OE "B. P." Shpk, me shkresën nr. 2749 prot., datë 16.10.2019 ka paraqitur kërkesën për marrjen e një sipërfaqe toke për ngritjen e kantierit dhe ndërtim të përkohshëm, pasi ka lidhur një marrëveshje nën kontraktimi me OE "B. M. I." Shpk.
Në zbatim të urdhrit nr. 182, e nr. 3441 prot., datë 03.12.2019 të Kryetarit të Bashkisë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave ka formuluar/nënshkruar raportin tekniko-ekonomik me nr. 278/1 prot., datë 23.01. 2021 (znj. B. R.- Inspektore Menaxhimi, z. P. H. Përgjegjës Sektori, z. Sh. D. inxhinier e z. B. K. Drejtor).
Me OE është lidhur kontratë qiraje nr. 3534 prot., datë 24.11.2021 "Kontratë qiraje për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik (për shesh depozitimi të materialit minerar zhavor bituminoz dhe ndërtim i çmontueshëm)" ndërmjet Bashkisë Selenicë e përfaqësuar nga Kryetari Z. P.B. dhe OE "B.P." Shpk përfaqësuar nga z. P.H. Afati është për 10 vjet (nga data 24.11.2020 deri më datë 23.11.2030), vlera e qirasë vjetore 140,000 lekë në vit.
10. Subjekti "A. I." Shpk me Nipt L, përfaqësuesit ligjor: z. P. D. dhe z. Q. T. ka marrë leje shfrytëzimi për zhavor bituminoz fond pyjor/kullosor nr. 1664, datë 02.07.2013, për sipërfaqe 0.36 km^2 vendburimi Selenicë.
Akt-Miratimin për Leje Minerare të Shfrytëzimit për mineralin zhavor bituminoz, që bën pjesë në grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet në zonën minerare nr. 748, të publikuar në hartën e planit vjetor minerar të vitit 2012, të subjektit "A.I." Shpk për kërkesën LC 8249 02- 2013 në vendburimin Selenicë, Qarku Vlorë.
Ky akt - miratimi shoqërohet me, aktin e verifikimit të AKBN për vlerësimin për kushtet e lejimit, oponencën e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit, Vendimin e Këshillit Teknik të AKBN nr. 152. datë 05.04.2013, (nr. 3460 prot., METE datë 10.04.2013 dhe nr. 2666 prot., AKBN datë 09.04.2013).

11. Subjekti "B.C." Shpk me Nipt L, administrator z. L. S. ka marrë leje shfrytëzimi për Zhavor Bituminoz & Bitum fond pyjor/kullosor nr. 1753, datë 15.05.2015, për sipërfaqe 0.322 km^2 vendburimi Selenicë.

Nga ana e Bashkisë Selenicë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me vlerën e bimësisë (pyje/kullota) të përllogaritur dhe të paguar nga OE "B.C." Shpk, për sipërfaqen 32.20 ha të miratuar për tu hequr në vijueshmëri nga zëri kadastral yjor/kullosor. Është konsideruar që gjithë sipërfaqja është karrierë. Nga informacioni i datës 17.02.2021 konstatohet se sipërfaqja e karrierës është 2,300 m^2.
Vlera e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguajë OE "B.C." Shpk për aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 32.20 ha, në Bashkinë Selenicë është **2,594,860 lekë.**
Nga Bashkia Selenicë nuk është zbatuar tarifa dysheme e qirasë vjetore për sipërfaqen e shfrytëzimit **32.20 ha** me vlerë ekonomike **2,594,860 lekë/vit.**

12. Subjekti "B. G." Shpk me Nipt L, administrator z. D. I. ka marrë leje shfrytëzimi për zhavor bituminoz & bitum nr. 1754, datë 21.05.2012, për sipërfaqe 0.251 km^2 vendburimi Selenicë.
Nga ana e Bashkisë Selenicë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me vlerën e përllogaritur dhe të paguar nga OE "B. G." Shpk, për sipërfaqen 25.10 ha të miratuar për tu hequr në vijueshmëri nga zëri kadastral. Është konsideruar që e gjithë sipërfaqja është karrierë. Nga informacioni i datës 17.02.2021, nuk konstatohet veprimtari e subjektit.
Vlera e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguajë OE "B. G." Shpk për aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 25.10 ha, në Bashkinë Selenicë është **1,556,200 lekë.**
Nga Bashkia Selenicë nuk është zbatuar tarifa dysheme e qirasë vjetore për sipërfaqen e shfrytëzimit **25.10 ha** me vlerë ekonomike **1,556,200 lekë/vit.**

Me OE është lidhur kontrata nr. 3798 prot., datë 31.12.2021 *"Kontratë qiraje për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik (për shesh depozitimi të materialit minerar zhavor bituminoz dhe ndërtim i çmontueshëm)"* ndërmjet Bashkisë Selenicë e përfaqësuar nga Kryetari Z. P.B. dhe OE "B. G." Shpk përfaqësuar nga z. D. I. Afati është për 10 vjet, vlera e qirasë vjetore vitin e parë 50,000 lekë/vit.

13. Subjekti "Y. S." Shpk me Nipt L, administrator z. Y. S. ka marrë leje shfrytëzimi për gëlqeror dekorativ fondi pyjor/kullosor nr. 1789, datë 14.01.2016, për sipërfaqe 0.198 km^2 vendburimi Lepenicë.
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se me nr. 4422 prot., datë 09.7.2016 Leje Mjedisi (Tipi B) me numër identifikimi 2044. Ky akt miratimi shoqërohet me aktin e verifikimit të AKBN për lejen minerare, vlerësimin për kushtet e lejimit të AKBN, dy oponenca të projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit, Vendimin e Këshillit Teknik të AKBN, nr. 415, datë 23.12.2015 (nr. 1312 prot., MEI datë 16.02.2016, dhe nr. 1917 prot., AKBN datë 12.02.2016).
Me shkresën nr. 6771 prot., datë 26.10.2016, "Për hartim të raportit tekniko ekonomik", Ministria e Mjedisit i ka kërkuar bashkisë realizimin e raportit në lidhje me kërkesën e OE "Y. S." Shpk për heqjen nga fondi kullosor të sipërfaqes sipas lejes minerare.
Në zbatim të urdhrit nr. 58, e nr. 1113 prot., datë 04.05.2018 të Kryetarit të Bashkisë, z. P.Sh. Drejtoria e Pyje-Kullota, ka formuluar/nënshkruar raporti tekniko ekonomik me nr. 88 prot., datë 15.05.2019.
Grupi i punës: z. P. H. (Inspektor Kontrolli), z. B. K. (përgjegjës Sektori) e z. A. V. (Inspektor Zone) nga data 08.05.2018 deri në datë 14.05.2018 ka realizuar verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore objektin për shfrytëzimin e gurit gëlqeror dekorativ.
Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, shoqëria kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur, vetëm pas lidhjes së kontratës me Bashkinë Selenicë dhe likuidimit të tarifës prej 422,244 lekë. *Kjo Shumë është paguar në raportin teknik të datës 09.11.2016, të kthyer nga Ministria.*
Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor rezulton se sipërfaqja e kërkuar është 19.80 ha, dhe shtrihet në:
- Ngastrën nr. 26, bën pjesë në ekonomisë pyjore Mali Bratit-Gumenicë me sipërfaqe 10.536 ha.
- Ngastrën nr. 13 bën pjesë në ekonomisë kullosore Gjorëm Vranisht me sipërfaqe 9.256 ha.
Referuar regjistrit kadastral prona VL, parcela nr. 26, përmban **ilqe.**
- Raporti është formuluar/nënshkruar nga: z. P.H., z. B. K., z. A. V., G. L. e zv. Kryetar z. N. V..

Nga ana e Bashkisë Selenicë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me vlerën e bimësisë (pyje/kullota) të përllogaritur dhe të paguar nga OE "Y. S." Shpk, për sipërfaqen 19.80 ha që duhet hequr në vijueshmëri nga zëri kadastral. Është konsideruar që e gjithë sipërfaqja është karrierë. Nga informacioni i datës 17.02.2021 konstatohet se sipërfaqja e karrierës është 1,000 m^2.
Vlera e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguajë OE "**Y. S.**" Shpk për aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 32.20 ha, në Bashkinë Selenicë është **1,767,824 lekë.**
Nga Bashkia Selenicë nuk është zbatuar tarifa dysheme e qirasë vjetore për sipërfaqen e shfrytëzimit **19.80 ha** me vlerë ekonomike **1,767,824 lekë/vit.**

Me OE është lidhur kontrata nr. 564 prot., datë 19.02.2021 "Kontratë qiraje për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik (për ndërtim/përdorim rruge dhe linjë tensioni)" ndërmjet Bashkisë Selenicë e përfaqësuar nga Kryetari Z. P. B. dhe OE "Y. S." Shpk përfaqësuar nga z. Y. S.. Vlera e qirasë vjetore vitin e parë 120,000 lekë, (që përbëhet nga) vlera e përdorimit të rrugës 1km x70,000lekë] b) 50,000 lekë nga raporti teknik.
OE "Y. S." Shpk, ka marrë në përdorim:
a) linja gjatësore, për ndërtim/përdorim të rrugës, në gjatësinë e 9.80 km, me gjerësi 6 m, për lidhjen e karrierës në zonën minerare 70/5, me rrjetin rrugor egzistues, rruga nacionale Kotë Brata,
b) për ndërtimin/përdorim të linjës së tensionit 35 KË,në gjatësinë lineare prej 1,2 km, për vënien në shfrytëzim të aktivitetit, sipas lejes përkatësë minerare, të cilat janë pjesë të fondit Pyjor/Kullosor, pronë publike e Bashkisë, në Ekonominë Kullosore Gjormë Vranisht dhe në Ekonominë Pyjore Mali Bratit Gumenicë, **sipas tabelës së raportit teknik,** të hartuar dhe miratuar, bashkëlidhur, në administrim të Bashkisë Selenicë.
Në proces verbalin nr. 239 Prot, datë 19.11.2020 është konstatuar se subjekti "Y. S." Shpk ka hapur rrugë në ekonominë pyjore Mali Bratit-Gumenicë me gjerësi 4ml dhe gjatësi 275 ml dhe nga dëmtimi i rrugës pa leje është dëmtuar sipërfaqja e kullotës 1100 m^2 dhe 4 dru lisi me diameter 10.1-20 cm.
Shkelja është klasifikuar referuar VKM-së nr. 1354, datë 10.10.2008 "Për kriteret e përcaktimit të vlerës së dëmit të shkaktuar në fondin kullosor", lidhja 8, pika 1 duke mbajtur proces verbalin nr. 240 Prot, datë 19.11.2020 sipas të cilit vlera e dëmit është 1,132,000 lekë.
Për këtë shkelje inspektori i zonës A. L. ka vendosur ndaj subjektit "Y. S. SHPK" gjobën me nr. serie 00.002, datë 19.11.2020 me vlerë 50,000 lekë.
Me vendim nr. 02 datë 24.10.2020 Komisioni me anëtarë M. H., P. A. dhe B. K. ka vendosur që të gjitha proces verbalet e mbajtura më datë 19.11.2020 të mos merren parasysh pasi rruga e ndërtuar nga ky subjekt kalon në karrierën e subjektit të miratuar. Vendimi nuk shoqërohet me dokumentacion justifikues.
14. Subjekti "A" Shpk me Nipt L. administrator z. P. V. ka marrë leje shfrytëzimi për "gëlqeror dekorativ, fond pyjor/kullosor nr. 1792, datë 10.03.2016, për sipërfaqe 0.14 km^2 vendburimi Lepenicë.
Me shkresën nr. 7458 prot., datë 14.9.2018 "Për përgatitjen e raportit tekniko ekonomik", Ministria e Turizmit dhe Mjedisit i ka kërkuar bashkisë realizimin e raportit në lidhje me kërkesën e OE "A.." Shpk për heqjen nga fondi kullosor të sipërfaqes sipas lejes minerare.
Në zbatim të urdhrit nr. 149, e nr. 2969 prot., datë 05.11.2018 të Kryetarit të Bashkisë, z. P.Sh. Drejtoria e Pyje-Kullota, ka formuluar/nënshkruar raporti tekniko ekonomik me nr. 38 prot., datë 13.02.2019.
Grupi i punës: Z. Sh. D. (Inxhinier Pyjesh) z. P.H. (Inspektor Kontrolli), nga data 11.12.2018 deri në datë 12.12.2018 ka realizuar verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore objektin për shfrytëzimin e gurit gëlqeror dekorativ.
Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor rezulton se sipërfaqja e kërkuar është 14.064 ha, dhe shtrihet në ngastrat/nënngastrat; 19; 25 e 26 të ekonomisë pyjore Mali Bratit-Gumenicë dhe ngastrat/nënngastrat; 13 e 14 të ekonomisë kullosore Gjorëm Vranisht, dhe janë në pronësi/administrim të bashkisë Selenicë.
Raporti është formuluar/nënshkruar nga: z. Sh. D., z. P. H., z. G. L. e z. N. V..
Vendimi i Këshillit Bashkiak me nr. 47, datë 24.05.2019 "Për shprehjen e dakortësisë për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor" (Ridërgimi i VKB nr. 24, datë 28.03.2019).

Me shkresën nr. 856/1 Prot., datë 12.06.2019 "Shprehje për ligjshmërinë për Vendimin e Këshillit të Bashkisë Selenicë", pika 11.
Subjekti "A" Shpk, me nr. 29 prot., datë 07.01.2019, ka kërkuar të marrë në përdorim me kontratë rrugën dhe linjën elektrike për të shkuar në karrierë.
Me subjektin është lidhur kontrata nr. 1437 prot., datë 02.08.2016 "Kontratë qiraje për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik (për rrugë në gjatësinë 1.5 km)" ndërmjet Bashkisë Selenicë e përfaqësuar nga Kryetari Z. P.Sh. dhe OE "A" Shpk përfaqësuar nga z. P. V. Vlera e qirasë vjetore vitin e parë 75,000 lekë, për përdorimit e rrugës (1.5 km x50,000lekë).
OE "A" Shpk, ka marrë me qira për përdorim:
- Për nxjerrjen minerale, gëlqeror, dekorativ në Zonën Minerare Konkurruese nr. 70/6 në sipërfaqen prej 6000 m^2 me (450.000 lekë/ha/vit).
- Sipërfaqen prej 1.5 Km (1.5 x 50,000 lekë/km/vit=75,000 lekë) për rrugë kalimi/ e drejte kalimi, për të bërë të mundshëm kalimin nga rruga kryesore për në sipërfaqen e marrë në përdorim.
Kontrata për dhënien në përdorim të sipërfaqes të përcaktuar, për ushtrimin e veprimtarisë "Leje minerare shfrytëzimi me nr. LC-6195-10-2015, datë 29.10.2015, në zonën minerare konkurruese Nr.70/6, minerare dekorativ, objekti Lepenicë rrethi Vlorë, qarku Vlorë, miratuar në planin vjetor të vitit 2015, vetëm sipas qëllimit dhe sipërfaqes të miratuar nga Bashkia për ushtrimin e veprimtarisë dhe kërkesave të përcaktuara në kontratë.
Kontrata e Qerasë lidhet për një afat deri 10 (dhjetë) vjet, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj më, 02.08.2016 deri në 01.08.2026 me të drejtë rinovimi, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.
Nga ana e Bashkisë Selenicë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me vlerën e bimësisë (pyje/kullota) të përllogaritur dhe të paguar nga OE "A." Shpk, për sipërfaqen 14 ha për fillimin e procesit të heqjes nga zëri kadastral. Është konsideruar që gjithë sipërfaqja është karrierë. Nga informacioni i datës 17.02.2021 konstatohet se sipërfaqja e karrierës është 3,000 m^2.
Vlera e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguajë OE "A" Shpk për aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 32.20 ha, në Bashkinë Selenicë është **1,200,600 lekë.**
Nga Bashkia Selenicë nuk është zbatuar tarifa dysheme e qirasë vjetore për sipërfaqen e shfrytëzimit **14 ha** me vlerë ekonomike **1,200,600 lekë/vit.**.
15. Subjekti "**M. P." Shpk** me Nipt L, administrator z. E. S. ka marrë leje shfrytëzimi për gëlqeror i mermerizuar fond pyjorë nr. 1826, datë 12.12.2016, për sipërfaqe 0.997 km^2 vendburimi Lepenicë. Leja minerare është me afat shfrytëzimi për 25 vjet me të drejtë rinovimi.
- Me shkresën nr. 4472/4 prot., datë 03.12.2018 "Për përgatitjen e raportit tekniko ekonomik", Ministria e Turizmit dhe Mjedisit i ka kërkuar bashkisë realizimin e raportit në lidhje me kërkesën e OE "M. P." Shpk për heqjen nga fondi kullosor të sipërfaqes sipas lejes minerare.
- Në zbatim të urdhërit nr. 165, e nr. 3267 prot., datë 13.12.2018 të Kryetarit të Bashkisë, z. P.Sh. Drejtoria e Pyje-Kullota, ka formuluar/nënshkruar raporti tekniko ekonomik me nr. 37 prot., datë 13.02.2019.
- Grupi i punës: Z. Sh. D. (Inxhinier Pyjesh) z. P. H. (Inspektor Kontrolli) dhe z. B. K., nga data 17.12.2018 deri në datë 18.12.2018 ka realizuar verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore objektin për shfrytëzimin e gurit gëlqeror dekorativ.
- Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor rezulton se sipërfaqja e kërkuar është 55.548 ha, dhe shtrihet në ngastrat/nënngastrat; 19;25;26;28;29;30 të ekonomisë pyjore Mali Bratit-Gumenicë, dhe janë në pronësi/administrim të bashkisë Selenicë.
Raporti është formuluar/nënshkruar nga: z. Sh. D., z. P.H., z. G. L., z. B. K. e z. N.V.
Vlera e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguajë OE "M. P." Shpk për aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 55.548 ha, në Bashkinë Selenicë është **5,309,148 lekë.**
Nga Bashkia Selenicë nuk është zbatuar tarifa dysheme e qirasë vjetore për sipërfaqen e shfrytëzimit **55.958 ha** me vlerë ekonomike **5,309,148 lekë/vit.**
- Vendimi i Këshillit Bashkiak me nr. 48, datë 27.05.2019 "Për shprehjen e dakordësisë për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor".
- Me shkresën nr. 856/1 Prot., datë 12.06.2019 "Shprehje për ligjshmërinë për Vendimin e Këshillit të Bashkisë Selenicë", pika 12.

- Me nr. 2009 prot., datë 25.04.2021 "Kontratë qiraje për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik (për rrugë në gjatësinë 1 km) e lidhur ndërmjet Bashkisë Selenicë e përfaqësuar nga Kryetari Z. P. B. dhe OE "M. P." Shpk përfaqësuar nga z. E. S.. Vlera e qirasë vjetore vitin e parë 120,000 lekë . (që përbëhet nga;a) vlera e përdorimit të rrugës [1km x70,000lekë] b) 50,000 lekë nga raporti teknik, i është dhënë me qira OE "M. P." Shpk, për dhënie në përdorim rruga me gjatësi 1 (një) km e cila është pjesë e fondit pyjor kullosor publik bashkiak, në ekonominë pyjore Mali Bratit, Gumenicë ngastrat nr .26 dhe nr. 28, në administrim nga Bashkia Selenicë për ushtrimin e veprimtarisë Leje minerare shfrytëzimi datë 12.12.2016 për mineralin gëlqeror i mermerizuar në zonën minerare nr. 70/08"

OE "M. P.", Shpk ka të drejtë të përdor sipërfaqen prej 1 km rrugë me gjerësi 10 m dhe sipërfaqja e objektit 1 ha, për një afat 10 vjet.

Në dosjen e subjektit "M. P." Shpk, gjenden Akt-konstatime mbi aktivitetin e subjektit.

1. Në proces verbalin nr. 253 Prot, datë 14.12.2020 është konstatuar se subjekti "M. P." Shpk ka hapur rrugë në ekonominë kullosore Gjorm-Vranisht me gjerësi 4ml dhe gjatësi 1500 ml dhe nga dëmtimi i rrugës është dëmtuar sipërfaqja e kullotës 6000 m^2 dhe 31 dru lisi me diameter 60.1-70 cm.

Shkelja është klasifikuar referuar VKM-së nr. 1354, datë 10.10.2008 "Për kriteret e përcaktimit të vlerës së dëmit të shkaktuar në fondin kullosor", pika A, lidhja 8, pika 1 dhe grupi i punës (Inspektor i zonës A. A., Përgjegjës Sektori P. A. dhe Inxhinier G. S.) kanë vlerësuar dëmin me 7,054,000 lekë. Për këtë shkelje inspektori i zonës A. L. ka vendosur ndaj subjektit "M. P." Shpk gjobën me nr. serie 00.0004, datë 14.12.2020 me vlerë 50,000 lekë.

Rezulton se nga Drejtori i Drejtorisë së Pyjeve z. B. K. është vendsur të verifikohet edhe një herë dëmi i shkaktuar pasi në akt konstatim shënohet se subjekti ka hapur rrugë në ekonomi kullosore dhe ndërkohë ka prerë drurë. Në dosje nuk administrohet dokumentacion lidhur me arkëtimin apo jo të kësaj vlere apo lidhur me ecurinë e kësaj procedure.

2. Në proces verbalin nr. 19 Prot, datë 24.02.2021 "Për konstatimin e kundërvajtjes administrative në pyje", i mbajtur nga Inspektori A. L., Përgjegjësi i Sektorit P. A., Inxhinieri G. S., është konstatuar se subjekti "M. P." Shpk ka hapur rrugë në ekonominë pyjore Gjorm-Vranisht me gjerësi 6ml dhe gjatësi 1500 ml jashtë sipërfaqes së kërkuar për heqje nga fondi pyjor dhe janë dëmtuar 31 dru lisi me diameter 60.1-70 cm.

Shkelja është klasifikuar referuar VKM-së nr. 1354, datë 10.10.2008 "Për kriteret e përcaktimit të vlerës së dëmit të shkaktuar në fondin kullosor", lidhja 8, pika 1 dhe është mbajtuar proces verbali nr. 20 Prot, datë 24.02.2021 dhe vlera e dëmit është 1,054,000 lekë.

Në referencë të Ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", neni 36, pika 5 kjo shkelje përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, dhe si rezultat nga inspektori A. L. ndaj subjektit "M. P. SHPK" është vendorur gjobë në vlerën 100,000 lekë.

Komisioni me përbërje z. B.K., P. A. dhe M. H. ka marrë vendimin nr. 2 datë 01.03.2021 ndaj subjektit "M. P. SHPK" për të paguar shumën totale prej 1,154,000 lekë ku 100,000 lekë është vlera e gjobës dhe 1,054,000 lekë është vlera e dëmit.

Në dosje nuk administrohet dokumentacion lidhur me ecurinë e arkëtimit të gjobës si dhe pagesën e dëmit që ka shkaktuar subjekti "M. P. SHPK".

Në vijim të procedurave me shkresën nr. 1132 Prot, datë 15.04.2021 nga Drejtori i DZHBAPK z. B. K. i është kërkuar Kryetarit të Bashkisë z. P. B. marrja e masave për bllokimin e mjeteve të subjektit "M. P." SHPK me agrumentimin se subjekti vazhdon punën pa leje si dhe pa shlyer detyrimet për raportin teknik në vlerën 2,314,400 lekë.

16. Subjekti "T. E." Shpk me Nipt J, administrator z. A. T. ka marrë leje shfrytëzimi sipas çështjes LC - 0023-04-2017 për zonën minerare nr. 70/11, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, që bën pjesë në grupin e mineraleve ndërtimore nr. 1844, datë 13.09.2017, për sipërfaqe 0.127 km^2 vendburimi Gumenicë (sipërfaqja që preket është 12.7542 Ha).

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se me aktin e miratimit të lejes minerare nr. 539 prot., datë 06.06.2017 Leje Mjedisi (Tipi B) me numër identifikimi 2623. Ky akt miratimi shoqërohet me; aktin e verifikimit të AKBN për lejen minerare të shfrytëzimit, vlerësimin për kushtet e lejimit të AKBN, oponencën e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit, Vendimin e Këshillit

Teknik të AKBN, nr. 561, datë 12.06.2017, me (nr. 4612 prot. MEI datë 21,06.2017 dhe mr. 5037 prot AKBN datë 20.06.2017).
Sipërfaqja që zihet nga leja minerare nr.1844, datë 13.09.2017, Gumenicë sipërfaqje që është kërkuar të hiqet nga fondi pyjor kullosor:
Me shkresën nr. 1234 prot., datë 15.5.2019 "Raportet tekniko-ekonomik për heqjen nga fondi pyjor/ kullosor, për kryerjen e aktivitetit minerar për shoqërinë "T. E." Shpk" Kryetari i Bashkisë z. P.Sh. i ka drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ka dërguar zyrtarisht:
1- Raportin tekniko-ekonomik për dhënie në përdorim/heqje nga fondi pyjor dhe kullosor të sipërfaqeve në pronësi publike të bashkisë Selenicë", për lejen minerare nr. 1844, datë 13.9.2017.
2- Tabelat e llogaritjes të sasisë dhe vlerës financiare, për lejet minerare nr. 1844, datë 13.9.2017, të miratuar nga MIE.
3- Urdhrin nr. 38 e nr. 633 prot., datë 11.03.2019 e Kryetarit për vijimin e procedurave.
4- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 21, datë 28.03.2019 "Për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kullosor, Brenda territorit administrative".
5- Me nr. 512/1 prot., datë 15.04.2019, konfirmimi i ligjshmërisë nga ana e Prefektit Qarkut Vlorë për Vendimin e KB.
Me nr. 673 Prot., datë 15.03.2019, Drejtoria e Pyje Kullotave, është hartuar/nënshkruar *"Raport mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënie në përdorim/heqje nga fondi pyjor dhe kullosor të sipërfaqeve në pronësi publike të bashkisë Selenicë",* në zbatim të urdhrit të nr. 38 Prot., datë 11.03.2019 të Kryetarit të Bashkisë, dhe shkresës nr. 1998/1, datë 22.09.2019, të Ministrisë së Turizmit, nga grupi i punës: Z. Sh. D. Inxhinier pyjesh, Z. P. H. Përgjegjës Kontrolli, dhe Z. B. K. Përgjegjës Sektori, nga data 12.03.2019 deri në datën 12.03.2019, ku citohet *Mbështetur në të dhënat e regjistrit pyjor/kullosor rezulton që sipërfaqja të kërkuar është 12.74 ha dhe shtrihet në ngastrat/nëngastrat nr. 2 me sipërfaqet 11.43 ha në ekonominë kullosore Gjormë-Vranisht dhe në ngastrat 45, 46 me sipërfaqe respektive 0.56 ha dhe 0.75 ha në ekonomin pyjore dhe janë në pronësi/administrim të bashkisë Selenicë.*
Leja minerare ka një periudhë shfrytëzimi 3(tre) vjeçar dhe duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi është kërkuar heqja nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe 0.35.59 km^2.
Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 21, datë 28.03.2019 e nr. 842 prot., datë 02.04.2019 është shprehur dakortësia për dhënien në përdorim të sipërfaqes 12.74 ha, të fondit pyjor/kullosor, ndodhet ne ekonominë pyjore Selenicë.
Nga Bashkia Selenicë nuk është lidhur kontratë qiraje duke zbatuar tarifa ligjore *minimale* për zbatimin e kontratave të shfrytëzimit/kërkim-zbulimit për vlerën vjetore për sipërfaqen 12.74 ha.
Për sipërfaqen **12.74 ha**, qiraja vjetore është 993,720 lekë (12.74ha x 78,000 lekë/ha/vit).
Vlera e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguajë OE "**T. E.**" Shpk për aktivitetin minerar sipas lejes në sipërfaqen 12.74 ha, në Bashkinë Selenicë është **993,720 lekë.**
Nga Bashkia Selenicë nuk është zbatuar tarifa dysheme e qirasë vjetore për sipërfaqen e shfrytëzimit **12.74 ha** me vlerë ekonomike **993,720 lekë/vit.**
17. Subjekti "T. E." Shpk me Nipt J, me administrator z. A. T. ka marrë leje shfrytëzimi sipas çështjes LC -0029-04-2017 për zonën minerare nr. 70/10, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, që bën pjesë në grupin e mineraleve ndërtimore nr. 1845, datë 13.09.2017, për sipërfaqe 1.00 km^2 vendburimi Gjorm. (sipërfaqja që preket është 100 ha)
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se me nr. 539 prot., datë 06.06.2017, Leje Mjedisi (Tipi B) me numër identifikimi 2623. Ky akt miratimi shoqërohet me; aktin e verifikimit të AKBN për lejen minerare të shfrytëzimit, vlerësimin për kushtet e lejimit të AKBN, oponencën e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit, Vendimin e Këshillit Teknik të AKBN, nr. 560, datë 12.06.2017, me (nr. 4613 prot. MEI datë 21,06.2017 dhe nr. 5036 prot., AKBN datë 20.06.2017).
Sipërfaqja që zihet nga leja minerare nr.1845, datë 13.09.2017, Gjorm sipërfaqje që është kërkuar të hiqet nga fondi pyjor kullosor.
Në datë 08.06.2018, Akt Konstatimi, i mbajtur në fshatin Gjormë, nga z. A. V. (Inspektor i Zonës) dhe z. B. K., gjatë inspektimit në parcelat nr. 5; 42; 44 e 45, në Ekonominë Pyjore/Kullosore Mali Bratit -

Gumenicë, me emërtimin popullor “Moçali Hoxhë”, subjekti “T. E.” Shpk ka filluar rrugën në gjatësinë 2.512 km, pa marrë miratimin në Këshillin Bashkiak dhe pa Raportin Teknik për këtë sipërfaqe.
-Administratori i “T. E.” Shpk” me nr. 75/2018 prot., datë 15.02.2018 “Kërkesë për heqje nga fondi Pyjor/kullosor të sipërfaqes së rrugës Gjorm Gumenicë- territor i lejes minerare të shfrytëzimit nr. 1845, datë 13.09.2017.
Me shkresën nr. 1234 prot., datë 15.5.2019 **“**Raportet tekniko -ekonomik për heqjen nga fondi pyjor/kullosor, për kryerjen e aktivitetit minerar për shoqërinë “T. E.” Shpk” Kryetari i Bashkisë z. P. Sh. ka dërguar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit:
1-Me **nr. 673 Prot., datë 15.03.2019,** *"Raport mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënie në përdorim/heqje nga fondi pyjor dhe kullosor të sipërfaqeve në pronësi publike të bashkisë Selenicë", nga grupi i punës:* Z. Sh. D. Inxhinier pyjesh, Z. P. H.j Përgjegjës Kontrolli, dhe Z. B. K. Përgjegjës Sektori, nga data 12.03.2019 deri në datën 12.03.2019, nënshkruar nga z. G. L. e konfirmuar nga z. N. V. zv. Kryetar.
2- Tabelat e llogaritjes të sasisë dhe vlerës financiare, për lejet minerare nr. 1845, datë 13.9.2017, të miratuar nga MIE.
3- Urdhrin nr.38 e nr. 633 prot., datë 11.03.2019 e Kryetarit për vijimin e procedurave.
4- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 22, datë 28.03.2019 “Për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kullosor, Brenda territorit administrative”
5- Me nr. 512/1 prot., datë 15.04.2019, konfirmimi i ligjshmërisë nga ana e Prefektit Qarkut Vlorë për Vendimin e KB.
Me nr. 664 Prot., datë 15.03.2019, Drejtoria e Pyje Kullotave, është hartuar/nënshkruar *”Raport mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënie në përdorim/heqje nga fondi pyjor dhe kullosor të sipërfaqeve në pronësi publike të bashkisë Selenicë”,* në zbatim të urdhrit të nr. 39 prot, datë 11.03.2019 të Kryetarit të Bashkisë, dhe shkresës nr. 1998, datë 22.02.2019 të Ministrisë së Turizmit, është ngritur grupi i punës: Z. Sh. D. Inxhinier Pyjesh, Z. P. H. Përgjegjës Kontrolli, dhe Z. B. K. Përgjegjës Sektori, nga data 12.03.2019 deri në datën 12.03.2019, ku citohet *Mbështetur në të dhënat e regjistrit pyjor/kullosor rezulton që sipërfaqja të kërkuar është 35.58 ha dhe shtrihet në ngastrat/nëngastrat nr. 4, bën pjesë në ekonominë kullosore.*
- Me nr. 664 Prot., datë 15.03.2019, Drejtoria e Pyje Kullotave, ka hartuar/nënshkruar *“Raport mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënie në përdorim/heqje nga fondi pyjor dhe kullosor të sipërfaqeve në pronësi publike të bashkisë Selenicë”*

Nga informacioni i datës 17.02.2021 konstatohet se sipërfaqja e karrierës është 2,000 m^2, pa përcaktuar se për kë leje minerare bëhet fjalë. (nga grupi i auditimit është konsideruar që karriera gjendet në lejen minerare nr. 1845, datë 13.09.2017.
Nga Bashkia Selenicë nuk është lidhur kontratë qiraje duke zbatuar tarifa ligjore për zbatimin e kontratave të shfrytëzimit/kërkim-zbulimit për vlerën vjetore për sipërfaqen 35.95 ha.
a. Për karrierën 0.20 ha (2,000 m^2) qiraja vjetore është **88,000** lekë (0.10ha x 440,00 lekë/ha.vit).
b. Për sipërfaqen 35.75 ha (35.95ha – 0.20ha), qiraja vjetore është 3,432,200 lekë (35.75ha x 96,000 lekë/ha.vit).
Vlera e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguajë OE “T.E.” Shpk për aktivitetin minerar sipas lejes në sipërfaqen 35.95 ha, në Bashkinë Selenicë është **3,520,000 lekë.**
Nga Bashkia Selenicë nuk është zbatuar tarifa dysheme e qirasë vjetore për sipërfaqen e shfrytëzimit **35.95 ha** me vlerë ekonomike **3,520,000 lekë/vit.**

Me subjektin është lidhur kontrata e qirasë nr. 1902 prot., datë 16.07.2018 për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik (për rrugë 2.50 km = 1,507 ha) ndërmjet Bashkisë Selenicë, përfaqësuar nga Kryetari z. P. Sh. dhe OE “T. E.” Shpk, përfaqësuar nga administrator z. A. T., për përdorimin e sipërfaqes prej 2.50 km rrugë me gjerësi 5-6m me sipërfaqja e objektit 1.507 ha, pjesë e fondit pyjor/kullosor publik të bashkisë, në ekonominë pyjor Mali Bratit Gumenicë dhe ngastrat nr. 42;44 e 45 dhe në ekonominë kullosore Gjorm -Vranisht nr. 5. Vlera vjetore e qirasë është 90,545 lekë me një afat 2 (dy) vjet.

18. Subjekti "S. M." Shpk me Nipt L., administrator z. M. K. ka marrë leje shfrytëzimi për Gur Gëlqror fond pyjorë nr. 1863, datë 16.07.2018, për sipërfaqe **1.329 km^2** vendburimi Brataj.
Me subjektin është lidhur kontrata nr. 2074 prot., datë 25.04.2021 "Kontratë qiraje për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik (për rrugë në gjatësinë 1 km)" ndërmjet Bashkisë Selenicë e përfaqësuar nga Kryetari Z. P. B. dhe OE "S. M." Shpk përfaqësuar nga z. M. K.. Vlera e qirasë vjetore vitin e parë 35,000 lekë, vlera e përdorimit të rrugës [1km x35,000lekë].
OE "**S. M." Shpk** ka në përdorim gjatësinë lineare të rrugës prej 1 (një) km, e cila është pjesë e fondit Pyjor/Kullosor publik Bashkiak, në ekonominë kullosore Gjorm-Vranisht ngastra nr. 13, në administrim nga Bashkia Selenicë për ushtrimin e veprimtarisë *"Leje minerare shfrytëzimi datë 17.07.20 për mineralin gëlqeror i mermerizuar në zonën minerare nr. 70/9"*
Nga ana e Bashkisë Selenicë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me vlerën e e bimësisë (pyje/kullota) të përllogaritur dhe të paguar nga OE "**S.M.**" Shpk, për sipërfaqen 132.90 ha që duhet hequr në vijueshmëri nga zëri kadastral. Është konsideruar që gjithë sipërfaqja është karrierë. Nga informacioni i datës 17.02.2021 konstatohet se sipërfaqja e karrierës është 1,000 m^2.
Vlera e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguajë OE "**S. M.**" Shpk për aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 132.90 ha, në Bashkinë Selenicë është **10,402,400 lekë.**
Nga Bashkia Selenicë nuk është zbatuar tarifa dysheme e qirasë vjetore për sipërfaqen e shfrytëzimit **132.90 ha** me vlerë ekonomike **10,402,400 lekë/vit.**
19. Subjekti "B. A." Shpk me Nipt L, administrator z. D. Xh. ka marrë leje shfrytëzimi për Gur Gëlqeror fond pyjorë nr. 1867, datë 17.10.2018, për sipërfaqe 2.48 ha vendburimi Kaninë. Ka kaluar në NjQV Bashkia Vlorë.
Me nr. 1112 prot., datë 30.04.2019 "Kontratë qiraje për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik (për ndërtim rruge lidhëse)" e lidhur ndërmjet Bashkisë Selenicë e përfaqësuar nga Kryetari Z. P. Sh. dhe OE "B. A." Shpk përfaqësuar nga z. D. Xh.. Vlera e qirasë vjetore vitin e parë 105,000 lekë, për përdorimit e rrugës (3 km x 8m).
OE "B. A.**" Shpk, ka marrë me qira për përdorim:** gjatësia lineare prej 3 km (tre kilometra), me gjeresi 8 ml për ndërtim rruge lidhëse nga rruga kryesore (ish karriera ekzistuese) me sipërfaqen karrierë për shfrytëzim guri gëlqeror të mermerizuar e cila është pjesë e fondit kullosor pronë publike e bashkisë , në Ekonominë Kullosore Shashicë- Gumenicë ne objektin Drashovicë në ngastrën nr. 16, sipas tabelës së raportit teknik bashkëlidhur, në administrim të Bashkisë Selenicë.
Kontrata e Qerasë lidhet për një afat deri 10 (dhjete) vjet, duke filluar nga data e nënshkrimit të sajë më, 30.04.2019 deri në 29.04.2029 me të drejtë rinovimi, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.

<u>Problematika në lidhje me bimë drusore të klasifikuar në: "listën e kuqe të florës së egër"</u>
Me procesverbalin nr. 2226 prot., datë 14.07.2021 **"**Për kontrollin në subjektin "M.P." Shpk", në parcelën 26, ekonominë pyjore/kullosore Mali Bratit Gumenicë të formuluar/nënshkrua nga Z. A. L. (Inspektor i Zonës) Z. P.A. (Përgjegjës Sektori) e z. G. S. ku shprehen
1. Subjekti "M. P." Shpk, ushtron aktivitet në pyllin **me ilqe**. Ilqet janë të ndaluara me ligj, të vlerësohen për të dëmtuarat.
2. Raportet tekniko ekonomike për heqjen nga fondi pyjor/kullosor janë abuzive. Nëpërmjet këtyre raporteve është favorizuar Subjekti "M. P." Shpk, duke iu shkaktuar dëm financiar Bashkisë Selenicë.
Në volumin rreth 3,600 m^3 lëndë drusore, janë vlerësuar 110 m^3, ndërsa dru zjarri 3,550 m^3.
Lënda drusore në raport është rreth 3% kur në fakt duhej të vlerësohej 75%. Vlera e 1 (një)m^3 lëndë druri është 3,600 lekë/m^3, kurse vlera e 1 (një) m^3 druri zjarri është 3,600 lekë/m^3.
Duke ndryshuar këtë raport është dhe dëmi ekonomik.
Nga grupi i auditimit u konstatua që:
Për subjekti "Y. S." Shpk,
-Në raport tekniko- ekonomik me nr. 88 prot, datë 15.05.2018, të formuluar/nënshkruar nga Grupi i punës: z. P. H. (Inspektor Kontrolli), z. B. K. (përgjegjës Sektori) e z. A. V. (Inspektor Zone), është cituar: "Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor rezulton se sipërfaqja e kërkuar është 19.80 ha, dhe shtrihet në:

- ngastrën nr. 26, bën pjesë në ekonomisë pyjore mali Bratit-Gumenicë me sipërfaqe 10.536 ha.
- ngastrën nr. 13 bën pjesë në ekonomisë kullosore Gjorëm Vranisht me sipërfaqe 9.256 ha.
referuar regjistrit kadastral prona VL3300026, parcela nr. 26, përmban ilqe.

Në raport (përveç tabelës bashkangjitur raportit), nuk është përmendur statusi i veçantë i llojit të bimësisë, pasi është konsideruar si dru zjarri "trungishte".

Për Subjekti "A." Shpk:
-Në raport tekniko- ekonomik me nr.38 prot, datë 13.02.2019, të formuluar/nënshkruar nga Grupi i punës: Z. Sh. D. (Inxhinier Pyjesh) z. P. H. (Inspektor Kontrolli) , është cituar: Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor rezulton se sipërfaqja e kërkuar është 14.064 ha, dhe shtrihet në:
- ngastrat nr. 19; 25; 26 bën pjesë në ekonomisë pyjore mali Bratit-Gumenicë me sipërfaqe dhe ngastrat /nëngastart 1; 14, të ekonomisë kullosore Gjorëm Vranisht.
Përshkrimi parcelor i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj, pasqyrohen në tabelën 1; 2; 3;4; 5 të këtij raporti. Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje; sipas tabelave 1 dhe 2.
Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria "A" Shpk, ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit dhe treguesit kryesorë të grumbujve në **sipërfaqe totale 14.064** ha (*sipërfaqe që hiqet nga fondi pyjor **7.739 ha** e pakëson në volume **563.80 m3 drurë zjarri**), në ngastrat nr. 19 me 69.20 m3, ngastrën nr. 25 441.70 m3 dhe ngastrën nr. 26 52.90 m3, në ekonominë pyjore* mali Bratit-Gumenicë dhe sipërfaqe që hiqen nga fondi kullosor 6.325 ha në ekonominë kullosore Gjorëm Vranisht në ngastrën nr. 13 me 6.075 ha dhe në ngastrën nr. 14 me 0.25 ha.

Në raport (përveç tabelës bashkangjitur raportit), nuk është përmendur statusi i veçantë i llojit të bimësisë, pasi është konsideruar si dru zjarri "tungishte".
Subjekti "M. P." Shpk
Në raport tekniko- ekonomik me nr.37 prot, datë 13.02.2019, të formuluar/nënshkruar nga Grupi i punës: Z. Sh. D. (Inxhinier Pyjesh) z. P.H. (Inspektor Kontrolli), z. B. K. (Përgjegjës Sektori), është cituar: Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor rezulton se sipërfaqja e kërkuar është 55.48 ha, dhe shtrihet në; ngastrat/nënngastrat nr. 19; 25; 26; 28; 29;30, dhe bëjë pjesë në ekonomisë pyjore/kullosore mali Bratit-Gumenicë, dhe janë në pronësi/administrim të bashkisë Selenicë.
Përshkrimi parcelor i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj, pasqyrohen në tabelën 1; 2; 3;4; 5 të këtij raporti.
Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje; (nuk ka ndryshime)
Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria "M. P." Shpk, ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit dhe treguesit kryesorë të grumbujve (në *sipërfaqe prej 55.584 pakësohet në volume **3,700.40 m3**), në ngastrat nr. 19;25; 26; 28; 29; 30; 30/1, ekonominë pyjore* mali Bratit-Gumenicë.
Në raport (përveç tabelës bashkangjitur raportit ku përmbajtja e ngastrës 26 -përbërja e grumbullit është cilësuar "e thjeshtë"), nuk është përmendur statusi i veçantë i llojit të bimësisë, pasi është konsideruar si dru zjarri "trungishte".
Me shkresën e nr. 13974 prot, datë 07.12.2021, (protokolluar në Bashki me nr. 3565, datë 10.12.2021), "Kërkohen të dhëna dhe informacion i detajuar për subjektet që operojnë në ekonominë pyjore Mali Brati Gumenicë parcela nr. 26", Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë" me objekt "Kërkohen të dhëna", nga Drejtoria e ZHBAPK, Bashkia Selenicë.
Të dhënat e kërkuara i janë dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë më datë 16.12.2021 ku përfshihen dokumente për secilin subjekt që ka leje shfrytëzimi në këtë parcelë pyjore:

Mbi pajisjen me NIPT sekondar
Në Bashkinë Selenicë, 4 (katër) subjekte, që kanë aktive 6 (gjashtë) leje minerare, me sipërfaqe 548.1 ha aktive në regjistrin e AKB, nuk figurojnë si taksapagues në Bashkinë Selenicë:

	Leje	Datë	Subjekti	Sip. e hequr nga fondi Ha	Emërtimi i Vb	Minerali	Sipërfaqe Km^2
1	552/1	08.11.2011	"S." Shpk	2.50	Kava e Azines	Gur gëlqeror	0.025
2	641	16.08.2001	"A." Shpk	142	Treblovë	Rërë bituminoze	1.42
3	1115	12.12.2007	"T. I." Shpk	109	Resulaj	Zhavor Bituminoz	1.09
4	1496/2	10.07.2013	"B. M. I." Shpk	163.80	Treblovë, Romës	Rërë Bituminoze	1.638
5	1496/3	20.11.2013	"B. M. I." Shpk	117.10	Treblovë, Romës	Rërë Bituminoze	1.171
6	1578	07.09.2012	"B. M. I." Shpk	13.70	Zona e II Resulaj	Zhavor Bituminoz	0.137
				548.1			

Llogaritja e vlerave për taksat dhe tarifat vendore nga grupi i auditimit referuar informacionin që ka audituar është e pamundur pasi mungojnë të dhëna të detajuara për këto subjekte.

Konkluzione:

- Subjektet me objekt veprimtarinë minerare në Bashkinë Selenicë, nuk kanë zbatuar parimet e veprimtarisë minerare që rregullon marrëdhëniet midis subjektit dhe titullarit të pronësisë (Bashkisë Selenicë), në përputhje me pikën 4 të nenit 4, ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 "*Për Sektorin Minerar në Republikën ë Shqipërisë*" me ndryshimet e ligjit nr. 9/2013 dhe Ligjit nr. 134/2014 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar.
- Për të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari minerare nuk është miratuar ndryshimi nga fondi pyjor, parakushti për zhvillimin e aktiviteti minerar në Republikën e Shqipërisë, veprim në kundërshtim pikat 3, 5 e 8 të nenit 5 të ligjit 57/2020 *"Për Pyjet" (nenin 17 "*Heqja e sipërfaqeve (tokave) nga fondi pyjor kombëtar" të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, *"Për pyjet dhe shërbimin pyjor",* të ndryshuar.)
- Bashkia Selenicë nuk ka lidhur kontrata me subjektet që ushtrojë veprimtari të nxjerrjes, prodhim dhe depozitim materialesh inerte në karrierë, kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit të mineraleve, hidrokarbureve dhe të ujit, në fondin pyjor.

Sa më sipër nuk është vepruar në zbatim të pikave 3 e 4 të nenit 25 "Përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar" të ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", "*3. Dhënia në shfrytëzim/përdorim e pjesëve të fondit pyjor kombëtar për veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni, bëhet në bazë të kontratave të nënshkruara nga kryetari i bashkisë/organi përgjegjës për zonat e mbrojtura kur përfshihet në këto zona. Kontratat përfundojnë në çastin kur KKT-ja miraton tjetër zhvillim për sipërfaqen e fondit pyjor kombëtar, objekt kontrate. Rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për këto veprimtari caktohen me udhëzim të ministrit. 4. Çmimet dhe tarifat për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për pyjet dhe ministrit përgjegjës për financat. Pronarët privatë, për veprimtaritë që zhvillohen në fondin pyjor në pronësi të tyre, kanë të drejtë të përdorin çmime dhe tarifa të vendosura në marrëveshje me subjektet e interesuara*" .

-Nuk janë ndjekur procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, për subjektet e pajisura me leje minerare nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë (dhe MMT) për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për pasojë nuk janë lidhur kontrata dypalëshe.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe rregullativ si vijon: Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005 *"Për pyjet dhe shërbimin pyjor",* i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 "Për Fondin Kullosor", pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008 *"Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e*

dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10. 2008 *"Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor",* i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016 dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4.

Kriteri: Kuadri ligjor i sipër cituar

Ndikimi: Bashkia Selenicë nuk ka kontroll mbi veprimtarinë ekonomike që zhvillohet nga subjektet private që përdorin sipërfaqe të fondit pyjor/kullosor pronë e saj.

Shkaku: Mos respektimi e kuadrit ligjor nga Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Selenicë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave duhet të marrë masa të menjëhershme lidhur me:

1. T'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.

2. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

3. Të vendosen marrëdhënie kontraktuale me Operatorët Ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej 1,231.1 ha, duke aplikuar tarifat dysheme/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit (**80,078,812**, për 17 subjekte, Aneksi nr. 2.6/4 bashkëlidhur).

4. Gjatë hartimit të raporteve tekniko-ekonomike rast pas rasti të vlerësohet saktë lloji i bimësisë dhe lëndës drusore që ndodhet në sipërfaqen për të cilën po hartohet raporti, si dhe llogaritja e vlerës të jetë gjithashtu referuar llojit të bimësisë apo lëndës drusore.

5. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që të ngarkojë subjektet "S." SHPK, "A." SHPK, "T. I." SHPK ,"B. M. I." SHPK që kanë aktive 6 leje minerare në territorin e Bashkisë Selenicë me detyrimeve vendore
referuar përcaktimeve të Vendimit të Këshillit Bashkiak për miratimin e Pakës Fiskale.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z. P. Sh. me detyrë ish Kryetar i Bashkisë Selenicë, z. P.B. Kryetari i Bashkisë Selenicë, z. G. L. me Detyrë ish Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave, z. B. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë DZHBAPK, Sh. D. (Inxhinier Pyjesh), P. H., G. S., A. L. e P. A..

Me nr. 2116/44 Prot., datë 19.12.2022, administruar në KLSH me nr. 799/13 prot., datë 08.11.2022, janë paraqitur kundërshtime në lidhje me ***Akt Konstatimet*** *nr. 23 e nr. 24, datë 21.12.2022 me objekt: "Shfrytëzim për veprimtari ekonomike në fondin pyjor në Bashkinë Selenicë", formuluar/nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Selenicë z. P. B..*

Pretendimet e subjektit:

Në bashkinë Selenicë sipas programit të auditimit nr. 799/1 prot, datë 02.09. 2022, i ndryshuar me shkresën 799/2 prot., datë 03.10.2022 grupi i audititi KLSH, bëri auditim në Bashkinë Selenicë duke lënë konstatimet si dhe duke na kërkuar shpjegimet tona rreth gjetjeve sipas rasteve, shpjegime të cilat ne jau dërguam zyrtarisht në formë shkresore dhe elektronike. Brenda afateve të kërkuara.

Duke qenë se grupi auditimit, nuk ka marrë në konsideratë anjë nga shpjegimet tona sidomos disa shpjegime që ne si bashki po jua kërkojmë Juve si Drejtori Juridike të Cilësisë dhe Zbatimit të Standarteve, për të bërë interpretimin

ligjor në bazë të ligjeve dhe urdhëresave në fuqi që do ti citojmë më poshtë sipas konstatimeve dhe rekomandimeve nga grupi i auditimit në Projekt Raportin e dërguar në bashki më datë 07.12.2022.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:

Në aktet e konstatimit, dhe Projektraportin e Auditimit formuluar/nënshkruar nga grupi i auditimit të KLSH-së, në asnjë rast nuk është referuar Drejtoria Juridike e Cilësisë dhe Zbatimit të Standarteve. Nga grupi i auditimit nuk janë kërkuar shpjegime/interpretime ligjore por dokumentacione mbështetëse tekniko ligjore në lidhje me konstatimet e pasqyruara në aktet e sipërcituara.

Pretendimet e subjektit:

Dokumenti nr. 8, datë 24.10.2022 me objekt "Shfrytëzim për veprimtari ekonomike në fondin pyjor dhe kullosor në Bashkinë Selenicë", shpjegojmë si më poshtë:

- Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe administrimit të Pyje/Kullotave përbëhet nga dy sektorë: Sektori i Bujqësisë dhe Sektori i pyje/kullotave dhe si e tillë është e ndarë dhe sipërfaqja e fondit bujqësore nga ai i fondit pyjor/kullosor dhe secili sektor ka dhe organikën e tij përbërse, ndërsa ndryshe nga fakti grupi i Auditit e ka cilësuar të gjithin fond pyjor dhe kullosor dhe të gjitha veprimtaritë ekonomike kryhen në fondin pyjor dhe kullosor, pa bërë ndarjen e veprimtaritë ekonomike që kryhen në fondin bujqësor nga ai i fondit pyjor/kullosor

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:

Grupi i auditimit ka formuluar/nënshkruar tre akt konstatime të ndryshme lidhur me aktivitetin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave duke trajtuar edhe aktivitetet e kryera në fondin bujqësor.

Sofizmat tuaja në lidhje me: Sektorin e Bujqësisë dhe Sektori e pyje/kullotave dhe ndarjen e sipërfaqeve ku ushtrohen aktivitete minerare, në fondi bujqësore apo pyjor/kullosor.

Mungesa e dokumentacionit për statusin e sipërfaqeve ku zhvillohen aktivitetet minerare, në territorin e Bashkisë Selenicë (561.24 km^2 duke përfshirë edhe listën e inventarit të transferuar me VKM nr. 433), nuk plotësohet me "gjetjen" që: "*…grupi i Auditit e ka cilësuar të gjithin fond pyjor dhe kullosor dhe të gjitha veprimtaritë ekonomike kryhen në fondin pyjor dhe kullosor, pa bërë ndarjen e veprimtaritë ekonomike që kryhen në fondin bujqësor nga ai i fondit pyjor/kullosor",* por me saktësmin e sipërfaqeve konkrete nga ju.

Veprimtaritë ekonomike që kryhen në fondin pyjor/kullosor dhe bujqësor, në territorin e Bshkisë Selenicë, administrohet nga DZHBAP/K. Sektori i Bujqësisë e Sektori i pyje/kullotave në DZHBAP/K, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për statusin e pasurive ku zhvillohen aktivitetet minerare dhe ku realizohen veprimtari minerare në territorin e bashkisë. Gjatë gjithë periudhës së auditimit, është kërkuar informacion nga Bashkia Selenicë në lidhje me pasuritë ku zhvillohen aktivitete minerare

Nga Bashkia Selenicë nuk është realizuar inventarizimi i pronave, nuk është paraqitur asnjë informacion/dokumentacion ligjor në lidhje me veprimtaritë minerare që kryhen në sipërfaqet që përfshihen në fondin buqësor apo pyjor kullosor, në pronësi të bashkisë.

Ju si titullar i bashkisë (observacion-shkruersi), nuk dini subjektet që ushtrojnë aktivitet minerar dhe natyrën/llojin dhe statusin e pasurisë ku ushtrohet aktivitet minerar në teritorin që administrohet nga Bashkia Selenicë, kërkoni "*…ndarjen e veprimtaritë ekonomike që kryhen në fondin bujqësor nga ai i fondit pyjor/kullosor",* kur ky informacion është kërkuar vazhdimisht nga audituesit e KLSH-së, dhe është detyra juaj ligjore/funksionale veprimtaria ekonomike-financiare në territorin e bashkisë.

Pretendimet e subjektit:

1- *Lidhur me mospërputhjen e veprimtarive minerare sqarojmë se referuar nenit 3 të po këtij ligji, në këto raste dhe për këto veprimtari minerare pronësia e mineralit i përket shtetit dhe janë pronë publike e* ***shtetit*** *në pronësi të Ministrisë së Energjitikës dhe përfaqësohet nga ministri. me pikën 4, neni 4, ligji 10304/2010.*

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:

Në asnjë rast grupi i auditimit nuk është shprehur për "pronësinë e mineralit", jemi shprehur për "pronësinë mbi pronën"

Sjellim edhe një herë në vëmendje të subjektit përcaktimet e nenit 3 dhe nenit 4 pika 4 të ligjit nr. 10 304 datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë":

Neni 3 "*Mineralet në trajtë natyrore, që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në sipërfaqen nënujore, shtratit dhe nënshtratit të hapësirës detare shqiptare, përtej detit territorial, të përcaktuar sipas parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë*, **i përkasin shtetit dhe janë prona publike**. *Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, shteti, për efekt të zbatimit të këtij ligji, përfaqësohet nga ministri*".

Neni 4, pika 4 *"E drejta minerare është një e drejtë e dallueshme dhe e pavarur nga e drejta e pronësisë mbi sipërfaqen e tokës, ku ato gjenden.* ***Marrëdhëniet e subjektit përfitues të së drejtës minerare dhe titullarit të së drejtës së pronësisë mbi pronën,*** *ku gjenden minerale,* ***rregullohen me marrëveshje, sipas legjislacionit në fuqi"****.*

Neni 3 dhe neni 4 pika 4, janë dy përkufizime të qarta. E drejta minerare është e pavarur nga e drejta e pronësisë mbi sipërfaqen e tokës. Bashkia Selenicë është autoriteti që ka të drejtën e pronësisë mbi sipërfaqen së tokës, por nuk ka hartuar marrëveshje me përfituesin e të drejtës minerare sipas legjislacionit në fuqi.

Pretendimet e subjektit:

2- *Lidhje me mospërputhjen apo parakushtin për ndryshimin e sipërfaqes në fondin pyjor dhe kullosor për subjektet që zhvillojnë veprimtari minerare sqarojmë se për sipërfaqen ku zhvillohet aktivitet minerar (rërë dhe zhavorr bituminoz) në minierën historike të Selenicës, bashkia Selenicë nuk dispon asnjë lloj inventari e pronësie që të vërtetojë që të jetë pronare e kësaj sipërfaqeje bituminoze. Në listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave transferuar me VKM, 433/2016, i ndryshuar me VKM nr. 398/2020 ku identifikohen ngastrat dhe sipërfaqet që kalojnë në pronësi të Bashkisë Selenicë me nr. rendor nga 1- 485 ngastra, asnjë subjekt të cituar sipas jush nuk shfrytëzon rërë dhe zhavorr bituminoz në këto ngastra. Duke qenë e tillë nuk është vepruar për asnjë vit dhënia me qira përdorimi qysh nga vitet 1988 dhe DZHBAP/K nuk ka gjetur asnjë dokument pronësie apo inventari të pasqyruar në bilancet e Bashkisë Selenicë para reformës teritoriale të vitit 2015 për sipërfaqet bituminoze*

Bashkia për këto subjekte për shfrytëzim rëre dhe zhavorri bituminoz vjel vetëm taksat vendore sipas ligjeve në fuqi. (për taksat vendore)

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:

Fakti që nuk është gjetur asnjë dokument pronësie apo inventar vërteton konstatimet e auditimit të KLSH, nuk e justifikon DZHBAP/K në Bashkinë Selenicë që nuk ka asnjë informacion për veprimtaritë në terrenin që administrohet ligjërisht nga bashkia si NJQV.

Procesi i përcaktimit të tokës dhe pronave shtetërore dhe ndarja e tyre në mes të agjencive shtetërore dhe njësive të qeverisjes vendore është një proces i cili ka nisur që nga viti 2001.

Është detyrim ligjor i Bashkisë Selenicë përditësimi i plotë i pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre (brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 20/2020, proces i cili duhet të përfundonte në Nëntor të vitit 2021).

Gjithashtu, ju jeni në kundërshtim me deklarimet e bëra, pasi ju deklaroni që nuk jeni pronarë në sipërfaqet ku ushtrohet aktiviteti për rërë dhe zhavorr bituminoz por nga ana tjetër subjektet që ushtrojnë këtë lloj aktiviteti i ngarkoni me detyrime për taksa dhe tarifa vendore. Sqarojmë se referuar kuadrit ligjor në fuqi për taksat dhe tarifat vendore Bashkia Selenicë ngarkon me detyrime vendore ato subjekte që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe jo në territore jashtë juridiksionit të saj territorial. Mungesa e dokumentacionit për statusin e sipërfaqeve ku zhvillohen aktivitetet minerare, në territorin e Bashkisë Selenicë (561.24 km^2 duke përfshirë edhe listën e inventarit të transferuar me VKM nr. 433), vërteton gjetjen e grupit të auditimit.

Sipërfaqja nën administrimin e Bashkisë Selenicë, duhej inventarizuar .

Pretendimet e subjektit:

3- Referuar Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.20016 "Për regullat. procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" pika 4. struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki, propozon dhe llojin e veprimtarisë që mund të ushtrohet në përputhje me ***kërkesat e ligjit të cituar më lart****, dhe pregatit studimin me kërkesat përkatëse e në këto raste bashkia lidh kontratë dy palëshe për dhënie në përdorim siç dhe kemi vepruar.*

Kurse në rastet e karrierave minerare kur aktiviteti i shfrytëzimit është në fondin pyjor dhe kullosor publik leja e shfrytëzimit jepet nga Ministria përkatëse duke kërkuar heqjen. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit i kërkon bashkisë pregatitjen e raportit tekniko ekonomik për vlerësimin e sipërfaqes së kërkuar për heqje nga fondi sipas VKM nr .1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime ne VKM nr. 391, datë 21.6.2006 për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" dhe konkretisht zbatimin e Lidhjes nr. 4.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:

Pika 4 *e* Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.20016 *"Për regullat. procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik"* që ju i referoheni nuk i referohet veprimtarisë minerare. Jemi në gërmën **"a"** të pikës 22 ku citohet: "*Bëjnë përjashtim nga konkurrimi publik dhënia e sipërfaqeve në përdorim rastet kur persona fizikë/juridikë janë të pajisur me leje/licencë nga institucionet përkatëse për veprimtaritë që kanë të bëjnë me:*

a) *procedurat në zbatim të ligjeve për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë;"*

Në pikën 23 të Udhëzimit nr. 1, përcaktohet struktra përgjegjëse që harton studimin për sipërfaqen konkrete në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti. Dokumentacion që duhet paraqitur në bashki përshkruhet në pikën 24. Afati i studimit në terren, dhe mënyra e veprimit në rast të mungesave apo mangësive në dokumentacion përshkruhen në pikën 25 dhe **pika 26** e Udhëzimit të sipërcituar përcakton që: "*Kryetari i bashkisë miraton studimin teknik-ekonomik të hartuar nga struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki dhe* ***lidh kontratën e qirasë të sipërfaqes së fondit pyjor dhe kullosor*** *brenda një afati 20 ditë pune.*

Në shtojcën nr. 1, të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.20016 *"Për regullat. procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", jepet* modeli për "Raport mbi studimin tekniko-ekonomik *për dhënie në përdorim/heqje nga fondi pyjor dhe kullosor* të sipërfaqeve në pronësi publike të bashkisë", ku sanksionohet:

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, shoqëria kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur vetëm pas lidhjes së kontratës me bashkinë dhe likujdimit të tarifës prej ……lekë.

Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyieve dhe te kullotave" të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM nr. 391, date 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave', bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit.

Shuma në lek/vit konsiston në:

a) Vlerën e përdorimit lekë/ha/ vit____0 lekë

Trungishte: ___ha___x___lek/ha/vit_____lekë/vit
Cungishte: ___ha___x___lek/ha/vit_____lekë/vit
Shkurre: ___ha___x___lek/ha/vit_____lekë/vit
Inproduktive: __ha___x___lek/ha/vit_____lekë/vit

Ose **a/1) Vlerën e përdorimit për linjat gjatësore në km__0 lek**

Trungishte: ___ha___x___lek/ha/vit_____lekë/vit
Cungishte: ___ha___x___lek/ha/vit_____lekë/vit
Shkurre: ___ha___x___lek/ha/vit_____lekë/vit
Inproduktive: __ha___x___lek/ha/vit_____lekë/vit

Duke specifikuar përdorim për kanalet, tubacionet, linjat e tensionit të lartë etj, në rastet e HEC-eve.

b) Vlera e bimësisë pyjore, florës dhe faunës___lekë, përbërë nga:

1. Vlera e lëndës së punimit; _____lekë
2. Vlera e druve të zjarrit; _____lekë
3. Vlera e prodhimeve të dyta pyjore; _____lekë
4. Kullotja _____lekë
5. Vlera e faunës; _____lekë
6. Vlera e investimeve të kryera (pyllëzime, zëvendësime, përmirësime, etj)_____lekë.
7. Të tjera-_____lekë *(përfshihet volumin dhe vlera për gjithë sipërfaqen që hiqet dhe jepen në përdorim)*

Lidhja 4 e VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, e cituar (por jo e praktikuar) nga ana juaj si bazë e përllogaritjes, i referohet pjesës të fondit pyjor dhe kullosor publik, **që hiqen si pasojë** e ushtrimit të veprimtarive të parashikuara sipas **nenit 7 të** ligjit nr. 9791, datë 23.7.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9385, datë 4.5.2005 'Për pyjet dhe shërbimin pyjor" dhe në nenin 10 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor" i ndryshuar. Pasi sipërfaqet përkatëse që hiqen nga fondi fondit pyjor dhe kullosor, kanë një vlerë ekonomike historike (**a.** investimet e kryera për pyllëzimin dhe përmirësim kullote, **b.** shpenzimet e tjera për mbrojtjen e tokës,,;**c.** shpenzimet për ndërtimin e infrastrukturës: **d.** vlerën e burimeve pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese; **e.** investimet që do të kryhen për pyllëzimin (ripyllëzimin), përmirësimin e kullotës), vlerat e sipërcituara përcaktohen pasi në terren është ndryshuar zëri kadastral dhe ka filluar aktiviteti minerar. (asnjë nga sipërfaqet që ushtrohet veprimtaritë minerare në territorin e Bashkisë Selenicë nuk është hequr nga fondi pyjor/kullosor).

Në raportet tekniko ekonomike ju i referuar saktësisht shtojcës 1 të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.20016, (pa vendosur vlerë ekonomike për përdorim të sipërfaqeve, por vetëm vlerën e bimësisë që ka ngastra) dhe jo lidhjes 4 të VKM 1064, si pretendoni në kundërshtin tuaj.

Raportet tekniko ekonomik të realizuara nga Bashkia Selenicë	**Lidhja 4 e e VKM nr. 1064, datë 22.12.2010**
Shuma në vite konsiston në: **a) Vlerën e përdorimit lekë/ha/ vit____0 lekë** Trungishte: ___ha___x___lek/ha/vit_____lekë/vit Cungishte: ___ha___x___lek/ha/vit_____lekë/vit	Tarifat për pjesë të fondit pyjor dhe kullosor publik, **që hiqen si pasojë e ushtrimit të veprimtarive** të parashikuara sipas **nenit 7 të** ligjit nr. 9791, datë 23.7.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9385, datë 4.5.2005 'Për

Shkurre: ___ha___x___lek/ha/vit_____lekë/vit Inproduktive: __ha___x___lek/ha/vit_____lekë/vit **1) Vlerën e përdorimit për linjat gjatësore në km__0 lek** Trungishte: ___ha___x___lek/ha/vit_____lekë/vit Cungishte: ___ha___x___lek/ha/vit_____lekë/vit Shkurre: ___ha___x___lek/ha/vit_____lekë/vit Inproduktive: __ha___x___lek/ha/vit_____lekë/vit **b) Vlera e bimësisë pyjore, florës dhe faunës___lekë, përbërë nga:** 1. Vlera e lëndës së punimit; 2. Vlera e druve të zjarrit; 3. Vlera e prodhimeve të dyta pyjore; 4. Kullotja: 5. Vlera e faunës; 6. Vlera e investimeve të kryera (pyllëzime, zëvendësime, përmirësime, etj)) 00 lekë. 7. Të tjera; *(përfshihet volumin dhe vlera për gjithë sipërfaqen që hiqet dhe jepen në përdorim)*	pyjet dhe shërbimin pyjor" dhe në nenin 10 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar, përllogariten duke mbajtur parasysh: **a)** investimet e kryera për pyllëzimin (ripyllëzimin), përmirësimin e kullotës, si dhe investimet e kryera gjatë periudhës së rritjes, për sipërfaqen që hiqet nga fondi pyjor dhe kullosor kombëtar; **b)** të gjitha shpenzimet e tjera për mbrojtjen e tokës, për shfrytëzim të qëndrueshëm dhe produktiv; **c)** shpenzimet për ndërtimin e infrastrukturës përkatëse; **d)** vlerën e burimeve pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese (lënda drusore, flora spontane, fauna e egër, kullota, etj.), si produkt i humbur; **e**) investimet që do të kryhen për pyllëzimin (ripyllëzimin), përmirësimin e kullotës, për sipërfaqen që do të zëvendësojë sipërfaqen e hequr nga fondi pyjor dhe kullosor kombëtar.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me Subjektet minerare të paisura me: leje minerare shfrytëzimi, Leje mjedisore kërkesë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit drejtuar bashkisë për pregatitjen e raportit tekniko- ekonomik për sipërfaqen e kërkuar për heqje nga fondi pyjor dhe kullosor publik, urdhër të kryetarit të bashkisë për pregatitjen e raportit teknik, shprehjen e dakortësisë këshillit bashkiak, konifrmim ligjshmërie nga prefekti i qarkut, dërgim të dokumentacioni në Ministrinë e Turizmit dhe mjedisit si dhe pagesën e bërë për llogari të bashkisë nga secili subjekt. Kjo e realizuar sipas dokumentave standarte të hartuara në zbatim të VKM, nr.1353, datë 1010.2008 e ndryshuar me VKM, 434, datë 8.6.2016 "Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik si dhe të kritereve të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor si dhe të VKM, 591, për fondin pyjor dhe 592 për fondin kullosor.

Në Fondin pyjor dhe kullosor të Bashkisë Selenicë operojnë me leje minerare sipas procedurave të cituara më sipër gjithsej 5 subjekte; Dhe konkretisht: 1- "Y. S." Shpk ; 2- "A" Shpk; 3 – "M. P." Shpk; 4-"T. E." Shpk , dhe 5- "T. E." Shpk (pasi ka patur 2 leje minerare dhe qysh nga viti 2021 i ka mbaruar leja e shfrytëzimit) ndërsa subjekti "S. M." Shpk, i cituar nga ju nuk është bërë asnjë procedurë pasi ai ka vetëm Lejen minerare dhe mjedisore dhe procedurat e tjera nuk janë bërë pasi Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka paraqitur asnjë kërkesë në bashki për këtë subjekt në lidhje me procedurat që duhen realizuar

Për 5 subjektet minerare të mësipërm të cilët operojnë në fondin pyjor dhe kullosor është zbatuar ligji 434, datë 8.06.2016 sipas pikës 11 ku cilësohet: "*Vlera e sipërfaqes pyjore të hequr dhe infrastrukturës së sajë paguhet nga kërkuesi para hyrjes në fuqi të aktit të miratimit, të përmendur në shkronjat a; b; c ; të pikës 8 të këtij vendimi dhe derdhet në llogarinë bankare të bashkisë, brenda teritorrit administrative të të cilit është sipërfaqja e cila do ti nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi Pyjor" dhe për tarifat është zbatuar*

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:

Grupi i auditimit i është referuar lejeve minerale aktive të paraqitura në faqen zyrtare të AKBN-së nga ku konstatohen lejet minerare aktive, paraqitura në tabelën përmbledhëse në akt konstaimin nr. 24 janë 19 leje minerare.

Ju në kundërshtimet tuaja pranoni që; nuk keni asnjë informacion për 13 subjekt që "kanë leje minerare aktive", dhe ushtrojnë veprimtari minerare në fondin pyjor/kullosor të terrritorit të administruar nga Bashkia Selenicë, por nuk paraqesni asnjë dokument tekniko-ligjor për gjendjen kadastrale të pronave ku ushtrojnë veprimtari minerare subjektet e sipercituara.

Ju shprehni që në fondin pyjor/kullosor të Bashkisë Selenicë operojnë me leje minerare sipas procedurave të cituara më sipër gjithsej 5 subjekte; por nuk paraqisni asnjë dokumentacion ligjor për subjektet e tjera që ushtrojnë aktivitet minerar në territorin e bashkisë.

Nga ana e grupit të punës të ngritur me urdhërin nr. 547 prot., datë 17.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë *"Për verifikimin dhe matjen e sipërfaqeve të karrierave të firmave nxjerrëse të qymyreve bitumine dhe guroreve në territorin e Bashkisë Selenicë", [*Z. I. D. (Zv. Kryetar), Z. E. F. (Përgjegjës Tatim Taksa), Z. P.A. (Përgjegjës Pyje/Kullota) e z. A. K. (Specialist Topograf)], është konstatuar që në territorin e administruar nga bashkia Selenicë ushtrojnë aktivitet 13 subjekte (paraqitur hollësishtë në aktkonstatimin nr. 24).

Në lidhje me pesë subjekte minerare ju risqarojmë që përveç përllogaritjes së gabuar së vlerës së qirasë, ju në raportet respective mbi studimin ekonomik për heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor të sipërfaqeve në pronësi publike të bashkisë Selenicë, respektivisht.

a) Me nr. 88 prot., datë 15.05.2018 "Për vlerësimin tekniko – ekonomik të sipërfaqes pyjore/kullosore objekt: "Leje minerare shfrytëzimi për mineral gëlqeror dekorativ në zonën minerare nr. 70/5 për subjektin "Y. S." Shpk, formuluar/nënshkruar nga: z. P. H. (Inspektor Kontrolli), z. B. K. (përgjegjës Sektori) e z. A. V. (Inspektor Zone)
b) Me nr. 38 prot., datë 13.02.2019 "Për vlerësimin tekniko – ekonomik të sipërfaqes pyjore/kullosore objekt: "Leje minerare shfrytëzimi për mineral gëlqeror dekorativ sipas lejes minerare nr. 1792 për subjektin "A" Shpk, formuluar/nënshkruar nga: Z. Sh. D. (Inxhinier Pyjesh) z. P. H. (Inspektor Kontrolli)
c) Me nr. 37 prot., datë 13.02.2019 "Për vlerësimin tekniko – ekonomik të sipërfaqes pyjore/kullosore objekt: "Leje minerare shfrytëzimi për mineral gëlqeror dekorativ sipas lejes minerare nr. 1826 për subjektin "M. P." Shpk, Z. Sh. D. (Inxhinier Pyjesh) z. P. H. (Inspektor Kontrolli) dhe z. B. K.
Në të tre raportet e sipërcituar ju keni përllogaritur vlerën e "Ilqeve" si dru zjarri, kur duhet të refuzonit ushtrimin e aktivitetit minerar pasi ky dru është në listën e kuqe të florës së egër.

VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", përcakton **tarifat dysheme për dhënien në përdorim me kontratë qiraje** të fondit pyjor dhe kullosor publik për ushtrimin e veprimtarive **në pikën 6 "**Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë)" dhe pikën 9 "Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, **gjeologjike e minerare**, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe". Në asnjë pikë të saj, nuk përjashtohet asnjë veprimtari minerare te ushtruara në territorin e Bashkisë Selencicë nga subjektet e trajtuara nga grupi i auditimit. Ju duhej të përllogarisnit vlerën e qirasë sipas përcaktimit të sipërcituar.

Pika 5 e nenit 15 "Leja e shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet" e Ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" sanksionon: "*Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullosor, pronë shtetërore, dhe kalon si pasuri minerare, në varësi të ministrisë së linjës, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullosor.* ***Në këto raste leja hyn në fuqi për zbatimin e detyrimeve të saj në datën e ndryshimit të zërit kadastral."***

Pika 10 e nenit 24 *"Leja e shfrytëzimit me karrierë të grupit të mineraleve ndërtimore"* e Ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" sanksionon: "Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit të grupit të mineraleve ndërtimore, zona e lejuar *e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullosor, pronë shtetërore, dhe kalon si pasuri minerare në varësi të ministrisë së linjës,* sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullosor**.** ***Në këto raste, leja hyn në fuqi për zbatimin e detyrimeve të saj në datën e ndryshimit të zërit kadastral.***

Pika 54 e nenit 3 të Ligjit nr. 57/20 "Për pyjet" që: *"Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP)" është regjistri zyrtar i të dhënave kadastrale të fondit pyjor kombëtar, i organizuar në nivel qendror,* ***rajonal dhe vendor****, në të cilin regjistrohen të gjitha informacionet bazë dhe ndryshimet periodike të ndodhura në pronësinë, të drejtat reale, pozicionin hartografik, sipërfaqe, volum etj., shoqëruar me sistemin e informacionit gjeografik* ***(GIS),*** *i nevojshëm për administrimin dhe planifikimin e pyjeve.",*

Pretendimet e subjektit:
A -Sipas auditimit: *Për subjektet që shfrytëzojnë me karriera minerare duhen që përvec lidhjes 4 të VKM, nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave" duhet të lidhen dhe kontrata përdorimi për dhënie me qira të fondit pyjor dhe kullosor të mbështetur në lidhjen nr. 2, pika 6/1, "Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte direkt nga sipërfaqja karrierë me vlerë minimale 440,000 lekë ha/vit dhe pika 9/1; 2: 3; 4: 5; 6 ? me vlerë minimale, 1 = 96 000 lekë; 2- 78 000;3=78 000;4-78 000; 5-62 000 dhe pika 6 inproduktive = 62 000 lekë . (ndërsa në pikën 6/1 inproduktive me 440,000lekë/ha/vit) ? ! (me dy standarte) (Qartësimi është bërë në VKM 1064 Lidhja 4)*
Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:

Pika 6/1 në lidhjen 2, i referohet: *"*Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë)"

Pika 9/6 në lidhjen 2, i referohet: "Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe"
Ndryshimi midis dy aktiviteteve minerare është që:
1. Në rastin 6/1, konsiderohet që në sipërfaqe ku zhvillohet aktiviteti mineral nuk ka më bimësi (më hollësisht mundohuni të kuptoni termin "karrierë").
2. Në rastin 9/6, tarifa dysheme për dhënie në përdorim në kontrata me qira është 62,000 lekë/ha/vit, për aktivitetet që përshkruhen në pikën 9 të lidhjes 2.
Sqarim: Nëse sipërfaqja inproduktive shfrytëzohet si karrierë sipas kohëzgjatjes së kontratës ka çmime të variabël (1 vit 540,000 lek/ha/vit; 2-5 vite- 495,000 lek/ha/vit; dhe 6-10 vite- 440,000 lek/ha/vit), në këtë rast nuk përfshihen

tarifat e sanksionuara në Lidhjen 4 të VKM, nr. 1064, datë 22.12.2010, pasi nuk ekzistojnë pyje, infrastrukturë, burime pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese investime për sipërfaqe që do të zëvendësohen.

Lidhja 4 e VKM, nr. 1064, datë 22.12.2010, i referohet: **a.** Investimeve të kryera për pyllëzimin (ripyllëzimin), përmirësimin e kullotës **b.** shpenzimet e tjera për mbrojtjen e tokës **c.** shpenzimeve për ndërtimin e infrastrukturës (në pyje e kullota)**d**. Vlerën e burimeve pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese **e.** Investimet që do të kryhen për pyllëzimin (ripyllëzimin), përmirësimin e kullotës, për sipërfaqen që do të zëvendësojë sipërfaqen e hequr nga fondi pyjor dhe kullosor kombëtar. Në rastin e territorit inproduktiv këto shpenzime nuk ekzistojnë.

Nëse çmimet minimale dhe përllogaritjet e tarifave për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor ju duken *"me dy standarte"* mund të kërkoni ndryshimin e VKM, nr. 1064, datë 22.12.2010. Ju duhet të kuptoni ndryshimin midis; kthimit të një sipërfaqe pyjore/kullosore në karrierë nga një sipërfaqe inproduktive në karrierë.

Pretendimet e subjektit:
B *Shtrojmë pyetjen për pikën 6*/1 *Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja karrierë; në cilën pikë dhe germë të Udhëzimit nr. 1, datë 9.6.2016 lejohet ky lloj aktiviteti minerar për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik.*
Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:
Baza ligjore për dhënien me qira e sipërfaqeve pyjore e kullosore është e listuar në aktet e mbajtura në subjekt dhe e perifrazuar (pjesërisht) në përgjigjet e observacioneve. Ju i referoheni vetëm Udhëzim nr. 1, datë 9.6.2016, "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik". Përllogaritja e gjithë vlerës së bimësisë në raportet tekniko ekonomike nga ana juaj do të thotë "shpyllëzim" dhe i paraprin karrierës. Përveç sa më lartë përcaktim i tarifave duhej realizuar në zbatim të VKM .1064, datë 22.12.2010, "Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave". Në opinionin e grupit të auditimit VKM, është primare në hirarkinë ligjore në lidhje me Udhëzimin e Ministrit.

Pretendimet e subjektit:
C. *Shtrojmë pyetjen për pikën;9/1,2,3,4,5,6, "Për kryerjen e operacioneve të kërkim -zbulimit hidrokarbure,* ***gjeologjike e minerare****, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe". në cilën pikë dhe germë të Udhëzimit nr. 1, datë 9.6.2016 lejohet ky lloj aktiviteti minerar për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik.*
Lejet minerare Ministria e Energjitikës nuk jau ka dhënë subjekteve Për kryerjen e operacioneve të kërkim zbulimit hidrokarbure, ***gjeologjike e minerare****, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe; por janë Leje shfrytëzimi direkt nga sipërfaqja karrierë për shfrytëzim të gurit gëlqeror të mermerizuar, pra nuk janë në fazën e kërkim zbulimit,*
Nga sa më lart, të ndodhur në këto kushte të interpretimit ligjor jo të saktë nga ana e grupit të Auditimit, kërkojmë të na interpretoni ligjet dhe urdhëresat të cituara më lart sa më saktë në përmbajtje; në Ligj, nen, pikë, dhe germë. që vlejnë për zbatimin korrekt ligjor për lejet e shfrytëzimit minerare për lidhje dhe të kontratave të përdorimit.
Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:
Në termin tekniko-shkencor **"gjeologjike e minerare"** përfshihen të gjitha aktivitetet minerare-kërkim-zbulim-shfrytëzim-pasurim e përpunim. Në cilin akt ligjor e nënligjor ju jeni mbështetur për dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor pa qira *(ligj, nen, pikë, dhe germë)*, kjo është përgjigjia, bazuar në dokumentacion e referencë ligjore që është kërkuar nga grupi i auditimit. Ju kërkoni "të interpretohen ligje dhe urdhëresa" por i referoheni vetëm Udhëzimit nr. 1, datë 9.6.2016.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME
Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE
1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Selenicë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim.
-Nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.
-GMS nuk është mbledhur për hartimin e planit strategjik dhe PBA.
-Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.
-Nuk është hartuar regjistri i rriskut, si dhe nuk janë hartuar aktivitetet e kontrollit për zvogëlimin e rriskut të parashikuar, lista e proceseve të punës dhe gjurma e auditimit nga asnjë sektor dhe drejtori, si dhe në nivel institucioni.
-Në procedurat e marrjes në punë të punonjësve, marrëdhëniet e punës të së cilëve rregullohet me kodin e punës, u konstatua se nuk janë hartuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen e tyre në punë.
-Nuk ka procedura të përcaktuara anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsive.
-Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.
-Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollin.
Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 8, germa "b", neni 15, pika 1-4, neni 16, pikat 2-3, neni 17, pika 1, neni 21, pika 2, neni 27, pikat 1-2, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2, pika 2.2.4, nënpikat 1-5, dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli II, pika 2.5.2, pika 2.2.6, Kapitulli III, pika 2.2, pika 3.2, pika 3.2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 26-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1 Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Selenicë të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe komponentëve të tij, për hartimin e gjurmës së auditimit dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të përcaktohen procedurat antikorrupsion, rregulla të shkruara për sinjalizimin e parregullsive, si dhe të hartohen programe trajnimi për punonjësit.
1.2 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të hartohen rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me anë të Kodit të Punës.
1.3 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të merren masa që në Rregulloren e Brendshme hartimi i detyrave dhe përgjegjësive të shtrihet për të gjithë punonjësit dhe jo vetëm në nivel drejtorie, në mënyrë që secili punonjës të ketë të qartë detyrën funksionale dhe përgjegjësit sipas pozicionit të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm u konstatuan parregullsitë si më poshtë:
-Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka zhvilluar auditimin e prokurimeve me vlera të larta dhe të vogla, proces i cili është parashikuar në planin vjetor të vitit 2021.

-Subjektet e audituara pavarësisht se kanë pranuar rekomandimet e lëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve.
-Nga auditimi i dosjeve të evaduara për auditimet e zhvilluara përgjatë vitit 2021 nga Njësia e Auditimit të Brendshëm konstatohet se, në 1 rast nuk është zhvilluar "Takimi i hapur prezantues" si dhe në 5 raste nuk janë mbajtur "Letrat e punës".
-Nga Përgjegjësi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin VII, pika 7.1.1 "Vlerësimi i brendshëm i cilësisë" që kryhet nga vetë nga kjo Njësi. Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm, duhen bërë vlerësimet e brendshme të cilësisë me përcaktimin nëse politikat dhe procedurat e aplikueshme, janë krijuar dhe zbatuar për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet dhe kodin e etikës, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorit publik" dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, pika 4.1.12. Hapi 1, Kapitulli VII, pika 7.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 26-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1 Rekomandim: Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Selenicë të merren masa që, pjesë e planit vjetor të vitit 2023 të përfshihet edhe auditimi i procedurave të prokurimeve me vlera të larta dhe ato me vlera të vogla . T'u kërkohet subjekteve të audituara plani i veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve nga kjo Njësi me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore mbi zbatueshmërinë e rekomandimeve.
2.2 Rekomandim: Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Selenicë të merren masa që të hartohen dhe plotësohen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dosja e auditimit, duke zbatuar njëkohësisht edhe detyrimet e ligjore të parashikuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm. Të kryhet vlerësimi i brendshëm i cilësisë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me hapat e ndjekura për hartimin e PBA-së dhe dokumentimit të procesit rezulton se:
- Nuk është miratuar nga Këshilli Bashkiak raporti i vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave;
- Nuk janë përgatitur dhe dërguar për miratim në KB Tavanet Përgatitore të PBA-së 2021-2023, si rezultat nuk ka miratim të tavaneve për çdo program në Këshillin Bashkiak brenda datës 15 mars 2020;
- Nuk janë ngritur Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP);
- Nuk është miratuar Udhëzim i Brendshëm për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm;
- Drejtuesit e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve nuk kanë paraqitur kërkesat buxhetore sipas programit te Koordinatori i GMS;
- Projekt dokumenti i PBA 2021-2023, është miratuar jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 10 datë 28.02.2020 të MFE;
- Nuk është dokumentuar ndjekja e hapave të tjera në vijim për të publikuar dokumentin e parë të PBA-së brenda datës 5 korrik 2020;
- Në dokumentin e PBA-së nuk janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si dhe nuk është bërë analiza e zërave të buxhetit në tre vite dhe tendencat nga viti në vit për tre vitet që përfshin kjo PBA.

- Për hartimin e programit buxhetor afatmesëm dhe projektbuxhetit vjetor nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të "Buxhetimit me pjesëmarrje", pasi mungojnë dokumentet e evidentimit të kryerjes së këtyre konsultimeve.
- Buxhetet nuk janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, ndërmarrja e shërbimeve dhe ujësjellësi, etj, gjë që vërteton se prej tyre nuk janë marrë kërkesat për nevojat reale, ku mbi bazën e tyre të hartohej buxheti.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore" si dhe përcaktimet e Udhëzimit nr. 10, datë 28.02.2020 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 40-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Selenicë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare të marrë të gjitha masat për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm:
-Të hartojnë dhe të miratojnë Udhëzimi i Brendshëm për hartimin e PBA-së;
- Të përgatisë dhe të dërgojë për miratim në KB Tavanet Përgatitore të PBA-së brenda datës 15 mars të vitit përkatës;
- Të ngrihen Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) dhe të dokumentohet puna e tyre në hartimin e PBA-së;
- Të zbatohen afatet në miratimin e projekt dokumentit të PBA-së;
- PBA të hartohet mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, njësitë e varësisë, etj;
- Procesi i ndjekur për hartimin e PBA-së të dokumentohet në çdo fazë të tij, si dhe të bëhet publikimi brenda afateve;
- Në dokumentacionin që shoqëron procesin e hartimit të PBA-së të trajtohen risqet financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat cenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ndryshimeve të bëra në buxhet rezulton se:
- Gjatë vitit buxhetor 2021 ka patur lëvizje të konsiderueshme, gjë që tregon se planifikimi i buxhetit nuk është plotësisht efektiv;
- Ndryshimet nuk janë shoqëruar me relacion shpjegues lidhur me arsyet e ndryshimit;
- Nuk ka një analizë se si ndikon ky ndryshim në realizimin e objektivave të synuar të bashkisë;
- Kryetari i Bashkisë Selenicë nuk ka paraqitur brenda datës 31 mars të vitit pasardhës raport me shkrim pranë Këshillit Bashkiak për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë.
Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 47, ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 44. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 40-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Selenicë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare të marrin masa që:
- Për ndryshimet e bëra në buxhetin vjetor të hartohet relacioni shpjegues lidhur me arsyet e ndryshimit si dhe të bëhet analiza e duhur se si ndikojnë ndryshimet në realizimin e objektivave të synuara të bashkisë;

- Të përgatitet dhe të paraqitet brenda afateve raporti përkatës pranë Këshillit Bashkiak për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2021 rezulton si vijon:
1. Niveli i realizmit të treguesve të buxhetit për vitin 2021 është në masën 86%. Mos realizimi ka ardhur si rezultat i vonesave në zhvillimin e procedurave të prokurime, në lidhje kontratash apo në mosplotësim të organikës. Peshën specifike me të madhe të shpenzimeve në buxhet ndaj totalit, e zënë shpenzimet për investime 40.4% ndjekur nga shpenzimet për paga 35.4%, dhe shpenzimet operative 16.6%.
2. Bashkia Selenicë ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në vlera relativisht të konsiderueshme, përkatësisht në fund të vitit 2020 detyrimet janë në vlerën **98,988,441** lekë, dhe në fund të vitit 2021 janë në vlerën **77,195,390 lekë** nga të cilat **54,527,216 lekë detyrime nga buxheti i bashkisë** dhe 22,668,174 lekë detyrime nga buxheti i shtetit.
Nga analiza e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021 janë të pa likuiduara gjithsej 106 raste me vlerë **77,195,390** lekë. Këto detyrime janë të krijuara që nga vitet 2010 e në vijim si dhe disa prej tyre të trashëguara nga ish-komunat. Sipas zërave detyrimet janë të ndara si vijon:

g. 30 fatura për shpenzime për investime në vlerën 41,034,136;
h. 49 fatura për mallra e shërbime në vlerën 22,048,885 lekë;
i. 27 vendime gjyqësore në vlerë 14,112,369 lekë.

Detyrimet për vendime gjyqësore janë:
- Vendime gjyqësore për detyrime kontraktuale (6 vendime me vlerë 6,932,696 lekë);
- Vendime për largime nga puna (28 vendime me vlerë 7,127,593 lekë);
- Vendime për detyrime përmbarimi (2 vendime me vlerë 52,080 lekë).

Për vitin 2021 janë planifikuar fonde për investime në shumën 185,720 mijë lekë për 11 projekte me burim financimi nga të ardhurat dhe transferta e pakushtëzuar. Vlera e kontratave të lidhura për vitin 2021 është 72,823,574 lekë. Nga këto kontrata është likuiduar vlera 57,422,044 lekë dhe ka mbetur pa u likuiduar vlera prej 19,401,530 lekë.
Vlera e kontratave të pa likuiduara deri në fund të vitit 2021 duke përshirë dhe kontratat e lidhura para vitit 2021 është 64,839,887 lekë.
Vlera e detyrimeve të prapambetura në Bashkinë Selenicë më 31.12.2021 është **13.61%** të shpenzimeve vjetore të miratuara.
3. Bashkia Selenicë për vitin 2021 ka hartuar dhe dërguar në MFE vetëm një raport monitorimi. Ky raport paraqet vetëm realizimin e shpenzimeve për 8 mujorin e parë të vitit 2021.
Raportet e monitorimit nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", pasi nuk është plotësuar asnjë nga anekset përkatëse. Nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezulton që raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit të jenë paraqitur në Këshill sipas përcaktimeve të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48. Kryetari i Bashkisë Selenicë nuk ka miratuar rregullat specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 40-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Financiare në bashkëpunim me Ekipet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara. Planifikimi të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim efiçient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.
Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Shërbimeve Financiare të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.
Të monitorohet me kujdes zbatimi i buxhetit si dhe të hartohen raportet periodike të monitorimit duke plotësuar të gjitha anekset përkatëse, të cilat më pas të paraqiten në Këshillin Bashkiak si dhe të dërgohen në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore nuk është i dokumentuar. Nuk ka dokumentacion nëse Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave (DAPPLL) ka dërguar kërkesë për informacion në drejtoritë brenda bashkisë, njësitë apo strukturat në varësi për të grumbulluar informacion lidhur me planifikimin e të ardhurave për vitin 2021 që sigurohen nga veprimtari të ndryshme përtej të ardhurave nga taksapaguesve familjar dhe privat. Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstaton që metodologjia e përdorur nga DAPPLL për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmëritë lidhur me të ardhurat e veta të bashkisë. Veprime këto në kundërshtim me VKB-në nr. 71, datë 30.11.2020 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Selenicë, administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2021". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 40-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucionet e varësisë me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar realizimin e saktë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara të Bashkisë Selenicë për vitin ushtrimor 2021 konstatohet se nuk është hartuar formati i pasqyrës nr. 5, "Pyetësorë dhe shënime shpjeguese". Shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare janë element i rëndësishëm të cilat duhet ndër të tjera të sigurojnë edhe atë informacion shtesë që nuk mund të paraqitet në të gjitha formatet e pasqyrave financiare. Veprime këto në kundërshtim me SKK nr. 1, "Kuadri i përgjithshëm i pasqyrave financiare", pikat 67-68, pikat 120-121, dhe Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", aneksi nr. 2, "Pasqyra nr. 5, Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare vjetore të njësisë raportuese". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 65-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa që, gjatë hartimit të pasqyrave financiare ato të përfshijnë të gjitha formatet e tyre sipas përcaktimeve ligjore duke siguruar të dhëna dhe informacione të plota shpjeguese për përdoruesit e tyre.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" paraqitet më datë 31.12.2020, në vlerën 136,714,244 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2021, paraqitet në vlerën 142,398,480 lekë me një rritje në vlerë 5,684,236 lekë. Nga krahasimi i të dhënave të vlerës së debitorëve për taksa dhe tarifat vendore të paraqitur në bilanc, në listën e debitorëve të administruar nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në datën 31.12.2021, konstatohet se vlera e pasqyruar në bilanc nuk është e saktë. Në bilanc detyrimet për taksat dhe tarifat vendore janë në vlerën 212,403,902 lekë ndërkohë që vlera reale e këtyre detyrimeve është në vlerën 362,011,099 lekë me një diferencë paraqitje më pak në bilanc prej 191,868,902 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 5, Në total nga shuma prej 212,403,848 lekë të pasqyruar në bilanc në datën 31.12.2021, shuma prej 168,716,207 lekë ose 79.4% të debitorëve e zënë debitorët e taksave. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 65-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të sistemojë llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm", duke pasqyruar në të vlerën reale të debitorëve për taksat dhe tarifat vendore të kategorisë privat dhe familjar.

Deri më datë 31.03.2023

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 202 "Studime dhe kërkime" konstatohet se vlera prej 8,641,700 lekë e kësaj llogarie përbëhet nga 12 projekte, të cilat nuk duhet të regjistroheshin në këtë llogari pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e secilit investim për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 7, dhe nenet 9-10, dhe Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 65-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 "Studime e kërkime", duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 8,641,700 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.

Deri më datë 31.03.2023

10. Gjetje nga auditimi: 1. Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 "Toka, troje, terrene", për koston historike në vlerën 140,307,952 lekë, Bashkia Selenicë nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001, "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjithave pronave të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu VI, "Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme", pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata

materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 35, germa "a", "b" dhe "c".

2. Gjithashtu, Bashkia Selenicë nuk ka marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 "Toka, troje, terrene". Në këtë llogari pasqyrohen aktivet e ish-Bashkisë Selenicë të cilat janë zbërthyer në mënyrë analitike, por jo ato të ish-komunave. Nuk disponohet një bilanc i saktë se cilat nga këto prona janë të regjistruara në ASHK dhe cilat janë të pa regjistruara.

3. Llogaria 211 "Pyje, plantacione" paraqitet me vlerën 0 lekë, ndërkohë në pasqyrat financiare të vitit 2021, nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe e kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Selenicë me VKM nr. 433, datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", pika 57, shtojca nr. 55, me listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Selenicë me numër nga 1 deri në 485. Duke u bazuar në vendimin e sipërcituar Bashkisë Selenicë i kanë kaluar në pronësi gjithsej 26,899.51 ha sipërfaqe nga të cilat: 16.633.1 ha sipërfaqe "Kullotë", 10,062.1 ha sipërfaqe "Pyll" dhe 204.31 ha sipërfaqe "Shkëmborë".

4. Nga auditimi i llogarisë 210 "Troje, toka, terrene" konstatohet se gjendja më datë 31.12.2020, ka qenë 140,307,952 lekë për të cilën është përllogaritur amortizim në vlerën 58,000 lekë dhe çelja më datë 01.01.2021, ka qenë në vlerën 140,249,952 lekë. Duke u bazuar në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit SKK nr. 5, "Afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale", i përmirësuar, pika 30, nuk mund të aplikohet normë amortizimi për këtë llogari. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 65-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 "Toka, troje, Terrene" dhe llogarisë 211 "Pyje, Kullota Plantacione", duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.2 Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore në pasqyrat e vitit 2022 të bëjë sistemimin e vlerës 58,000 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të normës së amortizimit për llogarinë 210 "Toka, troje, terrene" si dhe për këto llogari mos të aplikohet normë amortizimi referuar parashikimeve në dispozitat ligjore përkatëse.

Deri më datë 31.03.2023

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore", konstatohet se në vitin 2016 janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 526,501,279 lekë në Ujësjellës Selenicë Sh.A, por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Selenicë kjo situatë e konstatuar edhe në auditimet e mëparshme të zhvilluara nga KLSH por e pa sistemuar, pra nuk janë marrë masa për hartimin e dokumentacionit të dorëzimit dhe marrjes së aktiveve midis Bashkisë Selenicë dhe Ujësjellësit Sh.A. Nuk janë hartuar procesverbale dorëzimi për aktivet transferuara nga dy institucionet. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" dhe Udhëzimin

nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 65-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të hartohen procesverbalet e transferimit dhe të marrjes në dorëzim të aktiveve nga Bashkia në Shoqërinë Ujësjellës Selenicë për vlerën kontabël 526,501,279 lekë. Të bëhet pasqyrimi në kontabilitet i efekteve të transferimit.

Deri më datë 31.03.2023

12. Gjetje nga auditimi: Bashkia Selenicë nuk disponon një regjistër aktivesh i cili hartohet në vartësi të llojit të aktiveve afatgjata apo afatshkurtra si dhe grupit përkatës brenda llojit. Gjithashtu ky regjistër duhet të përmbajë kërkesat minimale konkretisht, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datë e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26-30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 65-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrin masa për hartimin e regjistrit të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: 1. Për vitin 2021, Kryetari i Bashkisë Selenicë ka nxjerrë Urdhrin nr. 144, datë 19.11.2021, për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Selenicë dhe Njësive Administrative Armen, Vllahinë, Sevaster, Brataj dhe Kotë. Procesi i inventarizimit të aktiveve të institucionit është kryer dy herë radhazi nga i njëjti komision i cili ka ushtruar këtë funksion në vitin 2020, në zbatim të Urdhrit nr. 221, datë 18.11.2020, të Kryetarit të Bashkisë, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 84.

2. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t'i dorëzohej nëpunësit autorizues të institucionit, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 85, germa "c".

3. Me Urdhrin nr. 145, datë 19.11.2021, të Kryetarit të Bashkisë është krijuar komisioni për vlerësimin e aktiveve për vitin 2021. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të propozuara nga komisioni i inventarizimit, në total nga komisioni i sipërpërmendur janë mbajtur 41 procesverbale të datave 20.12.2021, 21.12.2021, 22.12.2021, 24.12.2021, dhe 29.12.2021.

Duke u bazuar në procesverbalet e hartuara nga komisioni për vlerësimin e aktiveve është vlerësuar që të nxirren aktive jashtë përdorimit të Bashkisë Selenicë dhe Njësive Administrative në total në vlerën 770,089 lekë.

Me Urdhrin nr. 146, datë 19.11.2021, të Kryetarit të Bashkisë është krijuar komisioni për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit i përbërë nga znj. O. M., znj. E. K., z. E. F., z. M. H., znj. D. A. dhe znj. Sh. Xh.
Nga komisioni i sipërpërmendur janë mbajtur në total 41 procesverbale të datave 20.12.2021, 21.12.2021, 22.12.2021, 24.12.2021, dhe 29.12.2021, ku janë nxjerrë në total aktive jashtë përdorimit në vlerën 770,089 lekë.
Gjithashtu në listën e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit ka materiale të cilat konsiderohen të dëmshme konkretisht, stabilizator 1 copë, termometër 1 copë, rezistencë 14 copë, zgjatues prize 1 copë, petrogaz ndriçimi 2 copë, freskuese 1 copë, makinë shkrimi 1 copë, telefon zyre 2 copë, ngrohëse 2 copë dhe magnetofon 1 copë për të cilat hedhja apo asgjësimi i tyre, duhet të kryhet me një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të destinuara për asgjësim si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore.
Nga Kryetari i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e transportit, asgjësimit të tyre dhe nuk disponohet asnjë korrespodencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejimin e asgjësimit dhe groposjen e pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe impaktin që kanë në komunitet.
Në të gjitha procesverbalet citohet se, "Gjatë verifikimit të këtyre materialeve u konstatua se këto materiale nuk janë në gjendje për t'u përdorur dhe nuk përshtaten për përdorim. Materialet që dolën jashtë përdorimit u ndryshua forma dhe një pjesë e tyre u gropos dhe pjesa tjetër u dogj".
Referuar të dhënave të paraqitura në procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve konstatohet se, nuk vërtetohet me dokumentacion justifikues (procesverbal, fotografi) transporti si dhe vendi në të cilën është kryer asgjësimi i aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit, veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, Ligji nr. 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, VKM nr. 957, datë 19.12.2012, "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike", Kreu I, pikat 1-2, dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 122. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 65-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
13.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë të marrë masa në të ardhmen që ngritja dhe përbërja e komisionit të inventarizimit të kryhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe nga komisionet e inventarizimit të hartohet raporti për inventarin fizik në përfundim të procesit të inventarizimit.
13.2 Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrin masa në të ardhmen që në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve të mbahet parasysh kuadri rregullativ ligjor për mbrojtjen e mjedisit gjithashtu të kërkohet plotësimi i saktë i dokumentacionit, të rregullt dhe justifikues, sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" në datën 01.01.2021, ka qenë në vlerën 6,158,973 lekë. Gjatë vitit 2021 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 25,282,461 lekë dhe pakësim në vlerën 25,529,911 lekë ndërsa në datën 31.12.2021, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 5,911,523 lekë. Gjatë kësaj periudhe për këtë llogari është likuiduar vlera minimale 247,450 lekë si dhe janë krijuar detyrime në vlerën 25,282,461 lekë. Kjo situatë ka ardhur për shkak se janë marrë angazhime për kryerjen e shpenzimeve pa u siguruar të ardhura reale nga llogaria e njësisë vendore në thesar.

Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" në datën 31.12.2021, ka vlerën 71,283,867 lekë të cilat përfaqësojnë detyrimet për investime në vlerën 40,935,736 lekë, detyrime për vendime gjyqësore në vlerën 14,112,369 lekë si dhe shërbime në vlerën 16,235,762 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 50, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pikat 82-91, VKM nr. 823, datë 21.10.2020, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 70. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 65-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1 Rekomandim: Me qëllim që të mos krijohen detyrime të prapambetura dhe planifikimi i shpenzimeve të një viti buxhetor të mos rëndoj shpenzimet e vitit pas ardhës, Kryetari i Bashkisë Selenicë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 71,283,867 lekë gjithashtu të paraqesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 "Kreditorë për mjetet në ruajtje" në pasqyrat financiare është në vlerën 21,403,554 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se janë ngurtësuar fonde në vlerën 18,071,576 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e para, të cilave u ka kaluar afati i garancisë. Bashkia Selenicë nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për kalimin e këtyre fondeve, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 65-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontrator për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në procedurat e prokurimit me objekt: "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara", "Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë", "Rikonstruksion rruge të brendshme me beton", "Rikonstruksion i ujësjellësit Vodicë", "Sistemim Asfaltim rruga tubo (rruga varreza, spital)", "Sistemim Asfaltim rruga Kropisht", "Rehabilitim ura Brataj", "Riparimi i shkarkuesit të rezervuarit të Harvalasë, Zgjerimi i rrugës Resulaj – Romës dhe punime gërmimi dhe riparimi në rrugën Bashaj - Vërmik", "Rehabilitim i kanalit ujitës Hasomat Velçë dhe punime për rrjetin e kanalizimeve qendër Kotë", zhvilluar në vitin 2021, janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik. Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme në hartimin e kritereve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat e, nenit 26, pika 5, nenit 27, neni 61 pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për rregullat e

prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2.4, faqe 65-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kritere të veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në 4 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht si vijon:

1-Në procedurën e prokurimit me objekt "Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë", me vlerë të fondit limit 6,651,036 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është shpallur fitues OE "I.. G." SHPK, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DST, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.

2- Në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksion rruge të brendshme me beton", Bashkia Selenicë, me vlerë të fondit limit 12,000,347 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021", është shpallur fitues operatori ekonomik "A" ShPK, me vlerë të ofertës ekonomike 14,388,000 lekë me TVSh , i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

3- Në procedurën e prokurimit me objekt "Sistemim Asfaltim rruga Kropisht", Bashkia Selenicë, me vlerë të fondit limit 12.500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2021, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "A." ShPK, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.

4- Në procedurën e prokurimit me objekt "Rehabilitim i kanalit ujitës Hasomat Velçë dhe punime për rrjetin e kanalizimeve qendër Kotë", Bashkia Selenicë, me vlerë të fondit limit 7.500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2021, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "K." ShPK, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm: neni 24 "Anulimi i një procedure prokurimi", pika nr. 1, germa (ç), neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1, neni 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 dhe pika 5, neni 55, "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese", pika 1, germa (a). *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2.4, faqe 87-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1 Rekomandim: Titullari i AK të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2021 janë realizuar 24 procedura prokurimi me vlera të vogla të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik të APP-së me fond limit 15,865,410 lekë pa TVSH dhe realizim kontrate në vlerën 12,337,782 lekë pa TVSH. Me zgjedhje janë audituar 9 procedura me fond limit në vlerën 6,400,000 lekë pa TVSH ose në masën 40.3% të vlerës totale të fondit limit ku janë konstatuar parregullsitë si më poshtë:

-Në 2 raste janë realizuar 4 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit në vlerën totale 3,200,000 lekë pa TVSH duke shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit pra këto procedura duhet të kryheshin me tenderim konkretisht:
a. "Letër fotokopje" me fond limit 800,000 lekë pa TVSH dhe "Tonera për printera e fotokopje" me fond limit 800,000 lekë pa TVSH të cilat i përkasin të njëjtit objekt prokurimi, Materiale Kancelarie.
b. "Furnizim vendosje pjesë këmbimi" me fond limit 800,000 lekë pa TVSH dhe "Goma e bateri për automjete" me fond limit 800,000 lekë pa TVSH të cilat i përkasin të njëjtit objekt prokurimi, Shërbime për Automjete.
-Në 9 raste nuk dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit i cili duhet të administrojë dokumentacionin e çdo procedure prokurimi.
-Në 4 raste nuk argumentohet dhe dokumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit.
-Në 9 raste nuk është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla.
-Në 5 raste në sistemin e prokurimit elektronik nuk është respektuar afati i kalimit nga një operatorë ekonomikë tek tjetri.
-Në 2 raste në dosjet e procedurave me objekt "Furnizim vendosje pjesë këmbimi" me fond limit 800,000 lekë pa TVSH dhe "Lyerje shkolle" me fond limit 800,000 lekë pa TVSH nuk disponohet i gjithë dokumentacioni i përcaktuar në kriteret e ftesës për ofertë konkretisht, Certifikata ISO 3834-2:2006, ISO 9001:2008, BS OHSAS 18001:2007, EN-ISO 9001:2015, EN-ISO 14001:2015, BS PAS 99:2012, vërtetime që OE nuk është në proces falimentimi, pagesat mbi detyrimeve të kontributeve për sigurimet shoqërore, deklarata për përmbushjen e specifikimeve teknike, kontrata pune, libreza pune, dëshmitë profesionale të lëshuara nga institucione shtetërore ose private të akredituara në Republikën e Shqipërisë, kjo për arsye se të gjitha riparim-shërbimet e M. dhe të M. kërkojnë cilësi dhe specialiste përkatës, me përvoje pune dhe besueshmëri në kryerjen e riparim-shërbimit të kërkuar, të cilat përbëjnë skualifikim të operatorëve ekonomikë për mos plotësimin e tyre ndërkohë që nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla edhe pse këto kritere nuk janë përmbushur operatorët janë shpallur fitues.
-Në 1 rast objekti i prokuruar për procedurën "Ndërtim çezme dhe shtrim sheshi me pllaka guri" me fond limit 800,000 lekë pa TVSH nuk është realizuar brenda afateve të përcaktuar në kontratën dypalëshe për realizimin e punimeve. Gjithashtu nga operatori ekonomikë nuk është lëshuar asnjë situacion punimesh ndërkohë që afati i realizimit të kontratës ka përfunduar. Nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla nuk është mbajtur asnjë procesverbal mbi dokumentimin e kësaj situate.
-Në 2 raste mallrat nuk janë bërë hyrje në institucion brenda afateve të përcaktuara në kriteret e ftesës për ofertë.
-Në 2 raste fatura tatimore nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit.
-Në 4 raste kanë rezultuar vonesa në likuidimin e faturave tatimore ndaj operatorëve ekonomikë, duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.
-Në 9 raste dosjet e procedurave të prokurimit me vlera të vogla nuk janë të inventarizuara dhe arkivuara, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", neni 7, VKM nr. 823, datë 21.10.2020, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 40, pika 3, pika 8, neni 56, neni 59, pika 2, Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" i ndryshuar, pikat 11-12, pika 19, Udhëzimin nr. 5, datë

25.06.2021, "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pika 1 dhe Normën Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë neni 3, neni 29, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për arkivat". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 87-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore përgjatë zhvillimit të procedurave të prokurimeve me vlera të vogla të marrë masa që:

-Përgjatë hartimit të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve, të shmanget mundësia e copëzimit të fondeve për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh.

-Përpara fillimit të procedurës të argumentojë dhe të dokumentojë nevojat e institucionit për mallra dhe shërbime.

-Të argumentohet dhe dokumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit.

-Të hartohen dhe nënshkruhen deklaratat e konfliktit të interesit nga të gjithë anëtarët e komisionit të prokurimit me vlera të vogla.

-Të respektohet afati njoftimit për kalimin nga një operatorë ekonomikë tek tjetri në rastet e tërheqjes apo skualifikimit të tyre për procedurat të cilat zhvillohen në Sistemin e Prokurimit Elektronik të APP-së.

-Për rastet në të cilat nga operatorët ekonomikë nuk paraqesin dokumentacionin e përcaktuar në kriteret e ftesës për ofertë si dhe për rastet që mallrat e prokuruara nuk paraqiten nga operatori ekonomikë brenda afateve të përcaktuara në ftesën për ofertë, të bëhet skualifikimi i tyre.

-Për çdo rast faturat tatimore të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit referuar përcaktimeve ligjore.

-Për çdo rast likuidimi i faturave të kryhet brenda afateve ligjore duke shmangur krijimin e detyrimeve kontraktuale.

-Për çdo dosje të procedurave të prokurimit me vlera të vogla pas përfundimit të vitit ushtrimor të inventarizohen si dhe të kryhet arkivimi i tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së paraqitur me shkresën nr. 588/7, datë 08.11.2021, rezulton se:

Nga Bashkia Selenicë nuk është respektuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve *(shkresa nr*. 2798/4 datë 07.12.2021*)*.

Është hartuar Plani i Veprimit nr. 2798/2 datë 07.12.2021 për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse sipas llojit të rekomandimit.

Nuk është respektuar afati që brenda periudhës 6 mujore, Bashkia Selenicë duhet të informojë KLSH-në mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Selenicë, nuk është raportuar Këshillin Bashkiak, bazuar në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", Neni 50-Auditimi i jashtëm. Gjithashtu rezulton se:

a. Janë rekomanduar gjithsej *20 masa organizative,* të cilat janë pranuar plotësisht. Janë zbatuar plotësisht 2 masa, janë zbatuar pjesërisht 7 masa, është në proces zbatimi 1 masë dhe nuk janë zbatuar 10 masa.

b. *Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 3 masa me* vlerë 6,029,810 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht. Masat janë në proces zbatimi.

c. *Për masa mos efektivitet dhe efiçensë,* janë rekomanduar gjithsej 3 masa me vlerë 2,634,928 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat nuk është zbatuar asnjë masë.

d. *Masa disiplinore* janë rekomanduar për 10 punonjës të cilat janë pranuar, për 6 punonjës nëpunës civil dhe 4 punonjës me kod pune. Këto masa janë zbatuar pjesërisht. Nuk është njoftuar Departamenti i Administratës Publike lidhur me marrjen e masave disiplinore për nëpunësit e bashkisë referuar shkeljeve të konstatuara nga auditimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil.
Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" neni 15, "*Të drejtat e KLSH*", germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 142-167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
19.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces zbatimi ose të pazbatuara, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 588/7, datë 08.11.2021 "*Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Selenicë*", duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre.
- Nga Këshilli Bashkiak të analizohet dhe të dalë përgjegjësia për ndërtimin pa leje të rikonstruksionit të rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Selenicë, Kote dhe Armen, si dhe shpimi i pusit gjeologjik në fshatin Kotë, kryer pa leje nga organet e menaxhimit të burimeve ujore dhe të merren masa për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.
- Të merren masa për zbatimin e procedurave ligjore dhe të kërkohet zhdëmtimi i vlerës së karburantit të pajustifikuar me dokumente nga:
1. F. V. ish kryeinspektor i Policisë Bashkiake për periudhën nga data 01.01.2019 deri më 31.01.2020 për vlerën *317,761 lekë;*
2. S. H. ish Drejtor i Territorit për periudhën nga data 01.02.2020 deri më 28.02.2020 për vlerën *13,857 lekë.*
19.2 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë të marrë masa të menjëhershme për raportimin në Këshillin Bashkiak, të masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e KLSH-së.
19.3 Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masat që të njoftojë Departamentin e Administratës Publike lidhur me marrjen e masave disiplinore për nëpunësit e bashkisë referuar shkeljeve të konstatuara nga auditimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil.
Deri më 31.03.2023

20. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me menaxhimin e aseteve që disponon Bashkia Selenicë rezultoi se:
- Për NJA Selenicë, bashkia administron listën me 109 prona që i janë transferuar me VKM nr. 195, datë 06.03.2013 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Selenicë, të Qarkut Vlorë".
- Për NjA Vllahinë, bashkia administron listën me 826 prona e përgatitur nga komisioni i ngritur për të kryer këtë proces.
- Për Njësitë e tjera Administrative, Armen, Kotë, Sevaster, Brataj nuk ka një listë të pronave të paluajtshme si dhe nuk është marrë asnjë masë për të hartuar këtë listë në secilën njësi administrative.
- Gjithashtu, lidhur me listat e pronave të paluajtshme të NjA Selenicë dhe Vllahinë nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse

në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentet e pronësisë.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 20/20 datë 05.03.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", neni 37. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.1, faqe 167-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
20.1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Selenicë të marrë të gjitha masat për të filluar procesin e inventarizimit dhe përditësimit të pronave/pyjeve/kullotave si vijon:
- Të ngrejë një grup pune për verifikimin dhe përditësimin e të gjitha pronave që ka bashkia dhe NJA të transferuara në favor të tyre.
- Të vendosë komunikim me ASHK-në me qëllim arritjen e një bashkëpunimi për të marrë asistencën e tyre për verifikimin e gjendjes faktike të pronave.
- Të angazhojë Drejtorinë Juridike për verifikimin e gjendjes juridike të pronave.
- Të dokumentohen me kujdes të gjitha hapat e këtij procesi të gjatë dhe të rëndësishëm për secilën Njësi Administrative dhe në nivel bashkie.

Deri më 31.12.2023

21. Gjetje nga auditimi: Bashkia Selenicë ka lidhur gjithsej 18 kontrata për dhënien me qira të tokave bujqësore të lira me qëllim sigurimin e të ardhurave. Kontratat janë lidhur për mbjellje me ullinj apo arrorë, për sipërfaqe nga 0.7 ha deri në 11.2 ha me afat 99 vjet. Në total sipërfaqja e dhënë me qira për këto 18 kontrata është 47.75 ha, dhe pagesa për 1 ha është 6,000 lekë. Vlera vjetore që pritet të arkëtohet nga këto kontrata është 286,500 lekë. Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me dhënien me qira të tokave të lira bujqësore rezultoi se:
- Është bërë njoftim për shpalljen publike të qiradhënies së tokave bujqësore të lira në të gjitha NJA. Njoftimi nuk shoqërohet me informacion lidhur me kriteret dhe dokumentet që duhet të plotësojnë të interesuarit për marrjen me qira të sipërfaqeve bujqësore të lira.
- Nuk ka dokumentacion që të vërtetojë se si është kryer procesi i detajuar i vlerësimit. Është plotësuar një tabelë vlerësimi të kërkesë - ofertave me të dhëna në fusha si: afati, kultivari, investimi mbi token, vlera e investimit, ujitja, numri i të punësuarve dhe çmimi i ofruar, por nuk është e qartë se në çfarë dokumentacioni është bazuar Komisioni i Qiradhënies së Tokave Bujqësore të Pandara (KQTBP) që ka bërë këto vlerësime.
- Në dosjet e qiramarrësve konstatohet vetëm dokumente si: të dhënat personale të aplikuesit, formulari i kërkesës, kontrata, harta me planin e rilevimit si dhe plani i biznesit. Konstatohet se përgjithësisht planet e biznesit janë vetëm disa faqe dhe nuk kanë informacion të plotë lidhur me investimet kryesore mbi infrastrukturën, burimet e financimit që garantojnë investimin, ndikimin e investimit ne rritjen e numrit të të punësuarve, propozimin për çmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (lekë/ha në vit) etj.
- Nga monitorimi në terren i kontratave të lidhura rezulton se:
    8. 4 qiramarrës nuk kanë filluar kryerjen e punimeve për mbjelljen e sipërfaqes së marrë me qira (D. I., M. M., M. M. dhe I. S.);
    9. 5 qiramarrësit e tjerë nuk kanë filluar kryerjen e punimeve për mbjelljen e sipërfaqes së marrë me qira për arsye të ndryshme: kanë bërë kërkesë për shtyrje afati (E. O.), probleme në rimenaxhim (Xh. V., S. M. dhe U. K.), kërkesë për pezullim kontrate (A.H.).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 1 datë 18.07.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.1, faqe 167-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masa që të monitorojë rregullisht zbatimin e kushteve të kontratave të qiramarrësve, të dokumentojë këtë proces si dhe të veprojë në kohë ndaj të gjithë qiramarrësve që nuk respektojnë përcaktimet në kontratë. Gjithashtu, në rastet e lidhjes së kontratave të tjera të këtij lloji, Komisioni i Qiradhënies së Tokave Bujqësore të Pandara të kryejë dhe të dokumentojë procesin e vlerësimit në të gjitha hapat e zhvillimit të tij si dhe dosjet e aplikuesve/fituesve të jenë të plotësuara me dokumentacionin përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i menaxhimit të sipërfaqeve kullosore në Bashkinë Selenicë konstatohet se:
- Nuk janë hartuar planet e mbarështimit të kullotave. Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave ka lidhur kontrata për përdorimin e sipërfaqeve kullosore pa patur të hartuar dhe miratuar planet e mbarështimit;
- Në nivel bashkie janë identifikuar në total 66,182 krerë bagëti. Është parashikuar që të lidhen kontrata dhe të jepen me qira sipërfaqe për 36,753 krerë bagëti, ndërsa për diferencën prej 29,429 krerë që janë të njohura nga bashkia nuk është parashikuar lidhje e kontratave për kullotje.
- Bashkia Selenicë ka lejuar 118 blegtorë të përdorin kullotat pa lidhur kontratat përkatëse. Këto blegtorë faturohen nëpërmjet prerjes së faturave për secilin prej tyre. Sipërfaqja kullosore e përdorur nga këto blegtorë është 2,615.5 ha.

Veprimet e mësipërme në menaxhimin e sipërfaqeve kullosore janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, "Për Fondin Kullosor", i ndryshuar me Ligjin nr. 49/2016, neni 14, neni 15, neni 26 si dhe Udhëzimit nr. 2 datë 20.07.201 6 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.1, faqe 167-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masa që:
- Të hartojë planet e mbarështimit të kullotave që ka në administrim;
- Të nxisë blegtorët që ju jep në përdorin kullota pa lidhur kontratat përkatëse që të pajisen me Nipt si dhe të fillojnë regjistrimin e bagëtive në Sistemin e Informacionit Blegtoral dhe Veterinar;
- Të sigurohet që të gjithë blegtorët të lidhin kontrata për shfrytëzimin e sipërfaqeve kullosore;
- Të planifikojë dhe të kryejë investime në përmirësimin e kullotave, riparimin apo ndërtimin e lerave.

Deri më 31.12.2023

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi administrimin dhe përdorimin e fondeve nga buxheti i shtetit dhe të ardhurave nga aktivitetet në fondin pyjor dhe kullosor rezulton se për vitin 2021:
- Bashkia Selenicë ka kryer financim për pyjet dhe kullotat në vlerën totale **8,421,610 lekë.** Shpenzimet për zërin paga dhe sigurime shoqërore janë në vlerën 7**,726,930 lekë**, ose **92%** e buxhetit.
- Bashkia Selenicë nuk ka planifikuar dhe përdorur fonde për mbrojtjen e pyjeve, florës dhe faunës, punime për përmirësimin e gjendjes së pyjeve, investime për shtimin e sipërfaqes dhe volumit, hartimin e planeve të mbarështimit etj. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 57/2020 "Për Pyjet" neni 13, pika 7.
- Nga ana tjetër të ardhurat e siguruara nga aktivitetet në sipërfaqet pyjore-kullosore për vitin 2021 janë në vlerën totale **3,715,637 lekë**. Kjo vlerë gjatë planifikimit të buxhetit është ndarë nëpër zëra të ndryshëm të buxhetit të bashkisë së bashku me të ardhurat e tjera të vitit 2021. Këto veprime

janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 57/2020 "Për Pyjet" neni 13 pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.1, faqe 167-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masa që të ardhurat e siguruara nga përdorimi i fondit pyjor dhe kullosor të përdoren në funksion të mbrojtjes dhe rimëkëmbjes së pyjeve, ndërtimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës pyjore, zhvillimin dhe shtimin e sipërfaqes së pyjeve dhe volumit të tyre, hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit, kryerjen e punimeve të pastrimit, të mirëmbajtjes e të përmirësimit, etj.

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me aktivitetin e kryer nga Bashkia Selenicë në fondin pyjor me objekt "Prerjet rigjeneruese dhe shfrytëzimin e lëndës drusore në fondin pyjor" konstatohen parregullsi në të gjitha hapat e zhvillimit të këtij procesi si më poshtë:

1. Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave (DZHBAPK) nuk ka dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit Projektin teknik të shëndetësimit të pyjeve për ngastrën nr. 37, të hartuar më datë 08.06.2018 dhe ka vijuar me procesin e prerjeve të lëndës drusore pa marrë miratimin nga MTM.

2. Studimi teknik i shëndetësimit të sipërfaqes në ngastrën nr. 37 është kryer jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 2 datë 03.03.2017, Kreu II, pika 1.

3. Në dosjen e audituar për shfrytëzimin në ngastrën nr. 37 nuk administrohet një urdhër i Titullarit të Bashkisë për organizimin e procesit të damkimit;

4. Proces verbalet me nr. 108 datë 13.06.2018, "Për dorëzimin e ngastrës/nënngastrës pyjore për shfrytëzim" dhe nr. 108/1 datë 13.06.2018 bien në kundërshtim me njëri tjetrin në përshkrimin e problemit të konstatuar;

5. Nuk ka dokumentacion që të jetë miratuar nga MTM shfrytëzimi në ngastrën nr. 23/a.

6. Është ngritur grupi i punës për të bërë verifikimin dhe damkosjen e pishave të rrëzuara në Ekonominë Pyjore Kotë-Sevaster, ngastra nr. 16, por në dosje nuk disponohet dokumentacion lidhur me përfundimin e këtij procesi, p.sh të jenë hartuar listëdamkat sipas llojeve drusore;

7. Në dosje nuk gjendet i dokumentuar zhvillimi i procesit të damkimit për ngastrën nr. 11/c;

8. Nga akt konstatimet e mbajtura nga inspektorët e bashkisë konstatohet se subjekti "L." SHPK në ngastrën nr. 16 dhe nr. 11 nuk ka respektuar kushtet e kontratës: janë vërejtur dëmtime të damkave dhe prerje të disa pishave të njoma pa damkë. Gjithashtu, është konstatuar se nga grupi i punës janë damkosur pisha të njoma të drejta që nuk janë objekt i projektit të përmirësimit të pyllit.

9. Bashkia Selenicë nuk kryen periodikisht procesin e vlerësimit të fondit pyjor me prerje rigjeneruese, por edhe në rastet kur janë kryer disa vlerësime në ngastra të caktuara ato nuk janë miratuar të gjitha në MTM. Për ato ngastra që është miratuar nga MTM që të kryhet procesi i shëndetësimit të sipërfaqeve pyjore nuk janë marrë masa për të zhvilluar më tej procedurat.

10. Bashkia Selenicë nuk ka plane mbarështimi të pyjeve të cilat të shërbejnë si bazë për proceset që do të zhvillohen lidhur me trajtimin dhe shfrytëzimin e fondit pyjor me qëllim sigurimin e nevojave për ngrohje, rigjenerimin dhe shëndetësimin e pyjeve.

Për sa më sipër rezulton se Bashkia Selenicë në menaxhimin e fondit pyjor për zhvillimin e procesit të prerjeve rigjeneruese dhe shfrytëzimin e lëndës drusore, nuk ka ndjekur përcaktimet e VKM-së nr. 438, datë 08.06.2016, "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jo pyjore", e ndryshuar, Kreu III, pikat 1,3,6,15,16,18, Kreu V pikat 24,25, si dhe Udhëzimit nr. 2 datë 03.03.2017, "Për kërkesat teknike

të caktimit të ngastrave, grup ngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje", Kreu I pika 15, Kreu II pika 1, Kreu III pika 1, pika 4, pika 8, pika 9, pika 13.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2, faqe 179-185 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
24.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave të marrin masa që:
- Të hartojnë Planet e mbarështimit të pyjeve që kanë në territorin e bashkisë;
- Të kryejnë periodikisht procesin e vlerësimit të fondit pyjor me prerje rigjeneruese duke hartuar projektet teknike të shëndetësimit të pyjeve rast pas rasti;
- Të fillojnë procedurat e ankandit për ato ngastra që është miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit projekti për shëndetësimin e sipërfaqeve pyjore;
- Të dokumentohet i gjithë procesi në çdo hap të tij.

Deri në Dhjetor 2023 dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike në fondin pyjor në territorin e Bashkisë Selenicë u konstatua se kryejnë aktivitetin tregtar në fushën e minerare dhe kanë marrë në përdorim sipërfaqe nga fondi pyjor/kullosor gjithsej 19 OE me sipërfaqe totale në përdorim për S=12.311 Km^2 e konvertuar në sipërfaqe prej S=1,231.1 ha. Nga auditimi i dokumentacionit në dosjet e këtyre subjekteve si dhe të gjithë dokumentacionit që Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave vuri në dispozicion të grupit të auditimit u konstatuan parregullsi si vijon:
1. Bashkia Selenicë nuk ka informacion lidhur me llojin e pasurisë ku ushtrojnë veprimtari minerare subjektet e pajisura me leje nga AKBN;
2. Bashkia Selenicë nuk ka dokumentacion lidhur me statusin e pronës ku ushtrojnë aktivitet subjektet e pajisura me leje minerare;
3. Bashkia Selenicë nuk ka informacion për të gjitha subjektet e pajisura me leje lidhur me sipërfaqen e karrierës që kanë në shfrytëzim. Nga 19 subjekte aktive sipas të dhënave të AKBN-së, Bashkia Selenicë nga verifikimi i bërë në terren ka informacion lidhur me sipërfaqen e karrierës vetëm për 12 subjekte me aktivitet nxjerrje qymyri/gurore ndërsa për subjektet *"R."SHKP, "S." SHPK, "A." SHPK, "T. I." SHPK, "B. M. I." SHPK, "B. M. I." SHPK, "B. G." SHPK* nuk ka informacion sa është sipërfaqja e karrierës që këto subjekte shfrytëzojnë;
4. Bashkia Selenicë nuk ka lidhur kontratë qiraje me subjektet që ushtrojnë veprimtari minerare sipas tarifave *minimale* ligjore për zbatimin e kontratave të shfrytëzimit/kërkim-zbulimit. Nga auditimi u konstatua se në territorin e Bashkisë Selenicë kanë ushtruar aktivitet 19 subjekte private për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore për nxjerrje guri pllakë, gurë gëlqerorë, gëlqeror mermer dhe gëlqerorë masiv, referuar lejeve minerare të miratuara nga MEI. Nga bashkia nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private për sipërfaqen totale prej 1411.10 ha, detyrimi dysheme/minimal është përllogaritur përafërsisht **80,078,812 për vitin 2021**, për 17 subjekte (Aneksi nr. 2.6/4 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit), **vlerë e cila përbën të ardhura të pa planifikuara në buxhetin e Bashkisë Selenicë**.
Përdorimi dhe shfrytëzimi i pasurive të paluajtshme që përdoren nga subjektet që ushtrojnë aktivitet mineral në sipërfaqet ku funksionojnë lejet minerare aktive *(jo infrastruktura lidhëse apo depozituese)*, nuk ka asnjë impakt në situatën financiare të Bashkisë Selenicë. Niveli i të ardhurave të Bashkisë nga qiratë e kësaj pasurive të paluajtshme *(që nga viti 1998, kur janë aktive lejet minerare, referuar AKBN-së)* deri më sot, është në vlerë 0 lekë. **Për një sipërfaqe 1,231.14 ha që shfrytëzohet nga subjektet për aktivitet minerar, Bashkia Selenicë nuk merr asnjë të ardhur.**

Në përllogaritjen e vlerës së sipërcituar, grupi i auditimit i është referuar pikës 2, të VKM –së nr. 1064, datë 22.12.2010 *"Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", ku sanksionohet: "Për përdorim sipërfaqesh të fondit pyjor e kullosor publik, zbatohen tarifat dysheme, që llogariten duke mbajtur parasysh përdorimin aktual të territorit dhe kohëzgjatjen e veprimtarisë së parashikuar, sipas lidhjes 2 të shtojcës,..."*.
Lidhjen nr. 2, pika 6 "Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë)" *kohëzgjatje 6-10 vjet, për përdorim territori është: 440,000 lekë/ha/vit.*
Lidhjen nr. 2, pika 9 "Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe" *kohëzgjatje 6-10 vjet, për përdorim territori është: a) Pyll trungishte – 96,000 lekë/ha/vit;* ***b) Pyll cunqishte/shkurre e kullota – 78,000 lekë/ha/vit;*** *c) Tokë me bimësi pyjore, djerr e Inproduktive 62,000 lekë/ha/vit.*
Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", neni 25 "Përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar", pikat 3 dhe 4.
5. Bashkia Selenicë nuk ka përpiluar raporte studimi tekniko-ekonomike për të gjitha subjektet me qëllim për të dokumentuar çdo ndryshim që mund të ketë pësuar sipërfaqja e fondit pyjor/kullosor apo in produktiv, asete në pronësi publike e marrë në përdorim me qira nga subjektet sipas lejeve minerare. Raportet tekniko-ekonomike janë hartuar vetëm për 7 subjekte (*"R." SHKP, "B. P." SHPK, "B. G." SHPK, "Y. S." SHPK, "A" SHPK, "M." SHPK, "T.E." SHPK*). Raportet tekniko-ekonomike nuk japin informacion në lidhje me llojin dhe vlerën e bimësisë që përmban sipërfaqja që do të përdoret nga subjektet minerare.
6. Në Bashkinë Selenicë asnjë nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e minierave nuk ka të miratuar me VKM apo ligj të veçantë heqjen nga fondi pyjor/ndryshimi i zërit kadastral i sipërfaqeve të miratuara referuar lejeve të AKBN-së. Ndryshimi i zërit kadastral të sipërfaqeve përkatëse nuk është bërë edhe për ato subjekte për të cilët janë hartuar raportet tekniko-ekonomike.
Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor/rregullativ si vijon:
- Ligji nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", për shfrytëzimin e grupit të rërave dhe zhavorre Bituminoze neni 15, pika 5 ku citohet: "*Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jo metalore, qymyret dhe bitumet, zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullosor, pronë shtetërore, dhe kalon si pasuri minerare, në varësi të ministrisë së linjës, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullosor. Në këto raste, leja hyn në fuqi për zbatimin e detyrimeve të saj në datën e ndryshimit të zërit kadastral",*
Neni 24, pika 10, ku citohet: "*Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit të grupit të mineraleve ndërtimore, zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullosor, pronë shtetërore, dhe kalon si pasuri minerare në varësi të ministrisë së linjës, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullosor. Në këto raste, leja hyn në fuqi për zbatimin e detyrimeve të saj në datën e ndryshimit të zërit kadastral".*
-Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005 *"Për pyjet dhe shërbimin pyjor",* i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 "Për Fondin Kullosor", pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008 *"Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor",* i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10. 2008 *"Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor",* i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016 dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të

ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4.

7. Nga auditimi rezultoi se në Bashkinë Selenicë janë 4 subjekte ("S." SHPK, "A." SHPK, "T. I." SHPK ,"B. M. I." SHPK) që kanë aktive 6 leje minerare referuar të dhënave të marra nga AKBN të cilët edhe pse ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë nuk janë të pajisur me NIPT sekondar, si rezultat nuk ngarkohen për pagesën e detyrimeve vendore sikurse janë taksa e pastrimit / gjelbërimit / truallit / ndërtesës/ ndikimit në mjedis / mbrojtje, përmirësim mjedisi, në kundërshtim me përcaktimet e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 71 datë 30.11.2020 e nr. 3623 Prot., datë 01.12.20220 *"Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Selenicë-Administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për viti 2021".*

8. Nga auditimi i raporteve tekniko-ekonomike për vlerësimin e sipërfaqeve që do të hiqen nga fondi pyjor është konstatuar që në tre raste nuk është vlerësuar saktë bimësia/lënda drusore e ndodhur në sipërfaqen që është vlerësuar.

- Subjekti "Y. S." SHPK, në raportin tekniko- ekonomik me nr. 88 Prot, datë 15.05.2018, është cituar se sipërfaqja e kërkuar është 19.80 ha, dhe shtrihet në:

- ngastrën nr. 26, që bën pjesë në ekonominë pyjore mali Bratit-Gumenicë me sipërfaqe 10.536 ha;
- ngastrën nr. 13 bën pjesë në ekonomisë kullosore Gjorëm Vranisht me sipërfaqe 9.256 ha.

Në raport, nuk është përmendur statusi i veçantë i llojit të bimësisë, pasi është konsideruar si dru zjarri "trungishte".

- Subjekti "A" SHPK, në raportin tekniko- ekonomik me nr. 38 prot, datë 13.02.2019, është cituar se sipërfaqja e kërkuar është 14.064 ha, dhe shtrihet në:

- ngastrat nr. 19; 25; 26 bën pjesë në ekonomisë pyjore mali Bratit-Gumenicë dhe ngastrat /nëngastart 1; 14, të ekonomisë kullosore Gjorëm Vranisht. Në raport nuk është përmendur statusi i veçantë i llojit të bimësisë, pasi është konsideruar si dru zjarri "trungishte".

- Subjekti "M.P." SHPK, në raportin tekniko- ekonomik me nr. 37 Prot, datë 13.02.2019, është cituar se sipërfaqja e kërkuar është 55.48 ha, dhe shtrihet në; ngastrat/nënngastrat nr. 19; 25; 26; 28; 29;30, dhe bën pjesë në ekonominë pyjore/kullosore mali Bratit-Gumenicë, dhe janë në pronësi/administrim të Bashkisë Selenicë.

Në raport (përveç tabelës bashkangjitur raportit ku përmbajtja e ngastrës 26-përbërja e grumbullit është cilësuar "e thjeshtë"), nuk është përmendur statusi i veçantë i llojit të bimësisë, pasi është konsideruar si dru zjarri "trungishte".

Referuar regjistrit kadastral të shqyrtuar nga grupi i auditimit prona VL3300026, parcela nr. 26, në ekonominë pyjore/kullosore mali Bratit-Gumenicë përmban **ilqe**.

9. Subjektet me objekt veprimtarinë minerare në Bashkinë Selenicë, nuk kanë zbatuar parimet e veprimtarisë minerare që rregullon marrëdhëniet midis subjektit dhe titullarit të pronësisë (Bashkisë Selenicë), në përputhje me pikën 4 të nenit 4 "*E drejta minerare është një e drejtë e dallueshme dhe e pavarur nga e drejta e pronësisë mbi sipërfaqen e tokës, ku ato gjenden. Marrëdhëniet e subjektit përfitues të së drejtës minerare dhe titullarit të së drejtës së pronësisë mbi pronën, ku gjenden minerale, rregullohen me marrëveshje, sipas legjislacionit në fuqi*", të ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 "*Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë*" me ndryshimet e ligjit nr. 9/2013 dhe Ligjit nr. 134/2014 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.3, faqe 185-207 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave duhet të marrë masa të menjëhershme lidhur me:

1. T'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.
2. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.
3. Të vendosen marrëdhënie kontraktuale me Operatorët Ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej 1,231.1 ha, duke aplikuar tarifat dysheme/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit (**80,078,812**, për 17 subjekte, Aneksi nr. 2.6/4 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4. Gjatë hartimit të raporteve tekniko-ekonomike rast pas rasti të vlerësohet saktë lloji i bimësisë dhe lëndës drusore që ndodhet në sipërfaqen për të cilën po hartohet raporti, si dhe llogaritja e vlerës të jetë gjithashtu referuar llojit të bimësisë apo lëndës drusore.
5. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që të ngarkojë subjektet "S." SHPK, "A." SHPK, "T. I." SHPK ,"B. M. I." SHPK që kanë aktive 6 leje minerare në territorin e Bashkisë Selenicë me detyrimeve vendore referuar përcaktimeve të Vendimit të Këshillit Bashkiak për miratimin e Pakës Fiskale.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ecurisë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton se, qytetarët/individët që kanë përfituar legalizimin e sipërfaqeve të caktuara nuk kanë paguar rregullisht detyrimin ndaj Bashkisë Selenicë për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Përkatësisht për vitin 2021 nuk kanë paguar detyrimin 19 qytetarë me vlerë totale **485,846** lekë, ndërsa nuk kanë paguar ende detyrimin 225 individë/qytetarë për sipërfaqet e legalizuara përpara vitit 2021 me vlerë totale **5,765,781** lekë. **Në total vlera e detyrimeve nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton në 6,251,627 lekë për 244 objekte të legalizuara, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Selenicë.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" pika 5 si dhe VKB-së nr. 71, datë 30.11.2020 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Selenicë, administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2021". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 40-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1 Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masat e duhura ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 244 debitorë në vlerën 6,251,627 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Drejtoria e të Ardhurave të dërgojë informacion periodik në Drejtorinë e Financës lidhur me listën e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu, nga strukturat e

Bashkisë Selenicë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave lidhur me detyrimet që tatimpaguesit kanë ndaj Bashkisë Selenicë rezultoi se gjatë vitit 2021 borxhi i krijuar është në shumën **32,070,957 lekë** dhe përbëhet nga detyrimet nga taksat dhe tarifat për personat fizikë/juridikë, detyrimet nga taksat dhe tarifat vendore për familjet dhe detyrimet nga taksa e tokës bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifa e vaditjes.
Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore në mënyrë progresive më datë 31.12.2021 në Bashkisë Selenicë janë në vlerën **362,065,059 lekë** të përbëra nga:
- Detyrime për taksën e ndërtesës për 6343 familje në vlerën **4,110,003 lekë;**
- Detyrime për taksën e tokës bujqësore për 7516 familje në vlerën **255,577,812 lekë**;
- Detyrime nga biznesi i vogël për 470 subjekte në vlerën **38,882,100 lekë**;
- Detyrime nga biznesi i madh për 15 subjekte në vlerën **37,930,263 lekë**;
- Detyrime për taksat familjare (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim) për 7640 familje në vlerën **25,510,831 lekë;**
- Detyrime nga tarifa e vaditjes në vlerën **54,050 lekë**.

Lidhur me hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Selenicë rezulton se, të gjitha bizneset debitorë janë njoftuar për kalimin e afatit për pagesat vendore. Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore nuk janë marrë masa të tjera ligjore, veprime në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 40-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën totale **362,065,059 lekë**, e përbërë nga:
- **4,110,003 lekë** detyrime për taksën e ndërtesës për 6343 familje;
- **255,577,812 lekë** detyrime për taksën e tokës bujqësore për 7516 familje;
- **38,882,100 lekë** detyrime nga biznesi i vogël për 470 subjekte;
- **37,930,263 lekë** detyrime nga biznesi i madh për 15 subjekte;
- **25,510,831 lekë** detyrime për taksat familjare (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim) për 7640 familje;
- **54,050 lekë** detyrime nga tarifa e vaditjes.

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.
b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.
d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e

DAPPLL të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
e- DAPPLL të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Selenicë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i subjekteve që tregtojnë lëndë djegëse me pakicë lidhur me pagesën e pajisjes me autorizim për ushtrimin e aktivitetit rezultoi se, në Bashkinë Selenicë për vitin 2021 janë 3 subjekte (T. O., Xh. G., M. O.) që kanë ushtruar aktivitet të pa pajisur me autorizimin e nevojshëm edhe pse nga ekstrakti i QKB-së rezulton se kanë filluar aktivitetin në këtë bashki që në vitin 2015. **Të ardhurat e munguara vetëm për vitin 2021 nga mos pagesa për autorizimin llogariten në vlerën 600,000 lekë (3*200,000).**
Subjektet "P. SHPK" dhe "D. Gj. SHPK" janë pajisur me autorizim/licencë dhe me ato është lidhur akt marrëveshje për pagesën e detyrimit për autorizimin me këste. Marrëveshja konsiston në krijimin e mundësisë për subjektet që detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite ta paguajnë me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë. Vlera e mbetur ende për t'u paguar nga këto subjekte është **750,000 lekë**.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore, përkatësisht:
- Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, neni 4, neni 15 , neni 20 dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kreu II, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 40-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që subjektet "T. O.", "Xh. G.", "M. O.", që ushtrojnë aktivitet në kundërshtim me dispozitat ligjore të pajiset menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke kryer pagesa të plota apo të pjesshme. Gjithashtu, DAPPLL të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për subjektet "P. SHPK" dhe "D. Gj. SHPK" me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Selenicë gjatë vitit 2021 ka konstatuar 10 raste të shkeljes së legjislacionin në fushën e mbrojtjes së territorit. Inspektorët e IMTV-së për këto raste kanë mbajtur proces verbalet përkatëse të konstatimit të kundërvajtjes dhe në 4 raste kanë marrë vendim për pezullim punimesh. Për asnjë nga 10 shkeljet e konstatuara nuk është marrë vendim prishje apo masa e dënimit me gjobë, veprim në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", neni 52, pika 1, germa e. Mos dhënia e masës "Dënim me gjobë" për kundërvajtësit ka sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Selenicë në vlerën 5,000,000 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 40-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1 Rekomandim: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Selenicë të rivlerësojë shkeljet e konstatuara referuar kundërvajtjes dhe të marrë masat për dënim me gjobë bazuar në

llojin e shkeljes së kryer. Gjithashtu, në vijimësi për çdo proces verbal të konstatimit të kundërvajtjes të vendosen masat administrative përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", **nga Titullari i njësisë publike,** të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,828,092 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pafavorizuara", Bashkia Selenicë, me vlerë të kontratës (me TVSH) 14,961,413 lekë, fituar nga BOE "J." SHPK & "C." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 508,648 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1423 Prot. datë 10.05.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Selenicë dhe BOE "J." SHPK & "C." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 129-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **508,648 lekë pa TVSH** nga BOE "J." SHPK & "C." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1423 Prot. datë 10.05.2021, me objekt "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara", Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rehabilitim Ura Brataj", Bashkia Selenicë, me vlerë të kontratës (me TVSH) 1,968,720 lekë, fituar nga OE "A" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 138,400 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 818/1 Prot. datë 16.03.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Selenicë dhe OE "A" SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 129-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **138,400 lekë pa TVSH** nga OE "A" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 818/1 Prot. datë 16.03.2021, me objekt "Rehabilitim Ura Brataj", Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Sistemim-Asfaltim lagjja Tubo – Rromës (rruga e varrezave, spitalit", Bashkia Selenicë, me vlerë të kontratës (me TVSH) 9,609,120 lekë, fituar nga OE "J." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 254,080 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 830 Prot datë 17.03.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Selenicë dhe OE "J." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 129-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **254,080 lekë pa TVSH** nga OE "J." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 830 Prot. datë 17.03.2021, me objekt "Sistemim-Asfaltim lagjja Tubo – Rromës (rruga e varrezave, spitalit", Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme me beton", Bashkia Selenicë, me vlerë të kontratës (me TVSh) 14,388,000 lekë, fituar nga BOE "A" SHPK & "Sh." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 471,240 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1031 Prot. datë 06.04.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Selenicë dhe BOE "A" SHPK & "Sh." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 129-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **471,240 lekë pa TVSH** nga BOE "A" SHPK & "Sh." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1031 Prot. datë 06.04.2021, me objekt "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme me beton", Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë", Bashkia Selenicë, me vlerë të kontratës (me TVSH) 14,388,000 lekë, fituar nga OE "I.G." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 486,900 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1456 Prot datë 12.05.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Selenicë dhe OE "I.G." SHPK & "Sh." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 129-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **486,900 lekë pa TVSH** nga OE "I.G." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1456 Prot. datë 12.05.2021, me objekt "Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë", Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në dosjen e prokurimit dhe në SPE të dosjes së prokurimit me objekt "Sistemim Asfaltim rruga Kropisht", Bashkia Selenicë, rezulton që OE "B" ShPK është skualifikuar padrejtësisht. KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me këtë OE, me ofertë ekonomike 9,532,318.8 lekë me TVSH, ose **4,997,602.2** lekë më pak se vlera e kontratës së lidhur me OE "A." ShPK, vlerë që përbën përdorim pa ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Selenicë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 87-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në dosjen e prokurimit dhe në SPE të dosjes së prokurimit me objekt "Rehabilitim i kanalit ujitës Hasomat Velçë dhe punime për rrjetin e kanalizimeve qendër Kotë", Bashkia Selenicë, rezulton që OE "B. K." ShPK është skualifikuar padrejtësisht. KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me këtë OE, me ofertë ekonomike 6,386,960 lekë me TVSH, ose **2,307,781** lekë më pak se vlera e kontratës së lidhur me OE "K." ShPK, vlerë që përbën përdorim pa ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Selenicë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 87-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1-1.2 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Selenicë dhe KVO, të marrin masa për eleminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DST, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë.

Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE

I. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", neni 15 germat b, c dhe ç, Ligjin nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, neni 59 "*Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore*", pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"*, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64 germa g, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Selenicë** t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse referuar nenit 58 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar nga **"Vërejtje", deri në "Largim nga shërbimi civil", në proporcion me shkeljen, për punonjësit e mëposhtëm:**

1. Z. K. B. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Burimeve Natyrore, Mjedisit, Projekteve dhe Investimeve për problemet e konstatuara në menaxhimin e arkëtimeve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë.

2. Z. E. F. me detyrë Kryeinspektor në Inspektoratin Tatimor të Kundërvajtjeve Administrative, Menaxhimi i Debitorëve, Konfiskimi dhe Sekuestrimi për vitin 2021 për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhit tatimor.

3. Z. B. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e aktiviteteve të zhvilluara në fondin

pyjor dhe kullosor si dhe aktivitetet e prerjeve rigjeneruese dhe shfrytëzimin e lëndës drusore në fondin pyjor.

4. Z. M. H. me detyrë Jurist / Njësia e Prokurimit për shkeljet e konstatuara në hartimin e kritereve të kualifikimit për procedurat e prokurimit.

5. Z. A. V. me detyrë Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Burimeve Natyrore, Mjedisit, Projekteve dhe Investimeve (Njësia e Prokurimit) për shkeljet e konstatuara në hartimin e kritereve të kualifikimit për procedurat e prokurimit.

II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Ligjin 139/2015" Për vetëqeverisjen vendore", pika 4 e nenit 15, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë", neni 37, "Masa disiplinore", kontratën individuale të punës, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Selenicë** që bazuar në shkeljet e konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit të KLSh-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga "Vërejtje", deri në "Zgjidhje të kontratës së punës", **në proporcion me shkeljen**, për punonjësit e mëposhtëm:

1. Z. R. G. me detyrë inspektor në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhit tatimor.

2. Zj. E. H. me detyrë inspektor në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhit tatimor.

3. Z. V. T. me detyrë inspektor në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhit tatimor.

4. Z. V. S. me detyrë inspektor në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhit tatimor.

5. Z. D. A. me detyrë inspektor në IMTV për problemet e konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

6. Z. Ç. H. me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave për problemet e konstatuara në menaxhimin dhe mbrojtjen e pyje kullotave.

7. Z. O. Gj. me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave për problemet e konstatuara në menaxhimin dhe mbrojtjen e pyje kullotave.

8. Z. A. Ç. me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave për problemet e konstatuara në menaxhimin dhe mbrojtjen e pyje kullotave.

9. Z. P. H. me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave për problemet e konstatuara në menaxhimin dhe mbrojtjen e pyje kullotave.

III. Për punonjësit që kanë mbushur moshën e pensionit

Për punonjësit që kanë mbushur moshën e pensionit të pleqërisë nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara ekzistojnë por i rekomandojmë Titullarit të Bashkisë Selenicë të marrë masat për të ndërprerë marrëdhëniet e punës për:

1. Z. L. H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore.

2. Z. Sh. D. me detyrë Inxhinier Pyjesh në Drejtorinë së Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave.

IV. Për punonjësit e larguar

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara ekzistojnë, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë

institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e masës disiplinore:
1. Zj. Gj. Xh. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, për vitin 2021.
2. Z. K.K. me detyrë inspektor në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave.
3. Z. G. S., me detyrë inspektor në Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave.
4. Z. A. L. me detyrë inspektor në Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave.
5. Z. P.A. me detyrë inspektor në Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave.
6. Z. M. H. me detyrë inspektor në Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave.
7. Z. B. D. me detyrë Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave.
8. Z. G. L. me detyrë ish Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave.
9. Z. L. B.me detyrë inspektor në IMTV.
10. Z. F. Xh. me detyrë Kryeinspektor i IMTV-së.
11. Z. S. H. me detyrë inspektor në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave.
12. Znj. S. S. me detyrë Juriste / Njësia e Prokurimit për shkeljet e konstatuara në hartimin e kritereve të kualifikimit për procedurat e prokurimit.

V. Njoftimi i Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit të Mbikëqyrjes të Shërbimit Civil

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Selenicë pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**
a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

V. ANEKSET

Aneksi nr. 2.2/1: Detyrimet e prapambetura për investimet më 31 Dhjetor 2021

Fatura	Datë	Subjekti	Investimi	Vlera e fatures 31.12.2021	Shtesat	U.shpenzimi	Likuidimet	U.shpenzimi	Likuidimet	Totali i likuidimeve viti 2021	Gjendja ne 31.12.2021
		B.	Sistemim Asfaltim rruga treblov-Peshkëpi (diference fature)	349,752						-	349,752
220	28.12.2017	D. shpk	Supervizim i pastrimi te perroit Peshkëpi	36,240						-	36,240
34	29.03.2018	P.k.	Mbikëqyrje (Supervizim) Rehabilitim i rrugëve të fshatit Kotë	27,000						-	27,000
29	12.09.2018	P. shpk	Mbikëqyrje punimesh	34,800						-	34,800
26	30.09.2018	2.	Rehabilim i rrjetiti ujites Drashovice,Armen,Shkoze,Sevaster	50,213						-	50,213
		C. shpk	Ndërtim i kanalit ujites Lepenice	81,148						-	81,148
28	10.04.2018	I. G. shpk	Ndërtim ujesjellesi Drashovice	137,964						-	137,964
		B.	Rruge te brendshme dhe tumbino	34,733						-	34,733
		A.	Riparim ujësjellësi Romes -Karbunar	2,732						-	2,732
			Investime të ndryshme ne komunen Brataj	139,602						-	139,602
			Rrugë të brendshme Lepenicë	972,762						-	972,762
			N..	412,537						-	412,537
			A..	99,975						-	99,975
			Gjendje blerje projekte	432,840						-	432,840
4	18.04.2011	E. v.	Projekte	328,950						-	328,950
2	215.09.2017	J. shpk	Rehabilitimi i qendres Brataj	65,002						-	65,002
23	10.6.2019	C.G.	Studim projektim mbrojtje nga erozioni	2,657,000				.255,dt.07.04.2021	2,657,000	2,657,000	-
21	10.07.2019	Sh. shpk	Rehabilitim i kanalit pjesor te Petes dhe dega Mavrove	10,544,135		123,dt.02.03.2021	5,544,135	691,dt13.10.2021	5,000,000	10,544,135	-
32	27.06.2019	B.	Rikostruksion rruga hyrese Selenicë	13,099,254		333,dt.12.05.2021	2,500,000	692,dt.13.10.2021	5000000	7,500,000	5,599,254
30	31.05.2019	B.	Rikostruksion rruga hyrese Selenice	2,500,000				333,dt.12.05.2021	2,500,000	2,500,000	-
35	1.1.2019	C. shpk	Rikostruksion shkolla M. Xh.	13,352						-	13,352
28		M. B.	Kolaudim ObjektiShkolla 9 vjecare Kote	87,624						-	87,624
49	23.10.2019	I.G.	Rehabilitim i kanalit Vadites & stacionit të pompimit Dushkarak	299,904		140,dt.03.03.2021	299,904			299,904	-
		S. shpk	Mbikqyrje supervizim te kanalit kullues fush Shkoze Sevast	214,018				828,dt.22.12.2021	214,018	214,018	-
			Supervizim riparime mirmbajtje te ujesjellesave te fshatrave Bashkia selenice dhe kanaleve shkoze-sevaster	33,600						-	33,600
49	12.10.2019	R.	Studim projektim :Rikostruksioni i ujesjellesit te linjes shperndarese Selenice,Kote,Armen	20,580				334,dt.12.05.2021	20,580	20,580	-

45	24.02.2020	C.G.	Studim projektim i ujesjellesit Peshkepi Kocul	98,400						-	98,400
55	19.05.2020	C.shpk	Riparim mirmbajtje kanale ne njesit administrative te Bashkise Selenice	1,149,100						-	1,149,100
56	15.12.2020	A.	Blerje paisje zyre	886,800				279dt.15.04.2021	886800	886,800	-
22	28.12.2020	S.shpk	Supervizim I rehabilitimit te kanalit vadites Dushkarak	72,000				829,dt.20.12.2021	72,000	72,000	-
5	30.11.2020	2.	Rehabilitimi pjesa e pare e rrjetit ujites te rezervuarit Harvala	19,722				527,dt.11.08.2021	19,722	19,722	-
22	26.12.2020	B.	Rikostruksion i rrjetit te ujesjellesit Selenice ,Kote,Armen	11,198,836		83,dt.19.02.2021,nr.167,dt.16.03.2021	10,000,000	846,dt.29.12.2021	1,198,836	11,198,836	-
303	27.11.2020	S.	Rikostruksion I rrjetit te ujesjellesit Selenice ,Kote,Armen	12,191,176		83,dt.19.02.2021,168, dt.16.03.2021	10,000,000	847,dt.29.12.2021	2,191,176	12,191,176	-
162	03.11.2020	M...shpk	Kolaudim ndertim Ura Treblove	2,640				536,dt.12.08.2021	2,640	2,640	-
22	18.12.2020	N... shpk	Supervizim ura Treblove	43,716						-	43,716
14	22.06.2021	K.	Rehabilitimi i kanalit Hasomat		5,687,494			774,dt.02.12.2021	2,000,000	2,000,000	3,687,494
56	28.07.2021	Sh. shpk	Rruge te brendshme me beton		9,317,248			768,dt.18.11.2021	6,000,000	6,000,000	3,317,248
31	03.08.2021	A. shpk	Asfaltim rruga kropisht		4,529,924			775,dt.02.12.2021	3,400,000	3,400,000	1,129,924
24	28.09.2021	B.	Rikostruksion i rrjetit te ujesjellesit Selenice ,Kote,Armen		4,375,254					-	4,375,254
27	26.12.2021	S.	Rikostruksion i rrjetit te ujesjellesit Selenice ,Kote,Armen		17,012,628					-	17,012,628
88	7.12.2021	D. shpk	Kolaudim rrjeti im ujesjellesit Kot,Armen,Selenice		285,331					-	285,331
34	29.12.2021	P.C.	Supervizimm i rikostruksionit te rrjetit te ujesjellesit Kot,Armen,Selenice		994,961					-	994,961
			Shuma totale	**58,338,107**	**42,202,840**		**28,344,039**		**31,162,772**	**59,506,811**	**41,034,136**

Burimi: Bashkia Selenicë

Aneksi nr. 2.2/2: Detyrimet e prapambetura nga vendimet gjyqësore më 31 Dhjetor 2021

Nr	Emërtimi	Nr.vendimit	Shkaku	Gjendja 31,12,2020	Shtesat	U.Shpenzimi	Likuidimet	U.Shpenzimi	Likuidimet	U.shpenzimi	Shuma	Likuiduar gjithsejt	Shuma 31.12.2021
1	S.	Nr.231 dt. 28.10.2015	Detyrim kontraktual	469,562		nr.96 dt.2.3.2021	100,000			671 13.10.2021	100,000	200,000	269,562
2	N. M.	Nr.1548,dt.15.03.2017	Detyrim kontraktual	10,000								-	10,000

3	H.M.	Nr.1371,dt.27.06.2007	Largim nga puna	6,000								-	6,000
4	A.R.	Nr.1321,dt.30.04.2012	Largim nga puna	-								-	-
5	E.T.	Nr.646,dt.24.06.2010	Largim nga puna	100,000		nr.248 dt.2.4.2021	100,000					100,000	-
6	G.S.	Nr.518,dt.21.02.2012	Largim nga puna	178,289		nr.99 dt.02.03.2021	100,000			669 13.10.2021	78,289	178,289	-
7	C. S.	Nr.592,dt.16.03.2011	Largim nga puna	228,000		nr.249 dt.2.4.2021	100000			672 13.10.2021	128,000	228,000	-
8	T. A.	Nr.3759,dt.09.05.2011	Detyrim kontraktual	1,006,804		nr.98 dt.02.03.2022	100,000			670 13.10.2021	100,000	200,000	806,804
9	V. A.	Nr.1687,dt.23.09.2015	Detyrim kontraktual	160								-	160
10	F. M.	Nr.1869,dt.23.06.2016	Largim nga puna	83,150								-	83,150
11	E. A.	Nr.1283,dt.26.04.2012	Largim nga puna	20,750		nr.97 dt..2.3.2021	20,750					20,750	-
12	R. L.	4024,date.09.03.2005	Largim nga puna	-								-	-
13	A.M.	Nr.516,date14.02.2017	Largim nga puna	48,580		nr.100 dt.2.3.2021	48,580					48,580	-
14	A...	Nr.795,dt.01.06.2017	Detyrim kontraktual	1,137,531				600 dt.7.9.2021	1,137,531			1,137,531	-
15	I.B.	Nr.4251,dt.17.10.2017	Largim nga puna	600	120,000					805 06.12.2021	120,000	120,000	600
16	H.A.	Nr.1410,dt.04.04.2018	Largim nga puna	28,000		nr.101 dt.2.3.2021	28,000					28,000	-
17	G.N.	Nr.527,dt.13.02.2018	Largim nga puna	-								-	-
18	A. H.	Nr.1545,dt.12.04.2018	Largim nga puna	538,000		nr.115 dt.02.03.2021	100,000			673 13.10.2021	100,000	200,000	338,000
19	M.L.	Nr.1540,dt.12.04.2018	Largim nga puna	278,000		246 dt.2.4.2021	100,000			674 13.10.2021	100,000	200,000	78,000
20	S. S.	Nr.3095,dt.13.09.2018	Largim nga puna	192,379		247 dt.2.4.2021	100,000			13.10.2021	92,379	192,379	-
21	P. A.	Nr.2006,dt.16.05.2018	Largim nga puna	422,595		nr.114 dt.02.03.2021	100,000	622 dt.23.09.2021	200,000			300,000	122,595
22	P. C.	Nr.3091,dt.13.09.2018	Largim nga puna	101,000		nr.106 dt.2.3.2021	50,000			676 13.10.2021	51,000	101,000	-
23	V. M.	Nr.4042,dt.13.11.2018	Largim nga puna	-								-	-
24	A...	Nr.1066,date.20.07.2017	Detyrim permbarimi	52,080								-	52,080
25	B. G.	Nr.634,dt.28.06.2018Apeli	Largim nga puna	69,750		nr.113 dt.02.03.2021	69,750					69,750	-
26	A. h.	Nr.211,dt.28.03.2019Apeli	Largim nga puna	619,768		nr.102 dt.2.3.2021	100,000			677 13.10.2021	100,000	200,000	419,768
27	D. M.	Nr.3921,date02.11.2018 Apeli	Largim nga puna	127,040		nr.112 dt.2.3.2022	27,040			678 13.10.2021	100,000	127,040	-
28	J. B.	Nr.1158,date18.04.2019 Apeli	Largim nga puna	255,464		nr.111 dt.2.3.2021	100,000			679 13.10.2021	55,464	155,464	100,000
29	A. M.	Nr.175,date12..03.2019	Largim nga puna	21,500								-	21,500
30	M.Rr.	Nr.2010,date27.06.2019	Largim nga puna	332,800		nr.116 dt.02.03.2021	100,000			680 13.10.2021	100,000	200,000	132,800

31	L. P.	Nr.Nr.495,date04.07.2019	Largim nga puna	550,000		nr.105 dt.2.3.2021	100,000			681 13.10.2021	100,000	200,000	350,000
32	J. B.	Nr.447,dt.20.06.2019	Largim nga puna	853,000		nr.108 dt.2.3.2021	100,000			13.10.2021	100,000	200,000	653,000
33	H.R.	Nr.640,dt.22.10.2019	Largim nga puna	820,000		nr.109 dt.2.3.2021	100,000			683 13.10.2021	100,000	200,000	620,000
34	Z.L.	Nr.680,dt.31.10.2019	Largim nga puna	310,700		nr.103 dt.2.3.2021	100,000			684 13.10.2021	100,000	200,000	110,700
35	J. K.		Largim nga puna	515,200		nr.104 dt.2.3.2022	100,000			13.10.2021	100,000	200,000	315,200
36	S. B.	Nr675,dt.31.10.2019	Largim nga puna	690,603		nr.105 dt.2.3.2022	100,000			13.10.2021	100,000	200,000	490,603
37	D. M.	Nr.8,dt.22.01.202	Permbaruese	182,372		nr.107 dt.2.3.2021	182,372					182,372	-
38	F. L.	Nr.73,dt.23.01.2020	Largim nga puna	1,197,120		nr.118 dt.02.03.2021	100,000	459 dt.08.07.2021	400,000	13.10.2021	100,000	600,000	597,120
39	Dh. Z.	Nr.14,dt,21.01.2020	Largim nga puna	791,600		nr.250 dt.2.4.2021	100,000			13.10.2021	100,000	200,000	591,600
40	F. shpk	03.07.2020	detyrim kontraktual	7,977,015		nr.117 dt.02.03.2021	573,508	601 dt.7.9.2021	1,557,337			2,130,845	5,846,170
41	E. M.			-	48,000							-	48,000
41	M. K.			-	1,168,107							-	1,168,107
42	N.V.			-	880,850							-	880,850
		Shuma		**20,215,412**	**2,216,957**		**3,000,000**		**3,294,868**		**2,025,132**	**8,320,000**	**14,112,369**

Burimi: Bashkia Selenicë

Aneksi nr. 2.2/3: Detyrimet e prapambetura për mallra dhe shërbime më 31 Dhjetor 2021

Fatura	Data	Subjekti	Lloji i detyrimit	Shuma	Shtesat	U.shpenzimi	Likuidimet	U.shpenzimi	Likuidimet	Likuidimet gjithsej	Mbetur 31.12.2021
97	26.11.2018	P. B.	Blerje balester kamioni	20,000						-	20,000
		O...		1,070,524						-	1,070,524
		E..	Blerje materiale	10,000						-	10,000
		L. V.	Blerje materiale	6,000						-	6,000
13	13.04.2011	E. Z.	Blerje materiale	54,500						-	54,500
42	18.04.2011	A. M.	Blerje materiale	31,500						-	31,500
4	20.12.2010	B. F.	Blerje materiale	30,000						-	30,000
5	15.02.2011	M.	Blerje materiale	10,000						-	10,000

28	13.04.2017	D. g.	Blerje vaj motori	5,129						-	5,129
152	13.04.2017	G. B..	Blerje filtra	17,006						-	17,006
		A. G.	Diference fature	600						-	600
			A...	326,003						-	326,003
			C.....	3,078,149						-	3,078,149
			Qarku Vlore 5%	446,000						-	446,000
			C...	2,946,280						-	2,946,280
			P...	376,339						-	376,339
			Sigurime	52,454						-	52,454
			Tatime	51,039						-	51,039
			Roje Pastrues 602(Arsimi)	838,000						-	838,000
			Mirmbajtje pastrim	2,066,800						-	2,066,800
			Keshilltret bordero	433,167						-	433,167
			Qarku Vlore 5%	493,000						-	493,000
			P....	94,350						-	94,350
			S.....	28,800						-	28,800
Nr.3	3.1.2019	F. shpk	Blerje gazoil	834						-	834
Nr.31	7.10.2019	T.	Media	69,000				757 dt18.11.2021	69,000	69,000	-
Nr.18	9.5.2019	T.	Media	64,000				757 dt18.11.2022	64,000	64,000	-
Nr.4	10.04.2019	T.	Media	70,000				757 dt18.11.2023	70,000	70,000	-
Nr.56	11.02.2019	T.	Media	59,000				757 dt18.11.2024	59,000	59,000	-
Nr.18	22.05.2019	V.	Media	20,000						-	20,000
Nr.275	12.11.2019	S.	Materiale ndertimi	2,557,880						-	2,557,880
		T.	Sigurime	300,000				nr.211 dt.24.11.2021	300,000	300,000	-
		T.	Sigurime	55,323				nr.119 dt.02.03.2021	255,323	255,323	-
		T.	Sigurime	277,376				184-187 dt.24.03.2021	30,568	30,568	246,808
		T.	Sigurime komuna sevaster	60,152				202-210 dt.24.03.2021	60,152	60,152	-
		T.	Sigurime komuna Vllahine	51,212				93-201 dt.24.03.2021	51,212	51,212	-
			Kryepleqte	291,125						-	291,125
65	24.10.2020	O.	Sherbim Media	20,000						-	20,000
756	14.12.2020	S.	Punime dyer e dritare	567,204		nr.251 dt.07.04.2021	567,204			567,204	-
9	05.12.2020	T.	Sherbim televiziv	50,000						-	50,000

400	31.12.2020	S.A.	Blerje karburanti	781,543				nr.72 dt.16.02.2021	781,543	781,543	-
		bordero	Keshilltaret	181,440				nr.73 dt.6.02.2021	181,440	181,440	-
		bordero	Kryepleqte	1,439,050				nr.74 dt.16.02.2021 nr.166, dt.11.03.2021	1,439,050	1,439,050	-
			Tatim I keshilltareve	163,175		nr.273 dt.15.04.2021	32,025	nr.34 dt.11.1.2020 nr. 73 dt.16.02.2021	131,150	163,175	-
			Tatimi I kryepleqeve	354,150		nr.273 dt.15.04.2021	253,950	nr.34 dt.11.1.2020	100,200	354,150	-
			Tatim G.Sh.	18,000				nr.34 dt.11.1.2020	18,000	18,000	-
			Tatim U. Dh.	6,000				nr.34 dt.11.1.2020	6,000	6,000	-
			Tatim	2,700				nr.34 dt.11.1.2020	2,700	2,700	-
		U. S.	Uje	240,000				nr.79 dt.16.02.2021	240,000	240,000	-
9E+07	31.12.2020	A.	Interneti	27,158				16.02.2021	27,158	27,158	-
6240	31.12.2020	N.	Interneti muaji dhjetor	6,000				nr.78 dt.16.02.2021	6,000	6,000	-
65	31.12.2020	P. sha	Sherbim postar	15,050				nr.76 dt.16.02.2021	15,050	15,050	-
12	31.12.2020	P. sha	Sherbim postar	1,910				nr.76 dt.16.02.2022	1,910	1,910	-
67	25.09.2020	C. shpk	Riparim kanale vaditese		1,321,366					-	1,321,366
54	09.12.2021	B...	Blerje boje printeri &fotokopje		480,000					-	480,000
194	17.12.2021	M. V.	Blerje material per covid		480,000					-	480,000
15	16.12.2021	K. H.	Qera zjarfiksja		55,000					-	55,000
		V. H.	Objkt me qera		10,200					-	10,200
		U. Dh.	Objekt me qera		8,500					-	8,500
		E. I.	Qera banes sociale		5,100					-	5,100
		V. H.	Qera banes sociale		5,100					-	5,100
		F. H.	Qera banes sociale		5,100					-	5,100
			Keshilltaret		181,440					-	181,440
			Kryepleqte		306,425					-	306,425
54	29.12.2021	U. k.	Kanalizime		360,000					-	360,000
210	31.12.2021	S. A.	Blerje karburanti		760,556					-	760,556

191	30.12.2021	A. L.	Blerje materiale elektrike		985,354					-	985,354
192	31.12.2021	A. L.	Blerje materiale elektrike		505,763					-	505,763
		O.	Energji elektrike		556,694					-	556,694
136	02.12.2021	T.	Sherbim media		170,000					-	170,000
24	22.12.2021	T.	Sherbim media		180,000					-	180,000
			Shuma	**20,434,922**	**6,376,598**		**853,179**		**3,909,456**	**4,762,635**	**22,048,885**

Burimi: Bashkia Selenicë

Aneksi nr.2.2/ 4: Pasqyra e likuidimeve të kontratave të investimeve për vitin 2021

Nr.	Institucioni financues	Objekti	Fondi (lekë me TVSH)/ Buxheti	Operatori ekonomik fitues	Vlera e Kontratës me TVSH	Data e lidhjes së Kontratës	Likuidimi me TVSH para vitit 2021	Likudimi faktik me TVSH viti 2021	Mbetur pa likuiduar nga vlera e kontratës 31.12.2021
1	Buxheti i Bashkisë	Rehabilitimi i kanalit Vaditës Dushkarak dhe pompa e Shkozës	39,766,244	I.G.	39,216,055	2504 Dt.26.09.2018	27,596,545	11,219,510	400,000
2	Buxheti i Bashkisë	Rehabilitimi i rrjetit ujites Pete dega Mavrove	18,521,654	Sh.	18,509,120	464 Dt.19.02.2019	7,964,985	10,544,135	0
3	Buxheti i Bashkisë	Sistemim asfaltim rruga Shkolla e Mesme Qender	39,067,740	B.	37,099,584	648 Dt.12.03.2019	21,500,000	10,000,000	5,599,584
4	Buxheti i Bashkisë	Blerje projktembrojtje nga erozioni	6,729,600	C.G.	6,657,000	1012 Dt.17.04.2019	4,000,000	2,657,000	0
5	Buxheti i Bashkisë	Riparim mirembajtje te kanaleve vaditese ne njesite administrative te Bashkise Selenicë	5,400,000	C.	5,071,778	1485 Dt.11.05.2020	2,600,000		2,471778
6	Buxheti Bashkisë	Rehabilitimi i rrjetit ujites (Kanale sekondare te fushes Shkoze ,Golimbas ,Sevaster)	13,409,250	I.G.	13,004,554	2901 Dt.30.09.2020	6,968,117	6,036,437	0
7	Buxheti Bashkisë	Riparim ujësjellësa	10,563,600	J.	9,857,318	3058 Dt.13.10.2020	4,324,572	5,532,677	69
8	Buxheti i Bashkisë	Blerje mat. Hidraulike	2, 400,000	A.	2,138,994	817/1 Dt.16.03.2021		2,138,994	0
9	Buxheti i Bashkisë	Rehabilitimi Ura Brataj	2,000,000	A.	1,968,720	818/1 Dt.16.03.2021		1,968,000	720
10	Buxheti Bashkisë	Sistemim asfaltim Lagjja Tubo Romes	10,789,505	J.	9,609,120	830 Dt.17.03.2021		9,606,173	2,947
11	Buxheti i Bashkisë	Rikostruksion rruge me beton Drashovicë,Peshkëpi, Brataj,Sevaster	14,400,416	A.	14,388,000	1031 Dt.06.04.2021		11,000,000	3,388,000
12	Buxheti i Bashkisë	Rehabilitimi i kanalit ujites Hasomat-Velca	9,000,000	K.	8,694,741	1212 Dt.21.04.2021		5,000,000	3,694,741

13	Buxheti i Bashkisë	Asfaltim rruga Kropisht	15,000,000	A. SHPK	14,529921	1246 Dt.27.04.2021		13,400,000	1,129,921
14	Buxheti i Bashkisë	Rehabilitimi i kanalit Mesaplik Lepenice, Drashovice	7,981,243	I.G.	7,779,120	1456 Dt.12.05.2021		3,067,920	4,711,200
15	Buxheti i Bashkisë	Riparim i shkarkuesit të rezervuarit Harvalas ,Zgjerimi i rrugës Resulaj-Rome dhe punime germimi riparimi në rrugën Bashaj	7,800,000	2.C.	7,644,438	1752 Dt.24.06.2021		7,644,437	1
16	Buxheti i Bashkisë	Blerje materiale Hidraulike	3,600,000	A.	3,596,520	2149 Dt.05.07.2021		3,596,520	0
17	Buxheti i Bashkisë	Furnizim vendosje pjesë këmbimi	3,600,000	A.	3,414,000	3122/1 Dt.21.10.2021			3,414,000
18	Buxheti i Bashkisë	Blerje material elektrike	3,600,000	A. L.	3,060,000	3487 Dt.02.12.2021			3,060,000
19	Buxheti i Shtetit	Rikostruksion i rrjetit shperndares te ujesjellesit Selenice,Kote,arme te bashkise Selenice	95,371,356	S.	93,938,769	1328 Dt.27.04.2020	28,975,200	29,000,000	35,963,569
20	Buxheti i Shtetit	Supervizim, Rikostruksion i rrjetit shperndares Selenice,Kote,Armen Bashkia Selenice	1,846,934	P.C.	1,775,406	1576 Dt.26.05.2020	380,445	400,000	994,961
21	Buxheti i Shtetit	Rehabilitimi i kanalit vadites te rezervuarit Harvala rikostriuksion i kanalit ne pjesa e i nga dalja e ujesjellesit te rezervuarit te harvala -1800 ml	21,539,317	2.C.	20,167,457	2782 Dt.22.09.2020	10,000,000	10,167,456	1
22	Buxheti i Shtetit	Permiresim i kushteve te banimit per komunitetin e pafavorizuar	18,915,012	J.	14,961,413	1423 Dt.10.05.2021		14,953,018	8,395
		Shuma totale			**337,082,028**		**114,309,864**	**157,937,277**	**64,839,887**

Burimi: Bashkia Selenicë

Aneksi nr. 2.2/5: Lista e subjekteve fizikë/juridikë debitorë për taksat dhe tarifat vendore më datë 31.12.2021

Nr.	Emërtimi	Debitorët Progresiv 31.12.2021
A	**BIZNESI VOGËL**	
1	K. N.	10,000
2	Z.K.	27,120
3	B. A.	25,460
4	L. M.	54,050
5	B. I.	76,800
6	S. A.	41,840
7	Sh. K.	6,000
8	F.B.	124,200
9	S. K.	29,000
10	R.B.	30,370
11	N. A.	29,090
12	A. B.	41,350
13	B.M.	7,000
14	E. S.	332,300
15	D. B.	13,200
16	B. H.	25,900
17	Gj. Gj.	83,500
18	R. B.	128,680
19	K. F.	91,040
20	D.I.	931,810
21	M. M.	157,910
22	G. H.	179,220
23	Dh. N.	20,600
24	N. R.	79,230
25	L. H.	20,920
26	L. H.	11,600
27	A. H.	56,760
28	A. C.	82,640
29	E. M.	56,540
30	B. L.	49,210
31	L. Xh.	128,435
32	B.O.	51,625
33	I. Z.	36,500
34	Sh. A.	147,170
35	P. J.	36,190
36	L. D.	22,860
37	S. G.	95,970
38	T. Gj.	88,260
39	F. F.	43,890
40	S. D.	44,070
41	Dh. Ç.	49,290
42	S. L.	24,250
43	R.B.	51,210
44	V. B.	39,370
45	A. R.	79,302
46	B. N.	32,230
47	Xh. H.	55,447
48	E. B.	30,780
49	F.M.	72,700
50	D.B.	43,670
51	Gj.M.	160,365
52	R. S.	27,150
53	F. S.	108,500
54	F.E.	1,620
55	S. L.	59,690
56	M. O.	13,430
57	S. Z.	43,420
58	E. Xh.	26,790
59	P. B.	23,830
60	F.H.	67,330
61	Xh. M.	104,500
62	A. D.	49,420
63	A.L.	5,100
64	R. H.	39,880
65	Sh. M.	34,490
66	H.h.	91,170
67	B.B.	15,930
68	A.I.	71,885
69	R. Ç.	90,000
70	M. R.	11,990
71	S.M.	34,590
72	L. M.	33,670
73	K. D.	7,620
74	D. A.	305,160
75	B. A.	40,420
76	S. B.	29,340
77	E. M.	33,390
78	Sh.M.	10,020
79	T.B.	59,820
80	M. d.	33,740
81	V. N.	87,757
82	Th.K.	20,000
83	A. R.	7,220
84	O. Xh.	16,240
85	A. A.	14,120
86	E.L.	4,600
87	D.K.	47,775
88	B.R.	14,060
89	Xh. A.	10,340
90	R. Ll.	6,900
91	L. Rr.	28,700
92	A. Gj.	25,520
93	E.Sh.	4,000
94	E.K.	50,950
95	R.H.	10,600
96	S. A.	11,700
97	B. K.	16,480
98	Dh.H.	8,430
99	Xh. Xh.	320
100	Xh.H.	17,700
101	E. M.	7,600
102	G. N.	-900
103	S.B.	8,400
104	P.R.	58,150
105	D.R.	38,600
106	A.S.	14,400
107	Sh.B.	110,790
108	L.C.	11,370
109	P. H.	74,050
110	A. H.	65,920
111	S.H.	104,390
112	Sh. I.	113,840
113	N. K.	293,790
114	Sh.K.	84,520
115	A.L.	140,870
116	Z. L.	129,440
117	E. L.	101,540
118	R.L.	56,712
119	K.L.	47,140
120	M.M.	21,970
121	A. M.	63,330
122	F. P.	120,770
123	F.P.	107,495
124	H.D.	104,690
125	V.H.	95,170
126	A. H.	65,800
127	E.M.	66,610
128	E.M.	50,280
129	L.M.	141,965
130	I. R.	153,190
131	P. R.	73,363
132	P. Sh.	18,120
133	J. A.	21,095
134	P. B.	130,120

135	A.A.	62,500
136	S.A.	86,427
137	Nj.B.	136,180
138	A. B.	123,845
139	A. B.	198,070
140	J.B.	29,770
141	Gj.B.	11,070
142	T. D.	150,740
143	S.D.	85,045
144	S.D.	156,054
145	R. F.	147,890
146	E.Gj.	11,745
147	A. Gj.	309,398
148	L. Gj.	80,500
149	H.Gj.	117,740
150	D. Gj.	36,400
151	A.H.	81,820
152	Xh. H.	35,980
153	Xh. H.	239,200
154	B.H.	73,880
155	K. j.	154,280
156	F. K.	305,061
157	J. m.	119,590
158	A. M.	94,300
159	D.P.	129,590
160	V. P.	172,485
161	E.P.	138,239
162	K. R.	120,860
163	Sh.Sh.	90,930
164	K.Xh.	167,680
165	A.Z.	156,855
166	Q. B.	20,730
167	Xh.b.	281,590
168	F.B.	80,270
169	B.C.	37,940
170	H.C.	106,795
171	H. C.	26,395
172	K.D.	216,470
173	B.F.	113,040
174	P. H.	45,190
175	D. h.	114,240
176	J.H.	102,710
177	J.H.	119,730
178	H.H.	151,220
179	B.I.	133,265
180	A. I.	108,425
181	K. K.	131,153
182	M. k.	62,235
183	Sh. K.	47,240
184	G.l.	346,679
185	E. L.	305,645
186	S.M.	151,480
187	F.M.	138,010
188	D. M.	111,170
189	Xh.M.	95,916
190	D.M.	175,165
191	D. M.	213,065
192	Ç.M.	135,140
193	A.M.	140,085
194	Sh. M.	248,896
195	B. M.	240,840
196	S.M.	178,279
197	N.M.	43,840
198	F.M.	44,240
199	Q. R.	112,000
200	Q.R.	76,300
201	A.Sh.	304,608
202	A. Sh.	131,220
203	v.Sh.	137,720
204	M. Sh.	201,830
205	M.Sh.	127,490

206	M.Sh.	65,864
207	L. Sh.	86,540
208	N.Z.	213,645
209	M.I.	34,120
210	V. Gj.	54,820
211	S.Z.	113,720
212	L. Gj.	73,240
213	M.K.	114,920
214	E.m.	2,376
215	V. B.	40,043
216	A.P.	54,350
217	B. C.	14,845
218	E. P.	42,521
219	Sh.H.	26,038
220	B. S.	15,700
221	D.B.	15,824
222	D. M.	15,513
223	M.M.	10,460
224	F.L.	17,073
225	E. L.	25,455
226	M. M.	3,375
227	A. S.	11,898
228	L. Ç.	71,408
229	K.M.	8,592
230	E.Sh.	39,120
231	T.A.	35,970
232	B. Xh.	61,820
233	A. Sh.	110,470
234	I.N.	19,983
235	B.T.	3,620
236	L.D.	21,370
237	B.A.	17,020
238	A. B.	37,070
239	A.B.	81,570
240	B. A.	6,600
241	A. B.	13,870
242	M. S.	11,670
243	V. Z.	19,980
244	A.F.	47,150
245	V.A.	38,590
246	Z.Z.	2,330
247	M. M.	7,370
248	P. B.	3,000
249	B. P.	7,370
250	A.A.	3,770
251	A.A.	4,850
252	Q.G.	32,410
253	A. H.	29,500
254	H. B.	7,250
255	A. H.	134,100
256	L. S.	88,500
257	G. T.	31,000
258	E. H.	132,600
259	E. M.	47,100
260	A.J.	191,640
261	I. S.	49,200
262	Y. S.	35,500
263	B.H.	88,625
264	F. H.	11,450
265	Y. G.	118,393
266	S. B.	131,800
267	V. S.	127,600
268	B. H.	53,700
269	T.H.	140,100
270	L.M.	27,000
271	J. B.	81,850
272	O. Shpk	184,000
273	A. H.	35,187
274	A. V.	30,582
275	A. B.	17,500
276	F. L.	70,440

277	A. H.	100,975
278	H. Xh.	94,000
279	E. M.	186,800
280	L. Xh.	146,000
281	F. Z.	99,975
282	L. Xh.	66,000
283	Q. Z.	108,000
284	K. S.	125,013
285	L.M.	146,113
286	A. A.	105,770
287	P. H.	240,875
288	B.M.	70,400
289	P. S.	27,175
290	P. Xh.	60,745
291	K. M.	83,850
292	M.V.	90,000
293	M. B.	112,375
294	G.R.	170,595
295	A.L.	131,500
296	S. C.	51,000
297	F.A.	9,770
298	F. S.	8,800
299	B.H.	197,000
300	Sh. H.	76,500
301	Sh.H.	38,500
302	B.H.	50,000
303	Dh. K.	50,000
304	Sh. H.	48,500
305	F. M.	53,000
306	T. D.	70,500
307	N. Xh.	58,800
308	Xh. E.	38,350
309	S.I.	72,000
310	R. Xh.	38,500
311	L. H.	52,400
312	R. H.	67,500
313	F. S.	12,850
314	V. V.	-150
315	V. G.	-150
316	R. Xh.	7,100
317	Xh. L.	4,900
318	A. P.	107,040
319	K. K.	117,988
320	S. S.	185,069
321	B.Z.	146,908
322	B. C.	155,555
323	M. N.	155,451
324	N. B.	152,503
325	S.S.	134,159
326	B. B.	208,264
327	A. I.	104,026
328	L.A.	224,134
329	H.M.	194,106
330	L.D.	207,579
331	D. H.	251,764
332	J. M.	336,597
333	Z.H.	137,920
334	S.K.	112,748
335	U. Dh.	111,213
336	O. B.	141,197
337	I.M.	150,636
338	D.H.	173,104
339	R.K.	97,100
340	M. H.	222,909
341	M.B.	110,465
342	G.Z.	254,185
343	Sh. B.	83,904
344	A. M.	148,956
345	M.Dh.	300,910
346	P.H.	64,522
347	S. B.	212,716

348	S. B.	151,990
349	R. L.	424,689
350	Dh.M.	155,071
351	A. S.	139,903
352	T.H.	113,724
353	V. H.	279,596
354	P. M.	281,682
355	A.H.	192,890
356	S.B.	129,462
357	S.P.	618,861
358	N.F.	584,208
359	K. H.	46,000
360	E.B.	59,090
361	E.S.	83,896
362	V.B.	96,568
363	E.B.	73,567
364	E.P.	52,703
365	S. Xh.	37,801
366	Th. M.	99,326
367	D. Z.	163,491
368	L.B.	226,408
369	Q. B.	60,363
370	A. B.	100,216
371	G. Sh.	170,568
372	L. Ç.	44,570
373	T.H.	43,305
374	A. S.	32,666
375	O. O.	37,056
376	P. M.	22,840
377	E.Q.	8,000
378	A.K.	8,000
379	H. Z.	21,000
380	E. A.	21,000
381	Sh.S.	10,935
382	G. C.	84,194
383	L.D.	14,700
384	M. B.	9,800
385	D.H.	35,925
386	A. I.	10,000
387	K.B.	14,666
388	M.M.	12,901
389	Gj. P.	131,286
390	F. Ll.	62,116
391	K.H.	13,325
392	L.F.	7,000
393	S. D.	21,000
394	Sh.M.	40,000
395	B.Ç.	17,500
396	K. K.	78,678
397	E. M.	11,170
398	Ll. B.	16,591
399	J. K.	13,566
400	N.S.	32,000
401	M. N.	30,540
402	G.B.	10,500
403	R.S.	27,000
404	A.H.	7,000
405	N. K.	10,500
406	M.Ç.	7,000
407	Xh.H.	27,000
408	A.M.	10,500
409	A.A.	5,250
410	N.A.	9,500
411	K. N.	7,000
412	V. D.	3,656
413	Q.M.	60,810
414	F. S.	6,400
415	M.H.	58,680
416	E. S.	97,815
417	E. S.	99,262
418	M. F.	143,820

419	F. M.	104,050
420	V. S.	117,952
421	R. Sh.	32,265
422	T. A.	132,710
423	L.S.	44,390
424	Ç. M.	46,890
425	Ç. A.	100,842
426	L.T.	24,827
427	R. S.	8,760
428	P. S.	14,100
429	M. b.	109,315
430	A. H.	130,249
431	N. K.	76,119
432	B. Z.	23,680
433	D. H.	132,297
434	B. J.	6,790
435	V.G.	30,437
436	B. A.	162,797
437	B. B.	86,260
438	V. K.	123,455
439	A. I.	13,700
440	Gj. K.	13,640
441	G.L.	235,272
442	S. B.	30,060
443	A. R.	85,790
444	H.Z.	173,717
445	V. V.	173,235
446	R. A.	125,557
447	F. L.	123,512
448	Y. L.	67,467
449	P. H.	73,767
450	A.H.	77,740
451	Q. L.	56,180
452	F. B.	41,240
453	D. D.	32,627
454	A. M.	78,710
455	D. Sh.	10,620
456	N. J.	44,487
457	K. M.	81,522
458	Ç.Sh.	57,292
459	V. M.	6,727
460	B. L.	6,610
461	N. B.	10,887
462	B.B.	2,870
	Totali A	**38,882,100**
B	**BIZNES I MADH**	
1	S. B. sha	2,990,661
2	M. B. shpk	3,804,702
3	A. shpk	3,372,000
4	M.V.	14,000
5	A. shpk	780,000
6	N. Shpk	1,820,000
7	M. shpk	740,000
8	A.. shpk	300,000
9	B. G. shpk	400,000
10	M. C. shpk	700,000
11	A. I. shpk	270,000
12	R. shpk	630,000
13	Ph.P. Shpk	1,900,000
14	D. Gj.	350,000
15	P. shpk	400,000
16	A.	10,000,000
17	A.	2,550,000
18	B.C.	2,470,000
19	Z. shpk	2,600,000
20	B.shpk	170,000
21	S. shpk	44,000
22	O. t.	450,000
23	A.	28,200
24	I.	28,200
25	A.	42,500
26	Sh.	42,500
27	A.shpk	33,500
28	B.	1,000,000
	Totali B	**37,930,263**
	Totali A+B	**76,812,363**

Aneksi nr.2.3/ 1: Aktivet Bashkia Selenicë

Nr.	Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur	Ushtrimi paraardhës
1	**A**	**AKTIVET**	**2,828,900,712**	**2,776,470,338**
2		**I. Aktivet Afat Shkurtra**	**416,143,590**	**393,456,662**
3		**1. Mjete monetare dhe ekujvalente të tyre**	**99,019,937**	**63,226,385**
4	531	Mjete monetare në Arkë		
5	512,56	Mjete monetare në Bankë		
6	520	Disponibilitete në Thesar	98,939,337	63,145,785
7	50	Letra me vlerë	80,600	80,600
8	532	Vlera të tjera		
9	54	Akrediditiva dhe paradhënie		
10	59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)		
11		**2. Gjendje inventari qarkullues**	**14,678,107**	**12,565,670**
12	31	Materiale	3,482,374	1,442,642
13	32	Inventar i imët	11,195,733	11,123,028
14	33	Prodhim në proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshë në rritje majmeri		
18	37	Gjendje të pa mbritura, ose pranë të tretëve		
19	38	Diferenca nga çmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarit (-)		
21		**3. Llogari të arkëtueshme**	**225,250,156**	**218,676,166**
22	411	Klientë e llogari të ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	70,005,368	70,005,368
24	431	Tatim e taksa		
25	432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqësi natyrore që mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime shoqërore		
28	436	Sigurime shëndetësore		
29	437,438	Organizma të tjerë shtetërore		
30	44	Institucione të tjera publike		
31	465	Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë		
32	468	Debitorë të ndryshëm	142,398,480	136,714,244
33	4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	12,846,308	11,956,554
34	45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike		
35	49	Shuma të parashikuara për shvlerësim		
36		**4. Të tjera aktive afatshkurtra**	**77,195,390**	**98,988,441**
37	409	Parapagime		
38	473	Lloogari e pritjes të marrëdhënieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime për tu shpërndarë në disa ushtrime		
41	486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	77,195,390	98,988,441
42		**II. Aktive Afat Gjata**	**2,412,757,122**	**2,383,013,676**
43	**20**	**1. Aktivet Afatgjata jo materiale**	**8,641,700**	**9,616,918**
44	201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave		
45	202	Studime dhe kërkime	8,641,700	9,616,918
46	203	Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme		
47	**21**	**2. Aktive Afatgjata materiale**	**2,401,047,502**	**2,373,396,758**
48	210	Toka, Troje, Terrene	140,249,952	140,249,952
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndërtesa e Konstruksione	322,467,917	323,232,273
51	213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,905,636,411	1,870,556,375
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	7,009,104	7,130,734
53	215	Mjete transporti	13,422,978	16,778,722
54	216	Rezerva Shtetërore		
55	217	Kafshë pune e prodhimi		
56	218	Invetar ekonomik	12,261,140	15,448,702
57	24	Aktive, afatgjata të dëmtuara		
58	28	Caktime të Aktiveve Afatgjata		
59	**25-26**	**3. Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**
60	25	Huadhënie e nënhuadhënie		
61	26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet		
62		**4. Investime**	**3,067,920**	**0**
63	230	Për Aktivet Afatgjata jo materiale		

64	231	Për Aktivet Afatgjata materiale	3,067,920	0

Burimi: Bashkia Selenicë

Aneksi nr.2.3/ 2: Detyrimet Bashkia Selenicë 31.12.2021

65	**B**	**PASIVET (DETYRIMET)**	**323,929,700**	**331,881,240**
66		**I. Pasivet Afat shkurtra**	**323,929,700**	**331,881,240**
67		**1. Llogari të pagueshme**	**111,445,252**	**125,081,028**
68	401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	5,911,523	6,158,973
69	42	Detyrime ndaj personelit	9,029,397	8,488,237
70	16,17,18	Huat Afat shkurtra		
71	460	Huadhënës		
72	431	Detyrimendaj shtetit për tatim taksa	671,783	541,274
73	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqërore	2,762,354	2,570,322
76	436	Sigurime Shëndetësore	382,774	356,721
77	437,438	Organizma tëtjerë shtetërore		
78	44	Institucione të tjera publike		
79	45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike		
80	464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letraveme vlerë		
81	466	Kreditorë për mjete në ruajtje	21,403,554	14,136,033
82	467	Kreditorë të ndryshëm	71,283,867	92,829,468
83	4341	Operacione me shtetin (detyrime)		
84	49	Shuma të parashikuara për shvlerësim (-)		
85		**2. Të tjera pasive afatshkurtra**	**212,484,448**	**206,800,212**
86	419	Kreditorë, Parapagime		
87	475	Të ardhura për tu regjistruar vitet pasardhëse	212,484,448	206,800,212
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Të ardhura për tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Të ardhura të arkëtuara para nxjerrjes së titullit		
91		**II. Pasivet Afat Gjata**	**0**	**0**
92	Klasë 4	Llogari të pagueshme		
93	16,17,18	Huatë Afat Gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasë 4	Të tjera		
96	**C**	**Aktivet NETO/FONDET (A-B)**	**2,504,971,012**	**2,444,589,098**
97	**D**	**FONDI I KONSOLIDUAR**	**2,504,971,012**	**2,444,589,098**
98	101	Teprica (Fondi i akumuluar) Deficiti i akumuluar	2,424,367,309	2,395,579,346
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	77,535,783	49,009,752
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta të investimeve		
	15	Shuma të parashikuara për rreziqe Zhvlerësimi		
103	105	Teprica e Granteve kapitale të brendshme	3,067,920	
104	106	Teprica e Granteve kapitale të huaje		
105	107	Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata		
107		Të tjera		
108	**E**	**TOTALI I PASIVE (B+C)**	**2,828,900,712**	**2,776,470,338**

Burimi: Bashkia Selenicë

Aneks nr.2.3/3: Paraqitja e aktive, Bashkia Selenicë

Nr.	Referencë llogarie	Emërtimi	Shtesa gjatë vitit ushtrimor, kosto historike						Pakësime gjatë vitit kosto historike				Gjendja mbyllje të ushtrimit
			Gjendje në fillim të vitit	Shtesa pa pagesë			Lëvizje brenda aktiveve	Gjithsej	Shitje	Nx. Jashtë përdorimit	Pakësime të tjera	Gjithsej	
				Blerje e krijuar me pagesë	Jashtë sistemit	Brenda sistemit							
A	B		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	**20**	**I. AAGJ/JO MATERIALE**	**17,892,280**	**4,513,579**	**0**	**0**	**0**	**4,513,579**	**0**	**0**	**2,677,580**	**2,677,580**	**19,728,279**
2	201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave	0					0					
3	202	Studime dhe kërkime	17,892,280	4,513,579				4,513,579			2,677,580	2,677,580	19,728,279
4	203	Koncesione, patenta, licenca e tjera ngashme	0					0					
5	**21-28**	**II. AAGJ/MATERIALE**	**3,146,281,019**	**149,443,619**	**0**	**0**	**0**	**149,443,619**	**0**	**571,594**	**886,800**	**1,458,394**	**3,294,266,244**
6	210	Toka, troje, terrene	140,307,952					0					140,307,952
7	211	Pyje, Kullota, Plantacione	0					0					
8	212	Ndërtime e Konstruksione	425,328,945	15,553,018				15,553,018					440,881,963
9	213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	2,470,742,788	132,746,985				132,746,985					2,603,489,773
10	214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	14,367,085	285,616				285,616		203,264	28,800	232,064	14,420,637
11	215	Mjete transporti	45,690,576					0					45,690,576
12	216	Rezerva shtetërore	0					0					
13	217	Kafshë pune e prodhimi	0					0					
14	218	Inventar ekonomik	49,843,673	858,000				858,000		368,330	858,000	1,226,330	49,475,343
15	24	Aktive të qendrueshme të trupëzuara të dëmtuara	0					0					
16	28	Caktime	0					0					
17		**TOTALI (I+II)**	**3,166,917,699**	**153,957,198**	**0**	**0**	**0**	**153,957,198**	**0**	**571,594**	**3,564,380**	**4,135,974**	**3,313,994,523**

Burimi: Bashkia Selenicë

Aneks nr.2.3/4: Paraqitja e aktive, Bashkia Selenicë

Nr.	Referencë llogarie	Emërtimi	Teprica Neto			Shtesa gjtaë vitit		Pakësime gjatë vitit		Teprica në fund		Gjithsej
			Kosto Historike	Amortizimi Akumuluar	Teprica Neto	Kosto historike	Amortizimi	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	
A	B		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	20	**I. AAGJ/JO MATERIALE**	**17,892,280**	**8,275,362**	**9,616,918**	**4,513,579**	**2,811,217**	**2,677,580**	**0**	**19,728,279**	**11,086,579**	**8,641,700**
2	201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave	0	0	0					0	0	
3	202	Studime dhe kërkime	17,892,280	8,275,362	9,616,918	4,513,579	2,811,218	2,677,580		19,728,279	11,086,579	8,641,700
4	203	Koncesione, patenta, licenca e tjera ngashme	0	0	0					0	0	0
5	**21-28**	**II. AAGJ/MATERIALE**	**3,146,281,019**	**772,884,264**	**2,373,396,758**	**149,443,619**	**120,906,075**	**1,458,394**	**571,594**	**3,294,266,244**	**893,218,742**	**2,401,047,502**
6	210	Toka, troje, terrene	140,307,952	58,000	140,249,952					140,307,952	58,000	140,249,952
7	211	Pyje, Kullota, Plantacione	0	0	0					0	0	0
8	212	Ndërtime e Konstruksione	425,328,945	102,096,672	323,232,273	15,553,018	16,317,374			440,881,963	118,414,046	322,467,917
9	213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	2,470,742,788	600,186,413	1,870,556,375	132,746,985	97,666,949			2,603,489,773	697,853,362	1,905,636,411
10	214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	14,367,085	7,236,351	7,130,734	285,616	378,446	232,064	203,264	14,420,637	7,411,533	7,009,104
11	215	Mjete transporti	45,690,576	28,911,854	16,778,722		3,335,744			45,690,576	32,267,598	13,422,978
12	216	Rezerva shtetërore	0	0	0					0	0	0
13	217	Kafshë pune e prodhimi	0	0	0					0	0	0
14	218	Inventar ekonomik	49,843,673	34,394,971	15,448,702	858,000	3,187,562	1,226,330	368,330	49,475,343	37,214,203	12,261,140
15	24	Aktive të qendrueshme të trupëzuara të dëmtuara	0	0	0					0	0	0
16	28	Caktime	0	0	0					0	0	0
17		**TOTALI (I+II)**	**3,166,917,699**	**783,694,560**	**2,383,013,676**	**153,957,198**	**123,717,292**	**4,135,974**	**571,594**	**3,313,994,523**	**904,305,321**	**2,409,689,202**

Burimi: Bashkia Selenicë

Aneksi 2.4/1: Blerjet e vogla

Për vitin 2021 janë realizuar 24 procedura prokurimi me vlera të vogla të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik të APP-së me fond limit 15,865,410 lekë pa TVSH dhe realizuar me vlerë kontrate në shumën 12,337,782 lekë pa TVSH si më poshtë:

Lekë

VITI 2021					
Nr.	**Objekt**	**Fondi limit**	**Vlera e kontratës**	**OE i shpallur fitues**	**Publikuar në APP**
1	Blerje materiale për mirëmbajtjen e shkollave	431,390	369,000	5...G.	12.08.2021
2	Blerje tumbino në bujqësinë	800,000	578,900	B. E.	21.04.2021
3	Dizifektues, alkol materiale Covid-19	800,000	400,000	M. V.	30.12.2021
4	Furnizim çakëll kave dhe hedhje në rrugë	800,000	424,000	K.	30.09.2021
5	Furnizim vendosje pjesë këmbimi	800,000	749,900	Sh. K.	25.02.2021
6	Goma e bateri për automjete	800,000	749,900	J.	25.03.2021
7	Hartim plane rivelimi për tokat bujqësore	800,000	780,000	M.	18.03.2021
8	Hidroizolime	800,000	630,000	N.	21.10.2021
9	Letër fotokopje	800,000	595,000	I. Gj. K.	06.02.2021
10	Lyerje shkolle	800,000	712,000	E.G.	30.04.2021
11	Materiale hidraolike	800,000	391,452	E. D.	15.04.2021
12	Materiale ndërtimi	800,000	729,000	G... C.	22.10.2021
13	Materiale pastrimi e detergjent	600,000	317,317	I. C.	08.02.2021
14	Mbikëqyrje, supervizim objekti: Rehabilitimi kanali Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë dhe shkarkuesit Harvalsa zgjerimi i rrugës Romes dhe rrugës Ramicë	70,000	63,636	I.	18.05.2021
15	Mbikëqyrje supervizim: Rikonstruksion shkolle Armen	765,703	621,244	M.	28.05.2021
16	Mbikëqyrje supervizim: rruge (Lagja tubo, ura Brataj, Kropisht, Kanali Hasomat dhe përmirësimi i banesave)	726,317	618,344	N. G.	18.03.2021
17	Ndërtim çezme dhe shtrim sheshi me pllaka guri	800,000	570,000	A.	02.09.2021
18	Organizim ceremoni të festave të zonës	400,000	379,990	T.	08.09.2021
19	Përmirësimi i ndriçimit të Bashkisë	800,000	730,000	G. C.	21.04.2021
20	Projekte	800,000	749,999	C. G.	06.10.2021
21	Shërbim interneti	72,000	60,000	N.	08.02.2021
22	Siguracione	400,000	400,000	I. J. SHA SHA	08.09.2021
23	Tonera për printera e fotokopje	800,000	400,000	B. T.	09.11.2021
24	Vegla pune	400,000	319,000	B. C.	09.06.2021
		15,865,410	**12,337,782**		

Me zgjedhje nga 24 procedura të realizuara me fond limit në shumën 15,865,410 lekë pa tvsh janë audituar 9 procedura me fond limit në shumën 6,400,000 lekë pa tvsh ose në masën 40.3% të vlerës totale të fondit limit konkretisht si më poshtë:

Lekë

VITI 2021					
Nr.	**Objekt**	**Fondi limit**	**Vlera e kontratës**	**OE i shpallur fitues**	**Publikuar në APP**
1	Dizifektues, alkol materiale Covid-19	800,000	400,000	M. V.	30.12.2021
2	Furnizim vendosje pjesë këmbimi	800,000	749,900	Sh. K.	25.02.2021

3	Goma e bateri për automjete	800,000	749,900	J.	25.03.2021
4	Hartim plane rivelimi për tokat bujqësore	800,000	780,000	M.	18.03.2021
5	Lyerje shkolle	800,000	712,000	E. G.	30.04.2021
6	Ndërtim çezme dhe shtrim sheshi me pllaka guri	800,000	570,000	A.	02.09.2021
7	Organizim ceremoni të festave të zonës	400,000	379,990	T.	08.09.2021
8	Projekte	800,000	749,999	C.G.	06.10.2021
9	Siguracione	400,000	400,000	I. J. SHA SHA	08.09.2021
		6,400,000	**5,491,789**		

Aneks nr.2.6/1: Lista e kontratave dhe të ardhurat nga tokat bujqësore të lira të dhëna me qira

Nr.	Emër Mbiemër	Kontrata	Afati	Sip. Ha	Aktiviteti	Vlera Vjetore	Të ardhurat në lekë
1	E. O.	Nr. 3712 Prot. datë 11.12.2020	99-vjet	11.2	Arrore	67,200	70,560=67,200+3,360 k/vonesë
2	Sh. Xh.	Nr. 3735 Prot. datë 11.12.2020	99-vjet	2	Arrore	12,000	14,280= 12,000+ 2,280 k/vonesë
3	L. Xh.	Nr. 3734 Prot. datë 11.12.2020	99-vjet	1.3	Arrore	11,600	9,282= 7,800 + 1,482 k/vonesë
4	I. B.	Nr. 3740 Prot. datë 11.12.2020	99-vjet	4	Arrore	24,000	30,000=24,000=6,000 k/vonesë
5	Xh. V.	Nr. 3737 Prot. datë 11.12.2020	99-vjet	1.08	Ullishte	6,480	6,480
6	S. M.	Nr. 3738 Prot. datë 11.12.2020	99-vjet	2.38	Ullishte	14,280	14,280
7	K. Sh.	Nr. 3732 Prot. datë 11.12.2020	99-vjet	2.7	Ullishte	16,200	19,116= 16,200 + 2,916 k/ vonesë
8	A. Sh.	Nr. 3733 Prot. datë 11.12.2020	99-vjet	1.2	Ullishte	7,200	8,496=7,200 + 1,296 k/vonesë
9	Z. K.	Nr. 3730 Prot. datë 11.12.2020	99-vjet	1.1	Arrore	6,600	6,600
10	A. K.	Nr. 3730 Prot. datë 11.12.2020	99-vjet	0.73	Ullishte	4,380	4,380
11	D. I.	Nr. 3731 Prot. datë 11.12.2020	99-vjet	1	Ullishte	6,000	6,000
12	M. M.	Nr. 3739 Prot. datë 11.12.2020	99-vjet	2	Ullishte	12,000	12,000
13	M. M.	Nr. 3739 Prot. datë 11.12.2020	99-vjet	2	Ullishte	12,000	12,000
14	I. S.	Nr. 3683 Prot. datë 07.12.2020	99-vjet	10	Arrore	60,000	60,000
15	A. H.	Nr. 3742 Prot. datë 11.12.2020	99-vjet	1.69	Ullishte	10,140	11,800=6,480+5,320 k/ vonesë
16	S. Rr.	Nr. 3670 Prot. datë 07.12.2020	99-vjet	0.62	Ullishte	3,720	3,720
17	E. M.	Nr. 3741 Prot. datë 11.12.2020	99-vjet	1.6	Ullishte	9,600	13,536 = 9,600+3,936 k/ vonesë
18	U. K.	Nr. 131 Prot. datë 15.01.2021	99-vjet	1.15	Ullishte	6,900	6,900
	Shuma			**47.75**		**286,500**	**534,727**

Burimi: Bashkia Selenicë, përpunoi grupi i auditimit

Aneks nr.2.6/2: Lista e kontratave dhe të ardhurat nga sipërfaqet e dhëna me qira pjesë e fondit pyjor kullosor

Nr.	Subjekti	Kontrata	Afati	Aktiviteti	Sip. në përdorim Ha	Sip. Sipas Lejes Mjedisore Ha	Sip. rrugë	Sip. Linjë tensioni	Paguar (Vl.Kontr.+Kamata)	Debitor
1	Y. S. SHPK	564	19.02.2021-18.02.2031	Dhënie në përdorim të fondit Pyjor/Kullosor për ndërtim rruge dhe linjë tensionin1.2 km		19.8	9.8	1.2	372,000	
2	E. K. SHPK	1585	24.05.2021-23.05.2022	Dhënie në përdorim të fondit Pyjor, Shesh Pushimi për vendosjen e makinerive gjatë ndërtimit të rrugës Peshkëpi -Selenicë	1.0685				192,330	

3	S. M. SHPK	2074	29.06.2021-28.06.2031	Dhënie në përdorim të fondit Pyjor / kullosor Publik për ndërtim rruge lidhëse "Shfrytëzim i mineralit gëlqeror i mermerizuar		132.9	1		70,000	
4	M. P. SHPK	2009	25.06.2021-24.06.2031	Dhënie në përdorim të fondit Pyjor/Kullosor Publik për ndërtim rruge dhe linjë tensionin 1km zona minerare 70/8	99.7	55.55	1		120,000	
5	M. SHPK	1656	29.06.2018-21.06.2028	Dhënie në përdorim të fondit Pyjor Publik për Përpunim dhe amballazhim i ujit të pijshëm.	0.6505			0.57	54,581	
6	M. SHPK	58/1	22.06.2018-21.06.2028	Dhënie në përdorim të fondit Pyjor Publik për Përpunim dhe amballazhim i ujit të pijshëm.	0.25				70,081	
7	R. SHPK	1144	06.05.2019-05.05.2029	Dhënie në përdorim të fondit Pyjor / kullosor Publik për shesh depozitimi të matërialit minerar zhavorr bituminoz dhe ndërtim të përkohshëm.	0.85				95,000	
8	B. A. SHPK	1112	30.04.2019-29.04.2029	Dhënie në përdorim të fondit Pyjor/Kullosor për ndërtim rruge lidhëse.		248	98	3		115,500
9	A. SHPK	2740	10.0.2021-09.09.2022	Kontratë Qiraje për bimë medicinale					176,400	
10	B. V. SHPK	2541	01.10.2020-30.09.2030	Dhënie në përdorim të sipërfaqes së pafrytshme prej 4376 m2 për përpunim inertesh.	0.4376				20,675	
11	A. SHPK	1437	02.08.2016-01.08.2026	Shfrytëzim i materialit gëlqeror dekorativ		14.064	1.5		75,000	
12	B. P.	3534	24.11.2020-23.11.2030	Qira përdorimi (shesh depozitimi)	1.4				140,000	
13	B. G.	3798	28.12.2021-27.12.2031	Shesh depozitimi të përkohshëm	0.2				50,000	
									1,436,067	**115,500**

Burimi: Bashkia Selenicë, përpunoi grupi i auditimit

Aneksi nr. 2.6/3: Subjektet HEC-Miniera-Gurore që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Selenicë dhe ngarkohen me taksa dhe tarifa vendore

Nr.	Emri i subjektit	Aktiviteti	T.Pastrimi	T.Ndërtese	T.Gjelbërimi	T.Trualli	T.ndik.mj.rend	T.mbr/përm/mjedisi	Debitorë 2021	Debi e mbartur	Debi Totale
1	A. G. E.	HEC	500,000		100,000	23,976		2,000,000	0		
2	A. SHA	Hidrok.	2,000,000		2,000,000	2,769,144	2,000,000	23,600,000	10,000,000		10,000,000
3	P. P. SHPK	Hidrok.								1,900,000	1,900,000
4	M. B.	Miniera	500,000		150,000		500,000	1,720,000	0	3,804,702	3,804,702
5	S. b. SHA	Miniera	200,000	516,750	150,000		200,000	900,000	0	2,990,661	2,990,661
6	A. I. SHPK	Qym/Bitum	250,000		150,000		300,000	600,000	300,000	2,250,000	2,550,000

7	B.C. SHPK	Qym/Bitum	250,000		150,000		400,000	920,000	1,470,000	1,000,000	2,470,000
8	N. SHPK	Gurore	100,000		100,000		200,000	600,000	500,000	1,320,000	1,820,000
9	B. A.	Inerte	100,000		100,000		200,000	800,000	1,000,000		1,000,000
10	M. SHPK	Inerte							0	740,000	740,000
11	A. SHPK	Gur gëlqeror	100,000		100,000		200,000	600,000	0	300,000	300,000
12	S. M. SHPK	Gur gëlqeror	100,000		100,000		200,000	200,000	0		
13	M. P.	Gur gëlqeror	100,000		100,000		300,000	500,000	0		
14	A. I. SHPK	Inerte	100,000		50,000		100,000	20,000	270,000		270,000
15	Z. shpk	Qym/Sel	250,000		150,000		400,000	1,000,000	1,550,000	1,050,000	2,600,000
16	B. P.	Qym/Sel	250,000		150,000		400,000	1,200,000	0		
17	B. V.	Kote	100,000		50,000		100,000	20,000	0		
18	Y. S.	Gurore	100,000		100,000		200,000	200,000	0		
19	T. E.	Gurore									
20	A.I. SHPK	Inerte								3,372,000	3,372,000
21	B. SHPK									170,000	170,000
22	A. SHPK									780,000	780,000
23	B. G. SHPK									400,000	400,000
24	M. C.									700,000	700,000
25	R. shpk									630,000	630,000
			5,000,000	**516,750**	**3,700,000**	**2,793,120**	**5,700,000**	**34,880,000**	**15,090,000**	**21,407,363**	**36,497,363**

Burimi: Bashkia Selenicë

Aneksi nr. 2.6/4: Lista e subjekteve që kanë leje aktive për përdorim të fondit pyjor për aktivitete ekonomike në Bashkinë Selenicë

	Leje	**Datë**	**Subjekti**	**Sip. e hequr nga fondi Ha**	**Emërtimi i Vb**	**Karierë ha**	**Qira Vjetore Llogaritur nga grupi i auditimit**	**Kontrata që ka me Bashkinë Selenicë**
1	355/1	14.10.2016	S. B.	154.30	Selenicë	0.10	12,071,600	
2	390/1	22.01.1998	"R." Shpk	9.90	Vidhat e Haxhiut		613,600	0.85 ha shesh depozitimi
3	552/1	08.11.2011	"S." Shpk	2.50	Kava e Azines		155,000	
4	594/1	25.01.2012	"N." Shpk	14	Drashovicë.		981,400	
5	641	16.08.2001	"A." Shpk	142	Treblovë		8,804,000	
6	1115	12.12.2007	"T. I." Shpk	109	Resulaj		6,758,000	
7	1371	22.09.2009	"M. B." Shpk	32.40	Kume Murriz	0.43	2,171,000	

8	1496/2	10.07.2013	"B. M. I." Shpk	163.80	Treblovë, Romës		10,155,600	
9	1496/3	20.11.2013	"B. M. I." Shpk	117.10	Treblovë, Romës		7,260,200	
10	1578	07.09.2012	"B. M. I." Shpk	13.70	Zona e II Resulaj		849,400	
11	1644	02.07.2013	"A .I." Shpk	36	Selenicë	0.35	2,914,260	
12	1753	15.05.2015	"B.. C." Shpk	32.20	Selenicë	0.23	2,594,860	
13	1754	21.05.2015	B. G.	25.10	Selenicë		1,556,200	0.2 ha shesh depozitimi
14	1789	14.01.2016	"Y. S." Shpk	19.80	Lepenicë	0.10	1,767,824	9.8 km rrugë 1.2 linjë tensioni
15	1792	10.03.2016	"A." Shpk	14	Lepenicë	0.30	1,200,600	1.5 km rrugë
16	1826	12.12.2016	"M. P."	99.70	Lepenicë	0.25	5,309,148	1 km rrugë
17	1844	13.09.2017	"T. E." Shpk	12.70	Gumenicë	0.20	993,720	
18	1845	13.09.2017	"T. E." Shpk	100	Gjorm		3,520,000	
19	563	16.07.2018	"S. M."	132.90	Brataj	0.10	10,402,400	1 km rrugë
				1,231.1 ha			**80,078,812**	

Burimi: Të dhënat mbi subjektet dhe sipërfaqet janë marrë nga AKBN dhe Bashkia Selenicë, llogaritja e vlerës së qirave është bërë nga grupi i auditimit.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT